Uzimajući u obzir do sada izložena zapažanja, ono što sledi jeste pokušaj sumiranja glavnih argumenata iz prethodnih poglavlja. Prva stvar koju treba imati na umu prilikom razmatranja mogućnosti primene ustavnog patriotizma u podeljenim društvima poput kosovskog jeste (ne) postojanje referentne tačke zajedničkog života iz koje bi vremenom mogla da nikne politička kultura. Podsećam da je bitan preduslov ostvarivosti ustavnog patriotizma to da svaki građanin bude socijalizovan u zajedničku političku kulturu. Da bi to bilo moguće, kako ispravno primećuje Miler (Muller 2010, str. 70-72), neophodno je da postoje “posebni privesci” kojima će se ideja ustavnosti usidriti u datoj političkoj zajednici. Ukratko, potrebno je pronaći minimalnu zajedničku instancu vrednovanja naših odnosa, koja će očekivana i razumna neslaganja o najboljoj mogućoj primeni ideje ustavnosti držati na okupu čak i onda kada se naše predstave o tome kako treba da izgledaju pojedine odredbe ustavnog ugovora dijametralno razlikuju. Već je naglašeno da se ovaj zahtev specifičnosti, u nekim slučajevima, može ostvariti i inicijalnim pozivanjem na vrednost nacionalne kulture (naravno, ukoliko ona nije predmet velikih sporenja), bez opasnosti da se ugrozi sama supstanca ustavnog patriotizma. Međutim, tamo gde nacionalni identitet ne postoji ili je duboko kompromitovan, treba krenuti alternativnim putevima u potrazi za odgovorom na pitanje o identitetu zajednice – šta je to što nam je zajedničko? Tačno je da sam ustav vremenom može postati odgovor na postavljeno pitanje. U tom smislu slažem se sa svima onima koji tvrde da ustavni patriotizam ima kapacitete da generiše građansko poverenje i solidarnost iz sopstvenih normativnih izvora, ali takođe smatram da je tako nešto moguće tek onda kada su na samom početku bile prisutne dovoljno jake predustavne sponse.

---

<sup>7</sup> Miletski model uređenja većinsko-manjinskih odnosa ima dugu tradiciju na ovim prostorima. U sistemu mileta koji je postojao u Otomanskom carstvu pojedine verske grupe uživale su visok stepen autonomije u sprovođenju svojih religijskih običaja i praksi, naravno unutar granica sopstvene religijske zajednice. Opseg prava i dužnosti svakog pojedinca zavisio je prevashodno od toga kom miletu pripada. Mileti su funkcionisali kao svojevrstne oaze kulturne autonomije bez puno međusobnih kontakata i prožimanja. Stiče se utisak da su mnogi aktuelni problemi u primeni politika multikulturalnosti na balkanskom prostoru posledica činjenice da se etnokulturna prava i danas često razumeju kao sredstvo samogetoizacije etničkih grupa.

Jedan od načina da se obezbedi neophodna doza partikularnosti, a da se pritom izbegnu nedostaci etno-kulturne integracije, jeste da se društvena kohezija gradi pozivanjem na sećanje prema odbačenoj prošlosti. Ideja je da čak i negativna prošlost može predstavljati izvor društvenog i političkog jedinstva. Nešto slično odigravalo se u posleratnoj Nemačkoj u kojoj je suočavanje sa masovnim zločinima iz Drugog svetskog rata za svoj najvredniji rezultat imalo pronalaženje moralnih orijentira za osmišljavanje zajedničkog života u budućnosti. Za razliku od Nemačke u kojoj su svi Nemci bili zatočenici iste (negativne) prošlosti, te nije mogla postojati dilema “da li je Holokaust zaista naš”, na Kosovu se istorija tumači potpuno različito, u zavisnosti od toga kojoj etničkoj zajednici pripadate, pri čemu se “mračni trenuci” po pravilu pripisuju drugoj strani.<sup>8</sup> Otuda se, bar kada se radi o kosovskom slučaju, pokazuje kao utemeljena Kimlikina tvrdnja da bi “u onim multinacionalnim državama u kojima je prošlost izvor mržnje i podela, a ne izvor zajedničkog ponosa (ili srama – dodao NB), izgradnja osećaja zajedničkog identiteta verovatno zahtevala njeno zaboravljanje, pre nego prisećanje.” (Kymlicka 2003, str. 272)

Poteškoće se javljaju i onda kada se u pomoć prizove drugi potencijalni kandidat za posao “opremanja” teorije ustavnog patriotizma partikularnim sadržajem – koncept “borbene demokratije”. Argument, krajnje sažeto, glasi da bi suprotstavljanje antidemokratskim akterima u sadašnjosti moglo dovesti do jačanja političke lojalnosti i identifikacije kod građana koji na taj način čuvaju ustavna dostignuća svoje domovine. (Sternberger 2004, str. 131-132) Međutim, da bi se tako nešto i desilo u pluralnoj zajednici, neophodan je određeni nivo proživljenog iskustva međuetničkih odnosa, baš kao i socijalno poverenje koje se s pravom smatra glavnim sastojkom jedinstva u podeljenim društvima. (Weinstock 1999, p. 26) Drugačije rečeno, ustavnom patriotizmu najpre su potrebni saveznici da bi se uopšte moglo govoriti o suparničkom odnosu prema “neprijateljima demokratije”. Nažalost, kosovsko društvo se danas ne može pohvaliti ni jednim od navedenih kvaliteta.

Da li se posle svega može reći da su u pravu oni autori koji ustavni patriotizam opisuju kao plemenitu, ali “beskrvnu” ideju? Iako se možda mogao steći utisak da pojedini delovi teksta sugerišu pozitivan odgovor, duboko verujem da ustavni patriotizam i te kako ima šta da kaže na probleme složenih političkih zajednica. Takođe smatram da mnoge kritike ustavnog patriotizma zapravo barataju sa iskrivljenom slikom njegovih temeljnih postavki. Čini se da stanje savremenih debata o normativnoj vrednosti ustavnog patriotizma pre obeležava postojanje nesporazuma nego ozbiljnih teorijskih neslaganja. Manji deo nesporazuma proističe iz pogrešnog razumevanja njegove unutrašnje logike, dok mnogo značajniji izvor “razmimoilaženja” leži u prevelikim očekivanjima koja mu se pripisuju. S tim u vezi, sledi još jedna važna zaključna napomena. Radi se o tome da ustavni patriotizam, poput drugih teorijskih koncepata koji pretenduju da budu primenjeni u stvarnosti, u svojim praktičnim izvedbama uvek predstavlja kombinaciju njegovih bazičnih principa i kontekstualno specifičnih kvaliteta društva u kome se režim ustavnog patriotizma uspostavlja. Tek nakon što se ove dve dimenzije susretnu moguće je govoriti o praktičnim implikacijama ustavnog patriotizma. Bez obzira na (ne)uspešnost krajnjeg rezultata, to još uvek nije dovoljan dokaz za odbacivanje same teorije (njena validnost se proverava na drugi način), niti je razlog za tvrdnju da ona ne može biti adekvatnije primenjena u nekom drugom društvenom kontekstu ili u istom

---

8 Janoš Kiš (Janos Kis) je ovaj argument formulisao na sledeći način: “Oni narodi koji za istoriju kažu da je naša sopstvena jesu pripadnici iste političke zajednice, pod uslovom da jedni druge prihvataju kao nas.” (Kis 1995, p. 237)

društvenom kontekstu nakon što se ispune određene pretpostavke. Upravo se u poslednjoj rečenici krije osnovna poruka ovog teksta. Nije mi bila namera da u potpunosti odbacim mogućnost primene ustavnog patriotizma na Kosovu, već da ukažem na posao koji je prethodno potrebno obaviti. Bilo bi preambiciozno zahtevati od ustavnog patriotizma da ovde i sada odagna teško breme kontinuiranih međuetničkih sukoba i tenzija na Kosovu, baš kao što je nerealno i očekivanje da ustavni patriotizam može gotovo ni iz čega da proizvede spone građanske privrženosti.

## Literatura

Dimitrijević, N 2010, "Vrednosti za obezvređeno društvo: ustavna moralnost posle kolektivnog zločina" u *Država i demokratija* ur. M. Podunavac, Službeni glasnik i Fakultet političkih nauka, Beograd, str. 185-207.

Dimitrijević, N 2007, *Ustavna demokratija shvaćena kontekstualno*, Fabrika knjiga, Beograd.

Elster, J 1989, *The Cement of Society. A Study of Social Order*, Cambridge University Press, Cambridge.

Habermas, J 2003, "Borbe za priznanje u demokratskoj pravnoj državi" u *Multikulturalizam: Ispitivanje politike priznanja* ur. E. Gatman, Centar za multikulturalnost, Novi Sad, 2003, str. 93-122.

Kis, J 1995, "Beyond the Nation State", *Social Research*, vol. 63, no.1, pp 191-245.

Krasnići, G 2012, "Preklapanje nadležnosti, sporna teritorija, nerešen status države: Komplikovan slučaj državljanstva na Kosovu" u *Državljeni i državljanstvo posle Jugoslavije* ur. Dž. Šo & I. Štiks, Klio, Beograd, str. 119-143.

Kymlicka, W 1996, "Social Unity in a Liberal State", *Social Philosophy & Policy*, vol. 13, no. 1

Kymlicka, W 2003, *Multikulturalno građanstvo: liberalna teorija manjinskih prava*, Naklada Jesenski i Turk, Zagreb.

Muller, J 2010, *Ustavni patriotizam*, Fabrika knjiga, Beograd.

Podunavac, M 2006, *Poredak, konstitucionalizam, demokratija, Čigoja štampa*, Beograd.

Research Institute of Development and European Affairs and the Centre for International Studies- Oxford University 2012, *Research Report: Consolidating Kosovo's Statehood: Processes, Problems and Perspectives*, Available from: [http://ridea-ks.org/Articles/1/94/Docs/366Agenda\\_of\\_the\\_conference\\_organized\\_by.RIDEA-CIS.OXFORD.pdf](http://ridea-ks.org/Articles/1/94/Docs/366Agenda_of_the_conference_organized_by.RIDEA-CIS.OXFORD.pdf)

Sternberger, D 2004, "Ustavni patriotizam" u *Patriotizam* ur. I. Primorac, Kruzak, Zagreb, str. 123-133.

Tansey, O 2007, "Democratization without a State: Democratic Regime-building in Kosovo", *Democratization*, vol. 14, no. 1, pp 129-150.

Weinstock, D 1999, "Building Trust in Divided Societies", *Journal of Political Philosophy*, vol. 7, no. 3, pp. 1-26.



# **Perspektivat e shoqërisë multietnike në Kosovë**







## Bashkëpunimi për motivim dhe përkushtim

Marrëdhëniet mes Beogradit dhe Prishtinës, të përkeqësuar seriozisht në fund të viteve 1980, janë duke u rindërtuar mjaft ngadalë dhe me pengesa të shumta. Ky proces bashkëpunimi u fillua nga artistë, intelektualë të pavarur dhe aktivistë të të drejtave të njeriut. Ata që rrallë janë të ngarkuar me interesa të politikës ditore dhe të cilët nuk hezitojnë të flasin hapur për problemet e shoqërisë në të cilën jetojnë. Në sajë të tyre, komunikimi ndërmjet qarqeve të caktuara serbe dhe shqiptare në fakt nuk ka ndaluar.

Misioni i zvogëlimit të distancës midis shoqërisë shqiptare dhe serbe përfshin disa media, gazetarë mendje hapur raportimi i të cilëve kundërshton diskurset që më tepër pasqyrojnë nevojat e qeverive sesa realitetin ashtu siç është. Pas përfundimit të konflikteve, në fillim në një numër shumë modest, disa të rinj gjithashtu filluan udhëtimin e tyre drejt Beogradit dhe Prishtinës, duke shkuar në “anën tjetër” me dëshirën për të shembur muret e ngritura në rrethinat e tyre duke u njohur me njerëz të gjeneratës së njëjtë.

Sot, komunikimi në mes të Kosovës dhe Serbisë është i pa penguar në disa qarqe, pavarësisht bindjes ende dominuese se diçka e tillë është jo vetëm e panevojshme, por edhe e pamundur. Megjithatë, lidhjet e krijuara deri tani janë të dobëta sepse ndikimi i tyre në publik më të gjerë është ende i pamjaftueshëm. Shembujt e bashkëpunimit potencoohen ende si lajme dhe përmenden si përjashtime.

Një shembull i tillë është publikimi “Perspektivat e shoqërisë multietnike në Kosovë”, që është një hap pionier në krijimin e një bashkëpunimi akademik në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Është rezultat i punës së dhjetë bashkëpunëtorëve të Fakultetit të Shkencave Politike të Universitetit të Beogradit dhe të Departamentit të Shkencave Politike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Kjo doli nga nevoja e cila u shfaq spontanisht për t’u marrë në mënyrë akademike me disa çështje që lidhen me funksionimin e sistemit politik të Kosovës. Meritat më të mëdha për këtë projekt i ka Stefan Surlić, studiues i Qendrës për Studime Ndërdisciplinore të Ballkanit në Fakultetin e Shkencave Politike. Me iniciativën e tij, një grup prej bashkëpunëtorëve të rinj të Fakultetit të Beogradit u mblodhën, me qëllim të hulumtimit të jetës politike dhe shoqërore në Kosovë. Si pjesëmarrës në këtë projekt, ata udhëtuan për herë të parë në Kosovë, u takuan me kolegët e tyre nga Prishtina dhe u përfshinë aktivisht në kryerjen e një hulumtimi shkencor.

Negociatat e Brukselit midis përfaqësuesve të institucioneve të Beogradit dhe Prishtinës tregojnë se ka pasur disa sfera të jetës, normalizimi i të cilave ka kërkuar një marrëveshje ndër-qeveritare.

Megjithatë, pyetja esenciale mbetet ajo se çfarë ndikimi kanë takimet e dy kryeministrave dhe ekipeve të tyre në normalizimin e marrëdhënieve midis “njerëzve të zakonshëm”. Gjetjet në hulumtimet e kryeradëshmojnë për një distancë jashtëzakonisht të thellë etnike midis serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. Ato janë shkatërruese, por mund të përdoren gjithashtu si një motivim për një punë edhe më intensive dhe të vazhdueshme në uljen e paragjykimeve ekzistuese midis dy kombeve.

Dhjetë autorët e teksteve para nesh bënë hapat e parë, por na bënë edhe të mendojmë se si të kontribuojmë në intensifikimin e komunikimit midis universiteteve në Serbi dhe në Kosovë dhe rreth mënyrave të tjera të bashkëpunimit institucional gjithashtu. Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut konsideron se rrethanat aktuale socio-politike ofrojnë mundësinë për të rritur dhe pasuruar listën e mënyrave formale të bashkëpunimit në krahasim me iniciativat e realizuara në nivele jozyrtare.

Krijimi i hapave të parë të bashkëpunimit midis komuniteteve akademike të Kosovës dhe Serbisë u ndihmua nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Serbi. Ne me padurim presim që projekte të tilla dhe të ngjashme të realizohen nga fondet e buxhetit të shtetit ose nga buxhetet e fakulteteve përkatëse. Kjo do të vë bashkëpunimin akademik në mes të Beogradit dhe Prishtinës në kuadër të aktiviteteve të rregullta akademike, pa atribute të ekskluzivitetit.

Pavarësisht negociatave me dekanët e fakulteteve të shkencave politike në Beograd dhe Prishtinë, që zgjatën më shumë se një vit, ky botim nuk mban logon e ndonjërit fakultet. Asnjëra palë nuk kishte kurajo politike për tu dalë në krah punëtorëve të rinj akademike dhe të njohin nevojën e tyre për krijimin e kanaleve zyrtare të komunikimit me kolegët në rajon. Megjithatë, ky grup i të rinjve nuk e sheh këtë si një dështim, por një nxitje për të vazhduar bashkëpunimin derisa përpjekjet e tyre të njihen edhe nga akademia.

Për Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut

Jasmina Lazović, Koordinatore e projektit

Lidhur me Librin

## Perspektivat e shoqërisë multietnike në Kosovë

Ju jeni në fillim të një libri të pazakontë. Nuk është i pazakontë për shkak të temës së tij, pasi që mundësitë për ekzistencën e një shoqërie të vërtetë shumë etnike në Kosovë janë shkruar dhe debatuar për një kohë të gjatë, dhe veçanërisht pas valës së fundit të konflikteve të mëdha etnike në vitet 1990-ta. As nuk është ky libri i parë me tekstet e botuara në gjuhët serbe, shqipe dhe angleze; shumë autorë të gatshtëm për të arritur audiencë më të gjerë të mundshme e bëjnë këtë, dhe autorët e këtij libri, siç do ta shihni edhe ju vetë, meritojnë shumë lexues.

Ky libër është i ndryshëm nga ato të ngjashmet në të paktën tri mënyra: për herë të parë mbledhi hulumtime nga Universitetet e Beogradit dhe Prishtinës, autorët e tij janë akademikë të rinj dhe të gjitha tekstet janë ekskluzivisht akademike, edhe pse kanë të bëjnë me çështje jashtëzakonisht të ndjeshme në aspektin e politikës. Bashkëpunëtorët e rinj të Departamenteve të Shkencave Politike nga Beogradi dhe Prishtina arritën, më mirë se shumë nga kolegët e tyre të lartë, të mbështeten në traditat më të mira të shkencave politike, pa kërkim të argumenteve të tyre në qëndrimet politike dhe konflikteve etnike. Nëse do të ishte e lehtë, do të kishte shumë më tepër libra të tilla të mirë.

Bashkëpunimi akademik është vetëm njëra ndër mënyrat e shumta të bashkëpunimit që duhet të arrihet për të mundësuar që konflikti historik shqiptaro-serb, në Kosovë dhe për shkak të saj, të jetë më afër një zgjidhje të qëndrueshme. Askush, përfshirë edhe autorët e këtij libri të mirë, nuk kanë iluzion se vetëm bashkëpunimi akademik mund të kapërcej barrën e rëndë të problemeve të trashëguara nga konfliktet e kaluara, si dhe nivelin e frikshëm të mosbesimit ndëretnik në Kosovë. Një bashkëpunim i tillë është megjithatë i nevojshëm dhe ai duhet të ekzistojë pavarësisht nga konteksti politik. Ky libër është hapi i parë dhe i duhur në drejtim të mirë.

Libri nuk do të kishte qenë i mundur pa Jasmina Lazović dhe Anita Mitic nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut dhe pa mbështetjen e Ambasadës Britanike në Serbi. Angazhimi i Jasminës dhe Anitës për këtë dhe shkathtësia në pajtimin serbo-shqiptar është dhe do të jetë gjithmonë një frymëzim dhe një udhëzues për shumë njerëz të tjerë me vullnet të mirë dhe synime të ndershme.

Më tej, unë do të përpiqem që gjithashtu të rrisë interesimin për këtë libër, përmes një shqyrtimi të shkurtër të gjetjeve më të rëndësishme të autorëve. Duhet që patjetër të fillohet nga çështja kyçe e distancës ekzistuese etnike në Kosovë, temë kjo e një anketimi përfaqësues dhe jashtëzakonisht interesant të opinionit publik të bërë në katër komuna të Kosovës (Prishtinë, Graçanicë, Mitrovicë të veriut dhe jugut) në shkurt dhe mars 2014. Siç raporton Nikola Jović në tekstin e tij, bazuar në intervistat me 324 anëtarët të nacionalitetit

shqiptar dhe 430 pjesëtarë të nacionalitetit serb, studiuesit tanë jo vetëm që kanë arritur në përfundimin se distanca etnike është e thellë, por ata gjithashtu tregojnë se ku ajo ishte më e lartë ose më e ulët, dhe në cilët faktorë ajo varej kryesisht. Ndoshta të dhënat më intriguese janë që 87,7% të serbëve dhe 84,3% e shqiptarëve nuk do të martoheshin me një bashkëshort nga komuniteti tjetër! Në mënyrë të ngjashme, 62,8% serbë dhe 70,4% shqiptarë nuk do të donin që pozitat udhëheqëse të shtetit të jenë të zëna nga dikush nga bashkësia tjetër. Intensiteti i distancës etnike nuk është rrënjësish i ndryshëm për shkak të përfundimit se armiqësia ndaj “tjetrit” ulet me rritjen e arsimit, apo se kjo armiqësi është më e ulët tek meshkujt sesa tek femrat.

Milena Gligorijević krahason këto të dhënat e fundit në lidhje me distancën etnike me ato të mëparshmet, të fituara në studimet e ngjashme të kryera mes viteve 1960 dhe 1990. Distanca në mes të shqiptarëve dhe serbëve, siç mund të supozohet, ishte shumë më e vogël pesëdhjetë vjet më parë dhe në këtë kuptim ishte pjesë e së njëjtës pamje por më të harmonizuar të marrëdhënieve ndëretnike në tërë ish-Jugosllavinë. Gjatë rrjedhës së kohës konturet e kësaj pamjeje u përkeqësuan dhe distanca midis serbëve dhe shqiptarëve është në rritje, për shkak të një numri të madh të arsyeve që Milena përdori si një shpjegim për gjendjen palakmueshme të tanishme.

A mund një situatë e tillë të tejkalohet me konceptin e të ashtuquajturit patriotizëm kushtetues, si - sipas shumë mendimeve - strategjia më e përshtatshme për ndërtimin e identitetit politik dhe unitetit në shoqëritë plurale dhe me ndarje të thellë? Nikola Beljinac ofron një përgjigje për këtë pyetje, duke deklaruar se patriotizmi kushtetues, në të gjitha versionet e tij, kryesisht përqipet të përgjigjet në pyetjen e legjitimitetit të sundimit politik dhe jo në pyetjen paraprake se kush e përbën një politikë. Me fjalë të tjera, pika e fillimit është pyetja “Si do të dëshironim ne të jetojmë së bashku?“, Ndërsa pyetja “Pse jemi së bashku?” konsiderohet tashmë zgjidhur. Beljinac pretendon se kjo më tutje do të thotë se udhëzimet e teorisë së patriotizmit kushtetues mund t’i referohen vetëm hapësirës tashmë të lidhur politike, që mund të jetë rasti me shumicën e politikës bashkëkohore, por që në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet një fakt i natyrshëm në rastet e shoqërive të ndara. Përfundimi i tij është se është joreale të pritet që patriotizmi kushtetues, duke u mbështetur ekskluzivisht në logjikën normative të tij, mund të prodhoj lidhjet e përkatësisë qytetare.

Dušan Vučićević përqipet të përgjigjet në pyetjen nëse modeli ekzistues zgjedhor kontribuon në zbutjen e ndarjeve etnike në Kosovë. Modelimi i institucioneve të Kosovës ka adaptuar idetë e teorisë “konsociacionale”; prandaj deputetët e Kuvendit të Kosovës zgjidhen sipas modelit proporcional, me garanci të posaçme për mbrojtjen institucionale të minoriteteve. Ky autor paralajmëron se dizajni i tillë elektoral, edhe pse siguron përfaqësimin e pakicave në parlamentin e Kosovës, krijon stimuj institucional për politikë etnocentrike dhe nuk kontribuon në shfaqjen e partive multietnike dhe pajtimit të orientuar. Kjo është arsyeja pse teksti i tij analizon arritjet e mundshme të vendosjes së disa ideve “integraliste”, kryesisht votat alternative dhe votat e vetme të transferueshme.

Jelena Lončar në tekstin e saj analizon efektet e disa mekanizmave të ndarjes së pushtetit në Kosovë. Duke përdorur rezultatet nga intervistat me deputetët e Kosovës, ajo tenton të hulumtoj ndikimin e kuotave parlamentare etnike dhe të drejtat e vetos mbi stabilitetin demokratik, vendim-marrjen dhe kompetencat e grupeve minoritare në Kosovë. Autorja konkludon se kuotat etnike janë të nevojshme për përfshirjen e komunitetit në institucionet politike të Kosovës, por gjithashtu se vendet e rezervuara dhe e drejta e vetos e minoritetit kanë efekte negative në stabilitetin, bashkëpunimin ndëretnik dhe integritet të komuniteteve. Ajo thekson se duket të jetë një lloj tregtie mes fuqizimit të pakicave në njërin anë, dhe bashkëpunimit ndërgrupor dhe stabilitetit afatgjatë në anën tjetër.

Teksti i Hana Limanit ka për qëllim përcaktimin e pozitës së Kosovës në lidhje me akomodimin e diversiteteve, si një pjesë thelbësore të identitetit dhe, në të njëjtën kohë, nëse është e mundur të krijohet

një identitet i përbashkët qytetar. Ajo pohon se sistemi aktual ligjor-politik i Kosovës, duke i dhënë të drejta të veçanta minoriteteve, kontribuon në konsolidimin e shoqërisë. Në situatën aktuale kjo lehtëson procesin e integritit të pakicave në kulturën e shumicës më shumë se sikur këto të drejta të mos ishin të garantuara. Ajo thekson se potenciali që ky sistem të zgjerohet zbrazëriten mes komuniteteve dhe të kontribuojë në ndarje ekziston edhe më tutje, por në një masë më të ulët se sa që do të kishte qenë në rastin e kundërt të trajtimit të barabartë. Nga perspektiva e teorisë së Kymlickës, autorja arrin në përfundim se sistemit të Kosovës i mungon komponenti liberal pasi që çdo gjë është e bazuar në dallimet e komunitetit dhe trajtim të veçantë. Ky model megjithatë i shërben qëllimit afatgjatë të pajtimit me të kaluarën dhe relaksimit të tensioneve ekzistuese ndëretnike.

Tre tekstet e fundit nga ky libër merren me aspekte të ndryshme të negociatave mbi normalizimin e marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës, sidomos me të ashtuquajturën Marrëveshje e Brukselit e muajit prill 2013. Teksti nga Bekim Baliqi përshkruan në detaje jo vetëm fazën vendimtare “Bruksel” të negociatave, por edhe përkatësinë e tyre - negociatat e mëparshme në Vjenë. Autori konkludon se marrëveshjet e arritura janë një mundësi e madhe, pasi që ato mund të veprojnë si gjeneratorë të paqes dhe normalizimit të marrëdhënieve. Ato gjithashtu mund të ndihmojnë në forcimin e besimit dhe bashkëpunimit mes komuniteteve serbe dhe shqiptare në Kosovë në segmente të ndryshme. Pavarësisht nga kjo, ai paralajmëron, se vështirë mund të pritet që këto bisedime të çojnë në një marrëveshje të paqes dhe njohjes së ndërsjellë ose pajtimit historik midis këtyre dy kombeve.

Analiza e detajuar e Marrëveshjes së Brukselit nga ana Adem Behës ofron shumë propozime të dobishme për përmirësimin e punës dhe efikasitetit në negociata të mëtejshme midis Qeverisë Serbe dhe Kosovare. Në këtë kontekst, kritikën e tij për mungesën e transparencës dhe llogaridhënies, të treguara në shembullin e marrëdhënies së Qeverisë së Kosovës me qytetarët e Kosovës, janë veçanërisht interesante. Të njëjtat gabime, natyrisht, ekzistojnë në relacionin e qeverisë serbe ndaj qytetarëve të Serbisë. Kur është fjala për llogaridhënien, të dy qeveritë refuzojnë të paraqesin raporte për publikun dhe për përfaqësuesit e njerëzve dhe mbeten pa një mandat të qartë për negociatat. Mungesa e transparencës, Beha thekson, se do të thotë që njerëzit e thjeshtë nuk kanë informata të mjaftueshme se si marrëveshjet teknike, si dhe ato politike, do të ndikojnë në jetën e tyre.

Së fundi, Stefan Surlić, në bazë të një analize të gjerë të mekanizmave institucionale për përfaqësimin e serbëve në Kosovë, fokusohet në një nga konkluzionet e Marrëveshjes së Brukselit - krijimin e parashikuar të Asociacionit të Komunave Serbe. Ndërsa duke pritur themelimin e Asociacionit, i cili është vonuar, Surlić përpunon përfitimet të cilat Asociacioni mund t'i ofrojë edhe për serbët dhe për pjesën shqiptare të shoqërisë së Kosovës. Autori pretendon se anëtarët e komunitetit etnik serb do të marrin një siguri institucionale dhe një mundësi për administrimin e pavarur të departamenteve kryesore. Përfaqësuesit e zgjedhur do të veprojnë në nivel politik lokal, rezultatet e tyre do të jenë lehtësisht të matshme dhe llogaridhënia e qartë dhe e pandarë. Një tjetër avantazh është për palën shqiptare, e cila do të humbasë “çështjen serbe” si problemin kryesor politik në diskursin e saj politik dhe do të jetë në gjendje të përqendrohet në zgjidhjen e problemeve themelore sociale. Po aq kështu, përfaqësuesit serbë do të pushojnë së luajturi një rol në polarizimin e skenës politike në Prishtinë përmes mbështetjes për opsionin politik në pushtet. Aktivitetet në kuadër të Asociacionit të Komunave Serbe do të jenë me rëndësi të madhe, dhe aktivitetet e përfaqësimit në Prishtinë do të bazohen në mbrojtjen e të drejtave të garantuara të komunitetit serb në Kosovë.

Unë shpresoj se këto ide të autorëve tanë të rinj do t'ju motivojnë që të lexoni këtë libër së pari, le të shpresojmë, nga shumë të tjerë që do të jenë të shkruar brenda llojit të tillë të bashkëpunimit akademik.

## Biografi

**Adem Beha** është ligjërues i Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës. Ai përfundoi studimet e tij universitare në Shkenca Politike dhe Administratë Publike në Universitetin e Prishtinës dhe mban një diplomë master në Shoqërinë Civile dhe Zhvillim Lokal në Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Gracit dhe Universitetin Kombëtar të Irlandës, Galway. Interesat e tij kërkimore përfshijnë transformimin e konfliktit, sigurinë njerëzore, ndërtimin e shtetit dhe ndërtimin e paqes, të drejtat e minoriteteve dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

**Bekim Baliqi** ka studiuar Shkenca Politike në Universitetin e Vjenës, ku ai përfundoi doktoraturën e tij. Ai është Profesor i Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës. Interesat kryesore kërkimore të tij janë në shtet-ndërtim, demokratizim dhe analizë të politikave.

**Dušan Vučićević** është kandidat për doktoraturë në Fakultetin e Shkencave Politike, Universiteti i Beogradit, dhe asistent profesor në lëndët e sistemit politik të Serbisë dhe Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore. Fushat e tij të ngushta të interesit përfshijnë studime zgjedhore, politikë krahasuese dhe teori racionale të zgjedhjes.

**Hana Limani** është një studiuese e pavarur në fushën e studimeve të migracionit dhe teorisë politike. Ajo ka Master në Shkenca Politike. Interesat e saj kërkimore përfshijnë të drejtat e njeriut dhe të pakicave, studime të migracionit, teori kritike, ligjore dhe garuese.

**Jelena Lončar** është asistent profesor në Universitetin e Beogradit, Fakulteti i Shkencave Politike dhe kandidat për doktoraturë në Universitetin e Yorkut, Britani të Madhe. Interesat e saj kërkimore përfshijnë shoqërinë civile, politikat etnike, kuotat dhe përfaqësimi politik i pakicave etnike.

**Milena Gligorijević** është kandidatë për doktoraturë në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Beogradit, dhe asistent profesor në lëndët Psikologji Sociale dhe Sjellje Politike. Fushat e interesit të saj akademik përfshijnë sjelljen politike, identitetet gjeopolitike, sjelljen ndërgrupore dhe konfliktet ndërgrupore.

**Nikola Beljinac** është asistent profesor dhe kandidat për doktoraturë në Universitetin e Beogradit, Fakulteti i Shkencave Politike. Interesat e tij kërkimore përfshijnë multikulturalizmin, politikën e njohjes dhe të patriotizmit kushtetues.

**Nikola Jović** është asistent hulumtues dhe kandidat për doktoraturë në Universitetin e Beogradit, Fakulteti i Shkencave Politike. Interesat e tij kërkimore përfshijnë metodologjinë e hulumtimit social, metodat kërkimore sasiore dhe cilësore dhe teoria e vendimmarrjes në IR.

**Stefan Surlić** është asistent hulumtues në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Beogradit, dhe drejtor i Qendrës për Kërkime Sociale. Aktualisht ai është në vitin e tretë të studimeve të doktoratës të Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Politike. Fushat e tij të ngushta të interesit janë politika krahasuese, shoqëritë etnikisht të ndara dhe demokratizimi në shoqëritë post-komuniste dhe post-konfliktuale.

Nikola Jović

## Hulumtim i distancës etnike në Kosovë

Në këtë punim autori paraqet rezultatet e një hulumtimi të distancës etnike në territorin e Kosovës. Si një komunitet pas konfliktit, me një trashëgimi shumë të rëndë të konflikteve ndëretnike, kur është fjala për marrëdhëniet midis dy komuniteteve të mëdha etnike - shqiptare dhe serbe - Kosova është në një pozitë të palakmueshme. Kompleksiteti i këtyre marrëdhënieve jo vetëm që pengon procesin e ndërtimit të institucioneve, por pengon edhe pajtimin e shoqërisë. Hulumtimi është kryer nën kujdesin e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut dhe Ambasadës Britanike në Beograd.



distancë etnike, shkalla  
Bogardus, Kosova, Shqiptarët,  
Serbet



Ky tekst u shkrua fillimisht në  
gjuhën serbe.



## Lidhur me hulumtimin e distancës etnike në Kosovë

Hulumtimi i distancës etnike në territorin e Kosovës është zhvilluar në (terren) anketim ballë për ballë (F2F) në periudhën nga 1 shkurti deri më 1 mars 2014. Numri i përgjithshëm i të anketuarve ishte 754, nga territoret e komunave të Prishtinës, Graçanicës, Mitrovicës së Veriut dhe Mitrovicës së Jugut. Duke pasur parasysh faktin se popullsia e përgjithshme e këtyre komunave është gati 570.000 dhe se mostra ka përfshirë 754 të anketuar, intervali i besimit statistikor 95% për fenomenet me 50% incidenteve është + / - 3.5.

Shtresimi i mostrës përfaqësuese, mostra të rastësishme, është bërë në bazë të kombësisë, gjinisë, moshës, komunës së vendbanimit dhe nivelit të arsimit. Hulumtimi ka përfshirë 324 pjesëtarë të nacionalitetit shqiptarë dhe 430 pjesëtarë të nacionalitetit serb. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 53.7% ishin femra dhe 46.3% meshkuj. Sa i përket moshës, ne kemi ndarë mostrat në tri kategori të grupmoshave: të rinj (të moshës 18-30), mosha mesatare (mosha 31-50) dhe të anketuarit e moshuar (mosha 51 e lart).

Pjesëmarrja e kategorive të përmendura ishte relativisht e barabartë, me mbizotërim të butë të të rinjve. Pjesëmarrja e të rinjve në mostër ka qenë 46.2%, të moshës mesatare 29.6%, dhe 24.2% e të anketuarve ishin më të vjetër se 51 vjeç. Sa për territorin e mbuluar nga anketa, përqindja e të anketuarve në Prishtinë ishte 31.2%, në Graçanicë 30.3%, në Mitrovicë të Jugut 13.4% dhe në Mitrovicë të Veriut 25.1%.

Niveli i arsimit të respondentëve është sigurisht një e dhënë e rëndësishme për këtë lloj të hulumtimit. Hulumtimi jonë i distancës etnike në Kosovë ka përfshirë 4.2% të anketuarve me arsim të fillor, 54.3% me arsim të mesëm, 7.1% me dy-vjeçar pas arsimit të mesëm (shkollë lartë) dhe 34.4% me arsim të nivelit universitar. Duke pasur parasysh se numri i atyre me arsim fillor dhe atyre me arsim dy-vjeçar pas arsimit të mesëm nuk është statistiki i rëndësishëm, në analizën tonë ne kemi vendosur të integrojmë nivelet e arsimit në dy variabla: të arsimit fillor dhe të mesëm në një variabël, dhe arsimimin dy-vjeçar pas arsimit të mesëm dhe nivelin universitar në variablin tjetër. Në analizë ne kemi parë se të gjitha variablet e treguara, nga kombësia deri në nivelin e arsimit, janë treguar shumë të dobishme për të kuptuar të dhënat e marra dhe të dobishme për thellësinë e vëzhgimit tonë.

Përveç shkallës së modifikuar Bogardus e cila ishte instrumenti themelor i hulumtimit, pyetësi përmbante 10 pyetje të tjera që kanë për qëllim marrjen e qëndrimeve, vlerave dhe mendimeve për të cilat ne kemi supozuar se shkalla Bogardus nuk do të jetë në gjendje të sigurojë përgjigje mjaft të vërtetë dhe të besueshme. Sa i përket shkallës Bogardus ne kemi përdorur një shkallë të modifikuar të përshtatur për marrëdhëniet e veçanta në këtë fushë. Pyetjet në shkallën e modifikuar janë të përshtatshme për marrëdhëniet dhe kontaktet karakteristike me të cilat popullata e një mjedisi multietnik mund të hyjë me anëtarë të përkatësisë së ndryshme etnike. Në këtë rast, fokusi ishte në marrëdhëniet shqiptaro-serbe. Në këtë kuptim, shkalla Bogardus përmbante pyetje me shtatë karakteristika të marrëdhënieve sociale ku u është kërkuar të anketuarve të deklarojnë nëse do të praninin ndonjë anëtar të kombësisë tjetër si një bashkëshort, nuse apo dhëndër, mik, shef në vendin e punës, udhëheqës politik në shtet, fqinji dhe bashkëqytetar.

Përgjigjet e këtyre pyetjeve na siguruan një pasqyrë në distancën sociale në mes të pjesëtarëve të këtyre dy kombësive. Sidoqoftë, pyetësi nuk ishte i përbërë vetëm nga shkalla Bogardus, por ai përmbante disa pyetje të tjera të rëndësishme të cilat në kontekstin dhe kohën e studimit janë konsideruar shumë të rëndësishme për të kuptuar nivelin e afërsisë në mes të anëtarëve të të dy vendeve dhe pasojat të cilat niveli i cilësisë së këtyre marrëdhënieve në nivel personal mund të ketë në


nivelin e politikës. Për këtë qëllim, pyetjet ishin të lidhura me vlerësimin e mundësisë për konflikt të ri, planeve personale për të qëndruar në Kosovë ose për të lëvizur jashtë saj, negociatat midis Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel dhe çështje të tjera politike.

## Rezultatet e hulumtimit<sup>1</sup>

Procesimi i të dhënave ishte bazuar në statistikat përshkruese (analizat e frekuencave, crosstabs dhe koeficientet e paparashikuar), teste T, provë ANOVA dhe korrelacionet bivariate. Variablat e në vijim janë përdorur për post-stratifikimin: kombësia, gjinia, moshja, niveli i arsimit dhe vendbanimi.

Interpretimi ynë dhe analiza e të dhënave të marra së pari ka filluar nga një distancë e përgjithshme e përbashkët etnike mes shqiptarëve dhe serbëve. Në pyetjet nga shkalla e modifikuar Bogardus të anketuarve u është kërkuar të përgjigjen nëse ata do të pranojnë marrëdhënie të caktuara shoqërore me një tjetër anëtar të përkatësisë etnike. Të anketuarit u përgjigjen me po ose jo, ku po do të thotë se ata do të pranojnë lidhje të tillë dhe jo se lidhja e tillë nuk do të pranohet.


### 1A. DISTANCA E PËRGJITHSHME ETNIKE E SHQIPTARËVE NDAJ SERBEVE



Numri i të anketuarve të kombësisë shqiptare që kanë dhënë të gjitha përgjigjet pozitive, pra numri i atyre që nuk kanë distancë ishte 4%. Nga ana tjetër, numri i atyre me distance shumë të theksuar, që kanë rrethuar 6 ose 7 vlera negative, arriti në 16.1%.

<sup>1</sup> Më shumë mbi interpretimin dhe rezultatet e hulumtimit dhe krahasimin me hulumtime të ngjashme shihni punimin nga Milena Gligorijević

## 1B. DISTANCA E SERBEVE NDAJ SHQIPTARËVE



Numri i të anketuarve të nacionalitetit serb pa distancë ishte 9.1%. Në anën tjetër numri i atyre me distancë shumë të theksuar ishte 19.2%.

Siç mund të shihet nga lart, për të lehtësuar interpretimin e rezultateve të fituara dhe për të mundësuar krahasimin e tyre me hulumtimet e njëjta (Kuzmanoviç, 1994 Pantiç, 1967, 1987, 1989.) ne kemi ndarë të gjithë të anketuarit në katër grupe: ata pa distancë (0 përgjigje negative), ata me një distancë të vogël (1-2 përgjigje negative), distancë të moderuar (3-5 përgjigje negative) dhe distancë të theksuar (6-7 përgjigje negative). Në bazë të tyre kemi marrë këto të dhëna:

	Pa Distancë	Distancë të vogël	Distancë të moderuar	Distancë të theksuar
Shqiptarët	4%	34.1%	45.8%	16.1%
Serbet	9.1%	25.2%	46.5%	19.2%

Këto grupe kanë shërbyer për kontrollin e variablave të tjera dhe për të kërkuar dallimet përkatëse dhe statistikisht të rëndësishme gjatë post-stratifikimit kur kemi ndarë gjininë, nivelin e arsimimit dhe moshën.

### 1. GJINIA

	Pa distancë	Distancë të vogël	Distancë të moderuar	Distancë të theksuar
Mashkull	10.9%	34%	39.3%	15.8%
Femër	3.8%	24.9%	52.7%	18.6%

Ne kemi parë se gratë kanë treguar dallim më të madh në kontaktet shoqërore, dmth se numri i femrave pa distancë është dukshëm më i ulët. Për të paraqitur këtë prirje në më shumë detaje, ne do

të marrin përgjigjet në dy pyetjet e para si një shembull. Në të vërtetë, kur i kemi pyetur të anketuarit në qoftë se ata do të pranonin një anëtar të një kombi tjetër për bashkëshort, ne kemi parë se njerëzit janë përgjigjur pozitivisht në 22.9% të rasteve ndërsa gratë janë përgjigjur pozitivisht në vetëm 6.3% të rasteve. Në lidhje me pyetjen e cila ka kërkuar që të anketuarit të imagjinonin situatën e të pasurit një anëtar të një etniteti tjetër për nuse ose dhëndër, burrat përsëri janë treguar më shumë liberal me ç'rast 30.2% prej tyre u përgjigjën pozitivisht, në krahasim me 16.5% të femrave që janë përgjigjur në njëjtën mënyrë. Ky trend është po aq i pranishëm si në mesin e shqiptarëve ashtu edhe të serbëve dhe përshkon pothuajse të gjitha pyetjet e tjera.

## 2. NIVELI I EDUKIMIT

	Pa distancë	Distancë e vogël	Distancë e moderuar	Distancë e theksuar
Fillor dhe i mesëm	6.2%	25.3%	47%	21.5%
I lartë dhe universitar	8.1%	37.2%	44%	10.7%

Ndarja e nivelit të arsimit dhe nivelit të distancës etnike tregoi se niveli i distancës etnike zvogëlohet me rritjen e nivelit të arsimit. Nëse e shikojmë tabelën, katrorin me distancë të theksuar, mund të shohim se përqindja e njerëzve me arsim të lartë që tregojnë një nivel jashtëzakonisht të lartë të distancës etnike është pothuajse dy herë më e ulët. Lidhja midis këtyre dy variablave është konfirmuar edhe nga koeficienti i korrelacionit linear Pearson i cili ka ngadalësuar një korrelacion të butë negativ ndërmjet këtyre dy variablave,  $r = -0.158$ , që do të thotë se niveli i distancës etnike zvogëlohet me rritjen e arsimit.

## 3. MOSHA

	Pa distancë	Distancë të vogël	Distancë të moderuar	Distancë të theksuar
18-30	7.5%	28.8%	44.7%	19%
31-50	7.2%	28.4%	49.5%	14.9%
51 +	5.5%	30.2%	45.1%	19.2%

Kur bëhet fjalë për moshën, mund të shohim se, për dallim nga më të vjetrit, të rinjtë janë më të gatshëm dhe të hapur për marrëdhënie më të "afërta" si martesë apo miqësi. Për shembull, niveli më i lartë i afërsisë, martesës, nuk do të ishte problem për 15.8% të rinj, ndërsa ky numër është pak më i ulët në rast tek të vjetrit kur ai shkon deri në 11.5%. Megjithatë, kur bëhet fjalë për kontakte të tjera sociale vlerat renditen + - 2% dhe dallime të rëndësishme statistikore në distancë etnike nuk mund të gjenden në mes të grupmoshave të ndryshme.

Krahasimi i vendbanimit me nivelin e distancës etnike ishte veçanërisht interesant. Rezultatet e marra tregojnë se popullsia e Mitrovicës Jugore dhe Veriore tregojnë distancë më të vogël se të anketuarit që jetojnë në territorin e Prishtinës dhe Graçanicës.

	Prishtina	Graçanica	Mitrovica V	Mitrovica J
Të jetë bashkëshorti/ja juaj	*14.5% **85.5%	7.5% 92.5%	18.5% 81.5%	17.8% 82.2%
Të jetë nusja/dhëndëri juaj	23.8% 76.2%	9.6% 90.4%	30.7% 69.3%	31.7% 68.3%
Të jetë shoku juaj	65.5% 34.5%	63.4% 36.6%	73.5% 26.5%	74.3% 25.7%
Të jetë mbikëqyrësi juaj në punë	49.4% 50.6%	42.1% 57.9%	63% 37%	72.3% 27.7%
Të ketë pozitën udhëheqëse në vendin tuaj	15.3% 84.7%	28.5% 71.5%	48.7% 51.3%	62.4% 37.6%
Të jetoj në lagjen tuaj	80% 20%	67.5% 32.5%	81.5% 18.5%	81.2% 18.8%
Të jetoj përgjithmonë në vendin tuaj	81.7% 18.3%	70.2% 29.8%	87.3% 12.7%	86.1% 13.9%

\* VLERAT MË LARTË JANË POZITIVE (PËRGJIGJA PO)

\*\* VLERAT MË LARTË JANË NEGATIVE (PËRGJIGJA JO)

Siç është përmendur tashmë, pyetëtori përmbante pyetje të tjera përveç shkallës Bogardus. Ne ishim të interesuar për të gjetur se si njerëzit vlerësojnë marrëdhëniet ndërpersonale në mjedisin e tyre. Të dhënat që morëm tregojnë se niveli i këtyre marrëdhënieve nuk është për t'u patur zili, duke pasur parasysh faktin se nota mesatare e dhënë nga të anketuarit në shkallë nga 1 në 5 ishte 2.67. Në mesin e shqiptarëve, gjithsej vlera pozitive janë 30.3%, ndërsa gjithsej vlera negative arrin në 36.1%. Në mesin e serbëve, vlerat pozitive janë 16.6%, dhe 44% negative. Këto të dhëna tregojnë se perceptimi i cilësisë së marrëdhënieve ndërnjerëzore është shumë më negativë në mesin e serbëve dhe kjo prirje mund të vërehet në pyetjet tjera të llojit të njëjtë.


Kur bëhet fjalë për socializim ndëretnik, parametrat janë edhe më keq. Vlera mesatare në shkallë nga 1 në 5 është 2.1. Edhe më shqetësues është fakti se 50.6% e shqiptarëve nuk kanë asnjë kontakt fare me serbët, ndërsa në anën tjetër 35.9% e serbëve nuk vijnë në kontakt me shqiptarët. E gjithë kjo flet në favor të tezës se shqiptarët dhe serbët rrallë herë socializohen. Megjithatë, ne gjithashtu mund të theksojmë prirjen që mund të ndihmojë në kapërcimin e kësaj pengesë, dhe kjo është e lidhur ngushtë me nivelin e arsimit. Gjegjësisht, siç tregohet nga koeficientët e korrelacionit, ka një lidhje të butë pozitive në mes të nivelit të arsimit dhe socializimit ( $r = 0.123$ ), në kuptimin që frekuenca e socializimit ngrihet me rritjen e nivelit të arsimit. Këto analiza korrelative gjithashtu tregojnë një korrelacion negativ midis shkallës së distancës dhe vetë frekuencës së socializimit. Rezultatet tregojnë se distanca etnike zvogëlohet me rritjen e frekuencës së socializimit ( $r = -0.440$ ), që konfirmoi supozimin tonë fillestar që një prej agjentëve të rëndësishme të dallimeve është pikërisht mungesa e kontaktit të drejtpërdrejtë dhe miqësor midis pjesëtarëve të kombit shqiptarë dhe kombit serb.

Në anën tjetër, kur i kemi pyetur respondentët në qoftë se ata dënojnë socializimin ndëretnik, një numër shumë i vogël prej tyre tha se ata anojnë kah një qëndrim të tillë, që ishte në kundërshtim me supozimin tonë se ka një presion nga mjedisi që manifeston dënimin e socializimit ndëretnik.

Një nga pyetjet e kontrollit e cila është ofruar në shkallën e modifikuar Bogardus ishte: "A do ti regjistroni fëmijën tuaj në shkollë ku shumica e fëmijëve janë të nacionalitetit shqiptar", përgjigjet në këtë pyetje ishin në përputhje me rezultatet e arritura përmes shkallës së distancës sociale, duke

treguar një nivel shumë të lartë të përjashtimit, pasi vetëm 10.5% e të anketuarve thanë se do të regjistronin fëmijën në një shkollë ku mbizotëron numri i fëmijëve të nacionalitetit tjetër. Numër shumë më i lartë është i shqiptarëve sesa i serbëve, 14.5% e shqiptarëve në krahasim me 7.5% të serbëve, janë të gatshëm të dërgojnë fëmijën në shkollën me strukture të tillë etnike.

Përgjigjet në pyetjen: "A planifikoni të largoheni nga Kosova" të marra nga shqiptarët dhe serbët kanë qenë statistikisht dukshëm më të ndryshme. Në të vërtetë, shqiptarët mendojnë të largohen në një masë shumë më të vogël (25.6%). Në mesin e serbëve kjo shifër është e dyfishtë dhe arrin në 59.5%. Arsyet vendimtare për lënë në mesin e serbëve mund të shihet në grafikon e mëposhtëm:



Kur u pyetën për mundësinë e konflikteve të reja në Kosovë, anëtarët e grupeve kombëtare kanë dhënë përgjigje të ndryshme. Në mesin e shqiptarëve, niveli i lartë i rrezikut për shpërthim të konflikteve është rrethuar nga 25% të të anketuarve, ndërsa përqindja në mesin e serbëve është pothuajse e dyfishtë - 49.6%.

Në pyetjen: "A i mbështetni negociatat e udhëhequra nga Beogradi dhe Prishtina në Bruksel", kemi marrë përgjigjet e mëposhtme:

	Përqindja
Po	32.3
Jo	36.1
Nuk kam ndonjë qëndrim	31.6

\* NË MES SHQIPTARËVE PO – 36.1 %

\* NË MES SERBEVE PO – 29.4 %

Duke ndarë të dhënat e marra në bazë të kësaj pyetje me rezultatet e marra nga shkalla Bogardus ne mund të shohim lidhjen e qartë në mes të mbështetjes për negociatat dhe distancë shumë të ulët etnike. Në të vërtetë, pikërisht ndarja e pyetjeve të tilla na mundëson të vëzhgojmë mënyrën në të cilën distanca etnike ndikon në qëndrimet politike rreth proceseve të ndryshme. Në këtë rast ne mund të shohim se të anketuarit që mbështesin negociatat tregojnë distancën shumë më të ulët etnike se sa të anketuarit të cilët nuk i mbështesin ato. Prej atyre që mbështesin negociatat, 14.6% tregojnë mungesën e distancës etnike, ndërsa 41.2% tregojnë

distancë shumë e ulët. Nga ana tjetër, numri i të anketuarve që nuk mbështesin negociatat dhe që nuk kanë distancën etnike është vetëm 1.9%, ndërsa numri i atyre me distancë shumë të ulët është 19%.

Në fund, por në një pyetje të vetme, ne kemi ofruar qëndrime të caktuara të të anketuarve dhe u kemi kërkuar atyre se në çfarë mase ata bien dakord me ato në shkallë prej 1 deri 5, ku vlera një do të thotë "Unë absolutisht nuk pajtohem" dhe vlera pesë "Unë plotësisht pajtohem".

Qëndrimi	Mesatarja	Serbet Po	Shqiptarët Po
Serbet dhe shqiptarët duhet të jenë të barabartë në autoritetet vetëqeverisëse	2.85	43.8%	27.8%
Serbet duhet të pranojnë autonominë brenda Kosovës <sup>2</sup>	2.23	30.7%	14.2%
Gjuha shqipe dhe serbe duhet të jetë e barabartë	2.72	49.6%	20.7%
Si shqiptarët ashtu edhe serbet duhet të jenë në funksione politike	1.94	19%	12.4%
Përfaqësuesit e minoriteteve duhet të jenë në parlamentin e Kosovës	3.47	56.7%	56.2%

Po ashtu, ndarja e të dhënave, nga pyetjet rreth mbështetjes për negociatat dhe shkalla e distancës etnike, në këtë rast, si dhe ndarja e qëndrimeve të përmendura më lart me shkallën e distancës etnike tregojnë të njëjtin rregull. Të anketuarit të cilët nuk shprehin ndonjë distancë etnike apo shprehin vetëm një distancë shumë të ulët etnike janë shumë më të hapur në pranimin e qëndrimeve politike në frymën e tolerancës dhe të bashkëpunimit. Për të treguar dhe shpjeguar këtë prirje, do të marrim si shembull çështjen e përfaqësimit të barabartë të shqiptarëve dhe serbëve në autoritetet e vetëqeverisjes lokale. Të anketuarit të cilët nuk pajtohen me idenë për përfaqësim të barabartë tregojnë një distancë shumë të lartë. Vetëm 2.4 % prej tyre treguan mungesën e distancës ndërsa niveli i distancës ishte i ulët në 15.1 %. Nga ana tjetër, në mesin e atyre që mbështesin qëndrimin për përfaqësim të barabartë, 16.1 % nuk e shprehin distancën etnike, ndërsa 42.7 % shprehin një nivel shumë të ulët të distancës. Për të kontrolluar këta tregues ne gjithashtu kemi kryer testin e korrelacionit i cili ka konfirmuar këto rezultate. Gjegjësisht, koeficientet e korrelacionit tregojnë korrelacion negativ midis variablave, në kuptimin se mbështetja për qëndrimet e përmendura më lart rritet me rënien e intensitetit të distancës etnike. Koeficientet radhiten nga  $r = -0.265$  për  $r = -0.412$ .

Së fundi ne kemi bërë pyetjen: "Mbi çfarë baze ju krijoni qëndrimin tuaj në lidhje me anëtarët e kombit tjetër" dhe morëm të dhënat sipas të cilave përvoja personale, opinioni familjes dhe mediet janë radhitur lart në atë listë.

	Mesatarja	Serbet	Shqiptarët
Përvoja personale dhe kontakti direkt me ta.	3.85	67.5%	67.6%
Mendimet dhe qëndrimet e familjes sime.	3.17	50.1%	46%
Mendimet, përvojat dhe tregimet e shokëve të mi.	3	39.4%	43.5%
Çfarë kam mësuar në shkollë.	2.15	17.6%	22.5%
Mendimet dhe qëndrimet e politikanëve.	1.9	10.7%	15.4%
Mendimet dhe qëndrimet e udhëheqësve fetar.	1.94	19%	16.4%
Informatat që i marr nga mediet.	2.62	21.2%	50.2%

2 Në pyetësorin në shqip pyetja ishte formuluar si në vijim: "Serbeve duhet tu jepet autonomi brenda Kosovës?"

Kjo pyetje ka pas për qëllim konfirmimin ose mohimin e supozimit se të anketuarit të cilët zhvillojnë mendimin e tyre në lidhje me pjesëtarët e kombit tjetër në bazë të kontakteve personale tregojnë nivel më të ulët të distancimit, dhe për të kontrolluar nivelin dhe rezultatet e veprimeve të - kryesisht - politikanëve dhe medieve në distancën etnike.

Kur bëhet fjalë për përvoja personale, ne mund të shohim se ata që krijojnë qëndrimin e tyre në lidhje me pjesëtarët e kombit tjetër në bazë të përvojës personale tregojnë distancën në mënyrë të konsiderueshme më të ulët etnike se sa ata që nuk kanë lloj të tillë të kontakteve. Përkatësisht, të anketuarit të cilët nuk krijojnë qëndrimin e tyre në bazë të përvojës personale nuk shprehin prani të distancës etnike në vetëm 3% të rasteve, ndërsa 36.6% prej tyre tregojnë një nivel shumë të theksuar të distancimit. Nga ana tjetër, ata të cilët krijojnë qëndrimet e tyre në bazë të përvojës personale në 8% të rasteve nuk tregojnë prani të distancës etnike, ndërsa 15.2% e tyre tregojnë një nivel shumë më të theksuar të distancimit. Nga agjentët e mbetur të qëndrimeve dhe nga lidhja e tyre me qëndrimet nga shkalla Bogardus, ne mund të shohim se të anketuarit të cilët krijojnë qëndrimet e tyre në bazë të politikës, politikanët dmth, tregojnë një dallim shumë të konsiderueshëm në lartësi të distancës etnike në krahasim me të anketuarit tjerë mes të cilëve kjo nuk u evidentua.

Në këtë kuptim, ata që krijojnë qëndrimet e tyre në bazë të qëndrimeve të politikanëve tregojnë një nivel shumë të lartë të distancës etnike (31.7%), ndërsa në mesin e të anketuarve që nuk krijojnë qëndrimet e tyre në bazë të qëndrimeve të politikanëve, niveli i distancimit të lartë arrin në 16.3%. Sa i përket medieve, ne kemi gjetur një vlerë statistikore të një rëndësie të ulët në formën e korrelacion pozitiv mes medias si agjent i qëndrimeve dhe distancës etnike e cila është  $r = .117$ .

Për hir të të kuptuarit edhe më të mirë të lidhjes midis agjentëve të qëndrimeve dhe distancës etnike ne kemi kryer analizat e korrelacionit bivariat i cili tregoi se vetëm përvoja personale dhe familjare ndikojnë në uljen e distancës etnike. Të gjithë agjentët e tjerë janë në korrelacion pozitiv me distancën etnike, dmth distanca etnike rritet me rritjen e ndikimit të tyre.

	Përvoja personale	Familja	Shokët	Shkolla	Politikanët	Udhëheqësit fetar	Mediet
Distanca etnike	-.184**	-.043	.012	.065	.151**	.056	.117**

\* STATISTIKISHT E RËNDËSISHME NË 0.05

\*\* STATISTIKISHT E RËNDËSISHME NË 0.01

## Përfundimi

Hulumtimi tregoi një nivel shumë të lartë të distancës etnike mes pjesëtarëve të nacionalitetit shqiptarë dhe serb. Duke pasur parasysh faktin që hulumtimet e kryera para shpërthimit të konfliktit të vitit 1999 treguan një nivel shumë të lartë të distancimit midis anëtarëve të të dy bashkësive etnike, mund të pritej që veçanërisht pas shpërthimit të luftës niveli i distancës të jetë shumë i lartë. Variablet e pavarura, siç janë gjinia, mosha, arsimi, vendbanimin, na kanë shërbyer për të përcaktuar nëse këta faktorë klasik të distancës sociale qëndrojnë në një korrelacion të konsiderueshëm me intensitetin e distancës etnike. Nga analiza statistikore e llojeve të ndryshme ne mund të shohim se të anketuarat femra tregojnë një distancë disi më të lartë se ato të meshkujve, që mosha nuk është një faktor i rëndësishëm dhe agjent i distancës etnike, ndërsa në lidhje me vendin e banimit ka një dallim në mes popullsisë së Mitrovicës së Veriut dhe Jugut dhe popullsisë së Prishtinës dhe Graçanicës



Dallimi më i rëndësishëm mund të vërehet në nivelin e arsimit, që tregohet edhe nga analizat e korrelacioni që konfirmojnë supozimin tonë se niveli i distancës etnike ulet me nivelin më të lartë të arsimit. Përveç kësaj, ne mund të vërejmë se sa më të shpeshta dhe më intensive të jenë kontaktet mes anëtarëve të dy komuniteteve distanca etnike bie.

Pyetjet kontrolluese na treguan se gjetjet nga shkalla Bogardus reflektojnë në marrëdhëniet tjera gjithashtu. Është e qartë se lufta krijoi kontekstin dhe mjedisin me konceptet dominuese të etnocentrizmit, distancës sociale dhe mosbesimit ndëretnik. Në rrethana të tilla nuk është e vështirë të kuptohet se pse marrëdhëniet mes dy komuniteteve etnike janë shumë të këqija. Megjithatë, përveç luftës ka faktorë të tjerë të distancës etnike, dhe ato janë të lidhura me identitetin strukturorë, institucional dhe psikologjik. Që ekziston dallimi i identitetit i cili gjeneron armiqësi midis këtyre dy bashkësive etnike është treguar edhe në hulumtimet e mëhershme (Mihailovic, 1998.) të bëra në kohë paqeje, në të cilat ishte e qartë se identitetet kolektive ishte themeluar mbi dallimin "Ne dhe Ata". Në kuptim etnologjik është dallimi ku "Ata" janë gjithmonë në një kontekst negativ, ndërsa "Ne" janë gjithmonë në kontekst pozitivë.

Strukturore, në kuptimin që ndarja e hapësirë të jetesës së këtyre dy kombeve nuk do të kontribuojnë në kontakte të shpeshta të cilat do të gjenerojnë interes dhe miqësi. Të dy kombet jetojnë në komunat e tyre, bëjnë pazar në dyqanet e tyre dhe ndjekin mësimin në shkollën e tyre. Institucionale, pasi që nuk ka të ose ka në një numër shumë të vogël institucionesh shumë pak të zhvilluara të cilat do të rrisin bashkëpunimin ndëretnik dhe dizajnimi i të cilave do të inkurajonte besimin dhe promovimin e bashkëpunimit. Kosova nuk është e vetmja shoqëri e ndarë në botë, ajo me siguri mund të përdorë institucionet të cilat diku tashmë janë provuar si shumë të mira për shoqëritë pas konflikteve - konsociationi dhe ndarja e pushtetit janë vetëm disa nga mënyrat në të cilat zhvillimet institucionale mund të zhvendosen drejt një drejtimi më të mirë. Psikologjikisht, ekziston një frikë ontologjike dhe mosbesim në mes të qytetarëve të të dy kombeve. Frika nga të tjera dhe frika tashmë nga përvoja, si personale ashtu edhe nga kujtesa kolektive. Këto ndjenja janë krijuar nga efekti kumulativ i fakteve të përmendura më lart, në mënyrë që ndryshimi i këtyre fakteve mund të sjellë shpresë për ndryshime në aspektin psikologjik, pra krijimin e mjedisit që stimulon kontakte të drejtpërdrejta dhe bashkëpunim të cilat do të çojnë në uljen e distancës etnike dhe krijimin e një shoqërisë më të lirë, të përgjegjshme dhe të hapur.

## Literatura

Kuzmanović, B. 1994, Socijalna distanca prema pojedinim nacijama (etnička distanca), u Razaranje društva: jugoslovensko društvo u krizi 90-tih, ur. Lazić, M. Filip Višnjić, Beograd.

Mihailović, S. 1998, Etnički stereotipi i heterostereotipi na Kosovu, Sociologija, LX, 3.

Pantić, D. 1987, Nacionalna svest mladih u SR Srbiji bez SAP, IIC SSO Srbije, Beograd.

Pantić, D. 1990, Vrednosti mladih u vreme krize, u Deca krize, ur. Mihajlović. S. IDN i Centar za politikološka istraživanja i javno mnenje, Beograd.

Pantić, D. 1991, Nacionalna distanca građana Jugoslavije. Jugoslavija na kriznoj prekretnici, IDN, Beograd.

Milena Gligorijević

## Shqyrtim krahasuese i anketave të mëhershme dhe të fundit të distancës etnike mes Serbëve dhe Shqiptarëve

Subjekt kryesor i këtij punimi është shqyrtimi dhe analizimi krahasues i rezultateve të hulumtimeve empirike të distancës etnike në mes të serbëve dhe shqiptarëve, sondazhe këto të kryera në periudhën nga mesi i viteve të 60-ta e deri në ditët e sotme. Punimi është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë autorja paraqet rezultatet e sondazheve të distancës etnike në ish-Jugosllavi, ndërsa pjesa e dytë ofron rezultatet e sondazheve të kryer në vitin 2014 në pjesën veriore dhe qendrore të Kosovës. Në bazë të një analize krahasuese të rezultateve të sondazheve të mëparshme me atë të vitit 2014, qëllimi i punimit është të përcaktoj nëse ka ndryshuar diçka në shpërndarjen dhe nivelin e distancës etnike në mes të këtyre dy grupeve etnike. Autorja analizon rezultatet e paraqitura dhe të interpretuara të sondazheve në kontekstin e ndryshimeve socio-politike që janë duke u zhvilluar në këtë territor.



distanca etnike, serbët,  
shqiptarët, Kosova



Ky tekst u shkrua fillimisht në  
gjuhën serbe.

Koncepti i distancës sociale është përdorur për herë të parë që në fillim të shekullit XX nga sociologu amerikan Robert Park, duke nënkuptuar disa "nivele të të kuptuarit dhe intimitetit të cilat karakterizojnë marrëdhëniet para-sociale dhe sociale në përgjithësi" (Park sipas Bogardus, 1925: 216). Edhe pse shfaqja e këtij koncepti është meritë e Parkut, ishte psikologu Emory Bogardus ai që e bëri atë të njohur – ai futi në fuqi në vitin 1925, duke ndërtuar shkallën për matjen e distancës sociale. Duke filluar nga supozimi i Parkut se marrëdhëniet e ndryshme shoqërore nënkuptojnë nivele të ndryshme të afërsisë dhe distancë emocionale, Bogardus për shkallën e vet zgjodhi shtatë lloj marrëdhëniesh shoqërore konkrete që mund të ndërtojnë individët, dhe të cilat dallojnë midis tyre për nga niveli i intimitetit (Bogardus, 1925a). Këto marrëdhënie janë:

- marrëdhënia e ngushtë përmes martesës,
- anëtarësimi në të njëjtin klub (si shprehje e një miqësie të ngushtë),
- fqinjësi (që jetojnë në të njëjtën rrugë),
- punësimi në të njëjtin profesion,
- shtetësia e përbashkët (banor i përhershëm i shtetit),
- vizita në një vend, dhe
- përjashtimi nga vendi.

Duke u kërkuar të anketuarve që të përgjigjen në pyetjen nëse do të hynin apo jo në këto marrëdhënie me anëtarë të grupeve të caktuara, Bogardus ka përcaktuar nivelin e afërsisë ose distancës së të anketuarve në raport me anëtarët e grupit, varësisht nga marrëdhënia(et) të cilën apo të cilat të anketuarit do t'i praninin apo nuk do t'i praninin. E përpunuar në mënyrë të tillë, "distanca sociale në fakt shqyrtohet si një gatishmëri për të hyrë në marrëdhënie me nivele të ndryshme të afërsisë" me anëtarët e grupeve të ndryshme sociale (Kuzmanoviç, 1994). Megjithatë, pranimi ose refuzimi i marrëdhëniesh të caktuara shoqërore me një anëtar të një grupi të caktuar shoqëror në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si një shprehje e qëndrimit të përgjithshëm të personit ndaj atij grupi, sepse koncepti i qëndrimit është më kompleks (në kuptim të përmbajtjes) dhe më i gjerë (në kuptim të dimensionit) se sa koncepti i distancës sociale (Kuzmanoviç, 2001). Sa i përket përmbajtjes, qëndrimi është një koncept më kompleks sepse ai gjithmonë përbëhet nga tre komponentë - kognitiv (ose të mësuarit), afektiv (ose emocional) dhe konativ (ose gatishmëri).<sup>1</sup> Kjo do të thotë se, për ndryshim nga distanca sociale, qëndrimi përveç një tendence (gatishmërie) për sjellje të caktuar, gjithashtu përfshin disa njohuri, mendime dhe ndjenja të caktuara ndaj anëtarëve të grupeve të tjera sociale. Me fjalë të tjera, distanca e madhe shoqërore jo domosdoshmërisht ka nevojë të jetë reflektim i një qëndrim negativ (në kuptimin e opinionit, emocioneve dhe tendencave negative duke ndërmarrë veprime negative kundër pjesëtarëve të një grupi të caktuar), por ajo mund të jetë një reflektim i polemikave mes klasave dhe interesave materiale (Pantiç, 1987), si dhe i normave të caktuara sociale (Havelka, Kuzmanoviç, Popadiç, 1998), dhe gjithashtu pasojë e njohurive të pamjaftueshme për një grup (Kuzmanoviç 2001), struktura të caktuara të karakterit të personalitetit ose rrethana specifike sociale (Vasoviç, 1995).

Duke u nisur nga premisa se distanca sociale është (jo)gatishmëria e një individi për të hyrë në marrëdhënie shoqërore të niveleve të ndryshme të afërsisë me anëtarë të grupeve tjera, dhe që komponenti konativ i një qëndrimi i referohet gatishmërisë së një individi që të bëjë diçka në lidhje me objektin e qëndrimit të tij/saj, sipas mendimit të disa autorëve distanca sociale nuk është asgjë më

---

1 Komponenti kognitiv (ose të mësuarit) i qëndrimit do të thotë njohuritë që kemi në lidhje me objektin e qëndrimit; afektiv (ose emocional) për ndjenjat ndaj objektit të qëndrimit, ndërsa komponenti konativ (ose gatishmëri) ka të bëjë me gatishmërinë për të bërë diçka në lidhje me objektin e qëndrimit (Rot, 2006).

shume se një komponent konativ i qëndrimit. Duke u pajtuar me atë se distanca sociale përmban një ngarkesë motivuese, Pantiç mendon se reduktimi i distancës sociale është i pajustfikueshëm ndaj komponentit konativ të qëndrimit, pasi që komponenti i tij i sjelljes shpesh merr forma të ndryshme të segregacionit dhe diskriminimit (Pantiç, 1991; Pantiç 2014).

Koncepti i qëndrimit jo vetëm që është më kompleks, por është edhe më i gjerë se sa distanca sociale pasi që ai "përfshin një vazhdimësi më të gjerë në polin negativ: mbështetje të mundshme ndaj masave negative për grupin e caktuar" (Kuzmanović, 2001: 184), ndërsa distanca sociale është vetëm (mos) gatishmëri për krijimin e marrëdhënieve të caktuara shoqërore, por jo gatishmëri për ndërmarrjen e veprimeve armiqësore ndaj pjesëtarëve të një grupi të caktuar shoqëror. Pikërisht për këtë arsye shumë sondazhe mbi distancën sociale e lënë jashtë marrëdhënien e fundit nga shkalla e Bogardus, pra atë që mbulon dëbimin nga vendi. Pra, në qoftë se dikush do të pajtohej që anëtarët e grupit të caktuar duhet të dëbohen nga vendi, kjo nuk do të ishte më tregues i një distance të thjeshtë por i një qëndrimi tejet negativ.

Nga gjithçka që u tha më lart mund të konkludojmë se, ndonëse të ndërlidhura, distanca sociale dhe qëndrimi ndaj anëtarëve të një grupi shoqëror nuk janë krejtësisht e njëjta gjë. Pavarësisht faktit se distanca social është një koncept teorikisht më pak i qartë se sa koncepti i qëndrimit, hulumtimi empirik i distancës sociale ka një rëndësi të madhe teorike dhe praktike, si në kontekstin e vrojtimit të grupeve tjera në të njëjtën hapësirë sociale, ashtu edhe në të kuptuarit e marrëdhënieve të tyre ndërgrupe. Pasi që distanca sociale nënkupton "nivele të ndryshme të të kuptuarit dhe të ndjenjave që ekzistojnë mes njerëzve", të cilat "shpjegojnë natyrën e një pjese të konsiderueshme të ndërveprimeve të tyre" dhe "adresojnë karakterin e marrëdhënieve shoqërore" (Bogardus, 1925a: 299), ajo mund të shërbej si një parashikues relativisht i besueshëm i nivelit të tolerancës sociale dhe se sa e hapur është një shoqëri. Për këtë arsye, sondazhi i distancës sociale, veçanërisht kur ka të bëjë me marrëdhëniet ndëretnike, e ka vëmendjen e studiuesve edhe sot.

## Sondazhet e distancës etnike në ish-Jugosllavi

Edhe pse sondazhet e para empirike të distancës etnike filluan të zhvilloheshin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës qysh në mesin e viteve të 20-ta, në rajonin tonë kanë filluar relativisht vonë - rreth fundit të viteve të 50-ta dhe në fillim të viteve të 60-ta. Duke pasur parasysh se kjo ishte koha e sundimit komunist në ish-RSFJ, kur opinioni mbizotërues ishte se çështja kombëtare në Jugosllavi ishte zgjidhur gjatë revolucionit socialist, sondazhet empirike të marrëdhënieve ndër-etnike konsideroheshin jo vetëm të panevojshme, por edhe të padëshirueshëm, pasi që vetë shprehja e qëndrimeve ndaj kombeve të tjera gjatë sondazheve do të ishte një shtytje për njerëzit që të mendonin për dallimet etnike, e që përfundimisht do të çonte në fenomene shoviniste në shoqëri (Pantiç, 1967). Një qëndrim i tillë zyrtar, i mbështetur nga një numër i anëtarëve të elitës intelektuale të asaj kohe, bëri që të ketë mungesë të interesit më të gjerë shoqëror dhe të mbështetjes politike për sondazhet empirike të këtij fenomeni.

Prandaj pasojat ishin si në vijim:

1. Sondazhe të pakta të kryera në mostrën jugosllave që do të mundësonte krahasim direkt ndëretnik;
2. Sondazhe të pakta të kryera në mostrën e qytetarëve të rritur, d.m.th orientim i dukshëm i studiuesve ndaj popullsisë së re (nxënës të shkollave të mesme/universitete);
3. Mospërputhje e metodologjisë së aplikuar (versionet e aplikuar të ndryshuara të shkallës së Bogardus ndryshonin nga një sondazh në tjetrin);
4. Mungesa e sondazheve të gjata që do të mundësonin interpretimin e gjetjeve në kontekstin e ngjarjeve dhe zhvillimeve më të gjera shoqërore-politike.

Pavarësisht faktit se hulumtimi i distancës etnike në vendin tonë ishte i pasistemuar, ekziston një fond i caktuar i të dhënave; në bazë të tij është e mundur, të paktën në vija të përafërt, të rindërtohet shpërndarja dhe niveli i distancës etnike midis kombeve jugosllave. Duke pasur parasysh se subjekti kryesor i këtij punimi është një përmbledhje dhe një analizë krahasuese e rezultateve të sondazheve empirike të distancës etnike në mes të serbëve dhe shqiptarëve nga vitet e 60-ta e deri më sot, punimi do të paraqesë vetëm sondazhet të cilat shqyrtojnë distancën etnike të të dy kombeve. Kjo do të thotë se vetëm sondazhet e kryera në territorin e RSF të Jugosllavisë do të merren parasysh, pasi që të gjitha sondazhet pas shpërndarjes së saj janë kryer në territorin e Serbisë pa Kosovën, d.m.th. është ekzaminuar vetëm distanca etnike e serbëve ndaj shqiptarëve, por jo edhe anasjelltas. Qëllimi i punimit është të përcaktojë, përmes një pasqyre dhe një analize krahasuese të rezultateve të këtyre sondazheve të mëparshme dhe sondazheve të kryera në vitin 2014 në territorin e Kosovës veriore dhe qendrore, nëse diçka ka ndryshuar në shpërndarjen dhe nivelin e distanca etnike në mes të këtyre dy grupeve etnike. Meqë sondazhet e distancës etnike të paraqitura në këtë punim janë kryer në kategori të ndryshme dhe janë përdorur versione të ndryshme të modifikuar të shkallës Bogardus, autorja paralajmëron se krahasimi i tyre është vetëm i kushtëzuar.

## Distanca etnike e serbëve dhe shqiptarëve në Jugosllavinë e dytë (1960-1990)

Sondazhet e para të distancës etnike në ish-Jugosllavi, të cilat ishin kryer me grupin e studentëve të Universitetit të Sarajevës (Fiamengo, 1960) dhe me brigadierët që ndërtonin autostradën "Bratstvo-Jedinstvo" (Supek, 1963), shënuan gatishmërinë e kombeve jugosllave për distancim të përbashkët si një fenomen i rrallë. Megjithatë, sondazhi i parë i bërë me grupin e qytetarëve të rritur dha rezultate pak më të ndryshme. Ky sondazh u bë në vitin 1966 me grupin e 2.600 të anketuarve më të vjetër se 18 vjeç dhe kishte për qëllim përcaktimin e shpërndarjes dhe nivelin e distancës etnike të qytetarëve të RSF të Jugosllavisë (Pantiç, 1967). Sondazhi kishte përdorur një shkallë të modifikuar Bogardus dhe të anketuarit u deklaruan për (mos)pranimin e tetë vendeve jugosllave: slovenë, kroatë, myslimanë, serbë, shqiptarë, malazezë dhe maqedonas.<sup>2</sup> Rezultatet e sondazheve treguan se 59.2% e qytetarëve në Jugosllavinë e atëhershme nuk treguan distancë etnike ndaj ndonjë kombi (që do të thotë se 40.8% shprehën një formë të distancës), 21.2% shprehën distancë shumë të dobët, 6.7% dobët, 4.8% mesatarisht, 2.7% e të anketuarve shprehën distancë të fortë etnike, 3,3% shumë të fortë, ndërsa vetëm 2.2% ishin plotësisht të distancuar.<sup>3</sup>

Distancimi etnike në republika të ndryshme kishte rezultate dukshëm të ndryshme. Kështu niveli më i lartë i pranimit në të gjitha kombet (për të gjitha marrëdhëniet e shqyrtuara) ishte regjistruar në Vojvodinë (71%) dhe Kroaci (70.3%), dhe niveli më i ulët i pranimit ishte në Maqedoni (41.7%), Slloveni (42.2%) dhe Kosovë (51.7%). Në anën tjetër, përqindja më e lartë e të anketuarve që tërësisht u distancuan, d.m.th. që refuzuan të gjitha llojet e marrëdhënieve me të gjitha kombet (përveç

---

2 Ky version i shkallës Bogardus ka përfshirë gjashtë marrëdhëniet hipotetike si në vijim: qëndrim i përhershëm në republikë/krahinë, punësim në të njëjtën kompani, shef në vendin e punës, udhëheqës politik i republikës/krahinës, miqësisë dhe martesës.

3 Rezultati maksimal i distancimit arriti në 48 (tetë kombësi me nga gjashtë marrëdhënie secila), d.m.th. 42 (kur kombësia e të anketuarit nuk ishte si opsion). Niveli i distancës etnike u përcaktuar në atë mënyrë që rezultatet globale të distancimit u klasifikuan në shtatë kategori: pa distancë (0 pikë), distancë shumë e dobët (1-8), distancë e dobët (9-16), distancë e mesme (17-24), distancë e fortë (24-32), distancë shumë e fortë (33-40), distancë e plotë (41-48).

me kombin e vetë) ishte regjistruar në Slloveni (5%) dhe në Kosovë (9%), dhe më e ulëta në Bosnje dhe Hercegovinë (0%), Vojvodinë (0,2%) dhe Maqedoni (0,5%). Nëse në anën tjetër përmbledhim modalitetet për distancë të fortë, distancë shumë të fortë dhe distancë të plotë, shpërndarja e fituar do të jetë pak më ndryshe: Sllovenia është në vendin e parë për nga intensiteti i distancës (31.6%), pasuar nga Kosova (14.2%), Kroacia (7.3%) dhe në fund Bosnja dhe Hercegovina (7%).

Përpos këtyre dallimeve ndërmjet republikave, ky sondazh regjistroi dallimet në shpërndarjen e distancës etnike duke marrë parasysh kombësinë e të anketuarve. Kështu mungesa e çfarëdo lloji të distancës etnike u tregua më së shumti nga hungarezët (85%) dhe kroatët (70.2%), ndërsa sllovenët shprehën distancën më të madhe etnik – deri në 32.2% të kombit sllovenë kishin distancë të theksuar fort, të theksuar shumë fort ose distancë të plotë ndaj kombeve të tjera të ish-Jugosllavisë. Ndryshe nga sllovenët, të cilët në masën më të madhe shprehën distancë shumë të fortë etnike (21.7%), kategoria e distancës së fortë ishte më e shprehur në mesin e shqiptarëve (4%) në krahasim me të gjitha kombet e tjera, regjistrimi i të cilëve në kategorinë "distancë e fortë" i rendiste brenda ose nën mesatare për tërë RSFJ-në (2.7%).

Sa i përket llojit të marrëdhënieve të mundshme që pranohen ose jo në të gjitha republikat, distancimi i të gjitha kombeve jugosllave theksohej më së shumti në lidhje me martesat. Rezultati më interesant i këtij sondazhi patjetër që ishin të dhënat se në të gjitha republikat distanca ishte më e madhe ndaj shqiptarëve, veçanërisht në lidhje me pranimin e marrëdhënieve më intime (martesa): në Slloveni (50.4%), Maqedoni (49.4%), Serbia pa krahinat autonome (38.5%), Mali i Zi (29%), dhe më e ulëta në Kroaci (21.6%). Distancat ndaj muslimanëve dhe hungarezëve ishin më pak të shprehura.

Shtrirja dhe niveli i distancës etnike ndryshonte në lidhje me variablat e analizuar socio-demografike si në vijim: gjinia, moshja, arsimit dhe përkatësia fetare. Një distancë më e madhe dhe më e fortë etnik ishte regjistruar në mesin e të anketuarve gra dhe të vjetër (megjithatë, edhe në mesin e më të rinjve!)<sup>4</sup>, ndërsa më e ulëta ishte regjistruar në mesin e ateistëve, punëtorëve të kualifikuar dhe me kualifikim të lartë si dhe të diplomuarve universitarë. Megjithatë, qytetarët më të arsimuar, edhe pse nga njëra anë kanë treguar distancën më të vogël pas klasës punëtore, nga ana tjetër kanë shprehur distancë shumë të fortë në një përqindje shumë më të lartë se sa të anketuarit me nivele të ulëta të arsimimit.<sup>5</sup>

Sondazhi tjetër, i realizuar në vitin 1985 në kategorinë jugosllave të punonjësve të sektorit publik ka treguar një distancë të vogël të qytetarëve të Jugosllavisë ndaj pjesëtarëve të kombeve dhe kombësive të tjera nga territori i RSFJ-së (Pantiç, 1987). Kur flasim për lidhje hipotetike të martesave, një e treta e të anketuarve (33%) kanë shprehur distancë ndaj të paktën një kombi, 21% prej të cilëve kanë shprehur distancë më të fortë (ndaj një numri më të madh të grupeve), dhe 12% kanë shprehur një distancë më të dobët. Edhe kësaj here, distanca ishte më e shpeshtë në mesin e maqedonasve (52%) dhe sllovenëve (41%), e pasuar nga muslimanët dhe malazezët (38% secili), kroatët (34%), serbë (31%), jugosllavët (24%) dhe në fund shqiptarët (20%). Një përqindje aq e vogël e të anketuarve të distancuar mes shtetasve shqiptarë është shumë për tu habitur duke pasur parasysh se kjo ishte koha kur lëvizja nacionaliste

4 Pantiç shpjegon mospërputhshmërinë midis rezultateve të fituara në këtë sondazh dhe rezultatet e sondazheve të mëparshme (në lidhje me shpërndarjen dhe nivelin e distancës etnike të të rinjve) me faktin që sondazhet e mëparshme ishin kryer vetëm në mesin e të rinjve urban (të cilët në përgjithësi janë më pak të distancuar se sa në fshat), si dhe nga që sondazhet e mëparshme janë kryer në situata të veçanta (të tilla si Veprimet e Punës së të Rinjve) të cilat kanë influencuar vetë "shkatërrimin e kufijve dhe distancimin midis rinisë" (Pantiç, 1967:33).

5 Çdo i pesti qytetar me arsimim të lartë i Jugosllavisë së atëhershme ka shprehur një distancë etnike të fortë, shumë të fortë ose të plotë ndaj kombeve dhe kombësive tjera (minoritete etnike).

shqiptare në Kosovë tanimë kishte filluar. Megjithatë, çka nuk duhet neglizhuar është fakti se ky sondazh kishte regjistruar një numër të madh të të anketuarve të pavendosur. Me shfaqjen e këtij fenomeni, Pantiç prezantoi konceptet e distancës së manifestuar dhe të fshehur ose latente, për të etiketuar distancimin e hapur dhe të përmbajturit prej tij. Rrjedhimisht, Pantiç thotë se distanca më e lartë e manifestuar (duke marrë për bazë lidhjen martesore) ishte ndaj romëve (32%) dhe shqiptarëve (30%), ndërsa distanca e fshehur ishte veçanërisht e pranishme në mesin e shqiptarëve (50%).<sup>6</sup> (Është e qartë se demonstratat masive të shqiptarëve në këtë krahinë, të shoqëruara me kërkesën për krijimin e Republikës së Kosovës, dhe shtypja e tyre nga Ushtria Kombëtare Jugosllave<sup>7</sup> kanë ndikuar që qytetarët e kombësisë shqiptare të mos shprehen lidhur me distancën, "sepse presioni social mbi ta ishte i lartë dhe kërcënimet me sanksione për nacionalizëm ishin shumë serioze" (Kuzmanoviç, 2001: 187).

Vetëm katër vjet më vonë (në vitin 1989) u realizua një ankesë e re me mostrën jugosllave, por këtë herë u përfshinë vetëm të rinjtë (Baceviq, 1990)<sup>8</sup>. Ky sondazh shqyrtoi distancën etnike vetëm sa i përket lidhjeve hipotetike martesore, ndërsa objektet e distancimit përfshinë të gjitha kategoritë e kombeve jugosllave (serbë, malazezë, kroatë, sllovenë, maqedonas dhe muslimanë) dhe dy nacionalitete (shqiptarët dhe hungarezët). Rezultatet e sondazhit treguan se nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 53% nuk kanë shprehur distancë të manifestuar, d.m.th. nuk kanë kundërshtuar në mënyrë eksplicite anëtarët e ndonjë kombi tjetër, ndërsa nga 47% e atyre që shprehën distancë të manifestuar 25 % treguan distancë më të fortë dhe 22% më të dobët.

Nga karakteristikat e kontrolluara socio-demografike, edhe pse shumica e tyre shkaktuan mospërputhje të dukshme në lidhje me distancimin etnik, vetëm përkatësitë republikane/krahinore dhe etnike ishin të lidhura me distancën e përgjithshme etnike në një masë të rëndësishëm statistikor. Kështu, duke marrë parasysh përkatësinë etnike, distanca më e lartë u regjistrua në mesin e të rinjve shqiptarë (72%), ku deri në një masë prej 58% hynin në kategorinë e distancës më të fortë.<sup>9</sup> Ata pasoheshin nga maqedonasit (65%), serbët dhe malazezët (53% secila kategori - kryesisht për shkak të distancës ndaj shqiptarëve!), sllovenët (49%) dhe kroatët (39%), ndërsa distanca më e ulët u regjistrua në mesin e jugosllavëve (23 %) dhe muslimanëve (25%). Në përgjithësi, bashkëshortët më të pranueshëm ishin serbët (ndaj të cilëve pothuajse rreth tre të katërtat e të anketuarve nuk shprehën ndonjë distancë), pastaj malazezët, kroatët, maqedonasit dhe sllovenët (ndaj të cilëve pothuajse dy të tretat e të anketuarve nuk treguan ndonjë distancë), ndërsa hungarezët dhe muslimanët ishin më pak dhe pothuajse njësoj të pranueshëm (për gjysmën e të anketuarve). Në anën tjetër, distanca më e madhe e regjistruar ishte ndaj shqiptarëve – një e treta e të anketuarve nuk pranuan anëtarët e këtij kombi si bashkëshort të mundshëm.

---

6 Edhe pse duhet paralajmëruar se të anketuarit e pavendosur nuk mund të barazohen me ata latent apo të fshehu (për shkak se mospërgjigja mund të jetë pasojë e mungesës së qëndrimeve apo përvojave personale ndaj objektit në lidhje me të cilin i padituri është distancuar), ai megjithatë arrin në përfundimin se një pjesë e të anketuarve në këtë mënyrë shprehin mos-pranimin e grupit të caktuar.

7 Kjo i referohet demonstratave masive të shqiptarëve në Kosovë të cilat filluan si protestë studentore në maj të vitit 1981 në kantinën e konvikteve. Ajo që filloi si një rebelim i studentëve kundër kushteve të këqija të jetesës, shpejt u shndërruar në protesta masive me konotacion politik, me parulla me karakter ekonomik dhe social ("Trepça punon, Beogradi ndërton") e që shpejt u zëvendësuan me ato politike ("Kosova Republië", "Kosova e Kosovarëve").

8 Sondazhi u realizua në një mostër prej rreth 5.000 të rinjve, moshë 15-27, në territorin e RSFJ-së.

9 Distancimi ndaj kombeve individuale ka paraqitur bazën për indeksin e përgjithshëm të distancës etnike, pastaj të anketuarit janë i janë bashkuar grupit të atyre pa distancë, me distancë të dobët dhe me distancë më të shprehur.



Kur është fjala për distancim individual, shqiptarët më së shpeshti hodhën poshtë mundësinë e martesës me maqedonasit (62%), malazetët (59%), serbët (58%) dhe hungarezët (51%), ndërsa serbët më së shpeshti refuzuan shqiptarët (48%), muslimanët (25%) dhe sllovenët (24%). Megjithatë, përderisa shqiptarët shprehën të njëjtin nivel të distancimit pavarësisht nga republika/krahina ku ata kishin jetuar, distanca etnike e serbëve ndryshonte varësisht nga përkatësia e tyre e republikës/krahinës: serbët nga Kosova distancoheshin shumë më tepër se sa serbët nga Serbia (pa krahinë) dhe republikat/krahinat tjera (Bosnja dhe Hercegovina, Vojvodina dhe Kroacia).

Në krahasim me të dhënat nga sondazhet e mëparshme, mund të konstatojmë se kjo periudhë pa rritjen e distancës etnike të të rinjve, si në vëllim ashtu dhe në intensitet në raport me vitet e 60-ta, veçanërisht në mesin e të rinjve shqiptarë. Nëse e kujtojmë se kjo ishte periudha kur, për shkak të ndryshimeve të shpallura në Kushtetutën e Serbisë<sup>10</sup> (e cila do të kishte hequr autonominë e gjerë dhënë krahinës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën e RSF të Jugosllavisë të vitit 1974), shpërthyen demonstratat masive të shqiptarëve në Kosovë dhe përfunduan me futjen e gjendjes së jashtëzakonshme, rritja e distancës etnike midis serbëve (kryesisht ata në Kosovë) dhe shqiptarëve në tërësi ishte krejtësisht e pritshme.

Sondazhi i fundit i distancës etnike në mostrën jugosllave u realizua në prag të shpërbërjes së RFS të Jugosllavisë në vitin 1990. Sondazhi kishte për qëllim përcaktimin e shpërndarjes dhe nivelin e distancës etnike midis gjashtë vendeve me numër më të shumtë në Jugosllavi (serbët, malazetët, kroatët, sllovenët, maqedonasit dhe muslimanët), dy nacionalitetete më të mëdha (shqiptarët dhe hungarezët) dhe qytetarët që deklaroheshin si jugosllavë, por vetëm duke marrë parasysh lidhjen sociale martesore (Pantiç, 1991).<sup>11</sup> Rezultatet e sondazhit treguan se gati një e treta e të anketuarve shprehën një mungesë të plotë të distancës ose ajo ishte në minimum (33% e atyre me nëntë apo tetë pranime), distancë e dobët u regjistrua në mesin e 12% të të anketuarve (pranimi i shtatë apo gjashtë kombeve), e mesme (pesë ose katër pranime) në mesin e 14%, e fortë (tre ose dy pranime) në 19% të rasteve dhe më e forta (vetëm një ose asnjë pranim) në 22% të rasteve.

Shpërndarja e distancës etnike duke marrë parasysh shtetësinë tregoi se mungesa e distancës ishte më e shpërndarë në mesin e të anketuarve të cilët ishin deklaruar si jugosllavë (56%), pastaj në mesin e muslimanëve (43%), kroatët dhe hungarezët (41%) dhe serbët (33%), ndërsa afërsia kombëtare ishte më e shpërndarë në mesin e shqiptarëve (69% shprehën distancë të fortë dhe të plotë) dhe sllovenët (65%), duke konfirmuar kështu të gjeturat e vitit 1967 në lidhje me këto grupe si më të mbyllurat.

Duke studiuar në të njëjtën kohë përkatësinë kombëtare dhe territoriale të të anketuarve, grupi më i hapur (pa distancë) ishin jugosllavët nga Vojvodina (70%), të pasuar nga jugosllavët nga Bosnja dhe Hercegovina (58%), muslimanët nga Bosnja dhe Hercegovina (51%) dhe serbët nga Bosnja dhe Hercegovina (47%), ndërsa më pak të hapur ishin serbët dhe shqiptarët nga Kosova (11% secili grup). Nga ana tjetër, distanca më e fortë ishte regjistruar në mesin e shqiptarëve nga Kosova (26% e të anketuarve shprehën distancë të fortë, ndërsa 44% shprehën distancë të plotë) dhe nga Maqedonia (28% dhe 42%), në mesin e Sllovenëve (19% dhe 46%) dhe serbët e Kosovës (49% dhe 13%).

Sa i përket lidhjes së shqyrtuar të mundshme martesore me pjesëtarët e kombeve të tjera, është bërë një matricë e pranimit dhe refuzimit të ndërsjellë të kombeve, e ngjashme me atë të marrë nga

10 Ndryshimet kushtetuese u paraprinë me demonstratat e serbëve në Fushë Kosovë në vitin 1987 kundër diskriminimit të serbëve nga udhëheqja shqiptare e krahinës.

11 Sondazhi është realizuar në mostrën përfaqësuese prej 4.230 qytetarëve të rritur (mbi 18 vjeç). Mostra ishte e tipit probabilistik, me republikat dhe krahinat si shtresat kryesore.



teknika socio-metrike. Edhe pse anëtarët e të gjitha kombeve pranohen si bashkëshortë të mundshëm nga shumica absolute (me përjashtim të muslimanëve dhe shqiptarëve), pranimi ndryshon nga 67% (serbët) në 41% (shqiptarët), ndërsa refuzimi renditet nga 21% (jugosllavët) në 44% (shqiptarët). Devijimet nga vlerat mesatare varen nga përkatësitë kombëtare të të anketuarve.

Kështu pranimi më i madh i të tjerëve ishte karakteristike për jugosllavët, ndërsa distanca më e madh etnike ndaj të gjitha kombeve të tjera ishte shprehur nga Sllovenët (të cilët distancoheshin nga të gjitha kombet e tjera në një shumicë absolute dhe në një mënyrë mjaft të barabartë, përveç se një shumicë e thjeshtë prej tyre i pranonin kroatët përderisa ishin të ndarë me jugosllavët) dhe shqiptarët (të cilët shprehën nivel më të lartë të pranimi se sa të refuzimit vetëm ndaj muslimanëve dhe sllovenëve). Jugosllavët i pranonin të tjerët në 70% të rasteve mesatarisht, pasuar nga hungarezët (62%), serbët dhe kroatët (55% secili), maqedonasit (54%), muslimanët (53%), malazetët (51%), sllovenët (33%) dhe shqiptarët (27%). Në anën tjetër, vende të tjera mesatarisht ishin refuzuar me 51% nga sllovenët, 49% nga shqiptarët, 38% nga maqedonasit, 31% nga serbët, 29% nga kroatët, 28% nga malazetët, 26% nga muslimanët, 20% nga hungarezët dhe vetëm 14% nga të anketuarit të cilët ishin deklaruar si jugosllavë.

Kur është fjala për variablat socio-demografike, ky sondazh tregoi se personat e prirur për distancë etnike, kur është fjala për lidhje të mundshme martesore, kanë qenë më të vjetrit (sidomos femrat), më pak të arsimuar dhe fetarë. Edhe pse dallimet në moshë janë të vogla, gratë e moshuara janë më të distancuarat, ndërsa grupi më i hapur nuk ishin anëtarë të gjeneratës më të re, por të anketuarit në mes 26 dhe 35 vjeç. Niveli i arsimit në disa vende, si për shembull në mesin e shqiptarëve, kishte një ndikim shumë të dobët në uljen e afërsisë së tyre për ndryshim nga, për shembull, sllovenët, ku ndër më të arsimuarit ka pasur pothuajse një numër të dyfishtë të atyre që nuk kanë distancë në krahasim me bashkëqytetarët e tyre me arsim fillor.

Duke krahasuar rezultatet e këtij sondazhi me rezultatet e sondazhit të vitit 1996, Pantić arrin në përfundimin se distanca etnike është rritur në pothuajse të gjitha pjesët e Jugosllavisë së atëhershme (Pantić, 1991). Gjatë periudhës pesëmbëdhjetëvjeçare, duke marrë në konsideratë vetëm lidhjen hipotetike martesore, distanca më së paku ishte rritur në Slloveni (nga mesatarja 47% në 50%), pastaj në Serbi pa krahinat autonome (nga 28% në 35%) dhe në Mal të Zi (nga mesatarisht 20% në 27%), ndërkohë që rritja më e larta ishte në Kroaci (nga mesatarja 15% në 29%) dhe Maqedonia (nga 28% në 39%). Në të gjitha pjesët e analizuar të vendit (Serbia pa krahinat autonome, Mali i Zi, Maqedonia, Kroacia dhe Sllovenia) distanca ndaj shqiptarëve dhe muslimanëve ishte rritur, kryesisht në Kroaci (nga 22% në 43% ndaj shqiptarëve; nga 15% në 37% ndaj muslimanëve) dhe në Serbi pa krahinat autonome (nga 39% në 58% ndaj shqiptarëve, nga 31% në 48% ndaj muslimanëve). Po ashtu, Serbia pa krahinat autonome dhe Mali i Zi patën rritje të distancës etnike ndaj sllovenëve dhe kroatëve, dhe e njëjta ndodhi edhe në Kroaci dhe Slloveni ndaj serbëve dhe malazetëve.

## Rezultatet e sondazhit të distancës etnike në Kosovë, 2014

Sondazhi i realizuar nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd dhe nën kujdesin e Ambasadës Britanike në Beograd kishte për qëllim përcaktimin e shpërndarjes dhe nivelin e distancës etnike në mes të serbëve dhe shqiptarëve në territorin e Kosovës veriore dhe qendrore. Sondazhi u realizua në shkurt të vitit 2014. Aty u përfshinë një numër prej 754 të të anketuarve, nga territoret e komunave të Prishtinës, Graçanicës, Mitrovicës Jugore dhe Mitrovicës Veriore (përfshirë Zveçanin, Zubin Potokun, Leposaviqin, Soçanicën dhe Leshakun)<sup>12</sup>. Sondazhi ka përdorur një shkallë të modifikuar Bogardus të distancës etnike. Të anketuarve iu dhanë marrëdhëniet e mëposhtme si tregues të afërsisë së tyre, respektivisht distancës:

1. të jetë bashkëshorti/ja ime;
2. të jetë dhëndri/nusja ime;
3. të jetë shoku/qja ime (të kalojmë kohë së bashku, të vizitojmë njëri-tjetrin);
4. të jetë shefi im në vendin e punës;
5. të ketë pozitë udhëheqëse në vend;
6. të jetojë në lagjen time (në të njëjtën ndërtesë apo rrugë);
7. të jetë banor i përhershëm i vendit;

Duke u përgjigjur me "po" ose "jo", të anketuarve u është kërkuar që të shprehin gatishmërinë e tyre për të hyrë në marrëdhëniet e listuara më sipër me një anëtar të kombësisë serbe, respektivisht shqiptare. Analiza e rezultateve të fituara tregoi se serbët dhe shqiptarët e Kosovës pranojnë ose të refuzojnë marrëdhëniet e ofruara hipotetike në një masë përafërsisht të barabartë (Tabela 1).

TABELA 1: DISTANCA ETNIKE MES SERBËVE DHE SHQIPTARËVE

	%JO total	%JO shqiptarë	%NO serbë	X2	p (rëndësia)
Të jetë bashkëshorti/ja jote	86.2	84.3	87.7	1.81	0.178
Të jetë dhëndri/nusja jote	77.7	74.1	80.5	4.36**	0.037
Të jetë shoku/qja jote	31.9	31.5	32.2	0.04	0.841
Të jetë shefi yt në vendin e punës	46.4	42.4	49.4	3.63*	0.057
Të ketë pozitë udhëheqëse në vendin tend	66.0	70.4	62.8	4.73**	0.03
Të jetoj në lagjen tënde	23.2	19.8	25.8	3.81*	0.051
Të jetë banor i përhershëm i vendit tend	19.8	16.7	22.1	3.43	0.064

\* P<0.1

\*\* P<0.05

Siç mund të shihet nga tabela 1, marrëdhëniet më pak të pranueshme si për serbët ashtu edhe për shqiptarët janë marrëdhëniet e farefnisë së ngushtë (bashkëshorti, dhëndri/nusja) dhe pozita udhëheqëse në vend. Pra, lidhja martesore hipotetike është refuzuar nga 87.7% të serbëve dhe 84.3% të shqiptarëve, lidhja farefnisore e ngushtë me anë të martesës të fëmijëve nuk pranohet nga 80.5% e serbëve dhe 74.1% e shqiptarëve, ndërkohë që 62.8% e serbëve dhe 70.4% e shqiptarëve nuk duan të

12 Për më shumë hollësi lidhur me modelin shikoni tekstin e Nikola Joviç: "Sondazh i Distancës Etnike në Kosovë".

shohin një shqiptar, përkatësisht serb, në pozitën udhëheqëse të vendit.

Në anën tjetër, marrëdhëniet më të pranuar për të dy grupet etnike janë jetesa e përbashkët në vend, fqinjësi dhe miqësi. Shqiptarët si bashkë qytetarë janë pranuar nga 77.9% e serbëve, ndërsa 83,3% e shqiptarëve i pranojnë serbët në lidhje të tillë; lidhja e fqinjësisë është pranuar nga 74.2% e serbëve dhe 80.2% e shqiptarëve, ndërsa marrëdhënia e miqësisë është pranuar nga 67.8% e serbëve dhe 68.5% e shqiptarëve. Marrëdhënia shef në vendin e punës është pranuar si nga shumica e serbëve (50.6%) ashtu dhe e shqiptarëve (57.6%).

Edhe pse kombësia nuk ka treguar të jetë një ndërlidhje e rëndësishme e distancës etnike, në kuptimin se nuk janë gjetur dallime në mes të serbëve dhe shqiptarëve në shprehjen e distancës etnike (Tabela 2), statistikiqist janë gjetur ndryshime të mëdha në mes të këtyre dy grupeve (në dy nivele të ndryshme të rëndësisë statistikore) kur ka qenë fjala për (mos)pranimin e marrëdhënieve hipotetike si në vijim: "dhëndër/nuse", "shef në vendin e punës", "pozitë udhëheqëse në vend" dhe "të jetojnë së bashku në një lagje". Kështu shqiptarët krijojnë distancë më të madhe në krahasim me serbët vetëm në rastin e "pozitës udhëheqëse në vend", ndërsa në të gjitha marrëdhëniet e tjera (statistikiqist të rëndësishme) serbët tregojnë një distancë më të madhe (Tabela 1).

TABELA 2: REZULTATI I PËRGJITHSHËM I DISTANCËS ETNIKE PËR PËRKATËSI KOMBËTARE

Kombësia	N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
Shqiptare	323	3.39	1.920
Serbe	428	3.61	2.079

$T(749)=1.47, P=.143$

Në bazë të këtyre të gjeturave mund të konstatohet se disa marrëdhënie zyrtare dhe të institucionalizuara (shef në vendin e punës dhe pozita udhëheqëse në vend) janë pranuar në mesin e serbëve dhe shqiptarëve në territorin e Kosovës me më shumë vështirësi se sa marrëdhëniet që zakonisht konsiderohen si private dhe intime (lidhja e miqësisë). Rezultati i tillë, edhe pse nuk duket të ketë justifikim logjik (pasi që lidhja "miqësore" nënkupton një nivel më të lartë të afërsisë se sa lidhja "pozitë udhëheqëse në vend"), nuk është për t'u habitur dhe është në përputhje me pritjet tona për të paktën dy arsye.<sup>13</sup>

Së pari, në rastet e marrëdhënieve shumë të institucionalizuara (kuptuar nga pozita e kreut të shtetit), anëtar i kombit tjetër perceptohet më tepër si përfaqësues (zyrtar) i atij grupi se sa si një individ, dhe "t'i mundësosh anëtarit të një kombi tjetër të jetë president i shtetit..." do të thotë "ta nderosh dhe të tregosh besim ndaj gjithë atij kombi", dhe jo vetëm ndaj individit (Kuzmanović 2001: 212). Duke pasur parasysh konfliktet me dekada të gjata të manifestuar dhe latente në mes të këtyre dy grupeve etnike në territorin e Kosovës, niveli i lartë i refuzimit të kësaj lidhjeje si nga serbët ashtu edhe nga shqiptarët duket krejtësisht e kuptueshme. Një tjetër arsye për refuzimin e kësaj lidhjeje ka të bëjë me gjendjen aktuale politike në Kosovë. Pra, pas pavarësisë së vetëshpallur të Kosovës dhe refuzimit të Serbisë për ta njohur pavarësinë, mungesa e gatishmërisë për ta pranuar një anëtar të një kombi tjetër si personin që do të zë pozitën udhëheqëse në vend është plotësisht e pritur.

13 Rezultate të ngjashme me këto janë marrë në disa sondazheve të mëparshme të kryera në territorin e RSF të Jugosllavisë (Pantić, 1967), Serbia pa Kosovën (Kuzmanović, 1994) dhe Malin e Zi (Kuzmanović, 2001).

TABELA 3: DISTANCA ETNIKE NË MES TË SERBËVE DHE SHQIPTARËVE DUKE MARRË PARASYSH LIDHJEN SOCIALE MARTESORE

	%JO Serbë	%JO Shqiptarë
1990	57	60
2014	88	84

1991: Sondazh i mostrës jugosllave të moshës mbi 18 (vetëm martesë)

2014: Sondazh i realizuar në territorin e Kosovës veriore dhe qendrore (vetëm martesë)

Për të identifikuar intensitetin e distancës së ndërsjellë etnik të serbëve dhe shqiptarëve, të anketuarit në këtë sondazh janë klasifikuar në katër grupe (duke pasur parasysh numrin e përgjigjeve negative): pa distancë (0 përgjigje negative), me distancë të vogël (1-2 përgjigje negative), me distancë të moderuar (3-5 përgjigje negative) dhe me distancë të madhe (6-7 përgjigje negative). Rezultatet treguan se, në lidhje me marrëdhënien e tyre ndaj shqiptarëve, 9.1% e serbëve nuk kanë shprehur fare distancë, 25.2% shprehën distancë të vogël, 46,5% distancë të moderuar, ndërsa 19,2% shprehën distancë të madhe. Sa i përket marrëdhënies së shqiptarëve ndaj serbëve, 4% prej tyre nuk kanë shprehur fare distancë, 34.1% shprehën distancë të vogël, 45.8% distancë të moderuar 16.1% shprehën distancë të madhe.

Kur është fjala për variablat socio-demografike, dallimet e rëndësishme të lartë statistikore u gjetën në lidhje me gjininë e të anketuarve. Njësoj si në sondazhet e mëhershme, edhe ky sondazh tregoi (në nivel të mostrës në tërësi) se gratë janë më të prirura për tu distancuar se sa meshkujt. Nëse i krahasojmë të dy grupet etnike, do të shohim që si në mesin e serbëve (Tabela 4) ashtu edhe në mesin e shqiptarëve (Tabela 5) femrat tregojnë një nivel statistikiqsh shumë më të rëndësishëm të distancimit (në nivelin prej 99%), dhe se këto dallime janë më të dukshme në mesin e shqiptarëve.

TABELA 4: DISTANCA GJINORE DHE ETNIKE E SERBËVE

Gjinia	N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
Mashkull	196	3.29	2.262
Femër	216	3.82	1.835

T (410)=2.64, P=.009

TABELA 5: DISTANCA GJINORE DHE ETNIKE E SHQIPTARËVE

Gjinia	N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
Mashkull	145	2.89	1.819
Femër	177	3.79	1.912

T (320)=4.30, P=.000

Mosha nuk ka paraqitur ndonjë lidhshmëri të konsiderueshme në distancën etnike në nivelin e mostrës në tërësi. Kjo do të thotë se, sa i përket moshës së të anketuarve, nuk kishte dallime

statistikisht të rëndësishme në distancë etnike, edhe në qoftë se secila kategori krahasohet me tjetrën sipas moshës, matur me testin LSD post-hoc. Megjithatë, nëse i krahasojmë dallimet e distancës etnike sipas moshës së të anketuarve për shqiptarët dhe serbët, situata është pak më ndryshe. Siç mund të shohim, dallimet në moshë mes shqiptarëve janë shumë të rëndësishme statistikisht, me nivelin më të lartë të distancës midis të anketuarve mes 36 dhe 55, dhe me nivelin më të ulët të regjistruar në mesin e atyre të moshës mes 26 dhe 35. (Tabela 6).

TABELA 6: VLERAT MESATARE TË DISTANCËS ETNIKE SIPAS MOSHËS PËR SHQIPTARËT

Mosha	N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
18-25	118	3.20	1.833
26-35	71	2.99	1.832
36-55	76	4.04	1.907
56 dhe më lart	58	3.41	2.044
Total	323	3.39	1.920

$F(3, 319)=4.46, P=.004$

Megjithatë, në mesin e serbëve nuk janë gjetur dallime statistikisht të rëndësishme në distancën etnike sa i përket moshës së të anketuarve. (Tabela 7)

TABELA 7: VLERAT MESATARE TË DISTANCËS ETNIKE SIPAS MOSHËS PËR SERBËT

Mosha	N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
18-25	120	3.86	2.079
26-35	129	3.46	2.125
36-55	106	3.37	1.982
56 dhe më lart	73	3.81	2.113
Total	428	3.61	2.079

$F(3, 424)=1.51, P=.212$

Një korrelacion negativ është gjetur mes distancës etnike dhe nivelit të arsimit ( $r=-0.158$ ), që do të thotë se distanca etnike zvogëlohet me rritjen e nivelit të arsimit dhe anasjelltas. Megjithatë, këtu ekzistojnë disa dallime në mesin e serbëve dhe shqiptarëve. Në rastin e shqiptarëve, janë gjetur dallime me rëndësi të lartë statistikore në distancën etnike në lidhje me nivelin e arsimit. Të anketuarit me arsimim fillor treguan distancën më të madhe, ndërsa të anketuarit me arsimim universitar treguan distancën më të vogël (Tabela 8). Ky rezultat është në kundërshtim me rezultatet e sondazheve të viteve të 90-ta, kur niveli i arsimit në mesin e shqiptarëve kishte një ndikim shumë të ulët në nivelin e distancës etnike ndaj kombeve të tjera.

TABELA 8: VLERAT MESATARE TË DISTANCËS ETNIKE PËR SHQIPTARËT SIPAS NIVELIT TË ARSIMIMIT

	N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
Shkolla fillore	6	5.17	1.329
Shkolla e mesme	158	3.72	1.945
Dy vite pas sh. së mesme	7	3.86	2.673
Universiteti	152	2.95	1.773
Total	323	3.39	1.920

$F(3, 319)=6.34, P=.000$

Në mesin e serbëve dallimet sipas nivelit të arsimit ishin paksa më pak të theksuara, por megjithatë të rëndësishme në nivelin prej 95% (Tabela 9). Njëjtë sikurse tek shqiptarët, të anketuarit me arsimim universitar tregojnë distancë më të vogël.

TABELA 9: VLERAT MESATARE TË DISTANCËS ETNIKE PËR SERBËT SIPAS NIVELIT TË ARSIMIMIT

	N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
Shkolla fillore	23	3.61	2.330
Shkolla e mesme	232	3.72	2.071
Dy vite pas sh. së mesme	44	3.48	2.029
Universiteti	95	2.97	1.949
Total	394	3.51	2.069

$F(3, 390)=3.03, P=.029$

Përveç shkallës së modifikuar Bogardus, pyetësi përmbante edhe dhjetë pyetje shtesë për të kuptuar dhe shpjeguar më mirë distancën etnike në mes të serbëve dhe shqiptarëve në territorin e Kosovës.<sup>14</sup> Njëra prej tyre thoshte: "Mbi çfarë baze krijoni qëndrimin tuaj për pjesëtarët e kombit tjetër?" Të anketuarit të cilët kanë deklaruar se qëndrimet e tyre në lidhje me pjesëtarët e nacionalitetit serb/shqiptar janë formuar në bazë të përvojës personale kanë treguar nivel më të ulët të distancës etnike në krahasim me ata që qëndrimin e tyre nuk e kanë të bazuar në përvoja personale, ndërsa të anketuarit të cilët pohuan se qëndrimet e tyre janë formuar në bazë të deklaratave të politikanëve dhe informacioneve të marra nga mediat kishin një distancë etnike më të theksuar (të fortë) në krahasim me ata të cilët qëndrimet e tyre i kishin formuar në ndonjë mënyrë tjetër. Duke pasur parasysh këto rezultate, lidhja negative ndërmjet distancës etnike dhe shpeshësisë së bërjes miq ( $r = -0.440$ ) e llogaritur në këtë sondazh na çon në përfundimin se kontakti i drejtpërdrejtë i anëtarëve të këtyre dy kombeve redukton distancën e tyre të përbashkët, e jo e kundërta: që të anketuarit me një distancë më të vogël janë më të gatshëm të hyjnë në

14 Për më shumë hollësi shikoni tekstin e Nikola Jović: "Sondazh i Distancës Etnike në Kosovë".

marrëdhënie më të ngushta (siç është miqësia) me anëtarët e kombit tjetër. Duke pasur parasysh se një përqindje e vogël e të anketuarve deklaroi se qëndrimet e tyre për popullin tjetër janë formuar në bazë të qëndrimeve të politikanëve dhe informacioneve nga mediat e duke i krahasuar me ata të cilët deklaruan se mendimi i tyre është formuar në bazë të përvojës personale, përfundimi del se intensiteti, por jo shpërndarja e distancës etnike, është e shkaktuar të paktën pjesërisht nga politika aktuale dhe propaganda e medieve.

## **Distanca etnike e serbëve dhe shqiptarëve - në të kaluarën dhe sot**

Sondazhet empirike të distancës etnike të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë nga vitet e 60-ta deri në fund të viteve të 80-ta vazhdimisht kanë vënë në pah distancimin e ulët të kombeve jugosllave. Megjithatë, edhe pse në përgjithësi në nivel të ulët gjatë viteve të 60-ta, distanca etnike e kombeve jugosllave edhe në atë kohë ndryshonte për nga shpërndarja dhe intensiteti duke marrë parasysh përkatësinë kombëtare dhe përkatësinë e republikës së të anketuarve. Kështu niveli më i lartë i distancës etnike u regjistruar në Slloveni dhe Kosovë, ndërsa shqiptarët edhe në atë kohë ishin kombi ndaj të cilit të gjitha kombet e tjera ishin më së shumti të distancuar, veçanërisht në lidhje me marrëdhëniet më intime (martesat).

Në mes të viteve të 80-ta vazhdoi trendi i distancës së dobët etnike, edhe pse shqiptarët, pas romëve, ende mbeteshin kombi ndaj të cilit distanca manifestuese (e hapur) shprehej në masën më të madhe. Nga ana tjetër, tek shqiptarët kjo periudhë shënoi një nivel jashtëzakonisht të ulët të distancës etnike ndaj të gjitha kombeve tjera. Duke pasur parasysh se ky sondazh u realizua pas shpërthimit të demonstratave masive të shqiptarëve në Kosovë në vitin 1981, distanca e ulët etnike e regjistruar në atë kohë tek shqiptarët mund të shpjegohet me përmbajtjen e tyre për tu shprehur për të për shkak të presioneve dhe sanksioneve me të cilat ballafaqoheshin për pretendimet e tyre nacionaliste. Në këtë kontekst ne mund të kuptojmë një distancë etnik shumë më të theksuar latente të shqiptarëve në këtë periudhë kohore. Megjithatë, fundi i viteve të 80-ta solli ndryshime në fushëveprimin dhe nivelin e distancës etnike (të manifestuar) sidomos në mes të të rinjve serbë dhe shqiptarë. Në këtë periudhë, shqiptarët jo vetëm që ishin populli ndaj të cilëve më së shumti shprehej distancë etnike, por në të njëjtën kohë ishte populli i cili distancohej më së shumti nga të gjithë popujt e tjerë në ish-Jugosllavi. Nuk ka dyshim se konfliktet e hapura të nationalistëve shqiptarë me elitën politike të Serbisë në vitin 1989 dhe raportet e tensionuara ndëretnike në Kosovë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e distancës etnike midis këtyre dy kombeve. Ky trend i rritjes së distancës etnike është konfirmuar edhe në sondazhin e kryer në prag të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, kur distanca më e fortë është regjistruar pikërisht në mes të serbëve dhe shqiptarëve nga Kosova. Miratimi i ndryshimeve kushtetuese më 1989 dhe miratimi i Kushtetutës së Republikës së Serbisë më 1990, e cila reduktonte të drejtat dhe kompetencat të cilat Kosova si krahinë autonome kishte gëzuar deri atëherë në bazë të Kushtetutës së vitit 1974, të gjitha kanë kontribuar në konfliktet dhe armiqësitë e rritura në mes të këtyre dy popujve, e cila është reflektuar në rritjen e distancës së tyre të përbashkët etnike.

Edhe pas një çerek shekulli të realizimit të sondazhit të fundit në territorin e ish-Jugosllavisë, distanca etnike në Kosovë nuk ka regjistruar rënie. Lufta civile në ish-Jugosllavi, pasuar me konfliktet e armatosura në territorin e Kosovës në gjysmën e dytë të viteve të 90-ta, bombardimet e NATO-s në RF të Jugosllavisë në vitin 1999, si dhe pavarësia e vetëshpallur e Kosovës në vitin 2008, janë të gjitha ngjarje të cila kanë ndikuar në masë të madhe në armiqësinë reciproke të serbëve dhe shqiptarëve

gjatë 25 viteve të fundit. Megjithatë, edhe pse si serbët ashtu edhe shqiptarët sot refuzojnë marrëdhëniet më të afërta (martesore dhe lidhje të afërta familjare përmes martesave të fëmijëve), një rezultat inkurajues nga sondazhi ynë patjetër që është se lidhja e miqësisë me anëtarët e kombit tjetër është e pranueshme për shumicën absolute të të dyja grupeve etnike. Sa i përket distancës së lartë në pranimin e disa marrëdhënieve zyrtare (shef në vendin e punës, pozita udhëheqëse në shtet), ne besojmë se negociatat e suksesshme midis Beogradit dhe Prishtinës, së bashku me një periudhë të gjatë paqeje dhe stabiliteti, do të kontribuonin në uljen e distancës etnike në këtë sferë, e cila përfundimisht do të çojë në uljen e distancës së përgjithshme etnike në Kosovë. Duke pasur parasysh peshën e armiqësisë ndëretnike me dekada të gjatë, që është trashëgimi e Kosovës, rivendosja e afërsisë në mes të këtyre dy kombeve nuk do të jetë proces i shpejtë dhe as i thjeshtë.



## Literatura

- Bačević, Lj. (1990) "Nacionalna svest mladih", në Mihailović, S. et al.: Deca krize, Institut društvenih nauka, Belgrade.
- Bogardus E. S. (1925) "Social Distance and Its Origins", *Journal of Applied Sociology* 9, pp. 216-226.
- Bogardus E. S. (1925a) "Measuring Social Distances", *Journal of Applied Sociology* 9, pp. 299-308.
- Fiamengo, A. (1960) "Studenti Sarajevskog univerziteta – pitanje braka posmatrano iz aspekta nacionalne i religiozne pripadnosti i stepena obrazovanja bračnih drugova", *Sociologija*, No. 1.
- Havelka, N., Kuzmanović, B., Popadić, D. (1998) *Metode i tehnike socijalnopsiholoških istraživanja*, Centar za primenjenu psihologiju, Belgrade.
- Kuzmanović, B. (1994) "Socijalna distanca prema pojedinim nacijama (etnička distanca)", in Lazić, M. et al.: *Razaranje društva*, Filip Višnjić, Belgrade, pp. 225-244.
- Kuzmanović, B. (2001) "Etnička distanca u Crnoj Gori", in Đukanović, B., Kuzmanović, B., Lazić M., Bešić, M.: *Nacija i država: istraživanje nacionalne svijesti stanovništva o državi u Crnoj Gori*, CID, SoCEN, Podgorica.
- Pantić, D. (1967) *Etnička distanca u SFRJ*, Institut društvenih nauka, Centar za istraživanje javnog mnjenja, Izveštaji i studije, Sveska 2, Belgrade.
- Pantić, D. (1987) "Karakteristike socijalne distance zaposlenih u društvenom sektoru", *Sociologija*, pp. 559-602.
- Pantić, D. (1991) "Etnička distanca građana Jugoslavije", in Bačević, Lj. et al.: *Jugoslavija na kriznoj prekretnici*, Institut društvenih nauka, Centar za politikološka istraživanja i javno mnjenje, Belgrade.
- Pantić, D. (2014) "Društvena udaljenost građana Srbije od nekih ranjivih grupa", *Politički život- Časopis za analizu politike*, No. 10, pp. 17-29.
- Rot, N. (2006) *Osnovi socijalne psihologije*, Zavod za udžbenike i nastavna sredstva, Belgrade.
- Supek, R. (1963) *Psihologija radne akcije*, Mladost, Belgrade.
- Vasović, M. (1995) "Osnovne karakteristike grupnih identifikacija u populaciji", in Golubović, Z., Kuzmanović, B., Vasović, M.: *Društveni karakter i društvene promene u svetlu nacionalnih sukoba*, Institut za filozofiju i društveni teoriju "Filip Višnjić", Belgrade.

Bekim Baliqi

## Prej negociatave të Vjenës deri në marrëveshjen e Brukselit: Rregullimi i raporteve ndër-etnike në Kosovë

Ky punim do të analizoj negociatat midis Beogradit dhe Prishtinës me qëllim që të shpjegoj qëndrimet e të dyja palëve për çështjen e Kosovës dhe të elaboroj se si këto marrëveshje kanë rregulluar marrëdhëniet ndëretnike. Do të krahasohen bisedimet për statusin e ardhshëm të Kosovës, të mbajtura në Vjenë dhe dialogut për normalizimin e marrëdhënieve nga perspektivat e ndryshme kritike. Për më tepër do të shqyrtohen rezultatet dhe zbatimin e marrëveshjeve në praktikë, si dhe sfidat dhe shanset e mundshme. Këtu është elaboruar gjithashtu edhe e ardhmja e këtyre negociatave dhe janë bërë përpjekje që të ofrohet një përgjigje për pyetjet se çfarë mund të pritët nga përfundimi i tyre; Normalizimi i marrëdhënieve ndëretnike apo pajtimin ndërmjet tyre, si vende fqinje, si dhe si komunitete në Kosovë? Si dhe janë bërë supozimet në vijim në këtë hulumtim; se qëndrimet e kontestuara dhe marrëdhëniet e tensionuara ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, kanë përcaktuar marrëdhëniet ndëretnike mes serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë që vetëm përmes negociatave, të udhëhequra nga BE, marrëdhëniet mund edhe të normalizohen. Një tjetër hipotezë është se për shkak të mosbesimit të thellë mes shqiptarëve dhe serbëve dhe ndjenjave nacionaliste, arritja e marrëveshjeve, pa ndonjë zhvillim të konsiderueshëm ekonomik dhe perspektivë evropiane, janë në afat të gjatë të paqëndrueshme. Pyetjet e përmendura më sipër do të trajtohen në kapitullin e fundit dhe supozimet do të testohen në kapitullin përmblyës.



Marrëveshja e Brukselit,  
Negociatat e Vjenës, serbët në  
Kosovë, UE dhe Kosova



Ky tekst u shkrua fillimisht në  
gjuhën shqipe.

## Hyrje

Procesi i shtetformimit të Kosovës, i krijuar si rezultat i një plani të negociuar ndërkombëtar, i njohur edhe si Plani i Ahtisaarit, ka zgjuar interesim të madh si në botën akademike ashtu edhe në qarqe të ndryshme politikbërëse. Madje, vazhdon jo rrallë të përdoret si analogji edhe për raste të ndryshme, siç ishte së fundmi rasti me Krimenë. Tash, tre vite pas fillimit të negociatave mes Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel, Kosova ende nuk duket si një vend që i ka zgjidhur të gjitha sfidat- si telashtet e brendshme socio-ekonomike dhe rendit ligjor ashtu edhe ato të jashtme. Në rend të parë, çështja e mosnjohjes nga shumë shtete të botës dhe pamundësia e anëtarësimit në mekanizmat e organizatat e ndryshme ndërkombëtare e kanë bërë këtë shtet që të vazhdojë të jetë ende një lloj sui generis në marrëdhënie dhe në të drejtën ndërkombëtare. Gjithashtu, çështja e veriut të vendit, e cila nuk është ende integruar brenda sistemit politik e juridik të Kosovës, paraqet një problem serioz si politik ashtu edhe të sigurisë. Në këto, por edhe në shumë çështje tjera të hapura, raporti i Serbisë karshi Kosovës, respektivisht kontestimi i shtetësisë së saj mbetet faktor shumë i rëndësishëm.

Prandaj, për të zgjidhur këtë nyje gordiane, e cila jo vetëm që po dëmton Kosovën por po e lë tërë rajonin të tensionuar dhe peng në proceset integruuese evropiane, është paraqitur nevoja imediate e fillimit të negociatave mes këtyre shteteve për të gjetur zgjidhje të pranueshme për të dyja palët. Nisur nga përvojat historike si dhe marrëdhëniet e acaruar mes tyre, ndërmjetësimi nga ana e bashkësisë ndërkombëtare ka qenë më se i domosdoshëm. Në këtë rast, Bashkimi Evropian mori rolin vendimtar si në lehtësimin e bisedimeve ashtu edhe në garantimin e marrëveshjeve të arritura. Meqenëse kjo nismë nuk do të ishte tërësisht pa kundërshtime të ndryshme e të shumta politike si në Prishtinë ashtu edhe në Beograd, këto fillimisht u emërtuan me eufemizëm e me terma të buta diplomatike, u udhëhoqën nga nivelet më pak të rëndësishme zyrtare dhe u nisen më çështja më pak delikate. Sidoqoftë, më kalimin e kohës u zhvilluan raunde të ndryshme bisedimesh dhe ky dialog filloi të merr gjithnjë e më shumë karakter politik duke kulmuar me takime ndërmjet kryeministrave dhe përfundimisht me marrëveshjen mes tyre me 19 prill 2013. Sidoqoftë, historiku i negociatave mes dy palëve është i kahershëm dhe jo edhe aq konstruktiv. Prandaj qëllimi i këtij studimi është krahasimi i këtyre negociatave, pra ato të Vjenës 2006-2007, si dhe këto të Brukselit 2011 e tutje, për të kuptuar zhvillimet dhe mundësitë që negociatat aktuale do të kenë.

Në këtë punim, do të fillohet me përshkrimin historik të negociatave të mëhershme mes Beogradit dhe Prishtinës me qëllim që të pasqyrohen qëndrimet dhe veprimet e dy vendeve në raport me zgjidhjen e çështjes së Kosovës si dhe aranzhimin e marrëdhënieve ndëretnike. Më pas, fokusi do të bie mbi kontekstin politik dhe qëndrimin e qeverive përkatëse pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Në këtë kapitull, do të përqendrohemi në fillimin e negociatave të Brukselit, në etapa të ndryshme përfshirë këtu edhe marrëveshjet e arritura. Në pjesën vijuese do të shqyrtohen pozicionet e palëve negociuese, pra ato serbe dhe kosovare. Zbatimi i marrëveshjeve të arritura në praktikë, sfidat eventuale dhe bilanci i deritashëm do të shtjellohen po ashtu. Përfundimisht, do të shqyrtohet e ardhmja e këtyre negociatave si dhe kërkohet përgjigja në atë se çka mund të pritet nga përfundimi i tyre, normalizim raportesh ndëretnike, pajtim mes palëve apo edhe e njohje reciproke e dy vende fqinje?

Studimi del me këto hipoteza; se raportet kontestuese dhe tensionuara ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, kanë përcaktuar edhe marrëdhëniet ndër-etnike brenda Kosovës; se vetëm përmes negociatave mes tyre, e të udhëhequra nga BE-ja, këto edhe mund të normalizohen. Teza tjetër është, që për shkak të mosbesimit të thellë mes shqiptareve dhe serbeve si rezultat i qëndrimeve nacionaliste, marrëveshjet e arritura, pa ndonjë zhvillim të konsiderueshëm ekonomik dhe perspektive evropiane, në plan afatgjatë nuk do të jenë të qëndrueshme.

Gjatë analizës së këtyre negociatave, ndër sfidat themelore është paraqitur mungesa e transparencës së plotë të dokumenteve zyrtare, përfshirë këtu agjendat zyrtare të negociatave si dhe publikimi i versioneve zyrtare të marrëveshjeve të arritura. Në fakt, proceset negociuese janë mjaft të ndjeshme politikisht dhe praktikisht ndërkombëtare flasin zakonisht për mungesa të tilla të transparencës, sidomos gjatë procesit të zhvillimit të tyre, siç është rasti këtu. Së këndejmi një pjesë e burimeve është shfrytëzuar nga mediet e ndryshme si kosovare, serbe dhe ndërkombëtare por edhe nga burimet tjera sekondare.

## Konteksti i negociatave

Pas përmbylljes së pasuksesshme të negociatave mes delegacionit serb dhe atij kosovar në kështjellën franceze Rambouillet dhe më pas vazhdimi i tyre në Paris, rrjedha e ngjarjeve në Kosovë mori një kthesë dramatike duke pasuar me sulmet e NATO-s ndaj forcave serbe që zgjatën plot 78 ditë dhe rezultuan me tërheqjen përfundimtare të tyre dhe përfundim e luftës në Kosovë (Weller 2000). Duke u bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Kosova u vu nën administrimin e përkohshëm nga Misioni i Kombeve të Bashkuara i njohur me shkurtesën UNMIK, duke i ndërtuar gradualisht institucionet vetëqeverisëse por duke mos paragjykuar statusin e vendit. Ky administrim me kalimin e viteve filloi të ishte jo vetëm jo efikas por edhe pengues i proceseve pajtuese dhe atyre demokratike. Siç është përcaktuar me saktësi nga disa autorë: "Ky nuk ishte një dokument i projektuar për të përshkruar të ardhmen afatgjatë të Kosovës, por ishte një marrëveshje diplomatike për t'i dhënë fund fushatës së bombardimeve." (Judah 2001, f.55). Zgjidhja përfundimtare e statusit juridik e politik i Kosovës kërkohej gjithnjë e më shumë si nga aktorët vendor ashtu edhe nga ata ndërkombëtar (Goodwin 2007). Në këtë kuptim, në fillim të vitit 2006 filluan negociatat mes palës kosovare dhe asaj serbe të njohura më shumë si negociatat e Vjenës.

### NEGOCIATAT E VJENËS

Negociatat për statusin përfundimtar të Kosovës u ndërmjetësuan nga Zyra e të Dërguarit të posaçëm për Kosovën (UN Office of the Special Envoy for Kosovo- UNOSEK) dhe udhëhiqeshin nga i emisari i posaçëm i OKB-së për Kosovën, ish-presidenti finlandez Martti Ahtisaari si dhe zëvendësi i tij ishte diplomati austriak Albert Rohan duke bashkëpunuar ngushtë me shtetet e Grupit të Kontaktit dhe aktorë të tjerë relevantë ndërkombëtar (Këshillin e Sigurimit, NATO, Komisionin Evropian etj). Parimi themelor i ndërmjetësuesve ishte se nuk do të kishte kthim mbrapa në situatën që kishte ekzistuar në Kosovë para vitit 1999 dhe se çdo zgjidhje e njëanshme dhe e bazuar në përdorimin e forcës do të ishte e papranueshme.

Delegacioni i Kosovës përfaqësohej nga niveli më i lartë politik, i udhëhequr fillimisht nga presidenti Ibrahim Rugova dhe pas vdekjes së tij nga presidenti Fatmir Sejdiu dhe njihej me emërtimin simbolik "Ekipi i Unitetit" pasi aty ishin përfshirë përfaqësuesit si të qeverisë ashtu edhe të opozitës. Ky delegacion përkrahej edhe nga një mekanizëm i krijuar nga "Grupi Politik Strategjik" i përbërë nga përfaqësuesit më të lartë të Kosovës. Delegacioni i Serbisë kishte zgjedhur për përfaqësim qeveritarët të rangut më të ulët, kryesisht zyrtar nga radhët e ministrisë së saj të jashtme, ekspertë dhe përfaqësuesit e "komuniteteve minoritare" të Kosovës. Pozicionet e dy palëve ishin diametralisht të kundërta dhe gjatë atij viti u mbajtën 15 raunde të negociatave të drejtpërdrejta ku çështja e decentralizimit, të drejtat e komuniteteve dhe vetëqeverisjes lokale ishin temë boshte. Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, iu dorëzua të dy palëve më 2 mars 2007. Pas

14 muajsh negociatash diplomatike dhe pas refuzimit nga ana e Serbisë për propozimin e "Pakos së Ahtisaari", i dërguari special i paraqiti Këshillit të Sigurimit një propozim gjithëpërfshirës, i cili kërkon pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën (Weller 2008). Kosova, ndër tjerash obligohej, që të decentralizoj pushtetin lokal duke krijuar 5 komuna të reja më shumicë serbe ofruar kompetenca të shtuara vetëqeverisëse.

Ashtu si edhe më parë në rastin e Rambouille-s, pala serbe iu kthye taktikës së kërkesave për ri-negociata dhe të propozimeve të reja, por që ishin në kundërshtim të plotë me marrëveshjet e arritura dhe realitetin në terren. Pas kalimit të një periudhe prej 120 ditësh që nga shqyrtimi i Këshillit të e Sigurimit të OKB-së të propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës (Kombet e Bashkuara S/2007/169/Add.1), më 17 shkurt 2008 Kosova u shpall shtet i pavarur dhe sovran.

## Negociatat e Brukselit

### KONTEKSTI POLITIK PARA FILLIMIT TË DIALOGUT

Rrethanat e reja të krijuara pas shtetësisë së Kosovës, ka bërë që Beogradi por edhe Prishtina të vazhdojnë me raporte të tendosura, por që shumë çështje jetike mbeten të hapura për qytetarët e të dy vendeve. Gjithashtu, shpallja e pavarësisë së Kosovës pati reflektim edhe në skenën e brendshme të Serbisë duke thelluar mospajtimet ndërmjet partnerëve të koalicionit, presidentit Vojislav Koštunica dhe kryeministrit Boris Tadić. Qeveria e Serbisë si masë kundërshtuese i tërhoqi përkohësisht ambasadorët serb nga ato vende të cilat e njohën shtetin e Kosovës, si dhe paraqiti kërkesën pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë rreth ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Ardhja e një qeverie të re në Serbi po atë vit, ndryshoi paksa qasjen, duke bashkëpunuar jo vetëm me UNMIK-un por edhe me misionin e BE-së në Kosovë, EULEX-in. Megjithatë, pavarësia e Kosovës refuzohej edhe më tej kategorikisht.

Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtaree Drejtësisë për pavarësinë e Kosovës u shpall në korrik 2010 dhe ishte pozitiv në lidhje me deklaratën e njëanshme të pavarësisë (Mendimi këshilldhënës i Gjykatës Ndërkombëtare Drejtësisë mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës, 22 korrik 2010). Kjo shkaktoi një goditje të rëndë të politikës serbe ndaj Kosovës. Disa muaj më vonë me presion nga ana e përfaqësueses së lartë të BE-së baroneshës Catherine Ashton, Serbia së bashku me BE-në përpiloi një rezolutë për OKB-në ku kërkohet transferimi i çështjeve të pazgjidhura serbe-kosovare nga organet e OKB-së në institucione të BE-së.

Në anën tjetër në Kosovë filloi transferimi final i kompetencave nga ana e ndërkombëtareve në ato vendore dhe zbatimi i Pakos së Ahtisaarit, përfshirë miratimin e Kushtetutës dhe mekanizmave tjerë shtetërorë. Sidoqoftë, në vitin 2010 përplasjet mes partnerëve të koalicionit qeverisës u thelluan në shpërbërje të qeverisë dhe rrjedhimisht në një krizë institucionale disamujore. Pas zgjedhjeve parlamentare u krijua koalicioni qeverisës i ri, gjë që i hapi rrugë fillimit të bisedimeve me Serbinë. Stimulimi më i madh për të dy vendet vinte nga ana e BE-së dhe ka të bëjë me përfitimet por edhe kushtëzimet në procesin e integrimi evropiane. Së këndejmi të dy vendet u detyruan të ulen përsëri në tavolinën e bisedimeve.

## NGA “DIALOGU TEKNIK” NË MARRËVESHJE POLITIKE

Konteksti i ri i krijuar pas shtetësisë së Kosovës ka bërë që Beogradi dhe Prishtina të vazhdojnë më raporte të tendosura, mirëpo shumë çështje të hapura mes tyre kërkonin të gjenin zgjidhje. Pas miratimit të rezolutës së përbashkët të Serbisë dhe BE-së pranë OKB-së, për herë të parë publikisht u bë i njohur edhe fillimi i bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë të njohura edhe si bisedime teknike. Mirëpo, rrethanat e krijuara në Kosovë pas krizës institucionale dhe shpallja e zgjedhjeve të përgjithshme, bën që fillimi i tyre të shtyhet për disa muaj. Pas formimit të qeverisë së Kosovës, u krijua delegacioni kosovar për bisedime i udhëhequr nga zëvendës-kryeministria Edita Tahiri, kurse kryenegociator serb u caktua Borislav Stefanovič, drejtor politik në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Serbisë. Ndërsa, ndërmjetësues apo lehtësues siç prezantohej nga ana e BE-së ishte caktuar diplomat i lartë Robert Cooper si i emisar i posaçëm i Përfaqësueses së Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri Catherine Ashton.

Dialogu filloi me takimin e parë ndërmjet palëve, që u zhvillua në Bruksel me 8 mars, ku tema boshte ishin përfaqësimi rajonal, liria e lëvizjes dhe sundimi i ligjit. Dy ditë më pas Kuvendi i Kosovës miratoi rezolutën për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë në mbështetje të saj për, siç thuhet aty “çështjet teknike të interesit të përbashkët, pa prekur në asnjë rast sovranitetin e Kosovës (...).” (Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për dialogun mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, 10 Mars 2011)

Raundi i dytë i bisedimeve filloi po atë muaj dhe ngërthej një varg temash duke filluar me çështjen e vulave doganore, targarat e automjeteve, regjistrat civil si dhe rreth energjetikës. Takimi i radhës u zhvilluar në Prill ku në agjendë të bisedimeve ishin çështjet rreth certifikatave të lindjes, vdekjes, targarat dhe pranimit të diplomave universitare të cilat në takimin e radhës u arritën edhe si marrëveshje. Dialogu ndërpritet për disa kohë, pas përpjekjeve të njësiteve speciale të Kosovës për marrjen nën kontroll të pikave doganore në pjesën veriore të vendit. Kjo situatë u tensionua pasi një polic u vra dhe serbët ngritën barrikada të shumta dhe dogjën pikat doganore. Raundi i ri i bisedimeve fillon përsëri në Shtator, kur arrihen marrëveshjet për vulën doganore dhe çështjet e kadastrave. Reagimet e serbëve të Kosovës dhe disa incidente quan në bllokimin e radhës të dialogut që pas disa vizitave në Beograd dhe Prishtinë nga ndërmjetësuesi Cooper, zhbllokohen. Në raundin e ri të bisedimeve arrihet marrëveshja e ashtuquajtur për Integrimin e Menaxhuar të Kufirit (IBM) që shihej si një hap i rëndësishëm në procesin e dialogut. Raundi i ri i bisedimeve në Shkurt ku çështja qendrore ishte përfaqësimi i Kosovës në nismat dhe bashkëpunimet rajonale solli edhe marrëveshjen e re mjaft kundërtënëse ku parashihej që Kosova të përfaqësohej me fusnotën ku shënohej; “Pa paragjykim për pozicionin e palëve për statusin, në përputhje me Rezolutën 1244 të KS dhe Opininionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.”

Gjatë kësaj periudhe kohore janë zhvilluar nëntë (9) raunde takimesh dhe janë arritur shtatë (7) marrëveshje, apo në gjuhën diplomatike, konkluzione, që përfshijnë; lirinë e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, kthimin e regjistrave civil, të kadastrave, njohjen e diplomave universitare, njohjen e vulave doganore, integrimin e menaxhuar të kufirit si dhe të përfaqësimit rajonal. (Malazogu & Bieber 2012)

Bilanci i marrëveshjeve është i përzier, disa prej tyre janë zbatuar, si ajo për diploma universitare, vula doganore, targa të veturave, menaxhimi i përbashkët i dy pikave kufitare, të cilat ishin djegur dy vite më parë nga protestuesit serb dhe planifikohet që kjo të ndodhë edhe në pikat tjera. Ndërsa disa marrëveshje tjera janë duke u implementuar gradualisht, si ato rreth kthimit të regjistrave civil, kadastrave, mirëpo ka edhe marrëveshje të cilat ende nuk po gjejnë zbatim të mirëfilltë në realitet siç është rasti me përfaqësimin në bashkëpunime rajonale ku Serbia ose i bojkoton takimet ku është edhe Kosova ose në mënyra të ndryshme pengon Kosovën në nisma të tilla. Por edhe eksporti i

mallrave të Kosovës në Serbi vështirësohet dhe pengohet në mënyra të ndryshme. Sidoqoftë, fakti që për herë të parë palët arritën të gjejnë zgjidhje përmes dialogut dhe ato t'i vëjnë në jetë, është mjaft shpresëdhënëse edhe për të ardhmen e këtyre negociatave. Zgjedhjet në Serbi dhe ardhja në pushtet e një qeverie radikale, duke se do të rrezikonte vazhdimin e dialogut, por, përkundër retorikës së ashpër parazgjedhore, kjo nuk ndodhi. Dialogu i cili deri në këtë kohë emërtohej si "bisedime teknike" dhe marrëveshjet vlerësoheshin si "konkluzione" hyri në një fazë të re, kur kryenegociatorët si dhe ndërmjetësuesi u zëvendësuan. Kjo sinjalizonte ndryshimin e natyrës së negociatave nga temat "teknike" në ato më politike si dhe ngritjen e nivelit të takimeve. Kuvendi i Kosovës doli me një rezolutë të re "Për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë" me 18 tetor 2012. Kryeministrat e dy vendeve, ai i Kosovës Hashim Thaçi dhe i Serbisë Ivica Dačić u takuan për herë të parë më 19 tetor 2012 me ndërmjetësimin e Catherine Ashton në Bruksel. Ndërkohë presidentja e Kosovës emëroi Blerim Shalën si koordinatör për negociatat mes Prishtinës dhe Beogradit. Takime të tilla të nivelit të kryeministrave u mbajtën edhe katër herë, por që temat e diskutuara dhe arritjet ishin jo tërësisht të qarta për opinionin publik. Takimi i radhës ndërmjet dy kryeministrave u zhvillua me 18 dhe 19 shkurt 2013 ku është trajtuar njëra ndër çështjet kyçe, ajo e shpërbërjes së strukturave paralele serbe në veri të Kosovës dhe krijimit të Bashkësisë të Komunave me shumicë serbe në Kosovë, por e cila mbeti që të trajtohet për modalitetet e zgjidhjes në takimet e radhës. (Zëri 20 Shkurt 2013, f.2) Raundi i gjashtë i takimeve mes kryeministrave me 4 mars 2013 nuk solli ndonjë marrëveshje konkrete, por sipas deklaratave të negociatorëve pati përafrim të qëndrimeve, sidomos në shpërbërjen respektivisht integrimin e strukturave paralele serbe në ato kosovare. Takimi i radhës ishte me datën 20 mars 2013 ku u negociua marrëveshje rreth kompetencave të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe si dhe çështje që ndërlidhen me këtë temë. (Koha Ditore 5 mars 2013)

Këto takime kishin interpretime të ndryshme si në skenën politike dhe opinionin serb po ashtu edhe brenda atij kosovar. Një marrëveshje e arritur e bërë e njohur për publikun është shkëmbimi i zyrtarëve ndërlidhës që të veprojnë në kuadër të zyrave të BE-së në Beograd respektivisht në ato të BE-së në Prishtinë.

Takimi i radhës pasoi mes presidentëve të dy vendeve Atifete Jahjagës dhe homologut të saj serb Tomislav Nikolić më 6 shkurt 2013, që ishte mjaft simbolik dhe përçonte mesazh shpresëdhënës për përafrimin e qëndrimeve rreth zgjidhjes së çështjeve mes dy vendeve.

Më 19 prill 2013 u arrit, e cilësuar si historike, marrëveshja 15 pikëshe mes kryeministrit Thaçi dhe Dačić e njohur si "Marrëveshja e parë mbi parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve" e cila parashih krijimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe dhe kompetencat e saj, shuarjen dhe integrimin e strukturave paralele serbe të sigurisë dhe gjyqësisë në strukturat kosovare, organizimin e zgjedhjeve lokale në pjesën veriore në përputhje me legjisllacionin e Kosovës, zgjidhjen e çështjeve energjetike dhe telekomunikacionit dhe formimin e komisioneve punuese që do të i zbatojnë këto pikë. (Koha Ditore 19 Prill 2013, f. 3) Përkundër diskutimeve të nxehta politike rreth kësaj marrëveshje, Kuvendi i Kosovës në qershor të atij viti e ratifikoi marrëveshjen me 84 për, 3 kundër dhe 1 abstenim. Madje edhe opinioni publik kosovar, i cili ishte mjaft i hutuar, e përkrahte marrëveshjen me 43% për dhe 38 % kundër dhe 19% që refuzuan të përgjigjen në anketë. (Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë 2013)

Tash, pas një viti është arritur progres i konsiderueshëm në zbatimin e marrëveshjeve duke përfshirë mbajtjen e zgjedhjeve komunale dhe themelimin e institucioneve lokale edhe në pjesën veriore të Kosovës si dhe inkuadrimit e ish-pjesëtareve të sigurimit serb në policinë e Kosovës. Negociatat rreth zbatimit të marrëveshjes janë duke vazhduar dhe deri në fund të marsit 2014 janë zhvilluar 23 runde bisedimesh të nivelit të lartë në Bruksel. Megjithatë, mbeten ende mjaft mospajtime dhe sfida në procesin e zbatimit të tyre, të cilat kërkojnë kohë dhe përkushtim nga dy palët.

## **POZICIONET E PALËVE**

Pozicionet e dy palëve ishin tashmë të njohura për njëra tjetrën dhe dallonin diametralisht nga njëra tjetra. Derisa Serbia nuk pranonte në asnjë mënyrë shtetësinë e Kosovës, Kosova këmbëngulte që pakoja e Ahtisarit paraqet të vetmen alternative për të siguruar të drejtat e serbëve në Kosovë. Në fakt të dyja palët më shumë janë të shtyra për këtë dialog më shumë nga joshja dhe kushtëzimi i BE-së që i bëhet në procesin e integritimit evropian sesa nga vullneti i mirë për të zgjidhur problemet e qytetarëve të tyre.

Sidoqoftë, qëndrimet e ngurta që kishin palët që nga fillimi i dialogut deri më tani, po dëshmojnë se ato po bëhen gjithnjë e më fleksibile dhe se teknika e "karotës e shkopit" nga Brukseli po duket të jetë, së paku deri në këtë fazë, mjaft efektive në përafrimin e pozicioneve.

## **POZICIONI I SERBISË**

Serbia kundërshton shtetësinë e Kosovës, jo vetëm në planin e jashtëm duke penguar njohjet ndërkombëtare dhe anëtarësimin e vendit në institucionet dhe organizatat ndërkombëtare por edhe në funksionimin e brendshëm të shtetit duke i mbajtur gjallë dhe përkrahur në forma të ndryshme strukturat e saj qeveritare paralelisht gjatë tërë këtyre viteve. Veçanërisht veriu i Kosovës, që de facto është nën kontrollin e Serbisë, mbetet njëra ndër çështjet kryesore në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes Prishtinës dhe Beogradit.

Beogradi jo formalisht kishte hedhur disa herë idenë e ndarjes së Kosovës si mundësi e zgjidhjes përfundimtare të çështjes së Kosovës. Pasi që ky opsion është hedhur poshtë kategorikisht si nga bashkësia ndërkombëtare ashtu edhe nga Prishtina zyrtare, Serbia filloi të propozonte ide rreth autonomisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë si një entitet i veçantë brenda Kosovës.

Siç u cek edhe më lartë, mendimi i GjND-së për pavarësinë e Kosovës si dhe mesazhet e qarta të kancelarës gjermane Angela Merkel në Beograd se Serbia nuk mund të llogaritet në statutin e kandidatit për anëtarësim në BE, pa i shpërbërë strukturat e saja në veri dhe të normalizojë marrëdhëniet me Kosovën, bëri që Serbia të jetë më pragmatike rreth Kosovës. (Todorovic & Malazogu, 2011. F.9). Në këtë kontekst, dilema se Serbia duhet të zgjedhë mes Kosovës dhe Brukselit, qeveritarët në Beograd së shpejti e zëvendësuan me qëndrimin se donë "edhe Kosovën edhe BE-në". Plani i hedhur nga ish-presidenti Boris Tadić përmbante katër pika kyçe, që kishin të bënin me zbatimin e Pakos së Ahtisaarit edhe në pjesën veriore, pjesa tjetër përfshinte krijimin e regjionit autonom të "Kosovës Veriore", pastaj krijimin e statusit të posaçëm të institucioneve fetare e kulturore serbe si dhe zgjidhjen çështjeve pronësore të ndërmarrjeve publike e shoqërore. Kjo sinjalizonte se serbët janë të gatshëm të dialogojnë me Prishtinën, me qëllim të, siç thuhej, përmirësimit të jetës dhe kushteve të qytetarëve në Kosovë. Megjithatë, tone të ashpra ndaj ndonjë dialogu vinin nga opozita në Serbi, e sidomos lideri radikal i Partisë Përparimtare Serbe (Srpska Napredna Stranka-SNS) Tomislav Nikolić, i cili pas arritjes së fitores në zgjedhje dhe marrjes së postit të Presidentit të vendit, i zbuti qëndrimet dukshëm. Kështu në Janar të 2013 parlamenti i Serbisë miratoi një rezolutë në mbështetje të platformës së dialogut me Prishtinën, ku kërkohet krijimi i Bashkësive të komunave autonome serbe. Nga një njohës kjo interpretohej se Serbia përfundimisht po largohet nga iluzioni se mund të ketë pushtet në Kosovë dhe se me këtë pranon tërësisht integritetin territorial. Ndërsa disa analistë të tjerë këtë platformë e shohin më shumë si kusur politik ndërmjet liderëve dhe partive brenda Serbisë. (Kanin 2013)

Qëllimet e Serbisë në këtë dialog, përveç stimulimeve që vijnë nga kandidatura për anëtarësim në BE, janë edhe krijimi i një entiteti autonom serb në veri të Kosovës i cili shkon përtej të drejtave dhe vetëqeverisjes lokale që gëzojnë komunat tjera me shumicë serbe sipas planit të Ahtisaarit. Ky skenar do t'i përshtatej Serbisë në dy aspekte, nga njëra anë në opinionin dhe elektoratin serb



do të servohej si fitore e madhe nga bisedimet, ndërsa në anën tjetër serbëve të Kosovës do t'iu mundësonte që të mos qeverisen nga Prishtina dhe që do të krijojnë një entitet thuaja të pastër etnikisht, ngjashëm si Republika Serbe në Bosnje, brenda Kosovës. Kështu që njohja e Kosovës nga ana e Serbisë nga ky dialog vështirë se mund të pritët, dhe se veriu i Kosovës mbetet çështja më e ndjeshme e negociatave pasi që edhe synimet kryesore të serbëve ndërlidhen kryesisht me këtë qëllim, respektivisht të një entiteti territorial i cili do të ishte politikisht dhe financiarisht shumë pak nën juridiksionin e Prishtinës zyrtare.

## **POZICIONI I KOSOVËS**

Një përparësi që kishte Kosova në këtë dialog ishte se ekzistonte një konsensus i plotë politik rreth nevojës për dialog, si nga ana e koalicionit në pushtet ashtu edhe nga partitë opozitare, më përjashtim të Lëvizjes Vetëvendosje e cila i kundërshton ashpër që nga fillimi këto bisedime. Mandati i qeverisë së Kosovës për dialog me Serbinë është caktuar qartë nga parlamenti i Kosovës me rezolutën e lartcekur. Një rezolutë tjetër në përkrahje të normalizimit të marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë u miratua nga Kuvendi i Kosovës me 18 tetor 2012.

Pozicioni i Kosovës në këto bisedime, të cilat u shpalosen fillimisht si teknike është që integriteti territorial dhe rregullimi kushtetues janë të panegocueshme dhe se qëllimi i tyre është integrimi i pjesës veriore të vendit si dhe normalizimi i raporteve me Serbinë. Dhe se pakoja e Ahtisaarit përmban ofertën më të mirë për akodimin e të drejtave të serbeve në Kosovë. Kështu që për Kosovën vijat e kuqe ishin caktuar brenda kornizës së planit të Ahtisaarit dhe Kushtetutës së vendit. Sikurse edhe pala serbe, joshja më e rëndësishme vinte nga Brukseli dhe procesi i integritetit evropian, respektivisht nga liberalizimi i vizave. Por me këtë dialog synohej gjithashtu që të zbutet qëndrimi i Serbisë, e cila përmes aleatëve të saj pengon anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe njohjen nga shtetet tjera.

Procesi i tejzgatur negociator, mungesa e transparencës rreth temave të diskutuara respektivisht mungesa e dokumenteve zyrtare nga marrëveshjet, pastaj ngecjet në procesin e integritetit evropian, sikurse edhe bllokimi i procesit të njohjeve dhe anëtarësimit në mekanizma ndërkombëtar, kanë bërë që përkrahja ndaj dialogut nga opinion publik të zbehet dhe kritika nga opozita të rritet në vazhdimësi. (UNDP 2012) Rreziku i dialogut vjen edhe nga frika se nëse pakoja e Ahtisaarit do të hapet, kjo mund të minonte funksionalizimin e shtetit dhe do të rrezikonte ndarjen e Kosovës. (Zëri 22 Shkurt 2013, f.2).

Pas opinionit të GJND-së për pavarësinë e Kosovës si dhe pas përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë në shtator 2012, sikurse edhe stabilitetit qeveritar qëndrimi i Kosovës dukej se ishte mjaft i favorshëm për zhvillimin e dialogut me Beogradin. Sidoqoftë, disavantazhi i Kosovës në këtë dialog është se kompromiset, sidomos rreth Asociacionit të Komunave, mund të çojnë në polarizime të thella politike apo edhe tensione të reja ndëretnike. Pala kosovare në këtë mënyrë, po ecën mbi një shtresë të hollë akulli, për shkak të presionit në rritje si nga politika e brendshme ashtu edhe nga bashkësia ndërkombëtare e që lidhet me Marrëveshjen për Stabilizim-Asocim dhe liberalizim të vizave. Sidoqoftë, Prishtina e ka një mundësi të shkëlqyer që përmes këtij dialogu të dal nga kjo status quo, filluar me normalizimin e raporteve me Serbinë duke hapur perspektiva të reja për kyçjen në arenën ndërkombëtare si dhe të arrijë të integroj përfundimisht pjesën veriore brenda sistemit politik e kushtetues të Kosovës. Çfarëdo përpjekje tjetër që do të krijonte ndonjë entitet territorial dhe etnik me pushtet të veçantë përtej asaj lokal, do të kishte pasoja destabilizuese si për Kosovën - pasi që do të acaronte tej mase raportet ndëretnike, ashtu edhe për rajonin pasi që modele dhe

kompetenca të tilla do të mund të synoheshin edhe për komunitetin shqiptar në Preshevë, Bujanovc dhe Medvegje, komunitetin boshnjak në Sanxhak, hungarez në Vojvodinë, komunitetin shqiptar në Mal të Zi, Maqedoni etj. Kështu që krijimi i njëjësive etnike territoriale me pushtet ekzekutiv do të ishte i paqëndrueshëm në një plan afatgjatë.

## **Normalizim marrëdhëniesh apo pajtim etnik?**

Para se të shtrohet pyetja se; çka kanë sjellë deri tani negociatat në normalizimin e marrëdhënieve dhe a mund të presim prej tyre një pajtim të mirëfilltë ndërmjet komuniteteve etnike, na duhet të shtojmë zhvillimin e deritashëm të këtyre marrëdhënieve.

Bashkëjetesa disa shekullore mes grupeve të ndryshme etnike në Kosovë kishte ndikime të ndërsjella mbi folklorin, traditat, kulturën e tyre por edhe dallime të thella politike e sociale. Duhet të theksohet se marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë kryesisht u dominuan nga marrëdhëniet e tensionuara ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, derisa mes grupeve tjera etnike bashkëpunimi vazhdon të mbetet në nivel të kënaqshëm. (Grupi Ndërkombëtar i Krizave 2003). Marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve duhet të shihen në kontekstin e zhvillimeve historike e politike dhe sidomos në sfondin e konfliktit të fundit. Arsyeja për këtë ishte dhe ende mbetet se Kosova, si për nacionalizmin serb ashtu edhe për atë shqiptar, shërben si mit, narracion historik dhe simbol kombëtar, e një rëndësie të veçantë fetare, kulturore si dhe teme boshte politike.

Vetëm pas përfundimit të luftës së fundit dhe gjatë administratës të misionit ndërkombëtar, ka pasur përpjekje serioze nga ndërmjetësues dhe me programe të ndryshme, që marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës t'i rregulloj apo palët t'i pajtoj. Qëllimi i të cilëve ishte krijimi i një shoqërie demokratike dhe shumëetnike. Edhe pse në lidhje me këtë qëllim ka skepticizëm në mesin e studiuesve të ndryshëm, ose siç e ka theksuar Komisioni për Ballkanin: "Një Kosovë multietnike nuk ekziston përveç në vlerësimet burokratike të bashkësisë ndërkombëtare" (Komisioni Ndërkombëtar mbi Ballkanin 2005 f. 19). Kështu UNMIK-u sikurse edhe organizatat dhe institucionet tjera ndërkombëtare i ka përcaktuar këto jo si grupe etnike, por thjesht si komunitete (communities). Praktikë e cila është bartë më vonë edhe në sistemin politik e kushtetues të Kosovës, me qëllim të shmangies së dallimeve dhe diskriminimit eventual ndërmjet shumicës e pakicave.

Sidoqoftë, gjatë administrimit të UNMIK-ut, marrëdhëniet ndëretnike mbeten ende të tensionuara. Kështu trazirat e marsit të vitit 2004, shpresat për pajtim e bashkëjetesë të dy grupeve gati se i shuan; këto ngjarje shpërfaqen në mënyrë dramatike, se procesi i pajtimit do të jetë mjaft i vështirë dhe i gjatë. Kjo përveç tjerash edhe për shkak se e ardhmja e statusit të Kosovës mbetet i paqartë. Madje Grupi ndërkombëtar i krizave theksonte se: "Derisa të jenë marrë vendimet themelore përfundimtare për statusin, ndarja etnike do të mbetet shumë e thellë për të lejuar përgatitje të besueshme, përfshirëse për vazhdimin e shtet-ndërtimit." (Grupi Ndërkombëtar i Krizave 2006)

Refuzimi i vazhdueshëm i serbëve të Kosovës të kyçen në jetën politike dhe në institucionet e përkohshme vetëqeverisëse si dhe krijimi i strukturave paralele serbe, të përkrahura nga Beogradi, vetëm se e thellojë ndarjen e polarizimin mes komuniteteve etnike. Kështu, vetëm për gjysmën e parë të vitit 2001, Serbia ka paguar më shumë se 50 milion Euro për këto struktura (Matveeva & Wolf 2003, f. 35) Kështu u krijua ideja e vetëqeverisjes lokale në baza etnike përmes decentralizimit e që ishte një prej temave më kontestuese gjatë negociatave të Vjenës. Krijimi i komunave të reja nga komunitetet me shumicë serbe ka dëshmuar që marrëdhëniet mes komuniteteve në këto lokalitetet

mund të normalizohen nëse ka bashkëpunim dhe krijohet besimi i ndërsjellë. Mbetet ende të shihet nëse funksionimi i komunave edhe në pjesën veriore si dhe krijimi i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe do të ndikoj pozitivisht në marrëdhëniet ndëretnike. Por, bashkëpunimi në nivel lokal për zgjidhjen e kërkesave dhe nevojave praktike të qytetareve e rrit besimin mes komuniteteve dhe përmirëson marrëdhëniet ndëretnike edhe në nivele tjera. Kështu, së paku matjet e opinionit publik flasin se trendet ku qytetarët serb dhe ata shqiptar i shohin marrëdhëniet ndëretnike dhe besimi i ndërsjellë janë duke u përmirësuar është në rritje të vazhdueshme. (UNDP 2013, f.18) Kjo nuk do të thotë se marrëdhëniet janë normalizuar krejtësisht, përderisa qëndrimet politike janë antagoniste, kontaktet dhe bashkëpunimet të rralla si dhe mosbesimi ende i lartë. (UNDP 2012, f.15) Mbetet të shihet se si pas zgjedhjeve parlamentare do të jetë situata e sigurisë dhe zhvillohet skena politike në vend, sa do të jetë BE-ja si ndërmjetësuese në gjendje t'i nxisë palët t'i implementojnë tërësisht marrëveshjet e arritura dhe se a do të mund modeli ekzistues i 'power-sharing'. (Sriram 2008, f.14). Zhvillimi pozitiv i këtij procesi do të krijoj ura bashkëpunimi ndërsa në të kundërtën vetëm se do të thellojë edhe më tutje ndarjen etnike. (ed. Malazogu 2014)

Gjithsesi, marrëveshjet e arritura janë një hap i rëndësishëm në procesin e krijimit të besimit dhe kohezionit social të nevojshëm për tejkalimin e ndarjes etnike dhe barrierave mendore e emocionale të ngritura mes palëve. Kjo, rrjedhimisht do të qonte në transformimin e raporteve ndëretnike dhe eventualisht në pajtimin e tyre. Mirëpo, pajtimi i palëve mund të arrihet vetëm atëherë kur paqja dhe zhvillim socio-ekonomik të jenë të qëndrueshme dhe të ketë stabilitet politik. Kjo nënkupton që Kosova do të duhej të pranohej nga Serbia dhe serbet si fqinj mik dhe serbet e Kosovës do të integroheshin plotësisht si komunitet i lirë dhe i barabartë.

## Konkluzione

Duke u nisur nga fakti se këto negociata janë të një rëndësie jetike si për Kosovën dhe Serbinë, ashtu edhe për stabilitetin e rajonit në përgjithësi, këto kërkojnë qartësim me të mirë karshi opinionit publik për rrjedhën e tyre dhe përmbajtjen e marrëveshjeve. Prandaj, diskutimet e bëra nga ana e shoqërisë civile dhe raportimet e medieve mbi këto bisedimeve janë në funksion të informimit të qytetarëve dhe transparencës më të madhe. Paqartësitë që dalin rreth këtyre bisedimeve dhe marrëveshjeve të arritura janë të shumta dhe hutojnë opinionin publik duke rrezikuar kështu vet procesin e mëtutjeshëm të negociatave.

Element shumë i rëndësishëm në këtë proces këtu është edhe roli i ndërmjetësuesit, respektivisht fuqisë realpolitike të Brukselit që t'i stimuloj apo shtyj palët për marrëveshje të pranuar nga dyja palët si dhe zbatimin e tyre të plotë. Ndërsa këtu shtohet edhe çështja se sa mund mediatimi i BE-së të garantoj qëndrueshmërinë dhe implementimin e marrëveshjeve, në mënyrë që palët t'i përmbahen plotësisht dhe pa (keq)interpretime atyre. Pra përfundimisht, sfidat që priten në këtë proces janë të shumta dhe të panjohurat edhe me të mëdha. Prandaj, negociatat duhet të prodhojnë rezultate konkrete dhe të pranueshme sa më parë në mënyrë që të mos dështojnë tërësisht.

Përkundër gjithë këtyre shqetësimeve, një arritur e jashtëzakonshme është, që palët janë pajtuar që problemet dhe mospajtimet t'i zgjidhin përmes dialogut duke përjashtuar çfarëdo përdorimi të forcës. Pastaj palët kanë arritur deri tani një varg marrëveshjesh shumë të rëndësishme dhe janë përafuar në qëndrimet e tyre për t'i zgjidhur edhe mjaft çështje tjera. Prandaj, do të duhej të caktohen qartë afatet kohore për trajtimin e çështjeve kryesore dhe zbatimin

e duhur të tyre. Kërkohen qëndrime dhe përkushtim më i madh për zbatimin e tyre në praktikë, si nga ana e Beogradit ashtu edhe e Prishtinës. Që të mos lejohet edhe më tutje interpretimi dualist e kundërrthënës i marrëveshjeve dhe krijimi i konfuzionit rreth tyre, duke fshehur temat e diskutuara dhe marrëveshjet e arritura. Kjo mund të çojë në nxehjen e gjakrave dhe toneve nacionaliste të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejt në përshkallëzimin e dhunës, sidomos në veri të Mitrovicës. Roli i shoqërisë civile, mediave por edhe subjekteve politike si në Kosovë ashtu edhe në Serbi ka qenë dhe mbetet i madh dhe konstruktiv, edhe pse kjo shpesh shfrytëzohet për pika politike dhe si temë e fushatës elektorale. Gjithashtu, kërkohet angazhim më i fuqishëm dhe transparent nga Brukseli për të zbatuar më sukses marrëveshjen.

Këto marrëveshje janë mundësi e shkëlqyeshme, pasi mund të jenë gjenerues të paqes dhe normalizimit edhe të raporteve Kosovë-Serbi, nëse palët arrijnë të gjejnë zgjidhje konstruktive në të mirë të qytetareve të dyja vendeve. Kjo do të mund të shërbejë edhe për ngritjen e besimit dhe të bashkëpunimit në segmente të ndryshme mes komunitetit shqiptar dhe serb brenda Kosovës. Mirëpo, për të qenë realist, vështirë është të pritët nga këto bisedime që të arrihet një traktat paqeje dhe njohje e ndërsjellët ose një pajtim historik mes dy popujve, por që është një fillim i mbarë dhe krijon urat e bashkëpunimit dhe normalizimit të marrëdhënieve mes tyre.

## Literatura

Anna Matveeva/Wolf-CP 2003: The Kosovo Serbs: An ethnic minority between collaboration and defiance, BIIC, Bonn

Sriram ChL 2008; Peace as Governance- Power-Sharing, Armed Groups and Contemporary Peace Negotiations, Plagrove, New York

Comprehensive proposal for Kosovo Status Settlement, United Nations S/2007/169

Kanin DB 2013:: Serbia's shaky platform. E qasshme në: <http://www.transconflict.com/2013/01/serbias-shaky-platform-313/> (3 janar 2013)

Development Group 2012: Larg Qytetarit afër BE-së; Dialogu Koosvë-Serbi, Prishtinë

Trintaphyllou D (Eds.) 2001: What status for Kosovo? Chaillot Paper Nr.50, Institute for Security Studies, Paris

International Commission on the Balkans 2005: The Balkans in Europe's Future, Sofia

International Crisis Group: Kosovo 2006: The Challenge of Transition, Europe Report Nr.170

International Crisis Group 2013: Serbia and Kosovo; The Path to Normalization, Report No.223

International Crisis Group 2003: Kosovo's Ethnic Dilemma.The Need for a Civic Contract. Balkans Report No. 143

International Court of Justice advisory opinion on Kosovo's declaration of independence, 2010. E qasshme në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/16010.pdf> (22 qershor 2010)

Malazogu L/ Bieber F 2012: The Future of Interaction between Prishtina and Belgrade, PER-K, Prishtina

Malazogu L, Ejduš F, Nic, M, Żornaczuk, T 2014 Integration or Isolation? Northern Kosovo in 2014 Election Limbo. CEPI e qasshme në: [http://www.cepolicy.org/sites/cepolicy.org/files/attachments/cepi\\_-\\_integration\\_or\\_isolation.pdf](http://www.cepolicy.org/sites/cepolicy.org/files/attachments/cepi_-_integration_or_isolation.pdf) (14 February 2014)

Weller M, 2000: The Rambouillet Conference on Kosovo, International Affairs 75:2211-251

Weller M, 2008: The Vienna negotiations on the final status for Kosovo, në; International Affairs 84: 4 659-681

Goodwin M, 2007: From Province to Protectorate to State? Speculation on the Impact of Kosovo's Genesis upon the Doctrines of International Law, in: German Law Journal, Special Issue – What Future for Kosovo? Vol.8 No.1

Rezolutë e Kuvendit të Kosovës Për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Serbisë, nga 10 March 2011

QKSS: 2013Barometri i Sigurisë në Kosovë – Zërat e Kosovës

UNDP2012: Raporti i Pulsit Publik, IV, Prishtinë

UNDP 2013: Pubic Pulse Report VI, Pristina,

Todorovic V, Malazogu L, 2011: Dialogu Beograd-Prishtinë; Nevojitet transformim i interest vetanak, New Policy Center&PER-K, Beograd-Prishtinë

Adem Beha

## Mosmarrëveshjet rreth marrëveshjes 15 pikëshe mbi normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë

Ky punim ekzaminon marrëveshjen prej 15 pikave mbi normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. Që prej ratifikimit të marrëveshjes nga të dy vendet, dy diskurse qëndrore kanë mbizotëruar: nga njëra anë, qeveria e Kosovës e ka cilësuar këtë marrëveshje si historike, duke marrë parasysh faktin se gjatë shekullit të fundit nuk është arritur asnjë marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë. Nga ana tjetër, opozita politike e Kosovës ka kritikuar këtë marrëveshje duke theksuar se marrëveshja 15-pikëshe shkatërron shtetësinë e Kosovës. Përtej dy qëndrimeve ekstreme, ne argumentojnë se autonomia e zgjeruar për katër komunat serbe të veriut duhet parë si një mjet për integrimin dhe jo disintegrimin e ndërtimit të shtetit të Kosovës. Ky punim arrin në konkluzionin se dialogu midis Kosovës dhe Serbisë është i aranzhuar nga 'lartë-poshtë' dhe mungesa e transparencës rreth rezultateve të këtij dialogu mund t'i dëmtojë arritjet e bëra gjatë këtij procesi. Mbi të gjitha, BE duhet të artikulojë qartë qëndrimin e saj se një rihartim dhe riarranzhim i kufijve të Kosovës dhe Serbisë mund të përmbyjë investimet madhore për stabilitet, paqe dhe prosperitet të BE-së dhe SHBA-ve në Ballkain Perëndimor.



Marrëveshje 15 Pikëshe, Plani  
Ahtisaari, Komunat Serbe të Veriut,  
Asociacion i Komunave Serbe, BE



Ky tekst u shkrua fillimisht në  
gjuhën shqipe.

## Hyrje

Përfshirja e tejzgjatur ndërkombëtare në Kosovë me anë të Misionit të Administratës së Përkohshme të OKB-së krioj parakushtet për përcaktim e statusit final të Kosovës. Pas 15 muajsh negociatash të pasuksesshme të sponsorizuar prej Kombeve të Bashkuara midis Serbisë dhe Kosovës për të arritur në një zgjidhje politike për statusin e Kosovës, i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, Marti Ahtisari, më 26 mars 2007 përgatiti një Propozim Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (këtëj e tutje Propozimi Ahtisaari) dhe rekomandoi një pavarësi të mbikqyrur për Kosovën.

Më 17 shkurt 2008 Kosova shpalli pavarësinë e saj. Deri më sot, 109 shtete anëtare të OKB-së e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Serbia vuri në pikëpyetje Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND), dhe në përgjigje të kërkesës së qeverisë së Serbisë, GjND lëshoi një opinion këshillues në lidhje me përputhshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës me të Drejtën Ndërkombëtare. GjND arriti në përfundimin se shpallja e pavarësisë nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare as nuk bie në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës.

Pavarësisht opinionit këshillues të GjND, Serbia e refuzoi këtë vendim. Si rezultat i kësaj, në mars 2011, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Rezolutën 64/298 me të cilën OKB detyroi BE-në të lehtësojë dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, me qëllim normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Nga marsi 2011 deri në arritjen e Marrëveshjes së 19 prillit, Serbia dhe Kosova kanë marrë pjesë në 10 raunde negociatash për të ashtuquajturat "çështje teknike".

Marrëveshja e Parë e Parimeve Rregulluese për Normalizimin e Marrëdhënieve është arritur më 19 prill 2013. Marrëveshja ka 15 pika dhe ka për qëllim për të adresuar akomodimin e serbëve në veri të Kosovës (Zveçan, Mitrovicën Veriore, Leposaviq, Zubin Potok), të cilët kanë refuzuar të pranojnë autoritetin e Qeverisë së Kosovës në atë rajon. Tërësisht, tri aspekte kryesore janë adresuar në Marrëveshjen e 19 prillit: siguria (shpërbërja e strukturave të sigurisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutrašnjih poslova (MUP) të pranishme në Kosovë dhe integrimin e tyre në Policinë e Kosovës, plus duke ofruar serbëve të veriut një komandant rajonal serb të policisë); vetëqeverisja (krijimi i komunës së Mitrovicës së Veriut dhe themelimin e Asociacionit të Komunave serbe); dhe drejtësia (krijimi i një gjykatë apeli në Mitrovicë). Të tre këto aspekte, nuk janë adresuar në Planin e Ahtisaarit.

Gjashtë nga 15 pikat e Marrëveshjes së prillit lidhen direkt me Shoqatën / Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë, një mekanizëm i cili është projektuar me këtë marrëveshje veçanërisht për të rritur autonominë lokale të katër komunave veriore serbe në Kosovë. Integrimi i katër komunave serbe në veri në kuadër të institucioneve të Kosovës mbetet një provë jo vetëm për konsolidimin e shtetësisë së Kosovës, por dhe të normalizimit të marrëdhënieve të këtij të fundit me Serbinë. Nga shkurti 1999 deri në prill 2013, Kosova ka zhvilluar negociatat të vazhdueshme me Serbinë. Fillimisht negociatat janë zhvilluar në Rambuje, dështimi i të cilave çoi në ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë.

Më vonë, vijuan negociatat e Vjenës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe, kohët e fundit, një dialog për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, stabilizimin e veriut të Kosovës dhe integrimin e serbëve në Kosovë është duke u zhvilluar në Bruksel. Gjatë 15 viteve të fundit, Kosova ka zhvilluar dialog të vazhdueshëm me Serbinë, por të dy palët nuk ranë dakord për çështje të diskutueshme. Më 19 prill, 2013, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshjen e tyre të parë për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. Marrëveshja ka potencialin të jetë historike, nëse ajo i shërben pacenueshmërisë së integritetit territorial dhe normalizimit, si dhe stabilizimit të marrëdhënieve të të

dy vendeve. Megjithatë, marrëveshja është e shoqëruar me një debat të nxehtë publik mbi rreziqet që kjo marrëveshje mund të sjellë për sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës.

Marrëveshja 15 pikëshe e 19 prillit 2013 mes Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve ka nxjerrë në pah dy reagime totalisht ekstreme. Derisa reagimi i parë konsideron se kjo marrëveshje është historike, për faktin se për here të parë në 100 vitet e fundit Kosova dhe Serbia nënshkruajnë një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve të tyre dhe, rrjedhimisht, përmes kësaj marrëveshjeje Serbia e njeh de facto Republikën e Kosovës, e cila është shpalluar në shkurt 2008. Në anën tjetër, reagimi i dytë është përcjellë me një shpërthim emocional nga grupe tjera në Kosovë, të cilat argumentojnë se kjo marrëveshje e legjitimon ndarjen e Kosovës, legalizon strukturat paralele dhe hap rrugë për krijimin e një 'Republike Serbe' të tipit boshnjak në Kosovë. Ne do t'i analizojmë pretendimet e dy palëve, duke krahasuar Marrëveshjen e 19 prillit me Planin e Ahtisaarit dhe aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës lidhur me këtë marrëveshje dhe ligjeve që kanë derivuar nga ajo.

Punimi argumenton se Marrëveshja e 19 prillit nuk paraqet as njohje dhe as shpërbërje të shtetit të Kosovës. Delegimi i pushtetit dhe ofrimi i një autonomie më të madhe për 4 komunat veriore serbe, mund të parandalojë ndarjen e veriut nga Kosova. Në anën tjetër, BE-ja duhet të ketë politikë të qartë duke e kushtëzuar kandidaturën e Serbisë në BE, nëse Serbia saboton shtetin e Kosovës dhe kërcënon integritetin territorial të saj. Ndarja juridike e veriut nga Kosova varet kryekëput se si do të menaxhohet implementimi i marrëveshjes. Ky mbetet skenari më i keq. Ndarja e Kosovës do të shkaktonte një konflikt të ri në Evropën juglindore, dhe do të ishte në kundërshtim me të gjitha investimet e bashkësisë ndërkombëtare për të ndërtuar stabilitet, paqe dhe të ardhme evropiane për rajonin.

## **Konsiderata teorike: Autonomia dhe vetë-qeverisja**

Wolff dhe Weller argumentojnë se koncepti i autonomisë për një kohë të gjatë ka qenë i ndërlidhur me diskursin e vetëvendosjes. Këta shkollarë argumentojnë se autonomia shihej si koncept i rrezikshëm, duke e ndërlidhur atë me irredentizmit dhe secesionizmit. Pas Luftës së Ftohtë, koncepti i autonomisë kishte fituar një domethënie tjetër. Autonomia tani shihej jo si një mjet i shtet-kontestimit, por si mjet i shtet-formimit. Një prej kushteve që kishte vendos Komuniteti Evropian për të njohur shtetet e daluara nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik dhe Jugollavisë pas viteve 1990 ishte trajtimit i pakicave, ose, me fjalë të tjera, njohja e statusit të pakicave dhe ofrimi i autonomisë si mjet për zgjidhjen e problemeve të tyre.

Në anën tjetër, Kymlicka e sheh autonominë territoriale, pos tjerash, si një mjet për të adresuar brengat e pakicave, që lidhen me kulturën, gjuhën, tokën, përfaqësimin etj. (Kymlicka 2003, 15). Henderes argumenton se 'autonomia territoriale i'u referohet një autoriteti të një njësie politike brenda shtetit, pra nën-njësie, për të qenë e vetë-administrueshme apo e vetë-qeverisur'. (Henderes, 2010, 12) Shkollarët të tjerë të shkencave politike e shohin autonominë territoriale si një mekanizëm për zvogëlimin e konfliktit, konsolidimin e demokracisë dhe vendosjen e paqes në shoqëritë diverse të daluara nga lufta. (Kolstø 2001, 214; Lijphart 2008, 42) Shkollarë si Lijphart, Gurr, Schneckener kanë argumentuar se ndarja e pushtetit dhe autonomia janë zgjidhje për konfliktet e thella etnike dhe shoqëritë e fragmentarizuara (Lijphart 1969, Gurr 1993, Schneckener 2004). Megjithatë, ka shkollarë të tjerë, si Norris, Horwitz që argumentojnë se në mënyrë që të ruhet kohezioni shoqëror dhe karakteri unitar i shtet, duhet të kihet kujdes me qasjen ndaj autonominë territoriale. Në fakt, këta shkollarë propozojnë më shumë autonomi personale, për faktin se ata mendojnë se pakicat mund t'i gëzojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre edhe brenda një shteti unitar (Norris 2008, Horwitz 1985).



Gurr argumenton se 'autonomia nënkupton që një pakicë ka një bazë kolektive të pushtetit, zakonisht në një rajon, në një shoqëri plurale' (Gurr 1993, 292). Wolf argumenton se autonomia regionale ose territoriale është mekanizëm për të fuqizuar një grupë për të vetëqeverisuar në një shkallë më të gjerë. Duke iu referuar Daftary, Wolff thekson se këto pushtete thjeshtë nuk delegohen, por transferohen. Me fjalë të tjera këto kompetenca nuk mund të revokohen pa e konsultuar entitetin autonom, vetëm në raste ekstreme kur rrezikohet siguria kombëtare (Wolf 2005, 105). Një shkollat tjetër rekomandon vetëqeverisje plus integrim rajonal si zgjidhje të mundshme për pretendimet e shumta për vetëvendosje. Danspeckgruber argumenton se realizimi i të drejtës së vetëvendosjes në plotëni, mund të prodhojë efekte të paparashikuara për stabilitetin dhe paqen e shumë rajoneve në botë. Danspeckgruber nënvizon se për të realizuar modelin që ai propozon 'vetëqeverisje plus integrim rajonal', që do të parandalonte rivizatimin e kufijëve, është e rëndësishme pranimi i identiteteve të shumëfishta dhe një kulturë politike fleksibile (Danspeckgruber 2005, 25)

Edhe pse autonomia si formë e shpërndarjes së pushtetit territorial mund të konsiderohet mekanizëm shumë i rëndësishëm për të parandaluar ndarjen dhe rivizatimin e kufijëve në shumë rajone, mënyra se si realizohet kjo autonomi dhe përkrahja që merr pikërisht nga grupet që iu është dedikuar, respektivisht pakicave, është e rëndësishme themelore. Shumë marrëveshje të nënshkruara mes elitave politike për të zvogëluar konfliktin kanë dështuar pikërisht për shkak se ka munguar përkrahja nga poshtë. Në përpjekje për të normalizuar marrëdhëniet mes serbëve dhe shqiptarëve në shtetin e Kosovës dhe marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, Kosova dhe Serbia, me lehtësimin e BE-së kanë nënshkruar një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve mes tyre. Të gjitha përpjekjet e ndërkombëtareve për ta integruar pjesën veriore të Kosovës, të populluar kryesisht me serb, ka rezultuar e pasuksesshme gjatë 15 viteve të kaluara. Kjo marrëveshje e parë e nënshkruar mes Kosovës dhe Serbisë siguron një formë autonomie për veriun e Kosovës, duke themeluar një Asociacion të Komunave Serbe në Kosovë, me kompetenca të gjera, të cilat nuk gëzohen nga komunat dhe asociacionet e tjera në Kosovë.

## Natyra e mosmarrëveshjeve

Natyra e mosmarrëveshjeve mes Kosovës dhe Serbisë që nga 17 shkurti 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë e saj, ka të bëjë kryesisht me faktin se kush e kontrollon dhe nën cilin autoritet do të shtrihet territori verior i Kosovës (Malazogu and Gligorov 2012, 19, Visoka and Beha 2013). Në shtator 2012 Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN) përfundoi misionin e saj në Kosovë, pas katër vitesh mbikëqyrjeje të pavarësisë së Kosovës. ZCN mbikëqyri implementimin e Planit Ahtisaari, veçanërisht mbi krijimin e komunave të reja serbe. Plani Ahtisaari propozonte të drejta të zgjeruara vet-qeverisjeje lokale për serbët të cilët jetonin në Kosovë, nëpërmjet decentralizimit të pushtetit, si dhe duke zgjeruar të drejtat e vet-qeverisjes lokale për Mitrovicën e Veriut. Plani Ahtisaari parashikonte se komuna aktuale e Mitrovicës do të ndahej në dy komuna- jugore dhe veriore, të cilat do të drejtoheshin nga një Bord i Përbashkë (Ahtisaari 2007, Article 13.1).

Megjithatë, edhe pse implementimi i procesit të decentralizimit dhe ndërtimi i komunave të reja me shumicë serbe u konsideruan histori suksesi në Kosovë, serbët në Veriun e Kosovës refuzuan ndërtimin e një komune të re të Mitrovicës së Veriut dhe Plani Ahtisaari mbeti i pazbatuar në tërësinë e tij. Bazuar në një sondazh të zhvilluar nga ZNC në Mitrovicë, 80 përqind e qytetarëve serb nuk dinin se çfarë përmbante Plani Ahtisaari. Gjithashtu ky sondazh tregoi mungesën e besimit që serbët kanë ndaj institucioneve të Kosovës. Ai gjithashtu tregoi besimin e tyre se nëse Plani Ahtisaari do të zbatohej, 50 përqind e atyre që punonin në strukturat paralele në verë do të mbeteshin të papunë. (Fearon 2012, 12).

Që nga viti 1999 kur bashkësia ndërkombëtare ishte vendosur në Kosovë për të ndaluar dhunën, restauruar paqen, dhe ndërtuar institucionet e Kosovës, bashkësia serbe në Kosovë nuk ka treguar gatishmëri për të qenë aktor përkrahës i projektit të bashkësisë ndërkombëtare për paqëndërtim dhe shtetndërtim në Kosovë. Një pjesë e madhe e serbëve nga pjesa jugore e Kosovës ishte zhvendosur në pjesën veriore, për të fuqizuar institucionet paralele dhe ndërtuar një sistem politik paralelisht asaj që kishte ndërtuar bashkësia ndërkombëtare në pjesën tjetër të Kosovës. Sidomos serbët e pjesës veriore kishin refuzuar bashkëpunimin me bashkësinë ndërkombëtare, e cila administronte Kosovën përmes Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK), të ngritur dhe fuqizuar nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSC), e cila pezulloi edhe sovranitetin e Jugosllavisë mbi Kosovën. Për më tepër, në të gjitha zgjedhjet lokale të organizuara në Kosovë që nga viti 2001, serbët kishin refuzuar që të merrnin pjesë dhe në njëfarë forme të legjitimonin qoftë institucionet e përkohshme në Kosovë, qoftë UNMIK-un. OSBE-ja i kishte definuar institucionet paralele serbe si institucione që punojnë në kundërshtim me Rezolutën 1244, e cila e koncentronte pushtetin ekzekutiv, legjislativë dhe gjyqësor në duart e PSPS-së, si kreu i UNMIK-ut. (UNSCR 1244, 1999).

As në negociatat e Rambujes (1999), të cilat u kishin hap rrugë për ndërhyrjen e NATO-së në Kosovë dhe as ato të Vjenës (2006), të cilat kishin modeluar përmbatjen e shtetit të Kosovë përmes Planit të Ahtisaarit, Serbia dhe Kosova nuk kanë arritur që të nënshkruajnë një marrëveshje. Aspirata e Serbisë që të marrë statusin kandidat në BE në kundëvlerë ndaj normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën kanë prodhuar rezultatet e para me marrëveshjen e parë të 19 prillit mes Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve mes të dyja vendeve.

BE, e autorizuar nga rezoluta 64/298 e OKB, hapi bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve midis këtyre vendeve. Momenti është i përshtatshëm për normalizimin e marrëdhënieve midis këtyre vendeve, duke konsideruar aspiratat për integrim evropian të Serbisë dhe Kosovës; megjithatë për rezultatin mbetet të vërehet. Normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën është parakusht për Serbinë për progress të mëtjetshëm në rrugën e saj drejt BE-së.

## Lehtësimi i mosmarrëveshjeve

Në mars të vitit 2011, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së kishte miratuar Rezolutën 64/298 përmes së cilës OKB-ja obligonte BE-në që të lehtësonte një dialog mes Kosovës dhe Serbisë, e që kishte për qëllim normalizimin e marrëdhënieve mes këtyre dy vendeve. Rezoluta 64/298 ju referohet rezolutës 63/3 të tetorit 2008, përmes së cilës Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me kërkesë të Serbisë, kishte bërë kërkesë GjND-së për të dhënë një opinion këshilldhënës nëse shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Rezoluta 64/298 ka dy pika, ku, së pari, pranohet përmbatja e opinionit të GjND-së të korrikut 2010, ku hiqen dilemat rreth legalitetit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës në përputhje me të Drejtën Ndërkombëtare GjND shprehu opinionin se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare) së dyti, mirëpritet gadishmëria e BE-së për lehtësuar dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, i cili dialog, pos tjerash, do të 'rriste progresin në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe të përmirësojë jetët e njerëzve'. (UNGA, Resolution, A/RES/64/298).

Që nga marsi i 2011 deri tek arritja e Marrëveshjes së 19 prilli, Serbia dhe Kosova kanë zhvilluar 10 runde të negociatave për të ashtuquajtuarat 'çështje teknike'. Negociatat ishin zhvilluar në nivel të ekspertëve dhe përfshinin çështjet si kadastrin, librat e regjistrimit, njohja e diplomave, liria e lëvizjes, vlatat doganore të Kosovës e deri tek çështjet e telekomunikacionin dhe IBM-it mes Kosovës dhe

Serbisë. Të dyja vendet ishin pajtuar për një mori çështjesh por përafrimet/dakordimet nuk kishin formë të marrëveshjes, por të konkluzioneve. Marrë parasysh faktin se Serbia nuk e njeht pavarësinë e Kosovës, çdo përpjekje për tu përafruar edhe për çështje teknike në këtë proces interpretohet si çështje politike. Negociatat fituan peshë politike, kur në agjendë të diskutimit u vendos çështja e menaxhimit të përbashkët të kufijëve (IBM). Kontrolli i përbashkët i kufijëve (IBM) konsiderohet si parakusht për vendet kandidatë ose kandidatët potencial për të ju ofruar BE-së dhe ligjit të saj, një aspiratë kjo afatshkurtër e Serbisë momentalisht. ICG e quan marrëveshjen e IBM si suksesin më të madh të dialogut teknik Prishtinë-Beograd:

Arritja më e madhe në dialog deri tani, ishte marrëveshja e dhjetorit 2011, mbi "menaxhimin e integruar të pikave të kalimit" (MIK) dhe fillimin e zbatimit të tij në dhjetor 2012 në dy pika kalimi, përfshirë njërin në veriun e Kosovës. Përgjatë periudhës 2011-2012, bisedimet u fokusuan në çështje të lidhura me kufirin: doganat, lirinë e lëvizjes dhe menaxhimin e pikave kufitare. Si pasojë e dialogut kanë filluar të përmirësohen elementë të tjerë të marrëdhënies dypalësh: kosovarët kanë filluar të shfrytëzojnë shpesh aftësinë e rikthyer për të udhëtuar përmes Serbisë për në vende të treta, regjistrat civilë po kopjohen dhe disa diploma kosovare janë njohur. Sidoqoftë, kufiri është jashtëzakonisht i rëndësishëm për Prishtinën për të shënjuar integritetin territorial dhe sovranitetin e vet, për të rritur të ardhurat përmes doganave dhe për të kontrolluar trafikimin dhe kontrabandën. (ICG 2013, 15).

Derisa Serbia e interpreton këtë marrëveshje si marrëveshje për 'boundary' (kufi administrativë), Kosova e interpreton si marrëveshje për 'borders' (kufi shtetëror). Ndonëse ishte arritur një konkluzion për këtë çështje, marrëveshja nuk kishte filluar të zbatohet, deri në tetor të vitit 2012, kur dy kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë, Ivica Dačić dhe Hashim Thaçi ishin takuar në Bruksel, nën ndërmjetësimin e Përfaqësueses së Lartë të Unionit për Politikën e Sgurisë dhe Marrëdhënive me Jashtë (HR) Cathery Ashton. Avancimi i dialogut teknik në atë politik mes dy kryeministrave, i kishte shndërruar dy 'armiçë' të dikurshëm, në paqendërtues potencial në Ballkan. Duke qënë se ky punim shqyrton vetëm Marrëveshjen e 19 prillit dhe kundërthëniet e lidhura që e kanë shoqëruar atë në Kosovë dhe vetëm përciptazi përmend marrëveshjet/konkluzionet teknike që janë arritur mes Serbisë dhe Kosovë, të cilat i kemi vendosur në figurën 2:

FIGURA 2: MARRËVESHJET TEKNIKE/KONKLuzionet mes Serbisë dhe Kosovës

Marrëveshjet Teknike/Konkluzionet mes Serbisë dhe Kosovës	Data	Progresi
Këmbimi i Zyrtarëve Ndërlidhës/ Një njësi special multietnike e Policisë së Kosovë për mbrojtjen e trashigimisë religjioze dhe kulturore serbe	Dhjetor 2010	Lartë
Librat e Regjistrave Civil	Korrik 2011	Mesatar
Liria e Lëvizjes	Korrik 2011	Mesatar
Vulat Doganre	Shtator 2011	Mesatar
Të Dhënat Kadastrale	Shtator 2011	Mesatar
Menaxhimi i Integruar i Kufijëve (IBM)	Dhjetor 2011	Mesatar
Fondi Special për Verin e Kosovës	Janar 2013	Mesatar

BURIMI: TABELË E VET AUTORIT

## Nga mosëmarrëveshja drejt marrëveshjes

Veriu i Kosovës nga shumë raporte ndërkombëtare është konsideruar vendstrehim i krimit të organizuar, kontrabandës dhe informalitetit. Në këtë pjesë janë evidentuar mbi 67 grupe kontrabande dhe 3000 përdorues të drogës, dhe momentalisht operojnë afër 500 deri në 620 pjesëtar të strukturave serbe të sigurisë, kryesisht nga MUP dhe BIA (Hysa et al 2011, 7). Përtej kësaj shkalle të pasigurisë, informalitetit dhe kontrabandës, problemi i veriut të Kosovës është parasegjithash problem territorial, që pretendohet si nga Kosova ashtu edhe nga Serbia. Kjo gjendje nuk ka ndryshuar as pas vitit 2008. Serbia ka vazhduar mbështetjen ndaj strukturave të saj të sigurisë në atë pjesë, dhe kishte bërë obstrukcion ndaj të gjitha veprimeve të qeverisë së Kosovës për të vendosur autoritetin në pjesën veriore të Kosovës. OSBE-ja në raportet e saj të vitit 2003 dhe 2007 i kishte quajtur këto struktura si 'struktura paralele', që vepronin në kundërtim me Rezolutën 1244 të KS (ICG 2013, 21). Prej vitit 1999 deri në vitin 2008, ushtrimi i misionit të UNMIK-ut ishte obstruktuar në atë pjesë të Kosovës nga serbët vendas. Pas shpalljes së pavarësisë, UNMIK-u e ka humbur legjitimitetin në sytë e shumicës së popullatës shqiptare në Kosovë, dhe ka fituar një legjitimitet të ri në pjesën veriore të Kosovës, pas riaranzhimit të qëllimit të misionit dhe neutralitetit kundrejt statusit të Kosovës.

Një studim nga Carnegie Endowment for International Peace, i publikuar në mars 2012, me autorësi të Stefan Lehne propozoi për herë të parë termin normalizim me planin e tij katër pikësh. Lehne argumenton se përmes përdorimit të fortë të politikës së kushtëzimit, BE-ja mund të ndihmojë të zgjidh disa probleme në veri të Kosovës, përmes dialogut ku do të përfshihesh drejtpërdrejt Serbia, Kosova dhe përfaqësuesit serb nga veriu i Kosovës. Dialogu, sipas Lehnes, duhet të bazohet në katër elemente: a) Tejkalimi i ndarjes mes veriut dhe pjesës tjetër të Kosovës duke ofruar një autonomi rajonale; b) Garancione për manastiret ortodokse serbe; c) Krijimi i një bashkëpunimi mes palëve marrë për bazë modelin e dy Gjermanicve të vitit 1972 dhe d) Ndalja e kundërshtimeve të Serbisë ndaj Kosovës në raport me anëtarësimin në saj në organizata ndërkombëtare (Lehne 2012).

Në po të njëjtin vit, para planit 4 pikësh të Lehnes, Presidenti i Serbisë Boris Tadiç, kishte propozuar poashtu një plan katërpikësh, ku adresimin e problemit serb e shihte përmbi Planin e Ahtisaari, duke inkorporuar disa elemente të Planit, por duke shtuar disa tjera. Tadiçi kërkonte që serbët të kishin të drejta të zgjeruar me decentralizim në të gjitha pjesët e Kosovës, ashtu si në thelb ishte adresuar më parë nga Ahtisaari. Menjëherë pas kësaj kërkesë vendoste kërkesën tjetër për krijimin e një rajoni serb në veri të Kosovës me të drejta të veçanta; statusi special për manastiret ortodokse serbe dhe zgjidhja e problemeve të pronës serbe në Kosovë.

Ndërkohë që koha për dialog politik po afrohej, më 18 tetor 2012, Kuvendi i Kosovës adaptoi një 'Rezolutë për Normalizimin e Marrëdhënive mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Rezoluta ka gjashtë pika dhe në të theksohet: 1) mbështetja e Kuvendit të Kosovës për normalizimin e marrëdhënive mes Kosovës dhe Serbisë, si dy shtete sovranë dhe avancoj agjendën evropiane mes dy shteteve, 2) që ky dialog të lehtësohet nga BE dhe mbështetet nga SHBA-të, 3) që dialogu të mos cenoj integritetin territor, karakterin unik kushtetues dhe sovranitetin e Kosovës, 4) që Kuvendi e autorizon qeverinë që të udhëheq këtë proces dialogues, 5) që Qeveria të raporton në baza të rregullta në Kuvend dhe 6) që marrëveshjet që dalin nga ky proces të ratifikohen nga Kuvendi i Kosovës (Kosovo Assembly Resolution 04-R-08). Partitë politike shqiptare të Kosovës arritën në konsensusin se zgjidhja e problemit të Veriut të Kosovës nuk do të zgjerohej jashtë Planit Ahtisaari.

## Riinterpretimi i Planit të Ahtsaarit

Dy muaj para arritjes së Marrëveshjes së 19 prillit Grupi i Krizave Ndërkombëtare (GKN) kishte nxjerrë një raport në të cilën fjala normalizim ishte vendosur qysh në titull. Raporti analizon progresin e arritur në lidhje me arritjen dhe zbatimin e marrëveshjeve mes Kosovës dhe Serbisë dhe përdor për herë të parë fjalën ‘bashkësi autonome’, e cila fjalë do të përdorej më vonë në marrëveshje. GKN argumenton se platforma serbe ka të bëjë me krijimin e një ‘bashkësie autonome’, që do të udhëhiqej nga një ekzekutiv dhe legjislativ i zgjedhur, që me fjalë të tjera do të ishte shkallë e tretë e qeverisjes që nuk ekziston në pjesë të tjera të Kosovës. Në këtë raport vetëm njëherë përmendet fjala asociacion në kontekstin që komunat serbe të krijojnë partneritetet mes tyre (ICG 2013, 23). Megjithatë, fjala asociacion do të bëhet fjala më e rëndësishme e Marrëveshjes së 19 prillit.

Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e u arrit më 19 prill 2013, sipas së cilës serbëve verior do të ju lejohet që të krijojnë një Asociacion/Bashkësi të Komunave si mënyrë e autonomisë lokale. Plani Ahtisaari, i interpretuar rreptësisht, nuk mundëson hapësira për krijimin e një rajoni serb autonom në veri të Kosovës, por i jep kompetenca shtesë Mitrovicës së veriut në lidhje me arsimin e lartë dhe kujdesin shëndetësor dytësor, kompetenca të cilat nuk i gëzojnë gjashtë komunat e tjera serbe në Kosovë. Tani ky është një lexim më fleksibël dhe i zgjeruar i Planit Ahtisaari (ICG 2013).

## Marrëveshja e 19 prillit

Vlerësimet për arritjen e kësaj marrëveshje kanë osciluar mes disa ekstremeve. Qeveria e Kosovës e ka quajtur Marrëveshjen e 19 prillit si ‘marrëveshje historike’, ‘njohje faktike të Kosovës’, ‘integrim i veriut në Kosovë’. Në fjalët e Thaçit: ‘Arritja e kësaj marrëveshjeje është njohje e Kosovës, e subjektivitetit ndërkombëtar, sovranitetit dhe integritetit territorial’ (Zekaj 2013). Po ashtu, Kryeministri i Kosovës, në seancën e Kuvendit të Kosovës të 22 prillit, kishte theksuar se marrëveshja nuk cenon sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovë dhe se kjo marrëveshje: ‘Është marrëveshje e paqes mes Kosovës dhe Serbisë. Është marrëveshje ku Kushtetuta dhe ligjet do të funksionojnë në tërë territorin e vendit dhe do t’i japim fund strukturave ilegale në veri’ (Minutes of the meeting of Kosovo Assembly, 22 April 2013).

Mediat ndërkombëtare, poashtu, e kanë vlerësuar marrëveshjen me këto cilësime: ‘breakthrough’, ‘milestone’, ‘historic’, ‘landmark agreement’, ‘broker agreement’, ‘The end of an era’ (The Economist 2013, Smolar 2013). Mediat e pavarura lokale në Kosovë, në krahasim me mediat që përkrahen Qeverinë, kanë dhënë vlerësime më neutrale duke e quajtur marrëveshjen e 19 prillit si ‘marrëveshje neutrale’, ose ‘marrëveshje anti-kushtetuese’ (Peci 2013). Lëvizja Vetëvendosje në Kosovë, e cila ka kundërshtuar krejt proceset negociatore që nga viti 1999 me Serbinë, ka artikuluar pozicionin e saj karshi marrëveshjes, si në vijim: “Marrëveshja me Serbinë ka pezulluar tërësisht shtet-ndërtimin e Kosovës. Në vend të shtet-ndërtimit, ne kemi një asociacion të komunave serbe”. Duke lënë me një anë të dyja vlerësimet ekstreme, të Qeverisë nga njëra anë që e paraqet marrëveshjen si sukses maksimal për Kosovë, dhe Lëvizjes Vetëvendosje që e konsideron marrëveshjen si ‘shbërberje’ dhe ‘pezullim’ të shtetësisë së Kosovës, administrata amerikane e ka quajtur marrëveshjen si kompromis: “Marrëveshje ka kërkuar kompromis dhe guxim politik nga të dyja palët,” pati deklaruar Sekretari Amerikan i Shtetit, John Kerry. Në anën tjetër, ambasadorja e SHBA-ve në Kosovë, Tracy Jacobson edhe pse nuk shihte rrezik me faktorizimin dhe marrjen e pushtetit nga Iniciativa Qytetare Serbe në 9 komuna (4 në veri dhe 5 në jug), kishte kërkuar vëmendje që të mos krijohet një Republikë Serbe në Kosovë’ (Bota Sot 2013).

Frika për një 'Republika Srbska' në Kosovë (të ngjashëm me atë që serbët lokal kishin kishin krijuar dhunshëm në Bosnje dhe Hercegovinë) mbetet frikë reale, marrë për bazë strukturën e marrëveshjes dhe paqartësitë lidhur me kompetencat ekzekutive të asociacionit të komunave serbe. Nëse analizohet teksti i marrëveshjes, shihet se fjalët që më së shpeshti përdoren në Marrëveshjen e 19 prillit, e që adresojnë problemin e veriut të Kosovës, janë: komunat (12), asociacioni (9), bashkësia (8), veriu (6), policia (5), komandati (4), rajon (4) gjykata (3). Siç shihet prej fjalëve kyçe në këtë marrëveshje, komunat serbe në rajonin verior të Kosovës do të themelojnë një asociacion, territor i së cilit do të kishte kompetenca më të mëdha në gjyqësi dhe polici, duke pasur një gjykatat të apelit dhe një komandat rajonal të policisë, të udhëhequr nga serbët. Përmbledhtazi, tri aspekte themelore adresohen në Marrëveshjen e 19 Prillit: siguria (shpërbërja e strukturave të sigurisë së MUP dhe integrimi i tyre në policinë e Kosovës, plus një komandat rajonal policor serb); vetëqeverisja (krijimi i komunës së Mitrovicës së veriut dhe themelimi i Asociacionit të Komunave Serbe) dhe drejtësia (krijimi i një gjykata e apelit në Mitrovicë). Të treja këto çështje nuk janë të adresuar me Planin e Ahtisaarit.

Një muaj pasi ishte nënshkruar kjo marrëveshje, në maj 2013 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë kishte zhvilluar një hulumtim, sipas të cilit 43 për qind e qytetarëve përkrahnin dialogun në krahasim me 38 për qind që ishin kundër dialogut, dhe 19 për qind nuk kishin pasur informata apo nuk kishin dhënë asnjë përgjigje. Kjo tregon faktin se një pjesë e madhe e qytetarëve nuk kanë informata për këtë proces dialogues, dhe mungesa e transparencës është e evidente. Në pyetjen se kush fiton më shumë nga dialogu, 21 për qind e qytetarëve ishin përgjigjur se Kosova fiton nga ky proces, kurse 30 për qind prej tyre ishin përgjigjur se Serbia është fituesi kryesor. 37 për qind e qytetarëve të tjerë kishin dhënë mendimin se të dyja vendet përfitojnë dhe pjesa e tjetër (11 për qind) nuk kishin mendim (KCSF 2013, 11).

Transparenca është konsideruar si një prej pikave më të dobëta të procesit të dialogut. Shoqëria civile në Kosovë dhe publiku i gjerë në shumicën e rasteve është i informuar prej mediave a posteriori pasi që marrëveshjet janë nënshkruar, duke e pamundësuar kështu si publikun ashtu edhe shoqërinë civile që të reagojnë me kohë. Mungesa e transparencës mund të shkaktoj probleme në terren, duke qënë se njerëzit e rëndomtë nuk kanë informata të mjaftueshme se si marrëveshjet teknike, ashtu edhe ato politike, do të ndikojnë në jetën e tyre në vendbanimet ku do të implementohet marrëveshja. Për më tepër, duke qënë se marrëveshjet janë dizajnuar 'nga lartë-poshtë', mundësia që këto marrëveshje të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në pajtimin etnik në Kosovë është e vogël. Historia e marrëveshjeve të tilla ndërkombëtare ka treguar se pa mbështetje e bazës, dhe pa përkrahje të atyre njerëzëve të cilët i dedikohet marrëveshja, marrëveshjet nuk mund të zbatohen në tërësinë e tyre (KIPRED 2013, 9).

Marrëveshja e 19 prillit është ratifikuar me një ligj të veçantë në Kuvendin e Kosovës me 27 qershor 2013 dhe kishte hyrë në fuqi me 12 shtator të të njëjtit vit. Lëvizja Vetëvendosje kishte organizuar një protest në ditën e ratifikimit dhe kishte tentuar të pamundësonte Kuvendin e Kosovës për të votuar këtë ligj. Duke qënë seqeveria e Kosovës nuk mund të shtrijë autoritetin e saj në pjesën e veriut të Kosovës, marrëveshja parashikon katër aktorë kryesor përgjegjës për zbatimin e saj. Këta aktorë janë Republika e Kosovës dhe tre organizata të tjera prezente në Kosovë- KFOR, EULEX dhe OSBE. Institucionet e Kosovës, me fjalë të tjera, ishin të vetëdijshme se marrëveshja nuk mund të realizohet pa partnerët e saj (KFOR, EULEX dhe OSCE), për shkak se çdo ushtrim i sovranitetit të Kosovës në atë pjesë pa përfshirjen e KFOR-it do të ishte i paqëndrueshëm. Në anë tjetër, garantimi i procesit zgjedhor që do të organizohej/lehtësohej më vonë nga OSCE në komunat veriore të Kosovës, do të ishte shumë i vështirë pa prezencën e Misionit të EULEX-it.

## Plani i veprimet për zbatimin e marrëveshjes 15 pikëshe

Plani i zbatimit të Marrëveshjes së 19 prillit përbëhet prej gjashtë elementeve: përshtatjen dhe rregullimin e kornizës ligjore, asociacioni, policia, gjyqësia, zgjedhjet komunale dhe provizionet e përgjithshme. Gjatë përshtatjes së kornizës ligjore të Kosovës me Marrëveshjen e 19 prillit parashihej që deri në fund të majit, Kosova të bëjë një plan për ndryshimet e duhura ligjore, përfshirë miratimin e Ligjit për Amnisti. Te pika e asociacionit, plani parasheh krijimin e një ekipi menaxhues nga 4 komunat veriore të Kosovës për themelimin e asociacionit/bashkësisë, i cili do të krijohet pas zgjedhjeve në Kosovë. Statuti i Asociacionit, sipas planit, duhet të jetë në përputhje me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjin e Kosovës, edhe pse nuk precizohet se për cilin ligj është fjala.

Pika katër e planit parasheh integrimin e forcave serbe të sigurisë në strukturat e reja, me përkrahje të EULEX. Kjo pikë do të realizohet me mbështetje edhe të Serbisë e cila do jepte informata për numrin e punëtorëve të saj të punësuar në sektorin e sigurisë në Kosovë, të cilët do të integroheshin në strukturat e policisë së Kosovës. Serbia, më pastaj, do t'i ndalte pagesat për këto struktura, në momentin e integrimin të tyre në policinë e Kosovës. Plani parasheh mbajtjen e zgjedhjeve në katër komunat veriore të Kosovës, të cilat do të lehtësoheshin nga misioni i OSBE-së në Kosovë. Dhe së fundi, një pikë që varej kryekëput prej qeverisë së Serbisë: Serbia do të bënte transparente të gjitha fondet përmes së cilave i përkrah strukturat serbe në Kosovë (Implementation Plan, 2013). Në tabelën e mëposhtme, ne kemi paraqitur progresin rreth veprimeve të ndërmarrura.

FIGURA 4: PLANI I ZBATIMIT

Veprimet	Afati Kohor	Progresi
Përshtatja e kornizës ligjore	Në fund të majit	Mesatar
Asociacioni	Në fund të majit/ në mesin e qershorit	Ulët
Policia	Në fund të majit	Mesatar
Drejtesia	Në fillim të qershorit/fund të tetorit	Ulët
Zgjedhjet komunale	Në mesin e korrikut	Lartë
Provizionet e përgjithshme	Në mesin e korrikut	Ulët

BURIMI: EUOBSERVER, JANAR 2014

Asnjë prej veprimeve të parapara me këtë plan veprimi, nuk janë realizuar në kohën e parashikuar. Megjithatë, deri në kohën kur po shkruhet ky punim, një numër i madh i veprimeve janë realizuar, përfshirë: zgjedhjet në veri të Kosovës; një numër i konsideruar i strukturave policore të MUP të Serbisë në veri të Kosovës kanë aplikuar për tu integruar në policinë e Kosovës dhe është themeluar Fondi për Zhvillimin e Mirëbesimit me buxhetin e vitit 2014. Ende ka mospajtime se si do të dukej asociacioni, çfarë kompetenca do të parashihen me statutin e tij, si do të themelohej Gjykata e Apelit, e kështu me radhë. Implikimet financiare për implementimin e marrëveshjes sillen afër 16 milion euro, ku rreth 6 milion euro do të ndahen nga Qeveria e Kosovës dhe 10 milion euro nga Bashkimi Evropian (KIPRED 2013, 8).



## Kritikat ndaj Marrëveshjes së 19 prillit dhe derivateve të saj

Janë disa kritika që janë adresuar karshi Marrëveshjes së 19 prillit. Kritika kryesore, e artikuluar përmes Levizjes Vetevendosje, mund të formulohet si në vijim: Marrëveshja e 19 prillit e çintegron shtetin e Kosovës dhe rrjedhimisht është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Pasi u miratua në Kuvendin e Kosovës, Ligji Nr.04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së 19 prillit, me iniciativë të Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Ymeri dhe 11 deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje, më 4 korrik 2013, u procedua në Gjykatë Kushtetuese (këtej e tutje GJK), për t'u vlerësuar kushtetutshmëria e tij. Parashtruesit e kërkesës arsyetonin se ligji ishte në kundërshtim me Kushtetutën, për shkak të shkeljes së procedurave gjatë miratimit të tij, sikurse edhe për nga vetë përmbatja e ligjit.

Në një aktgjykim 23 faqesh, të publikuar me 9 shtator 2013, rasti nr. KO95/35, GJK kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë

Ndërkombëtar të Parimeve që Rregullojnë Normalizmin e Marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. GJK, pasi kishte shqyrtuar të gjitha provat e parashtresëve, në aktgjykimin e saj bën një analizë krahasuese se si vendet e ndryshme ratifikojnë marrëveshjet ndërkombëtare dhe vjen në përfundimin se procedurat për miratimin e Ligjit Nr.04/L-199 ishin zhvilluar në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe refuzonte që të jepte një vlerësim për përmbajtjen e Marrëveshjes së 19 prillit. Rrjedhimisht, Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes me 15 pika ishte shpallur në Gazetën Zyrtare (CC 2013, No KO95/13).

Gjyqtarët e GJK kanë të drejtë të japin mendime mospajtuese. Gjyqtari Robert Carolan kishte nxjerrë një mendim konkurrues karshi këtij aktgjykimi dhe ai arsyeton se edhe pse pajtohet me aktgjykimin e shumicës së GJK se ligj është në përputhshmëri me Kushtetutën, por nuk pajtohet që GJK nuk ka juridiksion nëse përmbatja e ligjit (dispozitat materiale të këtij ligji) e shkelin Kushtetutën e Kosovës. Gjyqtari Carolan thekson se neni 113.5 i Kushtetutës së Kosovës 'qartazi autorizon GJK që shqyrtoj dispozitat materiale të një traktati' (CC 2013, No MK 467/13). Përkundër kësaj vërejtje, Carolan argumenton se dispozitat materiale të këtij ligji nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, por ky mendim nuk është i arsyetuar në detaje. Gjyqtari Carolan thekson një rast hipotetik për të arsyetuar mendimin e tij se pse GJK do të duhej të merrej edhe me përmbajtjen e një traktatit ndërkombëtar. Ai shkruan:

Për shembull, në qoftë se Kuvendi do të miratojë një traktat që ka shkelur të drejtat e njeriut të qytetareve apo të anëtarëve të bashkësive të caktuara, atëherë Kushtetuta do të jetë e pakuptimte nëse Gjykata Kushtetuese nuk do të mund të shqyrtonte dhe të zbatonte të drejtat e njeriut që janë të mbrojtura me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata ka autoritetin për të shqyrtuar dispozitat materiale të këtij ligji dhe vendimin e Kuvendit për miratimin e këtij ligji. Dispozitat materiale të këtij ligji dhe vendimi nuk shkelin Kushtetutën.

Po ashtu, si një derivat të kësaj marrëveshje, Kuvendi Kosovës, me 25 qershor 2013, ka adoptuar ligjin Nr.04/L-209 për Amnisti. Ligji për Amnisti parasheh amnistimin e personave që kanë kryer vepra penale të caktuara në territorin që tani quhet Republikë e Kosovës nga viti 1999 deri me 20 qershorit 2013. Ligji lë të kuptonte, por nuk precizohet me asnjë nen, se do të amnistonte fillimisht shumë grupe shoqërore jo vetëm në katër komunat veriore serbe të Kosovës por në tërë territorin e Kosovës dhe si e tillë dilte jashtë Marrëveshjes së 19 prillit. Sidoqoftë, është me rëndësi të theksohet këtu se Ligji për Amnisti nuk flet decidivisht për kategori të caktuara etnike apo shoqërore që do të amnistohen.



Shoqëria civile kishte kërkuar që ligji, i cili ishte miratuar në 11 korrik 2013 nga Kuvendi i Kosovës, të mos nënshkruhej nga Presidentja e Kosovës, dhe përkritazi me këtë ishte dorëzuar një peticion me 12764 nënshkrime (Kohagnet, 2013).

Albulena Haxhiu nga Lëvizja Vetëvendosje dhe 12 deputetë tjerë, më 19 korrik 2013, kanë kërkuar nga GJK të vlerësonte kushtetutshmërinë e këtij ligji, duke argumentuar se ligji është proceduralisht dhe përmbajtësisht antikushtetues duke aministuar 67 vepra penale që nuk janë ushtruar kundër rendit kushtetues të Kosovës. GJK në aktgjykimin e saj në pjesën analitike të aktgjykimit thekson se në mënyrë që të 'konsolidohet rendi juridik i Kosovës dhe të sigurohet shtrirja e autoritetit shtetëror në të gjitha pjesët e Republikës, është e nevojshme të inkorporohen në territorin e Kosovës komunitetet që kanë vepruar brenda kornizave institucionale të Republikës së Serbisë. Amnistia mund të shihet si kontribut në këtë konsolidim, duke mos penalizuar personat që kanë vepruar brenda kornizave të tjera institucionale deri më tani' (CC 2013, No KO108/13). Në aktgjykimin e saj, GJK shpallë se Ligji për Amnisti është në përgjithësi është në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës, megjithatë, GJK shpallë të pavlefshme 9 nene të këtij ligji, të cilat nene nuk ishin në pajtim me Kushtetutën (CC 2013, No MKM 472/13).

Ligji amnistion disa grupe shoqërore, megjithatë nga një lexim i kujdesshëm mund të vërehet se ligji kishte për qëllim që të amnistojë Serbët e Kosovës, të cilët kishin kundërshtuar apo sabotuar të gjitha institucionet e Kosovës dhe, pas 17 shkurtit, edhe shtetin e Kosovës. Ligji në mënyrë implicite ka për qëllim që jo vetëm ta shtrijë autoritetin e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës, por edhe të hap mundësi për një pajtim ndëretnik mes shqiptarëve dhe serbve në Kosovë. Veprat penale që amnistohen janë thuajse të gjitha veprat penale të kryera nga serbët në pjesën veriore të Kosovës: sulmi ndaj rendit kushtetutes të Republikës së Kosovës, kryengritja e armatosur, rrezikimi i tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, spiunazhi, nxitja e urrejtjes ndëretnike dhe ndërfetare, mbajtja e armëve në mënyrë të paautorizur, shmangja nga tatimi, kontrabandimi i mallërave, sulm ndaj personit zyrtar, pengimi i lëvizjes së automjeteve të doganës, ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore, thirrja për rezistencë, pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale, huliganizmi etj.

## Zgjedhjet lokale në veri të Kosovës

Plani për zbatimin e Marrëveshjes së 19 prillit parasheh organizimin e zgjedhjeve në katër komunat veriore të Kosovës, si prelude për krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe. Shpallja e pavarësisë së Kosovës ka ndarë komunitetin serb në dysh – në ata që pas këtij akti kanë provuar të akomodohen dhe marrin pjesë në institucionet e Kosovës (serbët në jug), dhe pjesën tjetër, që kanë refuzuar kategorisht të njohin institucionet e Kosovës (serbët verior).

Lidershipi në Kosovë, përfshirë presidentin dhe kryeministrin, mbajtjen e zgjedhjeve në veri të Kosovës e kanë konsideruar si garancion për integritetin territorial të Kosovës. Sfida më e madhe në zgjedhjet e 3 nëntorit nuk ishte vetëm pjesëmarrja e serbëve, por deri në çfarë mase serbët do të merrnin pjesë në këto zgjedhje, në mënyrë që lidërshipi dhe institucionet që do të dilnin nga këto zgjedhje do të kishin legjitimitetin e plotë dhe do të ishin garant për zbatimin e Marrëveshjes së 19 prillit, veçanërisht në krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe në veri të Kosovës.

Tani janë krijuar kushtet minimaliste për krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe. Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë ende nuk janë dakorduar nëse Asociacioni do të ketë pushtet ekzekutivë dhe çfarë kompetencash do të përfshihen në Statutin e Asociacionit, pos atyre që tashmë janë dakorduar rreth zhvillimit ekonomik, shëndetësi, planifikim urban dhe rural. Edhe pse Qeveria e Kosovës e ka

quajtur këtë asociacion një OJQ, Qeveria e Serbisë e sheh asociacionin si 'qeveri' serbe në Kosovë. Kritika kryesore e adresuar nga shoqëria civile dhe partitë opozitare karshi Asociacionit të Komunave Serbe është se ky mekanizëm përbën një nivel të tretë të pushtetit dhe është në kundërshtim me parimin e subsidiaritetit. Në fakt, vetë Plani i Ahtisaarit krijon një nivel të tretë të pushtetit, ku Mitrovica veriore do të kishte kompetenca më të gjera në arsim të lartë, shëndetësi sekondare etj., në krahasim me komunat e tjera në jug të Kosovës. Sidoqoftë, Marrëveshja e 19 prillit e përforcon një nivel të tretë 'më të fortë' të pushtetit në Kosovë, për shkak se Asociacioni i Komunave Serbe, si nivel i tretë i pushtetit në Kosovë, ka kompetenca të gjera, të cilat nuk i posedon Asociacioni i Komunave në Kosovë.

## Asociacioni i Komunave Serbe

Gjashtë 6 prej 15 pikave të Marrëveshjes së 19 prillit flasin drejtpërdrejtë për Asociacionin/Bashkësinë. Së pari, marrëveshja precizon se do të ketë një Asociacion për shumicën e komunave serbe në Kosovë, ku anëtarësimi do të jetë i hapur për anëtar të rinj. Së dyti, Asociacioni do të krijohet me statut dhe mund të shpërbëhet vetëm nga komunat pjesëmarrëse, por jo nga qeveria qendërore, dhe kjo do të rregullohet me ligj (por nuk precizohet se për cilin ligj është fjala) dhe me ligj kushtetues (të cilin ligj e posedon Serbia, por jo Kosova). Së treti, struktura e asociacionit do të jetë e ngjashme me strukturën e Asociacionit të Komunave të Kosovës (me një President, Zëvendëspresident, Kuvend, Këshill). Së katërti, Asociacioni do të ketë kompetenca në zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi, planifikim urban dhe rural. Së pesti, Asociacioni do të ketë kompetenca shtesë që do t'i ipen nga qeveria qendërore e Kosovës, megjithatë, marrëveshja nuk precizon kompetencat dhe si do të delegohen ato. Së gjashti, Asociacioni do të ketë një ulëse në Këshillin Konsulativë për Komunitete, mekanizëm jo vendimarrës ky brenda institucionit të Presidentit të Kosovës (D4D 2013, Deda 2013).

## Dekonstruktimi i Asociacionit të Komunave Serbe

Meqenëse Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka refuzuar të jap mendim për përmbajtjen e Marrëveshjes së 19 prillit, në vijim do të provojmë të analizojmë Marrëveshjen që rregullon në terma kushtetues. Ne argumentojmë se ka aspekte të cilët janë kushtetuese, por gjithashtu dhe aspekte të cilët duhen gjykuar si jokushtetuese.

### PIKA E PARË:

Sipas Marrëveshjes së 19 prillit, do të krijohet një Asociacion për shumicën e komunave serbe në Kosovë. Anëtarësimi do të jetë i hapur për anëtar të rinj-dukshëm secila nga 6 komunat e tjera me shumicë serbe- pas aprovimit të themeluesëve të Asociacionit, 4 komunat veriore serbe. Krijimi i asociacioneve rregullohet edhe Planin e Ahtisaarit. Duke qënë se Plani Ahtisaari është inkorporuar de jure në Kushtetuten e Kosovës, çdo akt ligjor që realizon një aspekt të Planit Ahtisaari është kushtetues. Aneksi III i Planit të Ahtisaarit rregullon decentralizimit e pushtetit në Kosovë, si mënyrë për të adresuar shqetësimet e serbëve në Kosovë. Me Planin e Ahtisaarit, komunat serbe do të kenë kompetenca të zgjeruara vetanake, të cilat kompetenca nuk i kanë komunat e tjera në Kosovë, si p.sh. kompetenca për arsimin e lartë, licensimit e institucioneve të arsimit, shëndetësinë sekondare etj. Më tutje, këto kompetenca të zgjeruar mund të ushtrohen përmes partneriteteve komunale, me përjashtim të kompetenca themelore për zgjedhjen e organeve që i ka secila komunë (Ahtisaari 2007, Annex 3). Sipas Planit të Ahtisaarit, komunat serbe kanë të drejtë jo vetëm të marrin pjesë në

Asociacion e Komunave të Kosovës, por edhe të formojnë asociacion. (Ahtisaari 2007, Annex 3). Ligji për Vetëqeverisje Lokalë në Kosovë, në nenin 31, thuhet se 'komunat formojnë dhe marrin pjesë në asociacione që funksionojnë, në pajtim me ligjin' (Ligji No. 03/L-040). Duke qenë se Asociacioni i Komunave Serbe, sipas Marrëveshjes së 19 prillit, koncetrohet më shumë në katër komunat veriore të Kosovës si themelues të Asociacionit, mundësia që 6 komunat jugore serbe të ndihen inferior në procesin e krijimit të asociacionit do të jetë e madhe. Kjo realisht mund të prodhojë një rezultat ku 6 komunat jugore serbe do të mund të dilshin nga ky asociacion, ose të krijonin një asociacion të ri. Megjithatë, e gjitha kjo do të varet nga statuti i Asociacioni i Komunave Serbe, dhe fuqisë së komunave jugore serbe në këtë mekanizëm, marrë për bazë se Asociacionit i Komunave Serbe i dedikohet kryesisht veriut të Kosovës.

#### **PIKA E DYTË:**

Marrëveshja e 19 prillit precizon se Asociacioni krijohet me statut, dhe jep garancione se veprimtaria e tij do të rregullohet me Ligj Kushtetues. Duke pas parasysh se Kosova nuk ka Ligj Kushtetues, atëherë pyetja shtrohet se me çfarë Ligji Kushtetues do të rregullohet veprimtaria e Asociacionit. Meqenëse Serbia ka Ligj Kushtetues, ekziston rrezik real që Serbia në Ligjin e saj Kushtetues të përfshijë edhe Asociacionin e Komunave Serbe të Kosovës. Kjo në fakt do të prodhonte një situatë ku në fakt Asociacioni i Komunave Serbe në Kosovë do të ushtronte veprimtarinë e saj brenda sovranitetit të Serbisë dhe sovranitetit të Kosovës, duke e shëndërruar veriun e Kosovës në një 'territor me sovranitet të dyfishtë. Kjo do të kërcenonte shtetësinë e Kosovës. Në fakt, nëse Serbia aspiron BE-në duhet të ndryshoj jo vetëm Ligjin Kushtetues, por edhe vetë Kushtetutën, dhe çdo referencë që ka të bëjë me Kosovën, në mënyrë që të përparoj drejt rrugës së BE-së.

#### **PIKA E TRETË:**

Pika e tretë e Marrëveshjes së 19 prillit rregullon strukturën organizative të Asociacionit të Komunave Serbe, i cili do të ketë një President, Zëvendës-president, Kuvend, Këshill. Në anën tjetër, struktura e Asociacionit të Komunave të Kosovës përfshin Kuvendin e Asociacionit të Komunave, Këshilli, Bordi Udhëheqës, Kolegjiumet profesionale dhe Administrata. Statuti i Asociacionit të Komunave në Kosovë rregullon se Asociacioni promovon bashkëpunimin mes komunave, ofron asistencë ligjore, përfaqëson interesat e komunave para autoriteve të jashtme, organizon trajnime, dhe koordinon informata (Statuti 2010). Në fakt, në asnjërën prej nëntë kompetencave që ka Asociacioni i Komunave të Kosovës, nuk përshihen kompetenca në zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi, planifikim urban dhe rural.

#### **PIKA E KATËRT:**

Pika katër e marrëveshjes së 19 prillit parasheh se asociacioni do të ketë kompetenca në zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi, planifikim urban dhe rural. Në Aneksin III të Planit të Ahtisaarit dhe në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, thuhet se 'Asociacionet e tilla mund t'u ofrojnë anëtarëve të tyre një numër shërbimesh, duke përfshirë trainimin, ngritjen e kapaciteteve, ndihmën teknike dhe hulumtim në kompetencat komunale dhe rekomandimet politike, në pajtim me ligjin. Pra, kompetencat si zhvillimi ekonomik, arsimi, shëndetësia, planifikimi urban dhe rural nuk janë kompetenca që listohen për asociacione. Ligji për Vetëqeverisje Lokale dallon tri lloj kompetencash të komunave: kompetenca vetanake të komunave, kompetenca të deleguara dhe kompetenca të shtuara të komunave. Kompetencat si zhvillimi ekonomik, arsimi, shëndetësia, planifikimi urban dhe rural janë kompetenca vetanake (bazike) të komunave. Duke qenë se brenda tekstit të Marrëveshjes së 19 prillit, pikërisht pika

ku iu referohet Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, atëherë është me rëndësi që të kuptohet drejt parimi bazë i kësaj Karte – subsidiariteti (ECLG 1985). Parimi i subsidiaritetit nënkupton që shërbimet institucionale duhet të jenë sa më afër qytetarit. Nëse komunat serbe që do të jenë pjesë e asociacionit i japin këtij mekanizmi kompetenca në zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi, planifikim urban dhe rural, kjo është në kundërshtim si me parimin e subsidiaritetit të garantuar me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, sikurse me Planin e Ahtisaarit dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë. Kompetencat e mësipërme janë kompetenca vetanake të komunave dhe jo kompetenca të asociacioneve.

#### **PIKA E PESTË:**

Marrëveshja e 19 prillit rregullon se Asociacioni do të ketë kompetenca shtesë, pos atyre që përmenden tekstualisht në marrëveshjen e 19 prillit. Ligji për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 18, rregullon se autoritetet qendrore të Kosovës mund të delegojnë 6 kompetenca shtesë komunave: a) shënime kadastrale; b) regjistrim civil; c) regjistrimin e votuesëve; d) regjistrimin e biznesit dhe licencimin; e) distribuimin e pagesave të ndihmës sociale; f) mbrojtjen e pyjeve. Megjithatë, Ligji për Vetëqeverisje Lokale nuk rregullon se këto kompetenca do të ju delegohen Asociacioneve të Komunave, por vetëm komunave. Poashtu, ky ligj thotë se: 'Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës mund t'u delegojnë kompetenca shtesë komunave, nëse është e nevojshme, në pajtim me ligjin' (Law No 03/L-040). Në fakt, vetë Ligji për Vetëqeverisje legale është i paqartë se për cilat kompetenca shtesë do të mund të delegoheshin te komunat, dhe në pajtim me cilin ligj. Kjo paqartësi duket se është shfrytëzuar mirë nga përpiluesit e Marrëveshjes së 19 prillit.

Në anën tjetër, Ligji për Bashkëpunim Ndër-komunal rregullon bashkëpunim e komunave për të rritur performancën e tyre, por nuk rregullon as formimin e asociacioneve dhe as partneriteteve të komunave. Në fakt, ky ligj flet për 5 forma të bashkëpunimit mes komunave, por në asnjërën prej formave të bashkëpunimit, komunat nuk mund të bashkëpunojnë përmes kompetencave të deleguara (Law No. 04/L-010, Article 9). Duke qenë se nuk dihet saktë se cilat kompetenca shtesë do të delegohen nga autoritet qendrore të Republikës së Kosovës tek Asociacioni, ekziston mundësia që kjo të jetë njëra prej temave të dialogut të ardhëm. Kompetencat shtesë së bashku me kompetencat që i garanton Marrëveshja e 19 prillit, e bëjnë Asociacionin e Komunave Serbe nivel të tretë të pushtetit 'të fortë' në Kosovë, pra, një autonomi rajonale përtej asaj që ofron Plani i Ahtisaarit dhe Ligji për Veqeverisje Lokale në Kosovë.

#### **PIKA E GJASHTË**

Me marrëveshje precizohet se Asociacioni do të ketë një ulëse në Këshillin Konsulativë për Komunitete, mekanizëm ky jo vendimarrës brenda institucionit të Presidentit të Kosovës. Këshilli Konsulativë për Komunitete si mekanizëm konsulativë është i rregulluar me Kushtetutën e Kosovës (Neni 60) dhe ka mandat për të shërbyer si një mekanizëm për këmbimet mes komuniteteve dhe institucioneve të Kosovës, duke pasur mundësi që në fazat e hershme të ligjëbërjes në Kosovë, komunitetet të japin rekomandime dhe sugjerime për të drejtat e tyre në Kosovë. Vendimet e këtij Këshilli nuk janë obligative. Në këtë Këshillë kanë marrë pjesë përfaqësues të shoqërisë civile (70 përqind) dhe partive politike (30 përqind) të të gjitha komuniteteve, përfshirë edhe 5 përfaqësues të serbëve jugor. Nëse do të anëtarësoheshin 10 komuna serbe (6 nga jugu dhe 4 nga veriu) në Asociacionin e Komunave Serbe, dhe nëse në të gjithë këta serbë do t'i përfaqësonte ky asociacion, atëherë pse është e nevojshme që serbët të kenë 6 përfaqësues në Këshillin Konsulativë për

Komunitete. Ky fakt tregon se qëllimi i Asociacionit është parasegjithash përfaqësimi i serbëve të veriut në Këshillin Konsulativë për Komunitete, jo dhe serbëve në përgjithësi.

## Shpërblimi: E ardhmja evropiane

Në qershor 2013 BE filloj negociatat për një Studim Fizibiliteti për MSA-në për Kosovën (European Commission 2013, MEMO/13/983). Në Rezolutën e Parlamentit Evropian të tetorit 2013, përhëndetet arritja e Marrëveshjes së 19 prillit dhe hapja e negociatave për MSA-në mes BE-së dhe Kosovës. Poashtu, inkurajohen 5 shtetet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën të procedojnë me njohjen e Kosovës. Rezoluta nënvizon nevojën për rritjen e transparencës për marrëveshjet e arritura mes Kosovës dhe Serbisë dhe përfshirjen e parlamenteve dhe shoqërisë civile të të dyja vendeve në implementimin e këtyre marrëveshjeve. Duke qënë se në Kosovë ende nuk ka pasur një proces të mirëfilltë të pajtimit ndër-etnik, rezoluta thekson nevojën për përgjegjësi dhe pronësi lokale mbi procesin e pajtimit dhe rekomandon autoritetet e Kosovës që të marrin hapa konkret për të integruar pakicën serbe në veri të Kosovës në institucionet dhe shoqërinë e Kosovës dhe inkurajon serbët që t'i shfrytëzojnë të gjitha të drejtat të cilat janë të garantuara me Kushtetutën e Kosovës (European Parliament 2013, B7-0000/2013).

Përkundër pritjeve të madhe se dialogu do të ndryshoj qëndrimin e 5 shteteve të BE-së të cilët nuk e kanë njohur Kosovën, 5 vite pas shpalljes së pavarësisë, këto shtete ende nuk kanë marrë vendim për ta njohur shtetin e Kosovës. Bashkimi Evropian ka shënuar rezultate duke i përafuar qëndrimet e Kosovës dhe Serbisë përmes Marrëveshjes së 19 prillit, por vetë nuk ka ndryshuar qëndrim ndaj Kosovës. BE vazhdon të mos e njoh pavarësinë e Kosovës. Në një studim të Forum 2015 nëvizohet se 'Kosova... është i vetmi vend evropian me të cilin BE-ja bën eksperimente edhe juridike se si mund të ketë raporte me një shtet pa e trajtuar atë si shtet sovran dhe të pavarur' (Palokaj 2013, 5). Marrë për bazë faktin se në 15 vite të kaluara Kosova ka kaluar 3 procese të lodhshme negociatore me Serbinë, tani është më se e nevojshme që pos zbatimit të Marrëveshjes së 19 prillit, BE-ja të vendos prioritetet afatgjata për Kosovën lidhur me zhvillimin ekonomik dhe rritjen e kapaciteteve për integrim evropian. Forumi 2015 nënvizon:

Insistimi në prioritetet afatshkurtra politike, siç është dialogu me Serbinë dhe stabiliteti politik në Kosovë, ka sakrifikuar prioritetet e tjera të nevojshme për integrim evropian, si: zgjedhjet e lira, kontrollin e ekzekutivit nga Kuvendi dhe luftën kundër korrupsionit (Palokaj 2013, 4).

E ardhmja evropiane e Ballkanit Perëndimor, përfshirë këtu edhe Kosovën, ishte rikonfirmuar në qershor 2003, në konkluzionet e Presidencës së Këshillit Evropian në Selanikë, ndryshe i quajtur si Samiti i Selanikut. Në tetor të vitit 2012, është lëshuar një komunikatë nga Komisioni tek Parlamenti dhe Këshilli Evropian mbi Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asocimit (MSA) mes BE-së dhe Kosovës (European Commission 2012, COM (2012) 602). Raporti i fizibilitetit vlerëson gjendjen politike, ekonomike dhe kapacitetet e Kosovës për të përmbushur obligimet që rreth nga MSA-ja. Në mënyrë që të hapen negociatat për MSA-në, raporti i fizibilitetit thekson se Kosova duhet të bëjë progres në prioritetet në vijim, përfshirë shtetin e së drejtës, gjyqësor, administratë publike, reform zgjedhore, të drejtat e njeriut, mbrojtjen e pakicave dhe tregti. Komisioni Evropian pret që Kosova të tregoj rezultate në luftën kundër krimit të organizuar; korrupsionit; reformojë administratën publike me staf adekuat dhe përfshijë personat që i përkasin pakicave në administratë; reformojë gjyqësorin dhe sigurojë masa mbrojtëse për gjyqtarët, prokurorët, dhe dëshmitarët; reformën

zgjedhore; Kuvendi i Kosovës të rrisë mbikëqyrjen ndaj ekzekutivit në zbatimin e politikave; promovojë një shoqëri multietnike, zbatojë ligjin që ka të bëjë me trashëgimin kulturore dhe Kishën Ortodose Serbe, dhe tregojë progres në zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës (European Commission 2012, COM (2012) 602).

## Konkluzion

Edhe pse Marrëveshja e 19 prillit mund të konsiderohet si një hap i mirë drejt pajtimit afatgjatë mes serbëve dhe shqiptarëve, ajo nuk e adreson në asnjë mënyrë çështjen e pajtimit, drejtësisë tranzicionale, kthimin e të pagjeturëve, dëmet e luftës dhe suksesionin. Megjithatë, kjo marrëveshje mund të konsiderohet si një hap drejt 'njohjes inkrementale' të Serbisë ndaj sovranitetit të Kosovës. Si çdo marrëveshje tjetër, edhe Marrëveshja e 19 prillit është një kompromis, përmes së cilës as Serbia dhe as Kosova, nuk mund të realizojnë maksimumin e pritjeve të tyre. Derisa Kosova pret njohje të menjëhershme nga Serbia dhe integrim të menjëhershëm të serbëve të veriut në institucionet e Kosovës, kjo pritje nuk mund të realizohet për një numër faktorësh. Megjithatë, përtej diskursit maksimalist në Kosovë – në njërën anë nga qeveria, se Kosovës po i njihet pavarësia me marrëveshje, dhe tjetrën anë nga opozita se Kosovës po i mirret pavarësia, Marrëveshja e 19 prillit nuk duhet të shihet si një akt por si një proces që ka për qëllim ta largoj Serbinë nga Kosova, dhe përafroj atë me Bashkimin Evropian, duke mundësuar kështu konsolidimin gradual të shtetësisë së Kosovës.

Ekzistojnë disa problem që e kanë shoqëruar të gjithë rrugën e negociatave politike mes Kosovës dhe Serbisë. Mungesa e llogaridhënies së negociatorëve në Kuvendin e Kosovës lidhur me natyrën, formatin dhe çështjet e negociuara ka qënë shpesh e paqartë për deputetët e Kuvendit të Kosovës se për çfarë po negociohet. Në anën tjetër, edhe pse natyra e negociatave të tilla nuk lejon të qenurit plotësisht transparent me pozicionet negociatore, publiku shqiptarë dhe veçanërisht ai serbë në veri të Kosovës ka mbetur totalisht i painformuar si nga Qeveria e Kosovës ashtu edhe nga ajo e Serbisë. Transparenca është konsideruar si një prej pikave më të dobëta të procesit të dialogut. Shoqëria civile në Kosovë dhe publiku i gjerë në shumicën e rasteve është i informuar prej mediave a posteriori pasi që marrëveshjet janë nënshkruar, duke e pamundësuar kështu si publikun ashtu edhe shoqërinë civile që të reagojnë me kohë. Mungesa e transparencës nënkupton se njerëzit e thjeshtë nuk kanë informata të mjaftueshme se si marrëveshjet teknike, ashtu edhe ato politike, do të ndikojnë në jetën e tyre.

Duke qenë se si Serbia ashtu edhe Kosova kanë aspiratë integrimet evropiane, Bashkimi Evropian duhet të shfrytëzoj këtë moment historik për të paqësuar njëherë e mirë rajonin e Ballkanit perëndimor, duke e shpërblyer jo vetëm Serbinë, por edhe Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së. Marrë për bazë faktin se Serbia tanimë ka filluar negociatat për anëtarësim në BE, kurse Kosova nuk ka fituar madje as liberalizimin e vizave dhe as nënshkruar MSA-në, kjo situatë mund të prodhoj si kundërefekt stopimin e negociatave me Serbinë, rritjen e diskursit nacionalist dhe përjashtues, dhe shtyrjen e normalizimit të marrëdhënieve mes dy shteteve dhe dy popujëve. Nëse kjo do të ndodhte, agjenda politike e Kosovës do të ndryshonte rrënjësisht. Edhe pse në 15 vitet e kaluara Kosova është lodhur shumë nga negociata të vazhdueshme, një agjendë për zhvillimin, demokratizimin dhe modernizimin e saj është mëse e nevojshme. Rubikoni për normalizimin e marrëdhënieve etnike brenda Kosovës dhe normalizimin e raporteve rajonale në Ballkanin perëndimor kalohet përmes zhvillimit ekonomik, konsolidimit demokratik dhe shtetit të së drejtës. Kur këto të trija të arrihen, nuk do të flitet më për aspirata integruese, por për fakte integruese drejt BE-së.

## Literatura

Arend Lijphart, 'Thinking about Democracy- Majority Rule and Power-sharing In Theory and Practice' (Routledge: London and New York, 2008).

Arend Lijphart, 'Consociational Democracy', World Politics Vol.21, No. 2 (januar 1969).

August Palokaj, 'Raportet Kosovë-BE: Historia e aspiratave të porealizuara?' (Priština, 2013), Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur', dostupno na: <http://kfos.org/ep-content/uploads/2013/04/Raportet-Kosove-BE-Historia-e-aspiratave-te-porealizuara.pdf> [pristupljeno: 4. novembra 2013].

Skupština Kosova, 'Resolution on Normalization of Relationships between Republic of Kosovo and Republic of Serbia', Rez. Nr. 04-R-08 (18. oktobar 2012), dostupno na: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolution\\_relationships\\_Kosovo\\_Serbia.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolution_relationships_Kosovo_Serbia.pdf) [pristupljeno: 23. decembra 2013].

Asocijacija kosovskih opština, 'Statute of the Association of Kosovo Municipalities' (Priština, jun 2010), dostupno na: <http://komunat-ks.net/wp-content/uploads/2011/11/Statuti-AKK.pdf> [pristupljeno: 23. decembra 2013].

Bob Matthews, Liss Ross, 'Research Methods: a Practical Guide for the Social Sciences' (Pearson Education Limited 2010).

Ustavni sud, 'Aktgjkim në Rastin Nr, KO95/13 Parashtrues Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Vlerësimi i kushtetutshmerisë së Ligjit Nr. 04/L-1999, për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve

ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje' (Priština, 9. septembar 2013), Ref. No. AGJ 469/13, dostupno na: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk\\_ko\\_95\\_13\\_shq.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_95_13_shq.pdf) [pristupljeno: 17. novembra 2013].

Ustavni sud, 'Concurring Opinion of Judge Robert Carolan', Ref. No. MK 467/13, dostupno na: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk\\_ko\\_95\\_13\\_mk\\_shq.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_95_13_mk_shq.pdf) [pristupljeno: 17. novembra 2013].

Ustavni sud, 'Aktgjkim në Rastin Nr. KO108/13 Parashtrues Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Vlerësimi i kushtetutshmerisë së Ligjit, Nr. 04/L-209, për Amnisti' (Priština, 9 September, 2013), Ref. No. AGJ 471/13, Tačka 84, dostupno na: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk\\_ko\\_108\\_13\\_shq.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_108_13_shq.pdf) [pristupljeno: 20. novembra 2013].

Ustavni sud, 'Concurring Opinion of Judge Almiro Rodrigues' (Priština, 9. septembar 2013), Ref. No. MKM 472/13, dostupno na: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk\\_ko\\_108\\_13\\_mkm\\_1\\_shq.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_108_13_mkm_1_shq.pdf) [pristupljeno: 22. novembra 2013].

Ustavni sud, 'Concurring Opinion of Judge Robert Carolan', Ref. No. MKM 468/13, dostupno na: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk\\_ko\\_108\\_13\\_mkm\\_shq.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_108_13_mkm_shq.pdf) [pristupljeno: 23. novembra 2013].

Council of Europe, 'European Charter of Local Self-Government', (Strazbur, 15. oktobar 1985), dostupno na: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/122.htm> [pristupljeno: 30. decembra 2013].

Ustav Republike Srbije (30. septembar 2006).

Ustav Republike Kosovo (15. jun 2008).

Donald Horwitz, 'Ethnic Groups in Conflict' (University of California Press, 1985).

D4D, 'Agreements in None, Including its Name: Kicking the Can Will not Bring the Side Closer around the Association/Community', Series: Scenarios, No. 1 (Priština, 2013).

European Commission, 'Communication from the Commission to the European Parliament and the Council on Feasibility Study for a Stabilization and Association Agreement between the European Union and Kosovo', (Brisel, 10. oktobar 2012), COM, 602 final, dostupno na: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_feasibility\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_feasibility_2012_en.pdf) [pristupljeno: 15. decembra 2013].

European Commission, 'EU starts the Stabilization and Association Agreement negotiations with Kosovo', (28. oktobar 2013) MEMO/13/983, dostupno na: <http://europa.eu/rapid/press-release-MEMO-13-938-en.htm> [pristupljeno: 27. decembra 2013].

European Parliament, 'Motion for a Resolution to wind up the debate on the statement by the Commission pursuant to Rule 110(2) of the Rules of Procedure on the European Integration Process of Kosovo (2013/0000(RSP))', (18. oktobar 2013) B7-0000/2013, dostupno na: [http://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2009\\_2014/documents/afet/re/1007/1007236/1007236en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2009_2014/documents/afet/re/1007/1007236/1007236en.pdf) [30. decembar 2013].



European Commission, 'Guidelines for Integrated Border Management' (2007) dostupno na: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/financiaL\\_assistance/cards/publications/ibm\\_guidelines\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/financiaL_assistance/cards/publications/ibm_guidelines_en.pdf) [pristupljeno: 24. novembra 2013].  
Edona Peci, 'Marrëveshja e 19 prillit neutrale ndaj statusit', Gazeta Jeta në Kosovë (27. maj 2013), dostupno na: <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,5662> [pristupljeno: 17. decembra 2013]

Gëzim Visoka and Adem Beha, 'Clearing up the fog of conflict', Kosovo Institute of Peace and Kosovo Foundation for Open Society, (Priština, 2013).

International Court of Justice (2010) Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo. General List no. 141, 22. juli 2010. Online: <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf> [pristupljeno 25. jula 2010]

ICG, 'Serbia and Kosovo: the Path to Normalization', Europe Report No. 223 (19. februar 2013) str.15, dostupno na: <http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/223-serbia-and-kosovo-the-path-to-normalisation.pdf> [pristupljeno: 2. decembra 2013].

'Implementation Plan', dostupno na: <http://euobserver.com/media/rc/0807580ad8281aefa2a89e38c49689f9.pdf> [pristupljeno: 5. januara 2014].

Ilir Deda, 'Kosovo after the Brussels Agreement: From Status Quo to an Internally Ethnically Divided State', KAS, Policy Brief (decembar 2013).

'Jacobson: Të vëmendshëm, që të mos krijohet një Republikë Serbe', Bota Sot (4. decembar 2013), dostupno na: <http://www.botasot.info/kosova/255257/jacobson-te-vemendshem-qe-te-mos-krijohet-nje-republike-serbe/> [pristupljeno: 23. decembra 2013].

Kate Fearon, 'Guests in Our Own House: the Comprehensive Settlement Proposal and the Serb Community in Northern Kosovo', ICO and FDFA (april 2012).  
Kosovar Center for Security Studies, 'Kosovo Security Barometer - The Voices of Kosovo: Insights and Perceptions' (22. maj 2013), f. 11, dostupno na: [http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo\\_Security\\_Barometer-The\\_voices\\_of\\_Kosovo\\_Insights\\_and\\_Perceptions\\_199745.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer-The_voices_of_Kosovo_Insights_and_Perceptions_199745.pdf) [pristupljeno: 23. decembra 2013].

KOHAnet, 'The petition against the Law on Amnesty was delivered to the President' (19. juli 2013), dostupno na: <http://www.koha.net/?page=1,13,152797> [pristupljeno: 5. januara 2014].

KIPRED, 'The Implementations of Agreements of Kosovo-Serbia: Political Dialogue', Policy Paper, No.4/(13. juli 2013), dostupno na: [http://www.kipred.org/advCms/documents/22356.The\\_Implementation\\_of\\_Agreements\\_of\\_Political\\_Dialogue.pdf](http://www.kipred.org/advCms/documents/22356.The_Implementation_of_Agreements_of_Political_Dialogue.pdf) [pristupljeno: 13. decembra 2013].

Kosovo Law No. 04-L-199 on Ratification of the First International Agreement of Principles Governing the Normalization of Relations between the Republic of Kosovo and the Republic of Serbia (27. juni 2013), dostupno na: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%2000n%20ratification%20of%20agreement%20-normalization%20of%20relations%20between%20Kosovo%20and%20Serbia.pdf> [pristupljeno: 5. novembra 2013].

'Kosovo and Serbia: a breakthrough at last', The Economist (20. april 2013) dostupno na: <http://www.economist.com/blogs/easternapproaches/2013/04/serbia-and-kosovo-o> [pristupljeno: 14. decembra 2013]

Leon Malazogu i Alex Gligorev, 'Nga paqartësia kreative në proces konstruktiv: Si t'i qasemi veritet të Kosovës?' Projekti për Marrëdhënie Etrnike dhe Demokracia për Zhvillim (Priština, septembar 2012).

'Law No. 03/L-040 on Local Self-Governance Assembly of Kosovo' (20 February, 2008), dostupno na: [http://komunat-ks.net/wp-content/uploads/2011/11/LIGJI-PËR-VETËQEVERISJEN-LOKALE\\_sq.pdf](http://komunat-ks.net/wp-content/uploads/2011/11/LIGJI-PËR-VETËQEVERISJEN-LOKALE_sq.pdf) [pristupljeno: 5. januara 2014].

'Law no. 04/L-010 on Inter-Municipal Cooperation' (21. juli 2011), dostupno na: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%2000n%20intermunicipal%20cooperation.pdf> [pristupljeno: 5. januara 2014].

Martti Ahtsaari, 'Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement', UN doc S/2007/168 (26. mart 2007), Article 13.1, dostupno na: [http://www.unosek.org/docref/Comprehensive\\_proposal-english.pdf](http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf) [pristupljeno: 15. decembra 2013].

Zapisnik sa sednice Skupštine Kosovo, 'Extraordinary session of the Assembly' (22. april, 2013), dostupno na: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,5582> [pristupljeno: 4. decembra 2013].

'Marrëveshja e 19 prillit cenon Kushtetutën', KOHAnet [pristupljeno: 19. avgusta 2013], dostupno na: <http://www.koha.net/?page=1,13,155925> [pristupljeno: 20. decembra 2013].

Pål Kolstø, 'Territorial Autonomy as a Minority Rights Regime in Post-Communist Societies' u Will Kymlicka, Magda Opalski (ed.), Can Liberal Pluralism be Exported? Western Political Theory and Ethnic Relations in Eastern Europe (Oxford University Press, 2001).



Pippa Norris, 'Driving Democracy: Do Power Sharing Institutions Work?' (Cambridge University Press, 2008).

Piotr Smolar, 'Serbia and Kosovo sign historic agreement', *The Guardian* (30. april 2013) dostupno na: <http://www.theguardian.com/world/2013/apr/30/serbia-kosovo-historic-agreement-brussels> [pristupljeno: 5. decembra 2013].

Stefan Wolff and Mark Weller, 'Self-determination and autonomy: A conceptual introduction' u Stefan Wolff and Mark Weller (ed.), *Self-governance and Conflict Resolution: Innovative approaches to institutional design in divided societies* (Routledge: Taylor & Francis Group, 2005).

Stefan Wolff, 'Complex autonomy arrangements in Western Europe: A comparative analysis of regional consociationalism in Brussels, Northern Ireland and South Tyrol', u Stefan Wolff and Marck Weller (ed.), *Autonomy, Self-governance and Conflict Resolution: Innovative approaches to institutional design in divided societies* (Routledge: Taylor & Francis Group, 2005).

Stéfan Sinclair & Geoffrey Rockwell, 'Voyant Tools', *Privacy v. 1.0 beta* (4623) (2013).

Susan J. Henders, *Territoriality, Asymmetry, and Autonomy: Catalonia, Corsica, Hong Kong, and Tibet* (Palgrave MacMillan, 2010).

Stefan Lehne, 'Kosovo and Serbia: toward a Normal Relationship', *Carnegie Endowment for International Peace*, (Mars, 2012), dostupno na: [http://carnegieendowment.org/files/Kosovo\\_and\\_Serbia.pdf](http://carnegieendowment.org/files/Kosovo_and_Serbia.pdf) [pristupljeno: 14. decembra 2013].

Ted Robert Gurr, *Minorities at Risk: A Global View of Ethnopolitical Conflict* (Washington, DC: US Institute of Peace Press 1993).

Ulrich Schneckener 'Models of Ethnic Conflict Regulation: Politics of Recognition', u Ulrich Schneckener & Stefan Wolfe eds. *Managing and Settling Ethnic Conflict: Perspectives on Success and Failures in Europe, Africa and Asia* (C. Hurst & Co: London, 2004).

Rezolucija UN 1244 (1999), usvojena od strane Saveta bezbednosti na 4011. sednici, 10. juna 1999.

United Nations General Assembly, 'Resolution adopted by the General Assembly: Request for an advisory opinion of the International Court of Justice on whether the unilateral declaration of Independence of Kosovo is in accordance with international law', Šezdeset četvrta sednica, A/RES/64/298.

United Nations Security Council, 'Security Council Welcomes Progress in Implementing Peace Accord as Members Urge Leaders of Serbia, Kosovo to Stay the Course'. 7026. sednica (29. avgust 2013).

Will Kymlicka, Wayne Norman, 'Citizenship in Culturally Diverse Societies: Issues, Contexts, Concepts', u Will Kymlicka, Wayne Norman (ed.), *Citizenship in Diverse Society* (Oxford University Press, 2003).

Wolfgang F. Danspeckgruber, 'Self-governance plus regional integration: A possible solution to self-determination claims', u Stefan Wolff and Marck Weller (ed.), *Autonomy, Self-governance and Conflict Resolution: Innovative approaches to institutional design in divided societies* (Routledge: Taylor & Francis Group, 2005).

Ylber Hysa et al., 'Report on Parallel Institutions on North of Kosovo: Belgrade – With a Foot on the North and an Open Hand in Brussels', (maj, 2011), dostupno na: [http://www.koha.net/repository/docs/Raporti\\_per\\_Veri\\_-\\_Englisht\\_-\\_2011.pdf](http://www.koha.net/repository/docs/Raporti_per_Veri_-_Englisht_-_2011.pdf) [17. decembar 2013].

Stefan Surlić

## Mekanizmat Institucional për Përfaqësimin e Serbeve në Kosovë - rastë studiimi: Asociacioni i Komunave Serbe

Subjekt i këtij punimi është analiza e statusit politik të serbëve përmes formave të mëhershme ekzistuese të përfaqësimit të komunitetit të tyre etnik në Kosovë. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet Marrëveshjes së Brukselit e cila parashikon krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe - një formë e organizimit institucional e bashkësisë etnike serbe në nivel rajonal, me komunat që janë kryesisht të populluara me serb.



Asociacioni i Komunave serbe, autonomia, ndarja e pushtetit, komunitetet etnike, Kosovë



Ky tekst u shkrua fillimisht në gjuhën serbe.

## Hyrje

Qëllimi i tekstit që vijon është të përgjigjet në pyetjen: Përse është e nevojshme që të ofrohet një nivel më i lartë i autonomisë për serbët në Kosovë, në formë të Asociacionit të Komunave Serbe? Argumenti kryesor nga i cili fillon ky punim është se marrëveshjet e mëparshme institucionale në Kosovë ishin të paafta për të neutralizuar tensione në periudhën e pas-konfliktit në marrëdhëniet shqiptaro-serbe dhe për të krijuar një shoqëri të qëndrueshme multietnike. Në rrethana të tilla, marrëdhëniet ndëretnike janë themeluar mbi një mosbesim të thellë mes komuniteteve të ndryshme etnike.

Dekadat e armiqësisë, luftës dhe pasigurisë pas konfliktit kërkojnë një kuadër institucional që do t'ua mundësojë komuniteteve serbe dhe shqiptare të jetojnë në paqe, por jo së bashku, por pranë njëri-tjetrit. Tek argumentet e mosfunksionimit institucional për shkak të ndjenjës së mosbesimit për dekada të gjata, që është reflektuar veçanërisht në marrëdhëniet politike, ne do t'ia shtojmë edhe avantazhin e autonomisë si mekanizëm i sigurisë shtesë dhe pavarësisë për komunitetin serb i cili ndihet i kërcënuar. Autonomia në formën e një asociacioni të komunave është veçanërisht me rëndësi jetike për pjesën veriore të Kosovës, të dominuar nga komuniteti etnik serb. Për më shumë se një dekadë, jeta socio-politike në veri të lumit Ibër është shpëlarur pa një kontakt me institucionet në Prishtinë, prandaj këtij rajoni, që përbëhet nga katër komunitet - Mitrovica veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan - duhet t'i njihet e drejta për qeverisje të pavarur lokale, duke mbajtur kompetencat kyçe në fushat e sigurisë, gjyqësisë dhe arsimit.

Përveç kësaj, përvoja e mëparshme me përfaqësimin e serbëve në institucionet e Prishtinës gjithashtu flet në favor të dhënies së një autonomie më të madhe për popullatën serbe në Kosovë. Përfaqësuesit e komunitetit Serb u bënë "etno-biznesmenë", duke përdorur të drejtat e tyre të veçanta jo në interes të komunitetit por në favor të ruajtjes dhe justifikimit të elitës shqiptare në pushtet. Prandaj ky punim do të jetë një analizë e plotë e marrëveshjes së mëparshme institucionale për serbët në Kosovë, një krahasim i decentralizimit dhe Asociacionit të propozuar të komunave serbe dhe një shqyrtim i arritjeve të Marrëveshjes së Brukselit dhe sfidat më të mëdha për zbatimin e saj.

## Korniza e mëparshme institucionale për serbet në Kosovë

Pas miratimit të Rezolutës të KS të OKB 1244 Institucionet serbe u tërhoqën nga Kosova, ndërsa forcat e Kombeve të Bashkuara hynë për të krijuar një sistem politik të ndarë nga ai i Beogradit. Në periudhën prej 1999 deri më sot, Kosova në mënyrë normative është përcaktuar nga Rezoluta 1244, me anë të kornizës Kushtetuese të bashkësisë ndërkombëtare që nga viti 2004 dhe më pas nga dokumentet të cilat nuk njihen nga Serbia, të cilat kishin kaluar me mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare: Plani i Ahtisaarit, Deklarata e Pavarësisë, dhe më vonë Kushtetuta e Kosovës. Gjatë gjithë kësaj periudhe, komuniteti etnik serb që ka mbetur për të jetuar në Kosovë ishte politikisht, më pak ose më shumë, i organizuar me sukses për të realizuar kërkesat e tij. Karakteristika kryesore e pjesëmarrjes së mëparshme të serbëve në institucionet politike është ekzistenca e sistemeve paralele institucionale, njëra e cila funksionoi nën kontrollin dhe me mbështetjen e Beogradit dhe një tjetër që, pas miratimit të Planit të Ahtisaarit, ka filluar të zbatohet nga Prishtina, si një formë e decentralizimit të gjerë për komunitet me shumicë serbe. Sistemi i mëparshëm ka gëzuar mbështetjen e komunitetit serb, por nuk mund të shtrinte në mase të konsiderueshme ndikimin e tij mbi politikën lokale përtej asistencës së kufizuar mjekësore dhe sociale; kjo e fundit kishte levat e pushtetit, por i mungonte mbështetja e qytetarëve të nacionalitetit serb. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Parë të Parimeve që

rregullon normalizimin e marrëdhënieve në Bruksel shënoi fillimin e fazës së heqjes së institucioneve nën kontrollin e Serbisë dhe integritet të tyre në një sistem të vetëm institucional, brenda kuadrit të legjislativitetit të ri të Kosovës. Kjo pjesë e punimit do të merret me dispozitat e Planit të Ahtisaarit, si dhe me çështjen dhe shkallën në të cilën Marrëveshja e Brukselit është pjesë e këtij plani, dmth është "Ahtisaari Plus".

Plani i Ahtisaarit, i quajtur zyrtarisht "Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës" parashikon një formë të decentralizimit të gjerë për serbët në Kosovë, përmes ndarjes së komunave të reja në territoret ku serbët janë shumicë, si dhe dhënien e vetëqeverisjes në fushat e shëndetësisë, arsimit dhe çështjeve sociale. Sipas planit të decentralizimit, përveç Kllokotit, statusi i komunës do të jepet për Mitrovicën e Veriut, Graçanicën, Ranillugun dhe Parteshin, ndërsa komuna e tanishme Novo Brdo është zgjeruar (Refki, 2009).

Komunat e Mitrovicës së Veriut, Graçanicës dhe Shtërpçës kanë kompetenca për ofrimin e kujdesit shëndetësor dytësor, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e stafit mjekësor dhe administrativ. Kjo i jep të drejtë komunave me shumicë serbe të formojnë partneritete jo vetëm në territorin e Kosovës, por edhe me gjerë; megjithatë kjo dispozitë mbetet e paplotë dhe është subjekt i mosmarrëveshjeve në negociatat e Brukselit. Plani më tej parashikon marrëdhëniet e veçanta të komunave serbe me qeverinë qendrore në Beograd me financim transparent, dmth nën "syrin vigjilent" të Prishtinës. Siç ka theksuar Gallucci "qëllimi ishte i qartë - t'u lejohej serbëve në këto komuna të jetojnë në të dy botët në të njëjtën kohë" (Gallucci, 2014).

Plani parashikon barazinë e gjuhëve shqipe dhe serbe në përdorim zyrtar. Theksi i u vu në mbrojtjen e identitetit etnik, fetar dhe kulturor të komuniteteve që jetojnë në Kosovë, veçanërisht ato të pakicave. Në aneksin II të tij, Plani parashikon autonomi të veçantë në fushën e arsimit, krijimin e shkollave fillore dhe të mesme në gjuhën e pakicave në përputhje me politikën arsimore të Beogradit, ndërsa Aneksi III i mundëson komunitetit Serb në veri nga lumi Ibër për të mbajtur universitetin e vet brenda "kompetencave të zgjeruara". Përveç autoriteteve administrative, njësitë e vetëqeverisjes do të kenë edhe gjykatat vendore, (Plani i Ahtisaarit, 2007).

Akti më i lartë juridik i Kosovës është një mishërim normativ i Planit të Ahtisaarit. Në kuadrin e garancive kushtetuese, anëtarët e komuniteteve pakicë, individualisht ose kolektivisht, kanë të drejtë të: "të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën"; "Marrin arsimim publik në njërin nga gjuhët zyrtare"; "të marrin arsimim publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre"; "krijojnë dhe menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe trajnimit"; "përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në marrëdhëniet e tyre me autoritetet komunale ose me zyrat lokale të autoriteteve qendrore"; "përdorin dhe shpalosin simbolet e komunitetit"; "të regjistrojnë emrat personal në formën e tyre origjinale"; "të kenë emërtime lokale, emërtime të rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë"; "krijojnë dhe përdorin mediet e tyre" duke përfshirë frekuencën kombëtare për kanalin serb", të mbajnë kontakte të lira dhe paqësore me personat në cilindo shtet, veçanërisht ata me të cilët ndajnë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar, ose trashëgiminë e përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare", që mund të interpretohet si konfirmim i garancive që Plani i Ahtisaarit i ofron të serbëve në kuadër të "pakos" së marrëdhënieve të veçanta me Beogradin (Plani i Ahtisaarit, Art. 59).

Në përputhje me propozimin e Ahtisaarit, vendet e rezervuara dhe të garantuara janë paraparë për pjesëtarët e komuniteteve pakicë në trup përfaqësues, ku në numrin e përgjithshëm të 120 deputetëve njëzet vende janë të rezervuara për pakicat, nga të cilat dhjetë vende janë për përfaqësuesit e komunitetit

serb.”Çdo vend i fituar përmes zgjedhjeve, përveç dhjetë (10) vende të rezervuara, do të jetë i ndarë për komunitetin serb të Kosovës dhe komuniteteve të tjera përkatëse.” (Plani i Ahtisaarit 148). Kjo, megjithatë, nuk është e mundur më tutje, sepse kjo dispozitë ishte e vlefshme gjatë të tre cikleve zgjedhore, pasi që – sipas supozimeve optimiste – jeta ndëretnike politike duhet të bëhet më e qëndrueshme. Plani Ahtisaari parashikon gjithashtu një pjesëmarrje të detyrueshme të përfaqësuesve serbë në degën ekzekutive dhe një sistem të vetos për ligjet të cilat mund të ndikojnë në komunitetet minoritare. Plani që diplomati finlandez kishte propozuar në 2007 ka karakteristika të rëndësishme të ndarjes së pushtetit, dmth modelin konsociativë të demokracisë. Demokracia Konsociative i referohet shoqërive plurale dhe të ndara. Segmentimi është pasqyruar në diversitete etnike, fetare, racore, kulturore dhe të tjera midis anëtarëve të shoqërisë. Konsociacioni është një model i demokracisë i cili mundëson pajtimin në shoqëritë me ndarje të thellë, ndryshe nga politika e ndarjes, asimilimit dhe migrimit të detyruar. Ka katër karakteristika themelore të përcaktuara të demokracisë Konsociative të cilat të paktën në mënyrë deklarative mund të njihen në strukturën e shoqërisë kosovare. Para së gjithash, pushteti ushtrohet nga koalicioni i elitave politike të subkulturave më të rëndësishme në shoqërinë pluraliste. E drejta e vetos është një mekanizëm për mbrojtjen e komuniteteve pakicë dhe ajo siguron interesat e tyre jetike. Parimi i proporcionalitetit parashikon pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në kryerjen e funksioneve shtetërore dhe publike, si dhe në shpërndarjen e burimeve publike, duke e mbajtur të drejtën e secilit segment të shoqërisë pluraliste për të vendosur në mënyrë të pavarur në çështjet e saj të brendshme, dmth për të pasur një formë e të autonomisë politike. (Lijphart, 1992, f. 32-37).

Në marrëveshjen aktuale institucionale, përfaqësuesit e komunitetit serb ushtrojnë pushtetin e tyre përmes koalicioneve të përshkruara kushtetutese post-zgjedhore me partitë shqiptare në pushtet. Bashkëpunimi më i rëndësishëm politik që është arritur midis Partisë së Pavarur Liberale (SLS) e cila përfaqëson serbët dhe PDK-së së Hashim Thaçit. Zgjedhjet e fundit lokale dhe parlamentare shënuan fundin e ekzistencës së SLS-në formën e saj të vërtetë për shkak të mungesës së mbështetjes së serbëve (Rezultatet e KQZ-së për zgjedhjet, 2014). Përfaqësuesit serbë e kanë të drejtën e vetos në fushat që prekin komunitetet minoritare dhe ata duhet të përfaqësohen proporcionalisht në të gjitha institucionet e rëndësishme në Prishtinë. Megjithatë, në çështje të rëndësishme të tilla është edhe krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës, që kërkon miratimin edhe nga ana serbe, por partitë shqiptare kanë përmendur tashmë një mundësi që vetoja potenciale serbe nuk do të jetë e vlefshme. (Gjorgjeviq 2014)

Forma dhe niveli i autonomisë politike për serbët mbetet e diskutueshme në marrëveshje për ndarjen e pushtetit. Plani i Ahtisaarit specifikon një nivel të lartë të decentralizimit dhe kompetencave në nivel lokal komunal. Marrëveshja e Brukselit përcakton një nivel më të lartë të saj, pra themelimin e Asociacionit të Komunave serbe (AKS) që do të ekzistojë si lëndë e veçantë politike. Analiza e Planit të Ahtisaarit dhe Marrëveshjes së Brukselit (më vonë në këtë punim) na tregon se kompetencat e parashikuara për nivelin lokal janë ngritur vetëm në nivelin e AKS. Politikat autonome arsimore, gjyqësore dhe të sigurisë tashmë janë parashikuar të jenë në duart e përfaqësuesve serbë. Gjithashtu, Plani i Ahtisaarit parashikon partneritetin e komunave me shumicë serbe, por pa një përcaktim të saktë të modelit dhe nivelit të partneritetit të tillë. Marrëveshja e Brukselit mund të konsiderohet më shumë si një shpjegim apo modifikim i Planit të Ahtisaarit, dhe sigurisht jo një “Ahtisaari Plus”.

Politika e Beogradit sjell konfuzion shtesë pasi që e paraqet AKS si një paralele të veçantë të institucioneve në Prishtinë, ndërsa Prishtina do që të relativizojë çdo formë të autonomisë serbe. Mund të thuhet se përderisa Beogradi dëshiron një “Republikë të re Srpska” në Kosovë, Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar kanë frikë nga një krijim i tillë. Megjithatë, shpresat apo frika e tillë, në varësi

të këndvështrim, janë absolutisht të pabaza. Veriu i Kosovës, i përbërë nga katër komunitat serbe dhe i lidhur me komunitat në pjesët qendrore dhe jugore të Kosovës pa një lidhje territoriale, nuk ka kapacitete organizative dhe institucionale, dhe në veçanti nuk ka kapacitete demografike dhe ekonomike për të krijuar një entitet të veçantë politik që do të mund të paraqiste një potencial separatist në të ardhmen e afërt.

Me fjalë të tjera, Kosova e veriut, së bashku me komunitat e tjera, nuk mund të mbijetojë pa ndihmë nga Beogradi apo Prishtina. Ka dallime të mprehta në mesin e teoricienëve dhe të kuptuarit e modelit konsocial të demokracisë. Dy shkolla të mendimit janë krijuar në teorinë politike, njëra e cila e konsideron Konsociationin si zgjidhje pozitive dhe të mundshme vetëm për shoqëritë plurale dhe të segmentuara, dhe një tjetër, e cila është e dyshimtë në lidhje me suksesin e rezultateve të demokracisë së themeluar në këtë mënyrë. Kritikët e modelit konsocial thonë se ajo ka një nivel të caktuar të separatizmit, potencialit dmth secesionist, ndërsa sipas mendimit të autorëve të tjerë demokracia Konsociative përmes mekanizmave të saj të suksesshëm e ka bërë veten edhe më të tepruar, sepse ajo hoqi konfliktet e identitetit brenda komuniteteve plurale.

Në kemi parë se Plani i Ahtisaarit përmban një bazë të fortë për krijimin e një marrëveshjeje për ndarjen e pushtetit. Ekziston, megjithatë, një pyetje e justifikuar se - deri në çfarë mase kanë zbutur këto mekanizma institucionale ndasitë ndëretnike dhe kanë krijuar një shoqëri të integruar? Në bazë të kritikave teorike Donald Horowitz, ne do të tregojmë për dukuritë e mundshme negative në zbatimin e marrëveshjes për ndarjen e pushtetit në Kosovë; shumica e tyre u manifestuan përmes veprimeve të papërgjegjshme të elitave politike. Horowitz i thekson pesë vërejtjet themelore për të mbrojtur qëndrimin se Konsociationi nuk ofron qëndrueshmëri institucionale.

Para së gjithash, elita politike e grupit shumicë në shoqërinë pluraliste nuk i percepton perspektivat afatgjata; prandaj impulsi për fitues afatshkurtër të pushtetit nuk është një motivim për ndarjen e pushtetit me minoritetet nëse elitat shumicë janë të afta të qeverisin vetëm. Kjo mund të shihet në njoftimet se qeveria e re e Kosovës duhet të përbëhet pa përfaqësues të Listës Qytetare Serbe, edhe pse prania e tyre është e garantuar me Kushtetutë (Novosti, 1 gusht 2014 f. 7). Së dyti, Horowitz hedh poshtë pretendimin se elitat politike të cilat përfaqësojnë segmentet e tyre do të jenë më tolerante se sa qytetarët e zakonshëm. Në disa raste u confirmua se mprehja e retorikës dhe nxitja e armiqësisë ndëretnike në fakt solli pikë politike, veçanërisht në periudhën zgjedhore. Më e shquara në këtë kuptim në anën shqiptare është një alternativë jo e papërfillshme nacionaliste Vetëvendosje e cila e kushtëzoi pjesëmarrjen e saj në qeverinë e re të Kosovës me anulimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më tani me Beogradin (Tota, 2013). Veçanërisht, marrëveshjet e arritura që kanë të bëjnë me të drejtat e serbëve të Kosovës. Së treti, ka shumë mundësi të del një rezistencë kundër elitave brenda subkulturave që mund të sfidojë kompromiset e arritura deri tani. I tillë ishte shembulli me Partin e Pavarur Liberale që pagoi pjesëmarrjen e saj në qeveri me përcëimin e komunitetit që ajo përfaqësoi. "Serbët e Thaçit", siç quheshin ata jozyrtarisht, ishin të marginalizuar në zgjedhjet e fundit, dhe "investim afatgjatë i Thaçit në ta ka ofruar rezultate të dobëta në momentet kyçe" (Morina 2014). Vërejtja e katërt e justifikuar ka të bëjë me faktin se një pasojë e autonomisë kulturore dhe e barazisë së segmenteve është zbutja e konflikteve ndëretnike por jo rregullimi i tyre. Rasti i Kosovës ka treguar se nëse nuk ka gatishmëri të etniteteve të ndryshme për të jetuar së bashku, modelet institucionale mbeten ndërtime vetëm teorike të përfshira në kushtetuta dhe ligje. Ky pohim do të vërtetohet veçanërisht brenda analizës sonë të hulumtimit të opinionit mbi distancën etnike ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. Së fundi, mos-dallimi i koalicioneve para-zgjedhore dhe pas-zgjedhore, dmth duke insistuar vetëm në aleancat pas-zgjedhore, e bën teorinë e konsolidimit demokratik të pambrojtur. Në Kosovë nuk

ka asnjë njohje të anës pozitive të koalicioneve para-zgjedhore të cilat do të shkonin përtej kufijve të ndarjeve shoqërore dhe etnike. Arena politike në këtë mënyrë do të fitonte një karakter multi-etnik dhe ndarjet do të bazoheshin në zgjedhje ideologjike. Megjithatë, në rrethanat e tanishme, një bashkëpunim para-elektoral i partive shqiptare dhe serbe do të konsiderohet tradhti nga të dyja anët. (Horoëitz, 2000, f. 19-22).

Qeveria qendrore në Prishtinë, si krijuese e politikave dhe rregullatore e procesit të decentralizimit, mori hapa drejt zbatimit të Planit të Ahtisaarit, por pa gatishmëri të mjaftueshme për të bërë këtë në një dialog me pjesën serbe. Ata nuk respektojnë faktin se pa një miratim nga Beogradi serbet e Kosovës nuk do të pranojnë asnjë formë të transferit të kompetencave, por vetëm bëjnë institucione paralele. Sigurisht, serbët do të mund të kishin realizuar interesat e tyre më mirë përmes decentralizimit dhe do të mund t'u kishte përgjigjur nevojave të qytetarëve për përmirësimin e kushteve të jetesës, por periudha e pas konfliktit, kërkon shumë më tepër përpjekje që politika të tilla të zhvillohen. Prandaj rezultatet e decentralizimit para nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit ishin shumë të pakta në kuptimin e legjitimitetit. Thelbi i problemit është mungesa e besimit në mesin e popullatës së mbetur serbe në enklava të pranojë një formë të vetëqeverisjes lokale që është projektuar dhe mbështetur nga pala shqiptare shumicë nga Prishtina. Serbët e konsideruan atë një ofertë e cila do të rezultojë në emigrimin e tyre të përhershëm nga vendet ku jetojnë. Koha e "paligjshmërisë" paralele, në të cilën institucionet e Prishtinës nuk ishin pranuar, përderisa institucionet e Beogradit vepronin në një shkallë të vogël, rezultoi me një katastrofë infrastrukturore dhe moszhvillimin ekonomik në komunat me popullatë shumicë serbe. Nëse i shtojmë kësaj edhe faktorin e pasigurisë si pasojë e armiqësisë etnike dhe konflikteve nga e kaluara e afërt, fotografia e plotë e pozitës së vështirë ekzistenciale të popullatës në komunat serbe bëhet më e qartë.

Ka pasur forca të caktuara politike në komunat e sapoformuara të cilat kanë pranuar integrimin me Prishtinën dhe zbatimin e dispozitave të Planit të Ahtisaarit. Institucionet e vetëqeverisjes lokale u krijuan, me qytetar serbë të emëruar në udhëheqësitë e tyre. Megjithatë, qytetarët shprehën mosbesimin e tyre ndaj institucioneve të krijuara për dy arsye kryesore: papërgjegjësia fillestare e manifestuar e autoriteteve të reja dhe ndjenja e besnikërisë dhe e përkatësisë ndaj institucioneve të udhëhequra nga Beogradi. Mungesa e legjitimitetit të institucioneve të reja të themeluara u manifestua përmes pjesëmarrjes minimale të votuesve në zgjedhjet lokale të organizuara nga Prishtina. Për shembull, në komunën e Graçanicës, e cila është komuna më e madhe serbe në Kosovën qendrore, vetëm 23% e numrit të përgjithshëm të votuesve morën pjesë në zgjedhjet lokale të 2009 (OSBE 2009).

Është e rëndësishme të theksohet se autoritetet e qëndrueshme dhe efikase komunale mund të ekzistojnë vetëm në qoftë se ka një mbështetje shumicë dhe legjitimiteti nga qytetarët. Duke pasur parasysh se Kosova sot është një sistem i veçantë politik përtej ndikimit të autoriteteve të Beogradit, pozita e komunave me shumicë serbe duhet të rregullohet në një marrëveshje me autoritetet në Prishtinë. Plani Ahtisaari ofron leva të rëndësishme të pushtetit në nivel lokal dhe garanton se autonomia në arsim, shëndetësi, në përbërjen e forcave të policisë, të shkallës së parë gjyqësorit etj do të jenë të aktivizuara.

Prandaj, qëllimi kryesor bëhet zbatimi i dispozitave të Planit të Ahtisaarit, i rregulluar me marrëveshjen e arritur në Bruksel ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës mbi themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe. Krijimi i Asociacionit të Komunave Serbe me levat aktuale të pushtetit është i shoqëruar me qëllime të veçanta të cilat duhet të arrihen në nivel lokal:

- A. Formimi i komunave të cilat do të gëzojnë legjitimitet nga qytetarët (përmes zgjedhjeve lokale të mbajtura në 2013)
- B. Mundësia që komunat të kenë të ardhurat e tyre dhe një rrjedhë të papenguar të mjeteve nga Beogradi dhe Prishtina (marrëveshje për financimin transparent të komunave serbe)
- C. Fillimi i projekteve të reja të infrastrukturës dhe rikonstruktimit të vjetrave që ishin shkatërrua në konfliktet e luftës dhe gjatë kohës
- D. Autonomia e garantuar për autoritetet komunale në rregullimin e sistemeve të arsimit dhe kujdesit shëndetësor, gjykatat e shkallës së parë dhe përbërjen e forcave policore.

## Marrëveshja e Brukselit

Marrëveshja e Brukselit, e nënshkruar më 19 prill, 2013 është "Marrëveshja e parë mbi Parimet që Qeverisin Normalizimin e Marrëdhënieve" e nënshkruar nga kryeministrat Ivica Daçiç dhe Hashim Thaçi. Marrëveshja e Brukselit u parapri me marrëveshjet dhe protokollet mbi lirinë e lëvizjes, regjistrat civile, regjistrat kadastralë, vulat doganore. Ne shkurt 2012 u arrit Marrëveshja për Përfaqësim dhe Bashkëpunim Rajonal e cila mundësoi që Kosova të marrë pjesë në nismat rajonale dhe takime nën një yll dhe fusnotë. Së fundi, njohja e diplomave universitare ishte rënë dakord dhe konkluzionet mbi menaxhimin e integruar të kufirit (IBM) janë harmonizuar (Pregled 1-2, 2013).

Marrëveshja e parë, e nënshkruar në mes të dy kryeministrave dhe e ndihmuar nga baronesha Ashton, përbëhet nga pesëmbëdhjetë pika. Marrëveshja përfshin katër tema të rëndësishme. Pjesa e parë e dokumentit ka të bëjë me formimin e Asociacionit të Komunave Serbe dhe kompetencave të saj të përgjithshëm. Pjesa e dytë përfshinë çështjet e sigurisë dhe sektorin gjyqësor, dmth integrimin e institucioneve ekzistuese politike dhe gjyqësore në veri të Kosovës në kornizën institucionale të Prishtinës. Tema e tretë kyçe ka të bëjë me zgjedhjet lokale, të mbajtura në bazë të artikullit 11 "në përputhje me ligjet e Kosovës". Së fundi, përveç afatit kohor dhe mënyrës së zbatimit të dispozitave të Marrëveshjes, pika 14 parasheh se "asnjëra palë do të bllokojë, apo inkurajojë të tjerët për të bllokuar, progresin e palës tjetër në shtigjet e tyre përkatëse të BE-së" (Marrëveshja Bruksel, 2013).

Marrëveshja e Brukselit parashikon ngritjen e një asociacion të komunave me shumicë serbe që do të jetë "e hapur për çdo komunë tjetër me kusht që anëtarët të jenë në marrëveshje". Asociacioni do të krijohet me statut, dhe ekzistenca e tij do të jetë e garantuar me ligje dhe me ligjin kushtetues. Asociacionit do të ketë trupat e tij: Presidentin, Kuvendin, Këshillin... dhe do të ketë një rol përfaqësues para qeverisë qendrore. Dispozita më e rëndësishme ka të bëjë me kompetencat e Asociacionit, duke thënë se AKS do të ketë "monitorim të plotë mbi fushat e zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural" (Marrëveshja e Brukselit, Neni. 4).

Ka një mosmarrëveshje ndërmjet palëve shqiptare dhe serbe nëse ky është një asociacion apo një shoqatë e përbashkët e komunave të cilat do të kenë kompetenca në nivelin e një organizate joqeveritare. Pala shqiptare e zvogëlon rëndësinë e AKS, duke theksuar se krijimi i ri institucional nuk do të ketë kompetenca më të mëdha se sa modelet e mëparshme ligjore për asociacionin e komunave, ndërsa pala serbe e mbithekson rëndësinë e AKS, duke e menduar Asociacionin si kuadër institucional për të ardhmen e komunitetit serb në mënyrë të pavarur nga vendimet e Prishtinës. Realiteti është në mes në mes të këtyre dy interpretimeve. Formulimi i gjerë i Marrëveshjes së Brukselit megjithatë na jep konturet e mjaftueshme të Asociacionit të ardhshëm të komunave serbe. Ai është një model i autonomisë që do të ketë aspektin e vet territorial dhe personal, të ofroj kompetenca të konsiderueshme për përfaqësuesit e serbëve për të vendosur në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe



zhvillimit ekonomik, që tejkalon kompetencat e përbashkëta të pushteteve lokale. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se AKS vepron në mënyrë të pavarur në raport me Prishtinën, por se ai do të bëjë një pjesë integrale të sistemit të saj institucional.

Marrëveshja e Brukselit u nënshkrua në interes të përbashkët pa marrë parasysh kritikën negative. Për Beogradin, përfitimet nga marrëveshja e arritur reflektojnë në realizimin e tri interesave kombëtare. Siç thekson Edjus, së pari është përmirësimi i pozicionit të Serbisë në integrimin në BE. I dyti pasqyron krijimin e një "mjedisi për mbrojtjen më të mirë të serbëve të Kosovës". Në fund të fundit, Serbia arriti në marrëveshjen e arritur që të jetë neutrale në aspekt statusor (Edjus, 2014). Do të jetë shumë e vështirë për autoritetet në Beograd të mbrojnë pozitën e mosnjohjes së shtetësisë së ndarë kur merret parasysh presioni ndërkombëtar dhe pritjet në raundin e ardhshëm të bisedimeve. Çdo fillim në Bruksel do të thotë heqje ligjore e Beogradit nga një pjesë e sovranitetit të tij. Gjithashtu, të gjitha kompetencat të cilat Beogradi i referohet Prishtinës në fund të dialogut do të duhet të "harmonizohen me Kushtetutën dhe sistemin juridik të Serbisë" (Edjus, 2014).

Avantazhet nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit për Prishtinën janë të shumta. Edhe pse ka një angazhim shumë më të madh në zbatimin e rënë dakord, Prishtina siguroi një rrugë pa pengesë drejt integritetit në BE, duke pasur parasysh se Beogradi është zotuar të mos e pengoj. Së dyti, Beogradi për herë të parë e njohu Prishtinën si një bashkëbisedues të barabartë dhe negociatat ishin të udhëhequra në nivelin e kryeministrit. Megjithatë, përfitimi i madh për Prishtinën është një integrim paqësor i veriut të Kosovës në institucionet nën kontrollin e saj. Fillimi i këtij integrimi është shënuar me mbajtjen e zgjedhjeve lokale ku kanë qenë të zgjedhur përfaqësuesit e rinj të katër komunave me shumicë serbe.

Rrethanë shqetësuese është se elita politike në Beograd dhe Prishtinë u detyruan nga pala e tretë për t'u ulur në tryezën e bisedimeve. Përveç kësaj, gatishmëria e të dy palëve për fillimin e negociatave është bazuar në motive të gabuara. Marrëveshja e Brukselit është arritur me lehtësimin e institucioneve të Bashkimit Evropian dhe me një premtim se marrëveshja e arritur do të përshpejtojë integrimin evropian. Interesi primar i Beogradit nuk ishte për të zgjidhur çështjet ekzistenciale dhe sigurinë e qytetarëve të Kosovës në veri që ndjehen si qytetarë të Serbisë, por për të parandaluar përfundimin e mundshëm të negociatave me BE-në. Në anën tjetër, mungesa me vite e interesimit të Prishtinës në veri të Kosovës u zëvendësua me tregimin lidhur me "papekshmërinë dhe përmbledhje të integritetit territorial". Kritikën e Marrëveshjes së Brukselit në Beograd dhe Prishtinë janë të ndryshme. Pala serbe konteston të drejtën e qeverisë për të nënshkruar marrëveshjet të cilat janë në kundërshtim me Kushtetutën aktuale të Serbisë. Ajo gjithashtu mohon legjitimitetin e marrëveshjes duke pasur parasysh se shumica e serbëve që jetojnë në veri nga lumi Ibër ende nuk kanë pranuar zbatimin e saj.<sup>1</sup> Ka rezerva të konsiderueshme kundër kompetencave të ardhshme të Asociacionit të Komunave Serbe sepse publiku serb nuk është i bindur se ky është kuadri institucional që do të garantojë mbijetesën e sigurt të serbëve në Kosovë.

Një anë negative e Marrëveshjes së Brukselit e vëzhguar nga perspektiva shqiptare është rreziku nga segregacioni. Siç thekson Morina, krijimi i AKS "sfidon të gjithë konceptin e Kosovës multi etnike" (Morina, 2014). Segregacioni është interpretimi i situatës në të cilën pakicat e tjera në Kosovë do të kenë më pak të drejta dhe mekanizma institucionale për mbrojtjen, në krahasim me serbët, dhe se kufijtë e "trojeve etnike" të ndryshme do të tërhiqen nëpër Kosovë.

Ky argumentim humb disa fakte nga vështrimi. Para se gjithash, institucionet në veri të Kosovës

---

1 Sipas hulumtimit të kryer në kuadër të projektit të Ambasadës të Mbretërisë së Bashkuar dhe në YIHR, vetëm 30,2% e popullsisë së Mitrovicës së Veriut mbështet Marrëveshjen e Brukselit.

kanë ekzistuar tërësisht në mënyrë të pavarur nga Prishtina dhe modaliteti i vetëm për institucionet për tu integruar me Prishtinën me miratimin e qytetarëve, është një autonomi e gjerë. Për më tepër, serbët në Kosovë gëzojnë një status të veçantë sepse deri në vitin 2000 ata ishin konsideruar anëtarë të popullatës shumicë dhe për këtë arsye kanë pasur të drejtat e barabarta e jo të një populli pakicë.”Ndjeshmëria” e veçantë institucionale për serbët është e justifikuar duke pasur parasysh se serbët lanë qytete dhe fshatra në të cilat shqiptarët morën pushtetin, ku për kthimin e serbëve të dëbuar është bërë përparim shumë i vogël dhe që ende nuk ka shqiptar që janë dënuar për krimet e kryera kundër serbëve. Në bazë të kësaj, Kosova multi etnike qëndron në këmbë të brishta. Serbët në Mitrovicë, Leposaviq dhe Zveçan kanë frikë se bashkëpunimi me Prishtinën do të reduktojë numrin e tyre me numrin e serbëve që jetojnë në këtë qytet sot (para 1999 kishte rreth dyzet mijë, sot rreth njëqind njerëz). Së fundi, analizat e hulumtimit të distancës etnike i cili vjen në kapitullin e ardhshëm do të tregojnë se shqiptarët nuk duan të shohin serbët në institucionet e përbashkëta dhe për këtë arsye Asociacioni i Komunave Serbe (AKS) del si një zgjidhje e qëndrueshme me efekt e shtypjes së segregacionit dhe jo thellimin saj.

## **Arritjet e bashkëjetesës ndëretnike në Kosovë.**

Hulumtimi i distancës etnike<sup>2</sup> të kryera në kuadër të projektit të mbështetur nga Ambasada e Britanisë së Madhe dhe me Inicativën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (IRDNJ), tregon për një ndarje të rëndësishme ndëretnike në Prishtinë me Graçanicë dhe në veri dhe jug të Mitrovicës. Vërejtur në kontekstin e Marrëveshjes së Brukselit dhe krijimin e AKS rezultatet paraqesin një pamje pesimiste. Mbështetja mungon si për rregullimin ekzistues institucional ashtu dhe për dhënien e mundshme të një autonomie më të madhe për serbët.

Kur u pyetën se ”A do të pranojnë një anëtar të nacionalitetit serb / shqiptar për të qenë në pozitën udhëheqëse në shtet?” 70,4% e të anketuarëve shqiptarë u përgjigj Jo, ndërsa përgjigja me më pak përqindje e serbëve - 62,8% - ishte negative. Përqindja e lartë e intolerancës dhe mos pranimit të anëtarëve të një kombi tjetër në udhëheqjen e institucioneve flet për mungesë të konsensusit bazë dhe mundësi për krijimin e institucioneve të përbashkëta. Baza e marrëdhënieve aktuale është mosbesimi.

Veçanërisht shqetësuese është përgjigja për pyetjen ”Sa shpesh ju bisedoni me anëtarët e nacionalitetit serb / shqiptar?”, Ku në total 42% e të anketuarve serbë e shqiptarë thanë se ata nuk socializohen fare, me 21.5% e të anketuarve duke thënë se kontaktet e tyre me anëtarët e një shtetësie tjetër ishin shumë të pakta. Përveç kësaj, në pyetjen ”Sa shpesh vizitoni restorante shqiptare / serbe, dyqane, kafe?”, 48% e të anketuarve janë përgjigjur ”shumë rrallë”, ndërsa 15,3% kanë thënë ”rrallë”. Këto të dhëna tregojnë një ndarje të thellë dhe mungesën e çfarëdo lloji të ndërveprimit në mesin e shumicës së anëtarëve të të dy grupeve etnike, në ambientet ku ata jetojnë krah për krah. Ndarja është, prandaj, tashmë ekzistuese dhe nuk duhet të arrihet me anë të nënshkrimit të marrëveshjeve të reja. Përgjigjet në pyetjet rreth sigurisë tregojnë se në sytë e të anketuarve Kosova ende nuk e ka lënë domenin e ndjeshmërisë së pas konfliktit dhe mundësinë për shkallëzimin e konflikteve të reja me baza etnike. Pothuajse 60% e të anketuarve të nacionalitetit serb mendojnë për ta lënë Kosovën. Megjithatë, shikuar në mënyrë individuale, gjendja ekonomike është arsyeja kryesore për të cilën ata do të largohen nga vendet e banimit të tyre (49,4%), arsyet si siguria e kërcënuar personale, armiqësitë

---

2 Një analizë më e thellë e rezultateve kërkimore dhe shpjegim metodologjik mund të gjenden në gazetat e Nikolla Jović dhe Milena Gligorijević.

ndëretnike, mosrespektimi i të drejtave të njeriut dhe paqëndrueshmërisë politike janë dominuese. Rëndësia e diferencë në mes të përgjigjeve të serbëve dhe shqiptarëve ka të bëjë me aspektin e zgjimit të një konflikti të dhunshëm etnik. Serbët shohin një nivel të lartë të rrezikut - 49,6%, ndërsa jorelativisht 25% e shqiptarëve mendojnë se rreziku nga konflikti i ri është i lartë. Komuniteti serb ndihet më i kërcënuar dhe ndjenjat e frikës dhe pasigurisë janë më të forta në mesin e anëtarëve të saj. Një formë e autonomisë dhe krijimi i Asociacionit të Komunave Serbe mund të mundësojë ndjenjën e sigurisë më të lartë.

Ekziston një marrëveshje e rëndësishme në mesin e popullatës së Kosovës për të drejtat e komuniteteve pakicë që të përfaqësohen në parlament (në favor të përfaqësimit: 56,7% Serbë, 56,2% - shqiptarë). Kjo duket të jetë modeli i vetëm institucional i pjesëmarrjes së serbëve që gëzojnë mbështetjen e shumicës shqiptare. Tashmë në qëndrimin se "serbët dhe shqiptarët duhet të jenë të barabartë në organet e vetqeverisjes lokale" përkrahja bie në 27,8% të anketuarve Shqiptarë.

Sipas rezultateve të hulumtimit të distancës etnike, shumë të drejta të garantuara në favor të modelit të ndarjes së pushtetit nuk kanë përmbushur miratimin e anëtarëve të komunitetit shqiptar. Barazia e gjuhëve serbe dhe shqiptare në përdorim zyrtar është përkrahur nga 20.7% e popullsisë shumicë. Përfaqësimi parlamentar bëhet vetëm një formë nëse komunitetet pakicë nuk marrin pjesë proporcionalisht në formimin e qeverisë. Megjithatë, vetëm 19% të serbëve dhe 12,4% e shqiptarëve pajtohen se "serbët dhe shqiptarët duhet të marrin pozicione politike". Përkrahja e parëndësishme për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunitetit tjetër etnik në pika të jetës politike në problemin e mungesës së përhershme të legjitimitetit të çdo forme të qeverisjes multi etnike. Dizajni ekzistues institucional prodhon ndasitë në nivel ndëretnik dhe në fushën ndër-etnike - mes votuesve dhe elitave të tyre politike (të tilla më sipër shembull të Partisë së Pavarur Liberale dhe pjesëmarrjen e saj në qeverinë e përmendur).

Përveç pjesëmarrjes në trup legjislativ, serbët dhe shqiptarët të bien dakord në një masë të konsiderueshme në një pyetje më shumë. Bëhet fjalë për negociatat midis Beogradit dhe Prishtinës të mbajtur në Bruksel. Kur u pyetën "A i përkrahni negociatat?" 36,1% e shqiptarëve dhe 29,4% të serbëve u përgjigjën pozitivisht. Edhe pse këto janë negociata që duhet t'i dërgojnë në pozita më të mira dhe mbrojtëse, duket se serbët që jetojnë në Kosovë nuk i kuptojnë përfitimet e veçanta. Nëse shtohen të dhënat se vetëm 14.2% e shqiptarëve përkrahin dhënien e autonomisë më të madhe për serbët, kemi ardhur në përfundim se Kosova, sipas dëshirave të popullsisë së saj, është në një lloj bllokimi institucional.

Vërejtur nga këndvështrimi i menaxhimit të pas konfliktit, arrijmë në përfundime të rëndësishme duke krahasuar rezultatet e hulumtimit për vendet e banimit. Frika më e lartë nga një konflikti i ri etnik (pothuajse 61,4% e të anketuarve) është në mesin e qytetarëve të Mitrovicës së Jugut nga Ibar Ribar, i cili është në shumicë absolute e banuar me shqiptarë. Në Prishtinë, të anketuarit shprehën mundësinë më të ulët të një konflikti të ri (vetëm 11,5%). Më e larta, por ende nuk është përkrahja absolute e shumicës në negociatat e Brukselit në fakt vjen nga ata që kanë frikë nga konfliktet e reja më së shumti - Qytetarët e Mitrovicës së Jugut (39,6% e të anketuarve përkrahin negociatat).

Në fund, të dhëna të rëndësishme janë marrë përmes përgjigjeve të qëndrimit përmes pyetjeve "Mendimi im për serbët / shqiptarët është krijuar në bazë të...". Përvoja personale dhe kontakti i drejtpërdrejtë janë dominuese në mesin e të anketuarve të moshës së mesme, e ndjekur nga opinioni dhe qëndrimet e familjes në kategoritë më të reja të popullsisë. Është interesante se pothuajse 20% e të anketuarve të nacionalitetit serb tha se qëndrimi i tyre ndaj shqiptarëve është i ndikuar nga "mendimi dhe qëndrimi i udhëheqësve fetarë" d.m.th. përfaqësues të Kishës Ortodokse Serbe.

Në mesin e përgjigjeve të anëtarëve të komunitetit shqiptar është interesant se 50,2% e të anketuarve thanë se imazhi i tyre ndaj serbëve është i formuar në bazë të informatave nga mediat. Këto të dhëna mund të flasin në favor të tezës se nuk ka kontakte direkte në mes të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike, në mënyrë që imazhi i njëjës palë për tjerën është marrë përmes mediave. Nga ana tjetër, hulumtimi zbulon fuqi të ndjeshme në duart e mediave, të cilat mund të investojnë në ndryshimin e vetëdijes dhe promovimin e ideve të bashkëjetesës multi etnike.

## **Autonomia si parakusht për krijimin e shoqërisë multi etnike – Vërejtjet përfundimtare**

Ndjenja e mosbesimit si dhe performanca e dobët e mekanizmave institucional, janë pengesat kryesore për krijimin e një shoqërie multietnike në Kosovë. Një kompromis duhet të arrihet midis dëshirave të popullatës shumicë shqiptare dhe komunitetit të mbetur serb. Pala shqiptare duhet të pranojë të drejtën e pamohueshme të serbëve në specialitet dhe dëshirën e tyre për një qeveri autonome në fushat e arsimit, shëndetësisë, sigurisë dhe drejtësisë. Në anën tjetër, popullata serbe duhet kuptuar domosdoshmërinë e bashkëpunimit dhe ndërtimit të kompromisit me palën shqiptare, d.m.th. institucionet në Prishtinë. Rruga drejt arritjes së këtij qëllimi ka dy pengesa kryesore. Pengesa e parë përbëhet nga një transparencë e pamjaftueshme e procesit të negociatave Beograd-Prishtinë. Diskutimet e udhëhequra në Bruksel deri tani kanë hapur hapësirë për manipulim, në të dyja anët, me të dhëna dhe në nivel politik, ku autoritetet në Beograd dhe Prishtinë shpesh kanë përdorur negociatat për konflikte të brendshme politike duke fituar pikë afatshkurtra politike. Në anën tjetër, në mesin e qytetarëve të cilët janë shumë të shqetësuar në lidhje me rezultatin e negociatave, pasiguria e procesit të thelloi tensionet dhe shkaktoi frikë nga ndryshimi i status quo. Fakti kryesor është anashkaluar - se çdo marrëveshje e arritur në Bruksel do të mbetet një letër e vdekur në fletë nëse nuk ka vullnet në mesin e qytetarëve për zbatimin e tij. Gjendja e tanishme në Kosovë - bllokada institucionale në Prishtinë (pa pjesëmarrjen e serbëve në institucione), forcimi i forcave politike që kundërshtojnë marrëveshjet dhe bojkotojnë heshturazi në Mitrovicën e Veriut, konfirmon këtë më së shumti.

Një tjetër rrethanë vështirësuese është se marrëveshja në Bruksel është arritur me lehtësimin dhe nën presionin politik të bashkësisë ndërkombëtare, institucionet e BE-së. E meta kryesore në projektimin institucional të bërë nga aktorët ndërkombëtarë është se qytetarët, në këtë rast anëtarët e komuniteteve të ndryshme etnike, ndjehen të përjashtuar. Mungesa e konsensusit ndëretnik plotësohet me presion ndërkombëtar ndaj elitave politike të komuniteteve "konfrontuese", ndërsa anëtarët e këtyre komuniteteve fitojnë një përshtypje të pamohueshme se zgjidhjet janë imponuar dhe nuk duhet të pranohen.

Ashtu si shoqëritë tjera me ndarje të thellë në Ballkan, Kosovës iu ofrua zgjidhja a la Carte, ku marrëveshjet shumë komplekse demokratike kushtetuese u përpoqën që të aplikohen në një demokraci të brishtë, mungesa e pjesëmarrjes dhe, legjitimiteti. Udhëzimet kryesore të komunitetit ndërkombëtar në këtë dizajnim janë arsyet gjeostrategjike dhe rajonale, me shpresa se marrëdhëniet komplekse "do të jenë normalizuar" në një kohë të ngjeshur. Aktet më të larta ligjore të miratuara apo të imponuara priten, siç theksohet nga Profesor Basta FLEINER, "prodhojnë njëkohësisht dhe garantojnë supozimet për vlefshmërinë e tyre" (Basta FLEINER, 2013). Njëjta gjë vlen edhe për Marrëveshjen e Brukselit.

Krijimi i Asociacionit të Komunave Serbe do të sjellë një përfitim të dyfishtë. Anëtarët e komunitetit etnik serb fitojnë siguri institucionale dhe mundësinë për të qeverisur në mënyrë të pavarur sektorët kyç. Përfaqësuesit të cilët ata i zgjedhin do të veprojnë në nivelin politik lokal, rezultatet e tyre do të jenë lehtësisht të matshëm dhe llogaridhënia e tyre do të jetë e qartë dhe e pandarë.

Një tjetër avantazh është relevante për palën shqiptare, që diskursi politik do ta humb "çështjen serbe" si problemin kryesor politik dhe të investojnë për zgjidhjen e problemeve themelore sociale. Përveç kësaj, përfaqësuesit e serbëve nuk do të kenë më një rol në polarizimin e skenës politike në Prishtinë përmes mbështetjes të disa opsioneve politike në pushtet. Aktivitetet kryesore do të jenë ato në kuadrin e Asociacionit të Komunave Serbe, ndërsa veprimtaria përfaqësuese në Prishtinë do të bazohet në mbrojtjen e të drejtave të garantuara të komunitetit serb në Kosovë.

Konflikti ndëretnik në mes serbëve dhe shqiptarëve në të kaluarën e afërt krijoi lidhjen e mosbesimit të thellë icilinë vitet e pas-konfliktit nuk është menaxhuar për ta bërë relative këte. Rezultatet e pikës kërkimore synojnë në pozicionet e ngulitura në llogore etnike të të dy palëve. Synimi për të krijuar një shoqëri multi etnike në Kosovë tani për tani vjen vetëm nga faktori i jashtëm. Mbyllja e institucioneve të menaxhuara nga Beogradi anulon paralelizmin institucional por e lë atë psikologjik. Mungesa e mundshme e autonomisë për serbët në formën e Asociacionit të Komunave Serbe do të ngrij ndjenjën e frikës, pasigurisë, izolimit, pra jetën e përhershme të serbëve në një botë paralele.

## Literatura

Basta Flajner, L 2010, "Međunarodna zajednica i ustavotvorna vlast" në Država i demokratija, ed. M Podunavac, Službeni glasnik, pp. 167-176.

Ejdus, F 2014, "The Brussels Agreement and Serbia's National Interests – A Positive Balance Sheet?", Konrad Adenauer Stiftung, Belgrade, pp.1-8.

Gallucci, GM 2012, "The Ahtisaari Plan and North Kosovo", TransConflict, Policy, Në dispozicion tek : <<http://www.transconflict.com/think/policy/ahtisaari-plan-north-kosovo/>>

Gjoni, R & Eetterberg, A & Dunbar, D 2010, "Decentralization as a conflict transformation tool: The challenge in Kosovo", Public Administration & Development, vol. 30, nr. 5, pp. 291-312.

Horoëitz, D 2002, "Constitutional Design: Proposal versus Processes" in The Architecture of Democracy: Constitutional Design, Conflict Management, and Democracy, ed A Reynolds, Oxford University Press, Oxford, pp. 19-22.

Horoëitz, D 2000, Ethnic Groups in Conflict, University of California Press, Berkley, Los Angeles&London.

Lajphart, A 1992, Demokracija u pluralnim društvima, Globus, Zagreb.

Lijphart, A 2008, Thinking about Democracy: Power-Sharing and Majority Rule in Theory and Practice, Routledge, Abingdon.

Morina, A 2014, "Brussels 'First Agreement' – A year after", Policy Briefs, Konrad Adenauer Stiftung, Belgrade, pp.1-7.

Tatalović, S 2010, Globalna sigurnost i etnički sukobi, Politička kultura, Zagreb.

Teokarević, J 2012, Demokratizacija postkomunističkih političkih sistema na Balkanu, Fakultet političkih nauka, Belgrade.

Plani i Ahtisarit 2007. OSBE raporti i zgjedhjeve, 2009. Duke parë 1-2, Gazeta Zyrtare, f. 129-143.

Marrëveshja e parë për Parimet në Qeverisjen e normalizimit të marrëdhënieve - "Marrëveshja e Brukselit", 2013.

Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare në Kosovë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2014.

Rezultatet e hulumtimit të distancës etnike midis serbëve dhe shqiptarëve, ekipi i Kërkimeve të Fakultetit të Shkencave Politike, 2014.

Đorđević, D 2014, "Čeku trikom pravi vojsku", Novosti August 11. Available at: <<http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/politika/aktuelno.289.html:504933-Ceku-Postoji-i-Plan-B-kako-da-Kosovo-dobije-vojsku>>.

Refki, A 2009, "Gde su obećane srpske opštine na Kosovu?", Deutsche Ėelle September 9. Available at: <<http://www.dē.de/dē/article/0,,4659213,00.html>>.

Tota, E 2013, "Self Determination Movement earns that it ĩll send the Brussels Agreement to the Constitutional Court", Independent Balkan Neēs Agency June10. Available from: <<http://www.balkaneu.com/determination-movement-earns-send-brussels-agreement-constitutional-court/#sthash.C98f4PLq.dpuf>>.

Taçi hoće vladu bez Srpske, 2014. Available at: <<http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/politika/aktuelno.289.html%3A503682-Taci-hoce-vladu-bez-Srpske>>. [September 21, 2014].

Dušan Vučićević

## Si sistemi zgjedhor si faktor i tejkalimit të ndasive etnike në Kosovë

Në këtë punim autori përpiqet të përgjigjet në pyetjen nëse modeli ekzistues zgjedhor kontribuon në zbutjen e ndarjeve etnike në Kosovë. Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës janë kryer sipas modelit proporcional, me lista të hapura zgjedhore dhe me pragun zgjedhor prej 5 %. Nga 120 ulëse, njëzet vende janë të garantuara për deputetët e pakicave, dhjetë prej tyre i përkasin subjekteve politike që përfaqësojnë interesat e komunitetit serb dhe dhjetë të mbeturat për komunitetet tjera jo shumicë. Projektimi i institucioneve të Kosovës miratoi idetë e teorisë konsociacionale; prandaj zgjedhja e deputetëve bëhet sipas modelit proporcional me garanci të veçanta për mbrojtjen institucionale të minoriteteve. Edhe pse sigurojnë që zëri i pakicave të dëgjohej në parlamentin e Kosovës, projektimi i tillë zgjedhor krijon incentiva institucionale për zbatimin e politikës etnocentrike pa kontribuar as në krijimin e partive shumetnike as në orientimin e palëve drejt politikës së pajtimit. Prandaj punimi analizon kapacitetet potenciale të akomodimit të disa ideve që rrjedhin nga teoria integriste, veç tjerash të votave të vetme të transferueshme dhe atyre alternative.



sistemi zgjedhor i Kosovës,  
komuniteti serb në Parlamentin  
e Kosovës



Ky tekst u shkrua fillimisht në  
gjuhën serbe.

Sistemi zgjedhor është tërësia e rregullave dhe procedurave me të cilat votat e votuesve individuale transferohen në mandate parlamentare. Është nervi qendrorë i një sistemi politik, pasi ky nënsistem kompleks është ai ku funksionet kyçe qeveritare dhe konfliktet midis aktorëve më të rëndësishëm politik dhe social në një shtet zgjidhen. Nuk ka asnjë marrëveshje të përgjithshme në shkencat politike mbi rëndësinë e sistemeve zgjedhore për zhvillimin e partisë dhe të sistemeve politike. Ka dy qëndrime diametralisht të kundërta. Sipas atij të parit, sistemeve zgjedhore u atribuohet një rol dytësor, pothuajse i parëndësishëm, duke neglizhuar se edhe në shoqëritë e qëndrueshme demokratike rezultatet zgjedhore ndikojnë direkt në përbërjen e parlamentit, formimin e qeverisë dhe të sistemit të partisë, dhe se rezultatet zgjedhore në vetvete janë një pasojë e drejtpërdrejtë e kombinimit të institucioneve të ndryshme zgjedhore dhe (jo) zgjedhja e qëllimshme e një modeli të caktuar. Sipas të dytës, pozitës maksimaliste, të gjitha problemet dhe sfidat në procesin e demokratizimit mund të zgjidhen me një reformë të sistemit zgjedhor, e cila në fund të fundit çon në inxhinieri kushtetuese dhe zgjedhore dhe qasje të njëanshme në zgjidhjen e problemeve të cilat, më shpesh, nuk mund të hiqen vetëm me ridizajnim të thjeshtë të rregullave kushtetuese dhe zgjedhore.

Edhe pse qëllimi i këtij punimi është që të përcaktojë nëse sistemi ekzistues zgjedhor në Kosovë kontribuon në zbutjen e ndarjeve etnike dhe nëse ndonjë model tjetër zgjedhor do të kontribuonte në mënyrë më efektive në tejkalimin e ndarjeve etnike dhe heqje të etnifikimit të skenës politike të Kosovës, autori do të përpikët të shmang kurthin e pozitës maksimaliste. Edhe pse ne besojmë se sistemi zgjedhor është pjesa më e rëndësishme e sistemit politik, pasi që ajo ndikon në sistemin partiak dhe zgjeron spektrin e përfaqësimit politik, ne nuk duam të reduktojmë fatin e "shoqërisë së Kosovës" për arkitekturën zgjedhore. Në fund të fundit, problemet me të cilat komunitetet e pakicave në Kosovë ballafaqohen nuk mund të zhduken nga një ndryshim i ligjeve zgjedhore. Institucionet zgjedhore nuk sigurojnë lirinë e lëvizjes për serbët e mbetur dhe kthimin e të zhvendosurve, nuk zgjidhin raste të vrasjeve e as zbulojë fatin e personave të zhdukur pas vitit 1999, nuk parandalojnë sakrilegje të shenjta ortodokse dhe varreza, nuk i bëjnë njerëzit të harrojnë të kaluarën e cila ishte shënuar me polarizim të mprehtë të dy bashkësive më të mëdha etnike, shqiptare dhe serbe, polarizim që ka çuar shpesh në rritje të konfliktit të hapur dhe dhunës, duke thelluar tutje antagonizmat në mes grupeve të kundërta etnike.

Megjithatë, ne mendojmë se për bashkëjetesën e mëtutjeshme të grupeve të ndryshme etnike në Kosovë modelimi i kujdesshëm i sistemit zgjedhor është i një rëndësie të veçantë, me kusht që, natyrisht, qëllimet e vendosura nënkuptojnë zgjedhjen e politikanëve të moderuar, të pranueshëm si për komunitetin shqiptar ashtu edhe për atë serb, krijimin dhe forcimin e partive shumetnike dhe heqja e etnifikimit të politikës në Kosovë. Vetëm në kushte të tilla institucionet e Kosovës do të mund të jenë të pranueshme për serbët si dhe vetëm institucionet e tilla do të mund të zgjidhin problemet e përmendura më lart.

## **A ekziston modeli "më i miri" zgjedhor për shoqëritë e ndara etnikisht?**

Një nga sfidat më të mëdha me të cilën një numër i madh i shtetesh përballet është diversiteti etnik, fetar, gjuhësor dhe kulturor. Prandaj përpjekjet për gjetjen e zgjidhjeve për rregullimin dhe zbutjen e konflikteve në shoqëritë me ndarje të thella paraqesin një sfidë të veçantë jo vetëm për politikanët, por edhe për studiuesit. Nëse ne neglizhojmë këshillat që alternativa më e mirë për shoqëritë heterogjene etnikisht është një përfundim i qetë politik, zhdukja e gjendjes së tanishme pluraliste dhe shfaqja e shteteve të reja, etnikisht (më shumë) homogjene, ne kemi dy zgjidhje para nesh.

Sipas të parës, është më mirë që të nxirren linja të qarta të demarkacionit institucional në mes komuniteteve etnike në konfrontim. Në mënyrë efektive, është e mundur që të arrihet ndarja institucionale nga federalizimi i shtetit, duke ndërtuar një sistem të veçantë gjyqësor apo arsimor në territoret e populluar nga anëtarët e grupeve të ndryshme etnike, nga formimi i zonave zgjedhore në zonat ku anëtarët e grupeve pakicë janë territorialisht të koncentruar, me krijimin e rregullave zgjedhore që lejojnë diskriminimin pozitiv të partive dhe kandidatëve të komuniteteve etnike, etj. Zgjidhje të tilla institucionale krijojnë kushte për zhvillimin e një politike ekskluzivisht etnike. Në shtyllën tjetër janë idetë që kanë për qëllim integrimin e komuniteteve në konflikt.

Përkrahësit e ideve të tilla kanë për qëllim minimizimin e rëndësisë së përkatësisë etnike në jetën politike, heqjen e etnikimit të politikës, promovimin e të drejtave dhe lirive individuale të njeriut dhe ndërtimin e një ndjenje të përkatësisë në shtet në mënyrë të pavarur nga identitetet përkatëse kombëtare, por jo në kundërshtim to<sup>1</sup>.

Debati lidhur me zgjidhjet e përshtatshme institucionale për shoqëritë me ndasi të thella mund të reduktohet në debatin për zgjedhjen e tyre të sistemit elektoral. Nga njëra anë janë protagonistët e idesë së përfaqësimit proporcional (PR). Sistemi proporcional zgjedhor - në kombinim me fuqinë e vetos për komunitetet e pakicave me të cilat ata mbrojnë interesat e tyre jetike, me autonomi të garantuar mundëson vendim-marrje të pavarur për çështjet e brendshme dhe me shpërndarjen proporcionale të burimeve shtetërore dhe poste publike në çdo segment të shoqërisë së ndarë – përmbledh tiparet themelore të konceptit të demokracisë konsociacionale ose të ndarjes së pushtetit. Rezultati i marrëveshjes së tillë institucionale është sundimi i koalicionit të madh me të cilin Lijphart nënkupton ndarjen formale dhe joformale të pushtetit midis grupeve të ndryshme etnike, fetare, gjuhësore dhe kulturore në një shoqëri. Sistemi proporcional zgjedhor, veçanërisht në dallimet e tij ekstreme (zonë e vetme elektorale dhe mungesa e pragut zgjedhor), siguron proporcionalitet maksimal në mes të pjesës së votave dhe mandatet e fituara, përfaqësimit të drejtë të të gjitha grupeve sociale dhe të interesit në parlament, zhvillimin e sistemit shumëpartiak, formimin e qeverisë me koalicione të cilat duhet të sigurojnë mbijetesën e tyre përmes negociatave të përhershme dhe ndërtimin e konsensusit në mes grupeve. Përfaqësuesi kryesor i këtyre ideve dhe krijuesi i konceptit të demokracisë konsociacionale është Arend Lijphart (Lijphart 1997, 1991, 1996, 2008). Mekanizmat konsociacionale u japin pushtet të tepruar elitave politike të zgjedhura nga segmente të ndryshme të shoqërisë pluraliste. Ato nuk krijojnë incentiva institucionale për politikanët që të punojnë për integrimin politik të shtetit, por motivojnë ata për të propozuar politika nga të cilat vetëm anëtarët e grupeve të tyre etnike do të përfitojnë.

Një shkollë tjetër përbëhet nga autorë të cilët propozojnë që mbajtësit e pushtetit politik të zgjidhen sipas procedurave zgjedhore të cilat janë më të favorshme për kandidatët që gëzojnë mbështetje në grupet e konfrontuara etnike, politikan të orientuar drejt politikës së pajtimit (Bochsler 2011; Horowitz 1985, 1991, 2003; O'Leary et al 2003; Reilly 2001). Ndërsa konsociacionistët vënë theksin në koalicione pas-zgjedhore, anëtarët e kësaj shkolle caktojnë rol më të rëndësishëm koalicioneve para-zgjedhore dhe krijimin e partive shumëetnike e cila do të nxjerrë fuqinë e tyre zgjedhore në bazë të votave që shkojnë përtej kufijve etnikë. Kandidatët e zgjedhur nga votat e bashkësive të ndryshme etnike do të kenë një detyrim të fortë për të zhvilluar politikë e cila nuk është ekskluzivisht e bazuar në etnitet. Modeli zgjedhor i propozuar nga Donald Horowitz si zgjidhja më e mirë për shoqëritë e ndërlikuara etnike ishte sistemi i votës alternative (AV). Sipas Horowitz, votimi alternativ krijon incentiva për

---

1 Mbi patriotizmin kushtetues si strategji për ndërtimin e identitetit politik dhe unitetit në shoqërinë pluralistë të Kosovës shih tekstin nga Nikola Beljinac në këtë vëllim.



akomodim ndër-grupor në zgjedhje duke inkurajuar partitë dhe kandidatët që të zhvillojnë fushata tërheqëse për votuesit nga kampi i kundërt etnik për t'i dhënë atyre preferencë të dytë (ose të tretë) kur është e sigurt se preferenca e parë e tyre është kandidati nga grupi i tyre etnik. Në situata kur asnjë kandidat nuk e ka shumicën absolute për të qenë preferencë e parë, numri i votuesve për preferencën e dytë (të tretë, të katërt...) mund të ndikojë në mënyrë vendimtare në rezultatin zgjedhor. Prandaj partitë politike do të jenë të motivuara që të marrin pozicione të moderuara, të cilat do të rrisin prirjen e tyre ndaj kompromisit, ndërsa kandidatët do të përpiqen të zgjerojnë bazën e tyre zgjedhore përtej grupeve të tyre etnike në kërkim të shumicës absolute të preferencave. Votimi Alternativ, si dhe sistemi i votës së vetme të transferueshme (STV) dhe sistemi i votës së vetme të pa-transferueshme (SNTV), me të cilat do të merremi në vijim të këtij punimi, mund të çojë në politikën e kompromisit ndër-grupor dhe negocijimit para-zgjedhor vetëm nëse zbatohet në zonat zgjedhore me karakter shumetnik.

Sistemet e votave alternative, p.sh. sistemet e balotazhit (instant runoff), janë të bazuara në votimin preferencial dhe një zonë të vetme elektorale. Në to votuesit shprehin preferencat e tyre duke shkruar numrin një (1) para emrit të kandidatit që është zgjedhja e tyre e parë, numri dy (2) para kandidatit që është zgjedhja e tyre e dytë, dhe kështu me radhë. Numërimi i votave në këtë sistem është një proces shumëfazësh i cili zgjat deri sa një kandidat nuk merr shumicën absolute të votave. Më saktësisht, nëse asnjë kandidat nuk ka shumicën absolute të preferencave të para, numërimi vazhdon duke eliminuar kandidatët me numrin më të ulët të preferencave të para dhe shpërndarjen e votave e tij / saj kandidatëve të tjerë në përputhje me preferencat e tjera të shënuara në fletën e votimit. Kjo procedurë përsëritet derisa një nga kandidatët mbledh shumicën absolute.

Në një situatë hipotetike në të cilën në një zonë zgjedhore 42% e votuesve votojnë për kandidatin radikal të grupit etnik A, 26% për kandidatin radikal të grupit etnik B, 17% për kandidatin e moderuar të grupit etnik A dhe 15% për kandidatin e moderuar të grupit etnik B, është e mundur që të zgjidhet një kandidat i moderuar, nëse votuesit e moderuar e shënojnë si preferencë të tyre të dytë kandidatin e moderuar nga grupi i kundërt etnik në vend të kandidatit radikal të tyre.

TABELA 1. SITUATË HIPOTETIKE NË NJË ZONË TË VETME ZGJEDHORE ME KANDIDATËT E TË DY GRUPEVE ETNIKE – A DHE B – TË ORIENTIMIT RADIKAL DHE TË MODERUAR

	42%	26%	17%	15%
preferenca e parë	rA	rB	mB	mA
preferenca e dytë	mA	mB	mA	mB
preferenca e tretë	mB	mA	rB	rA
preferenca e katër	rB	rA	rA	rB

TABELA 2. REZULTATET E ZGJEDHJEVE SIPAS SISTEMIT TË VOTËS ALTERNATIVE NË NJË SITUATË HIPOTETIKE

	rA	rB	mB	mA
numërimi i parë	42%	26%	17%	15%
numërimi i dytë	42%	26%	32%	Përrjashtuar
numërimi i tretë	42%	përrjashtuar	58%	

Edhe pse numri i përgjithshëm i preferencave të para të fituara nga kandidatët radikal është shumë më i lartë (68%) se sa ato të të moderuarve (32%), shpërndarja e preferencave të tjera - zgjedhësit radikal shënojnë përfaqësuesin e grupit të tyre etnik si preferencë të dytë, përdërisa votuesit e moderuar më shpesh zgjedhin kandidatët e moderuar nga grupi i kundërt, atëherë ata nga radhët e tyre të cilët nuk janë të gatshëm për normalizim dhe kompromis, por janë në favor të radikalizimit shtesë të marrëdhënieve ndër-grupore - çojnë në zgjedhjen e kandidatit të moderuar të grupit etnik B. Në këtë rast, rezultati i tillë zgjedhor ndikon në të dy partitë dhe në kandidatët dhe i bënë ata të zbusin retorikën e tyre, të kthehet në drejtim të negociatave ndërmjet grupeve dhe të pozicionohen më afër votuesit mesatar. Votimi Alternativ zbatohet në Australi, Fixhi dhe Papua Guinea e Re, dhe pas miratimit të tij, dy shtetet e fundit të përmendura kanë arritur të zbusin tensionet etnike dhe të reduktojnë armiqësitë etnike të cilat i kishin karakterizuar shoqëritë e tyre (eds. Gallagher & Mitchell 2005; Reilly 1997; Eds Reynolds, Reilly & Ellis 2005). Përveç që votimi alternativ është përdorur në zgjedhjet parlamentare në tre shtetet që i përket Oqeanisë, i njëjti është përdorur edhe në zgjedhjet presidenciale të Republikës së Irlandës. Rezultatet e zgjedhjeve presidenciale irlandeze të vitit 1990 tregojnë rëndësinë e preferencave tjera dhe ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë në zgjedhjen e kreut të shtetit në Irlandë.

TABELA 3. ZGJEDHJET PRESIDENCIALE NË REPUBLIKËN E IRLANDËS, 1990

kandidati	votat për preferencës e parë	Eliminimi i Currie-it	votat e fazës së dytë
Austin Currie (Fine Gael)	267,902	-267,902	-
Brian Lenihan (Fianna Fail)	694,484	+36,789	731,273
Mary Robinson (Labour)	612,265	+205,565	817,830
Non-transferable		+25,548	25,548
Total	1,574,651		1,574,651

Sipas sistemit zgjedhor i Pari i Listës Merr Postin (FPTP), fituesi i zgjedhjeve presidenciale do të ishte Lenihan. Sidoqoftë, në sistemin alternativ të votave, shumica e votuesve të cilët mbështetën Austin Currie si preferencën e tyre të parë kishin shënuar Mary Robinson si preferencën e tyre të dytë, e cila pas numërimit të dytë dhe në sajë të votave të votuesve të Currie-së u zgjodh Presidentja e Irlandës. Është e qartë se në një shoqëri komplekse etnike rezultati i zgjedhjeve presidenciale mund të ndikohet edhe nga përfaqësuesit e grupeve të pakicave duke qenë se ata do t'ua besonin preferencat e tyre të dyta kandidatit të grupit shumicë, të një orientimi më të moderuar. Modeli i tillë mund të çojë në forcimin e politikës së akomodimit.

Përveç votimit alternativ, përkrahësit tjerë të qasjes integroniste theksojnë vlerën potenciale të miratimit të votës individuale të transferueshme, si një mekanizëm për zbutjen e konfliktit fetar në Irlandën e Veriut (O'Leary et al. 2003), apo sa i përket çështjes së votës së patransferueshme individuale si një variant që mund të ndryshojë mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të Kryesisë së Bosnje dhe Hercegovinës (Bochsler 2011) pas vendimit në rastin Sejdiç - Finçi kundër Bosnje-Hercegovinës, me të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg ka vlerësuar se pjesëtarët e pakicave kombëtare në Bosnje - sipas modelit ekzistues – janë penguar për të kandiduar për anëtarë të Dhomës së Popujve të Asamblesë Parlamentare dhe Presidencës trepalëshe. Sipas Kushtetutës së Bosnje-Hercegovinës, vetëm kandidatët - anëtarë të kombësisë boshnjake, serbe dhe

kroate mund të kandidojnë për këto institucione, prandaj qytetarët e tjerë të BH janë diskriminuar për shkak të këtyre dispozitave.

Vota individuale e transferueshme bazohet edhe në votimin preferencial, por në zonat zgjedhore shumë-anëtareshe. Çdo kandidat në një zonë që arrin droop kuotën (numri i përgjithshëm i votave / numri i vendeve + 1) zgjidhet. Nëse një kandidat ka numër më të lartë të votave se droop kuota, "teprica" e votave të tij / saj i transferohet kandidatëve tjerë në përputhje me preferencat e tjera të shënuara në fletën e votimit. Në të njëjtën kohë, kandidatët me numrin më të vogël të votave përjashtohen nga numërimi dhe - njëjtë si me votimin alternativ - votat e kandidatit të tillë u transferohen kandidatëve të tjerë, përsëri në përputhje me preferencat e shënuara. Procedura për transferimin e votave përsëritet deri në zgjedhjen e sa më shumë deputetëve siç është numri i vendeve të fituara në zonën zgjedhore.

Në sistemin e votës individuale të pa-transferueshme, çdo votues ka një votë në një zonë zgjedhore shumë-anëtarëshe. Nëse është zonë zgjedhore tre-anëtarëshe, tre kandidatët me numrin më të madh të votave zgjidhen pa marrë parasysh faktin nëse shpërndarja e vendeve mes partive është proporcionale apo jo. Në situatën e paraqitur (Tabela 4), partia C është lënë pa një mandat të vetëm pavarësisht 38.7% të votave të fituara nga dy kandidatët e saj. Edhe pse SVITP nuk është një sistem proporcional dhe edhe pse kandidatët nuk kanë nxitje institucionale për të "kërkuar" votat brenda grupit të kundërt etnik, ai i jep shanset më të mëdha për pakicat që të fitojnë një vend sesa sistemet e klasike të mazhorancës brenda një zone të vetme zgjedhore. Prandaj Bochslar propozon këtë sistem për zgjedhjet e Kryesisë së BH, por në një variant në të cilin numri i anëtarëve të Kryesisë do të rritej në pesë, dhe shteti shndërrohet në një zonë zgjedhore një anëtarëshe. Sipas llogaritjeve të tij, tri kombësitë me numrin më të madh do të kishin ende të paktën nga një anëtar, vendi do të ishte i hapur për pjesëmarrjen e kandidatëve të komuniteteve të tjera pakicë në zgjedhje, dhe një parti shumetnike mund do të mund të kandidonte për ulësen e pestë në Kryesi, në përputhje për të fituar vota në dy entitetet - Federata e BH-së dhe Republika Serbska.

TABELA 4. VOTA E PA-TRANSFERUESHME INDIVIDUALE NË NJË SITUATË HIPOTETIKE

Zonë zgjedhore tre anëtarëshe	% votave	
kandidati 1 - partia A	21.1	zgjedhur
kandidati 2 - partia A	20.2	zgjedhur
kandidati 3 - partia B	20.0	zgjedhur
kandidati 4 - partia C	19.5	
kandidati 5 - partia C	19.2	

## Sistemi zgjedhor në Kosovë

Sipas modelit ekzistues zgjedhor në Kosovë, 120 deputetë zgjidhen nga sistemi zgjedhor proporcional në bazë të listave të hapura zgjedhore, duke përdorur metodën e Sainte-Laguë për transferimin e votave në mandate, me pragun zgjedhor prej 5%. Nga 120 ulëse, njëzet vende janë të rezervuara për komunitetet pakicë, dhjetë prej tyre i përkasin partive politike, koalicioneve, grupeve të qytetarëve dhe kandidatëve të pavarur që përfaqësojnë interesat e pakicës kombëtare serbe, tre vende u shkojnë boshnjakëve, dy janë për turqit dhe një për secilin prej goranëve, romëve, ashkalijve dhe egjiptasve, ndërsa vendi i fundit i rezervuar është i fituar nga lista zgjedhore e romëve, ashkalinjëve apo egjiptasve

që fiton numrin më të madh të votave (Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, 2008). Subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet pakicë marrin pjesë në ndarjen e 100 mandateve të mbetura edhe nëse dështojnë të arrijnë pragun zgjedhor prej 5%, i cili në fakt do të thotë se pragu natyror zgjedhor është aplikuar për ta. Për shkak të dispozitës kushtetuese, sipas të cilës çdo vend i fituar në zgjedhje i shtohet vendeve të rezervuara për komunitetin serb (dhjetë) dhe komuniteteve të tjera pakicë, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010 partitë e pakicave fituan pesë mandate më shumë përveç atyre njëzet që ishin të rezervuara (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 148 (1))

Sidoqoftë, kjo dispozitë kushtetuese ka karakter kalimtar dhe ka qenë në fuqi vetëm për dy mandatet e para të parlamentit të Kosovës pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë, në mënyrë që në prill të vitit 2014 një projektligj i ri për zgjedhjet e përgjithshme, i cili nuk u pranua nga komuniteti serb në Kosovë, të hyj në procedurë ligjore.

Projektligji prezantoi tre ndryshime të rëndësishme. Së pari, në modelin e ri të ligjit, vendet e rezervuara për komunitetet pakicë (njëzet) janë shndërruar në ulëse të garantuara. Në praktikë, kjo do të thotë se komuniteti serb ka dhjetë vende të garantuara dhe, për të marrë pjesë në shpërndarjen e 100 vendeve të mbetura, komuniteti duhet të fitojë të paktën njëmbëdhjetë vende në zgjedhje<sup>2</sup>. Pasi që të gjitha simulimet tregojnë se asnjë komunitet pakicë nuk është në gjendje që të fitojë më shumë mandate se sa është ato të garantuara, vetëm partitë politike shqiptare do të marrin pjesë në shpërndarjen e 100 vendeve të mbetura (Qendra Evropiane për Çështje Minoritare Kosovë më 2014). Së dyti, votuesit janë të lejuar të votojnë më së shumti për pesë kandidatë në listën zgjedhore, dhe në rast se votuesit nuk e përdorin këtë të drejtë apo votojnë për më shumë se pesë kandidatë, votat e tilla do ti shtohen kandidatit në krye të listës zgjedhore. Nëse ka një koalicion të disa partive të pakicave që konkurrojnë për zgjedhjet, do të jetë e vështirë që të arrihet një marrëveshje lidhur me atë se kush do të jetë bartës i listës, pasi që të gjitha votat e të gjithë zgjedhësve që nuk e përdorin të drejtën për të votuar për kandidatët brenda listës do ti shkojnë të parit të listës, sidomos kur kihet parasysh se një numër shumë i vogël i qytetarëve do të përdor këtë të drejtë pasi që shumica prej tyre votojnë vetëm për listën zgjedhore. Dhe së treti, vetëm qytetarët me dokumente të Kosovës do të gëzojnë të drejtën e votimit, që do të parandalojë një numër të madh të personave të zhvendosur brenda vendit dhe refugjatët që lanë Kosovën pas 1 janarit 1998 të ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit (Qendra Evropiane për Çështje Minoritare Kosovë më 2014).

Në nivelin lokal, zgjedhjet për kuvendet komunale janë të organizuara sipas sistemit zgjedhor të ngjashëm me atë të nivelit qendror - sistemit proporcional zgjedhor, listat e hapura, formula Sainte-Laguë për shpërndarjen e mandateve - por pa një regjistrim zgjedhor të parashikuar ligjërisht dhe vende të garantuara për komunitetet pakicë në territorin e vetëqeverisjes lokale, ndërsa kryetarët e komunave zgjidhen me shumicën e votave në dy raundet e para - shumica balotazh (Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, 2008). Presidenti i Kosovës nuk zgjidhet me zgjedhje të drejtpërdrejta, por në mënyrë të tërthortë, në parlament, e cila e vendos Kosovën në kategorinë e sistemeve parlamentare. Kuvendi i Kosovës zgjedh presidentin me shumicën e dy të tretave të votave, dhe në qoftë se pas dy raundeve të votimit asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar numrin e nevojshëm të votave, raundi i tretë është organizuar për votim për dy kandidatët me numrin më të lartë të votave, ku kandidati që fiton shumicën e votave të deputetëve të pranishëm (shumicë e thjeshtë) zgjidhet.

---

2 Në zgjedhjet e vitit 2010, partitë serbe kanë fituar tri vende të cilat së bashku me 10 vendet e rezervuara u kanë dhënë atyre në total trembëdhjetë deputetë. Sipas modelit të ri, shtatë vendet e garantuara do ti shtoheshin tri vendeve të fituara, kështu që komuniteti serb do ti kishte 10 deputetë në total.

## A mundet reforma e sistemit zgjedhor në Kosovës të çojë në tejkalimin e ndarjeve etnike?

Futja e sistemit zgjedhor proporcional, me mbrojtje të veçantë për komunitetet e pakicave përmes vendeve të rezervuara (garantuara) është një nga mekanizmat konsociacionale të pranuar në procesin e projektimit të institucioneve të Kosovës. Edhe pse mund të thuhet se këto institucione në një masë më të madhe ose më të vogël përmbajnë karakteristika të tjera konsociacionale - pjesëmarrja e garantuar me Kushtetutë e komuniteteve jo-shumicë dhe komunitetit serb në qeverinë e Kosovës (Koalicioni i madh?), statusi i veçantë i komunave me shumicë serbe të cilat kanë të drejtën në asociacion dhe të prerogativave të rëndësishëm në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale (autonomi) dhe pamundësia që ligjet që kanë të bëjnë me interesat jetike të komuniteteve pakicë të kalohen pa pjesëmarrjen e tyre (vetoja e pakicës) - është e vështirë të flitet për shoqërinë e Kosovës si një demokraci konsociacionale. Një lloj mbrojtje e të drejtave politike të komunitetit serb nuk mund të plotësojë rrezikimin e të drejtave themelore individuale dhe civile. E drejta për një vend të ministrisë për një anëtar të komunitetit serb nuk mund të zëvendësojë lirinë e kufizuar të lëvizjes për një numër të madh të serbëve. Mungesa e mirëkuptimit midis dy komuniteteve dhe dekada të jetesës në institucionet paralele nuk do të zhduken duke garantuar dhjetë vende për deputetët e komunitetit serb (njëzet për shqiptarët në total). Kjo do të jetë veçanërisht e vërtetë në qoftë se projektligji i ri për zgjedhjet e përgjithshme miratohet, që do të çonte në ndarjen e mëtejshme zgjedhore dhe getoizimit të komuniteteve pakicë. Në rrethana të reja, serbët dhe të tjerë jo-shqiptarë do të konkurrojnë në zgjedhjet për vetëm njëzet vende të garantuara, dhe për shkak të peshës së tyre relativisht të vogël në popullsinë e përgjithshme 100 vendet e mbetura do të shpërndahen vetëm brenda korpusit politik shqiptar.

Modeli i tillë gjithashtu do të rrisë politikën e bazuar ekskluzivisht në përkatësinë etnike dhe tërësisht do të çaktivizojë paraqitjen e partive shumetnike dhe të akomodimit të orientuar. Prandaj pyetja është nëse modeli ekzistues zgjedhor do të kontribuojë në zbutjen e linjave ekzistuese të ndasive dhe a ka ndonjë model tjetër zgjedhor nga përdorimi i të cilit do të jetë më lehtë të tejkalohen ndasitë e thella etnike?

Vitet e fundit dëshmuar kërkesat gjithnjë e më të dukshme për reformën e sistemit zgjedhor të Kosovës, që vijnë nga radhët e organizatave joqeveritare dhe nga intelektualët e pavarur (Qendra Evropiane për Çështje Minoritare Kosovë 2011; Demokraci për Zhvillim 2011; Instituti i Kosovës për Hulumtime të Politikave dhe Zhvillim, KIPRED - Kosovski Institut za političko istraživanje i razvoj 2012). Edhe midis partive kryesore shqiptare - të LDK-së, PDK-së, AAK-së - ka një marrëveshje në lidhje me nevojën për ridizajnimin e sistemit zgjedhor dhe e njëjta vlen edhe për zgjedhjet presidenciale. Zgjedhja e drejtpërdrejtë e presidentit nga ana e qytetarëve ka qenë e propozuar, në vend të zgjedhjeve në parlament, që ka qenë praktika deri më tani. Propozimet për reformën e modelit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare janë kryesisht të orientuara për ndryshimin dhe rritjen e numrit të zonave zgjedhore<sup>3</sup>. Variante të ndryshme kanë propozuar pesë (kufijtë rajonale të UNMIK-ut), gjashtë (ndarja e rajoneve sipas tabelave të regjistrimit të makinave), shtatë (në bazë të kodeve postare të ndarjes së qyteteve), tetë, ose deri në 26 zona zgjedhore. Numri i ulëseve për zonë zgjedhore do të përcaktohet në mënyrë proporcionale, dhe sipas disa propozimeve mund të ekzistojë një zonë e vetme zgjedhore në nivel shtetëror e cila do të shërbejë për kompensimin e një shpërpjesëtim si një pasojë e pashmangshme

3 Për më shumë lidhur me argumentet për përfshirjen e një numri më të madh të zonave zgjedhore shih raportet nga ECMI, D4D, KIPRED.

e transformimit të votave në mandate në rang të zonës zgjedhore. Zona zgjedhore (kombëtare) kompensuese do ti jap njëzet nga 100 (KIPRED), apo tridhjetë nga 100 ulëse (D4D). Risi të tjera do të përfshijnë pragun zgjedhor - propozimi është për të reduktuar atë në 1% ose 3% - dhe zvogëlimin e numrit të votave në posedim të çdo votuesi nga pesë në një, nëse votohet për kandidatët nga lista e hapur. Të gjitha propozimet e përmendura përkrahin megjithatë idenë se përfaqësimi i komuniteteve pakicë do të sigurohet më së miri me vendet e garantuara.

Edhe pse vendet e garantuara nuk janë zgjidhja më e keqe institucionale, pasi që të paktën ato garantojnë që zëri i pakicave të dëgjohet në institucione, ne mendojmë se ato më shpesh krijojnë stimuj institucional për zgjedhjet e organizuara ekskluzivisht në bazë të përkatësisë etnike. Kjo është veçanërisht e vërtetë në situatat kur partitë e pakicave konkurrojnë për vende të garantuara, ndërkohë që vetëm partitë e popullit shumicë marrin pjesë në shpërndarjen e mandateve të mbetura.

Në atë mënyrë jo vetëm që nuk stimulohet përfshirja dhe integrimi politik i grupeve të pakicave, por politikanët që vijnë nga grupi i shumicës nuk e ndiejnë nevojën për të krijuar dhe propozuar politika publike atraktive për të gjithë qytetarët pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike. Përveç kësaj, nuk është e qartë se si do të motivohen qytetarët e nacionalitetit serb për të marrë pjesë në zgjedhje në një masë më të madhe. Partive serbe u garantohen dhjetë vende, dhe për të marrë pjesë në shpërndarjen e 100 vendeve të mbetura ata duhet të fitojnë më shumë se 10% të numrit të përgjithshëm të votave, që është pothuajse e pamundur. Në mënyrë efektive, pavarësisht se sa është pjesëmarrja zgjedhore e serbëve, numri i vendeve që u përkasin partive të tyre do të jetë dhjetë. A mundet pra ndonjë nga idetë që rrjedh nga shkolla integriste të jetë të dobishme dhe e zbatueshme në territorin e Kosovës?

Votimi alternative në zgjedhjet parlamentare të Kosovës është fillimisht i lidhur me problemin e krijimit të zonave zgjedhore njëanëtarëshe. Së dyti, edhe në qoftë se një komision i pavarur zgjedhor do të arrijë të caktoj kufijtë e 120 zonave zgjedhore nga të cilat një numër i tyre do të ishte shumëetnike, është vështirë të pritët që serbët do të pranonin një zgjidhje të tillë për shkak se numri i vendeve që do të mund të fitonin në përputhje me atë model është më i ulët se ai i garantuar aktualisht, dhe ulëset, me manipulim të kujdesshëm të zgjedhjeve, mund të fitohen gjithashtu nga goranët, turqit dhe boshnjakët. Edhe pse sistemi i votës alternative do të krijojë stimuj për bashkimin e votave dhe shkëmbim të preferencave në zonat shumëetnike, futja e sistemit të votës individuale të transferueshme që mund të funksionojë në të njëjtën kohë me vende të garantuara për komunitetet jo-shqiptare do të ishte një zgjidhje më e mirë.

Vota individuale e transferueshme, në bazë të votimit preferencial sikurse ajo alternative, është aplikuar në zonat shumë-anëtarëshe zgjedhore. Territori i Kosovës në këtë rast do të duhej të ndahej në një numër më të madh të zonave zgjedhore të mesme e (katër deri në tetë ulëse), nga të cilat një numër i madh mund të jenë me karakter shumëetnike. Njëzet vendet do të mund tu jepen partive me kandidatët e pakicave (dhjetë komunitetit serb + dhjetë të tjerave jo-shqiptare), në mënyrë të tillë që të përmbledhet numrit i preferencave të para të fituara nga kandidatët e partive që përfaqësojnë interesat e komuniteteve pakicë, ndërsa vendet do të ndahen në proporcion me forcën elektorale të partive.

TABELA 5. SHPËRNDARJA E VENDEVE TË GARANTUARA PËR PARTITË DHE KANDIDATËT E KOMUNITETIT SERB (SITUATË HIPOTETIKE)

Kandidatët	partia A	partia B	partia C
1	2000	1500	700
2	1000	900	500
3	800	600	400
4	700		350
5	500		50
Totali i preferencave të para	5000	3000	2000
totali i vendeve	5	3	2

Nëse tri parti serbe marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare të Kosovës (Tabela 5) me kandidatët e tyre në zonat shumë-anëtarëshe zgjedhore, partia A do të fitojë tre vende të garantuara, partia B tre vende dhe partia C dy vende. Me komunitetet e pakicave që kanë një vend të garantuar në parlamentin e Kosovës, vendi do të fitohet nga kandidati i partisë i cili ka numrin më të madh të preferencave të para në total. Partia C do të duhet t'ia ofroj dy vendet e saj kandidatëve të cilët kanë fituar përqindjen më të lartë të preferencave të para nga numri i përgjithshëm i atyre që kanë votuar në një zonë shumë-anëtarëshe.

Kandidatët e pakicave do të kenë gjithashtu mundësinë për të fituar vendin brenda zonave zgjedhore shumë-anëtarëshe me kusht që ata të fitojnë droop kuotën  $(S / V + 1)$  në zgjedhjet. Në disa cikle të para zgjedhore mundësia që kjo të ndodhë ndoshta do të jetë e vogël, nëse supozojmë se shqiptarët më së shumti do të shënonin kandidatët serb si preferencat e tyre të fundit. Megjithatë, votuesit serbë do të mund të ndikojnë në zgjedhjen e kandidatëve shqiptarë, në një masë të caktuar, pasi që ata do të japin e preferencat e tyre të treta, e katërta, e pesta, etj për shqiptarët e moderuar, dhe në ndonjë fazë të numërimit këto preferenca do të mund të ndikojnë në mënyrë vendimtare në rezultatin zgjedhor. Kjo do të kontribuonte në forcimin e graduar të politikës së pajtimit. Vendet në parlamentin e Kosovës do të fitoheshin nga kandidatët e moderuar shqiptarë të zgjedhur edhe nga vota e qytetarëve që u përkasin komuniteteve jo-shumicë të cilët, nga njëra anë, do të zgjerohin bazën elektorale të disa deputetëve përtej grupit të tyre etnik dhe do të rritnin detyrimin e tyre për tu kujdesur për qytetarët jo-shqiptarë në paraqitjet e tyre publike dhe në propozimin e politikave. Nga ana tjetër, pjesëmarrja zgjedhore e komuniteteve jo-shumicë do të rritej dhe përfshirja e tyre sociale dhe politike do të rritej gjithashtu. Mundësia që, përveç ndikimit mbi shpërndarjen e vendeve të garantuara, ata direkt do të vendosnin për zgjedhjen e deputetëve të tjerë (shqiptarë) do të ndikonte që ata të fillojnë të perceptojnë institucionet e Kosovës si të tyre, dhe jo vetëm shqiptare.

Pas disa cikleve zgjedhore, ndryshimi gradual i klimës sociale dhe heqja e etnifikimit të politikës do të çojë në një situatë që, në zgjedhje, shqiptarët të shënojnë si preferencën e tyre të dytë dhe të tretë partinë serbe që është ideologjikisht më afër tyre, sesa atë shqiptare me propozimet e politikave publike të së cilës ata nuk pajtohen. Model i tillë zgjedhor, me kohë, do të çojë në krijimin e partive shumetnike.

Getoizimi dhe fortifikimi i jetëve paralele të dy bashkësive më të mëdha etnike në vend të bashkëjetesës, nuk janë pasoja të drejtpërdrejta të sistemit zgjedhor. Megjithatë, miratimi i ligjit i cili është në procedurë parlamentare do të tregojë se nuk ka vullnet politik për tejkalimin e ndarjeve etnike. Zgjedhja e njëzet deputetëve nga votat e komuniteteve jo-shumicë dhe 100 deputetëve nga votat e bashkësisë etnike shqiptare për më tepër do t'i thellonte ndasitë. Pas zgjedhjeve, nga shoqëria dhe me anë të sistemit zgjedhor, ato do të transferohen edhe në parlament gjithashtu. Një grup i njerëzve do të mbrojë të drejtat e pakicës, ndërsa tjetri do të mbrojë të drejtat e shumicës. Sipas integrationistëve, kjo është e gabuar. Modeli zgjedhor duhet të forcojë ndjenjën e përkatësisë dhe të komunitetit. Vota e vetme e transferueshme, me mbajtjen e vendeve të garantuara si masë e garancisë për përfaqësim të pakicave në parlament, mund të përfaqësojnë bazën për ndërtimin e një shoqërie shumë-etnike në Kosovë. Në kombinim me votimin alternativ në zgjedhjet presidenciale, në qoftë se ka një ndryshim në mënyrën e zgjedhjes së presidentit të Kosovës, modelet e reja dhe rrallë të përdorura zgjedhore mund të përbëjnë fillim të ri në marrëdhëniet midis dy grupeve më të mëdha etnike në Kosovë.



## Literatura

Bochsler, D 2011, 'Nediskriminativna pravila i etnička predstavljnost: izbor Državnog predsedništva Bosne i Hercegovine', *Godišnjak*, vol. 5, no. 5, Fakultet političkih nauka, Beograd;

Democracy for Development 2011, *Electoral System – Presentation*, Available from: <<http://d4d-ks.org/assets/2011-12-20t-Election-System-D4D.pdf>>. [25 April 2014];

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve Kosovë 2011, *Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve në reformën zgjedhore të Kosovës, në dispozicion në*: <<http://www.ecmikosovo.org/>>. [25 April 2014];

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve Kosovë 2013, *Zgjedhjet lokale të Kosovës 2013: Mësimet e nxjerra për Komunitetet Pakicë - Një analizë e shkurtër*, në: <<http://www.ecmikosovo.org/>>. [25 prill];

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve Kosovë 2014, *Një Përmbledhje e disa prej ndryshimeve në Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në dispozicion në*: <<http://www.ecmikosovo.org/>>. [25 prill 2014];

Gallagher, M & Mitchell P (eds) 2005, *The Politics of Electoral Systems*, Oxford University Press, Oxford;

Horowitz, DL 1985, *Ethnic Groups in Conflict*, University of California Press, Berkeley;

Horowitz, DL 1991, *A Democratic South Africa? Constitutional Engineering in a Divided Society*, University of California Press, Berkeley;

Horowitz, DL 2003, 'Electoral Systems: A Primer for Decision Makers', *Journal of Democracy*, vol. 14, no. 4, pp. 115-127;

Lijphart, A 1977, *Democracy in Plural Societies: A Comparative Exploration*, Yale University Press, New Haven;

Lijphart, A 1991, 'The Alternative Vote: A Realistic Alternative for South Africa', *Politikon*, vol. 18, no. 2, pp. 91-101;

Lijphart, A 1996, 'The Puzzle of Indian Democracy: A Consociational Interpretation', *American Political Science Review*, vol. 90, no. 2, pp. 258-268;

Lijphart, A 2008, *Thinking about Democracy: Power Sharing and Majority Rule in Theory and Practice*, Routledge, New York;

O'Leary, B, Lyne, T, Marshall, J, Rowthorn, B 1993, *Northern Ireland: Sharing Authority*, Institute for Public Policy Research, London;

Reilly, B 1997, 'The Alternative Vote and Ethnic Accommodation: New Evidence from Papua New Guinea', *Electoral Studies*, vol. 16, no. 1, pp. 1-11;

Reilly, B 2001, *Democracy in Divided Societies. Electoral Engineering for Conflict Management*, Cambridge University Press, Cambridge;

Reynolds, A, Reilly B & Ellis A (eds) 2005, *Electoral System Design: The New International IDEA Handbook*, International Institute for Democracy and Electoral Assistance, Stockholm;

Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008;

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës 2008;

Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës 2008;

Hana Limani

## Akomodimi i Pakicave: Një Qasje Teorike dhe Raŝti i Kosovës

Fusha e të drejtave është padyshim një imperativ politik në botën e sotme, duke pasur parasysh rëndësinë e saj në agjendën politike dhe sociale, sidomos gjatë shekullit të XX-të. Në lidhje me këtë temë janë zhvilluar debate të ndryshme sidomos gjatë dekadave të fundit, për këtë arsye shumë nën-tema janë pjesë e këtij spektri të gjerë të debateve. Në përgjithësi, fokusi i këtij punimi është për të drejtat e komuniteteve pakicë brenda kontekstit të realitetit pas pavarësisë së Kosovës dhe çështje tjera të ndërlidhura me këtë fushë (komuniteti serb është grupi më i madh i pakicës në Kosovë, prandaj është përzgjedhur kjo temë). Më saktësisht, theks i veçantë është vënë në pyetjen se si të akomodohet një komunitet pakicë, ndërkaq që punohet drejt qëllimit të krijimit të një identiteti të përbashkët qytetar për të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht dallimeve etnike. Kjo me të vërtetë konsiderohet si një parakusht për krijimin e një shoqërie funksionale, të lirë dhe demokratike, pa diskriminim, pabarazi, dhe marginalizim - probleme këto që janë të shumta në të gjithë botën, dhe veçanërisht në Ballkan – prandaj është e nevojshme ta shikojmë këtë çështje më nga afër dhe të kërkojmë alternativa dhe zgjidhje.

Duke marrë parasysh ato që u thanë më lartë, për të zgjidhur çështjen e pakicave dhe për të rregulluar konfliktin ndërmjet kulturave të pakicës dhe shumicës në Kosovë, duhet të shikohet sistemi juridik e shtetëror që është në fuqi në lidhje me trajtimin e minoriteteve; rrjedhimisht, duhet të identifikohet dhe vlerësohet një teori që trajton se si mund të bashkë-ekzistojnë të drejtat e pakicave me të drejtat e njeriut dhe se si të drejtat e pakicave janë të kufizuara nga parimet e lirive individuale, drejtësisë sociale dhe demokracisë. Së fundmi, teoria e përshtatshme do të zbatohet në sistemin e Kosovës, me qëllim të vlerësimit të gjendjes aktuale në këtë drejtim dhe gjasat - ose mungesa e tyre - e suksesit të saj. Rezultati në fund do të tregojë nëse sistemi i Kosovës në këtë fushë do t'i shërbejë qëllimit të përgjithshëm të akomodimit të minoriteteve (duke mos rritur hendekun mes tyre dhe shumicës) dhe ndërkohë, i kontribuon qëllimit afatgjatë të konsolidimit të identitetit të përbashkët qytetarë për të gjithë. Megjithatë tensionet në këtë fushë janë të vazhdueshme dhe intensive në të gjithë botën, dhe kjo tregon se ato do të mbeten në qendër të debateve në fushën e çështjeve politike dhe shoqërore.



komuniteti pakicë në Kosovë, komuniteti serb, mbrojtja ligjore e pakicave



Ky tekst u shkrua fillimisht në gjuhën angleze.

## Hyrje

Debatet më të rëndësishme në botë sot padyshim bëhen në fushën e të drejtave. Edhe pse ato kanë qenë të vazhdueshme gjatë fazave të ndryshme të historisë, në shekullin e XX dhe më pastaj këto debate janë bërë thelbi i debatit politik dhe rrjedhimisht, kanë formuar mënyrën se si funksionojnë shtetet e botës sot (veçanërisht demokracitë perëndimore). Me ngjarjet historike të shekullit XX dhe ndryshimet që ato sollën në sistemet politike, marrëdhëniet mes shteteve, dhe mënyrat se si funksionojnë shoqëritë, me të drejtë mund të thuhet se kurrë më parë në histori nuk ka qenë debati mbi të drejtat më i fortë. Për të ilustruar këtë, mund të shihen implikimet që nocionet në këtë fushë, të tilla si shtetësia, përfaqësimi, drejtësia, barazia, mosdiskriminimi, dhe të ngjashme, kanë pasur në çështjet politike dhe sociale globale. Ndërsa fuqia e debatit mbi këtë temë nuk është një fenomen i ri në vetvete, thellësia dhe dimensionet e reja të shtuara në teoritë bashkëkohore përkatëse, dhe rëndësia që luan në rolin e sistemeve politike, janë te reja.

Për shkak të fushës së gjerë të temës së të drejtave, nevoja për t'u përqendruar në një nga segmentet e saj në raste të ndryshme është pothuajse e pashmangshme. E njëjta gjë është e zbatueshme këtu, kur theksi i veçantë bie ekskluzivisht në të drejtat e pakicave dhe çështjet që rrjedhin prej tyre. Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të vlerësoj sistemin e Kosovës në lidhje me të drejtat e pakicave, duke marrë parasysh rrethanat e saja politike dhe sociale përkundrejt marrëdhënieve ndëretnike si rezultat i zhvillimeve historike të vendit. Tutje vlerësimi do të mundësoj arritjen e konkluzioneve mbi boshllëqet e mundshme dhe pikat e forta të sistemit politik në lidhje me trajtimin e pakicave, me synimin për të treguar kontributin e tij, apo mungesat rrjedhimisht, në procesin e shtet-ndërtimit. Paralelisht me këtë, një teori mbi të drejtat e pakicave, që konsiderohet si më e përshtatshme për Kosovën dhe raste të ngjashme, është paraqitur në një mënyrë të shkurtër, megjithatë të mjaftueshme, për të siguruar një qasje teorike që shërben si bazë e vlerësimit për përshtatshmërinë e sistemit të të drejtave të pakicave në Kosovë. Rrjedhimisht, rasti i Kosovës do të përdoret në këtë teori, ose do të vihet në paralele, duke treguar nëse ajo përputhet dhe deri në çfarë mase. Kjo do të pasohet nga konkluzionet krahasuese.

Është e panevojshme të thuhet se, theksi në tërë këtë punim nuk do të jetë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicave (si një sfidë kyçe në procesin e shtet-ndërtimit), por më tepër në llojet e të drejtave që shteti u garanton pakicave, dhe mënyra që ato ndikojnë në komunitetet përkatëse, që pason me integrimin apo mungesën e integritit në shoqëri. Në vijim është një prezantim i të drejtave të pakicave në sistemin e Kosovës, teoria e zgjedhur e të drejtave të pakicave, dhe ndikimi i të parës në këtë të fundit. Duke pasur parasysh se themeli i një shoqërie demokratike, të lirë, dhe stabile është shumë i varur në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat, qëllimi kryesor i këtij punimi është krijimi i një identiteti të përbashkët qytetar për shoqërinë e Kosovës, në të njëjtën kohë duke respektuar dallimet; me fjalë të tjera, tejkalimin e hendekut mes grupeve duke lejuar hendekun e nevojshëm për ruajtjen e identitetit të tyre. Kjo e fundit nga ana tjetër shërben në mënyrë ideale si një mjet për të sjellë grupe të ndryshme sa më pranë që të jetë e mundur, dhe të eliminoj idenë e kërcënimit të asimilimit.

## Rasti i Kosovës: të drejtat dhe përfaqësimi

Pjesa e dytë e punimit, siç u përmend më parë, përbëhet nga një prezantim i sistemit politik të Kosovës në lidhje me pakicat e saj. Vlenë të theksohet se termi "minoritete" nuk përdoret në Kushtetutën e Kosovës dhe kornizën ligjore: por përdoret termi "komunitet". Megjithatë, termi paraprak përdoret këtu për t'u referuar një komuniteti që përbëhet nga një popullatë më e vogël, pa paragjykuar ndonjë

status të mundshëm, si politik apo social. Prandaj, termat "minoritet" dhe "komunitet" në këtë artikull janë përdorur në mënyrë të këmbyeshme. Më poshtë janë paraqitur rregullimet kushtetuese që tregojnë se çfarë lloj shteti është Republika e Kosovës, ne raport me grupet e pakicave, mekanizmat e përfaqësimit, të drejtat e veçanta, dhe një pasqyrë e përkushtimit institucional për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Si i tillë, kjo pjesë fokusohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjin përkatës, institucionet shtetërore që përfaqësojnë komunitetet pakicë (në qeverisjen e nivelit qendror si dhe në atë lokal), dhe organet specifike brenda këtyre institucioneve që merren me të drejtat e tyre.

## Kushtetuta

### SHTETI SHUMË-ETNIK

Republika e Kosovës është e përcaktuar me Kushtetutën e saj si një shtet shumë-etnik. Shtatë (7) grupet e njohura pakicë që jetojnë në vend, të njohura si "komunitete" në dokumentet zyrtare, janë serbët, boshnjakët, turqit, goranët, romët, ashkallitë dhe egjiptianët, ndërsa shqiptarët e Kosovës janë komuniteti shumicë në nivel vendi, edhe pse në disa komuna ata bien në grupin e pakicës (sistemi komunal dhe implikimet e tij janë të shpjeguara më vonë në këtë pjesë). Duhet përmendur se komunitetet e njohura që banojnë në Kosovë (duke përfshirë këtu shumicën shqiptare të Kosovës) janë të përfaqësuara në flamurin e Republikës së Kosovës, ku secili grup përfaqësohet nga një yll (megjithëse komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian janë të grumbulluara së bashku dhe përfaqësohen me një yll). Se çfarë lloj i shtetit Kosova është përshkruar në Nenin 3 të Kushtetutës së saj [Barazia para Ligjit] të Kapitullit 1 (Dispozitat themelore) të këtij dokumenti, ku thuhet:

1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.
2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli 1, neni 3, pika 1-2)

### TRAJTIMI I PAKICAVE

Tashmë është e qartë se trajtimi i pakicave në Republikën e Kosovës është rregulluar me Kushtetutën e saj dhe me ligjet përkatëse. Përqendrimi këtu është në shqyrtimin e pjesëve të legjislacionit të Kosovës, ku janë të përcaktuara llojet e të drejtave dhe modeli i shtetit që ka Kosova. Kapitulli III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre], Neni 57 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës paraqet në përgjithësi dhe në mënyrë të qartë llojet e të drejtave që janë të garantuara për komunitetet jo-shumicë, dhe thuhet kështu:

1. Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute.

2. Çdo pjesëtar i komunitetit do të ketë të drejtën që të zgjedhë lirisht nëse do të trajtohet ose të mos trajtohet si pjesëtar i komunitetit dhe nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që ndërliiden me këtë zgjedhje, nuk do të rezultojë asnjë diskriminim.
3. Pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet.
4. Ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Republikës së Kosovës, dhe nuk i cenon të drejtat e të tjerëve. (Kushtetuta, kapitulli 3, neni 57, pka 1-4)

Pika 1 e nenit të mësipërm të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e përcakton në parim vendin si të orientuar ndaj të drejtave të pakicave (kundrejt modelit liberal, të orientuar ndaj të drejtave të njeriut) dhe pason me atë se këtyre grupeve u janë dhënë të drejta të veçanta në bazë të statusit të tyre të pakicës. Këto të fundit janë një shtesë krahas të drejtave dhe lirive të njeriut që u garantohen çdo qytetari të Kosovës. Për më tepër, në pikën 3 të po atij neni thuhet që komunitetet nuk do të pengohen të ushtrojnë specifikat etributeve të tyre kulturore. Me këtë mund të thuhet se Kosova nuk koïncidon me modelin e një shteti liberal, ku dallimet janë të bashkuar nën konceptin e të drejtave të njeriut për të gjithë.

Për të pasur një pasqyrë më të plotë të sistemit në këtë aspekt, do të shikohen disa pika të tjera kyçe nga ky Kapitull (d.m.th. të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre). Neni pasues në të sipërpërmendurat (neni 58 - Përgjegjësitë e Shtetit) thotë se:

1. Republika e Kosovës siguron kushtet e duhura, të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre. Qeveria do të përkrahë veçanërisht nismat kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë këtu edhe nëpërmjet ndihmës financiare. (Kushtetuta, Kapitulli 3, neni 58, pika 1)

Ndërsa pika 4 nga i njëjti Nene thotë se:

3. Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit. (Kushtetuta, Kapitulli 3, neni 58, pika 4).

Bazuar në pikën 1 dhe 4 të [Përgjegjësitë e Shtetit] Neni, që është përgjegjësitë që lidhen me komunitetet e njohura zyrtarisht që jetojnë në vend, është e qartë se Republika e Kosovës mban përgjegjësi shtesë ndaj komuniteteve të saj, përpos të drejtave që u garanton atyre. Në bazë të kësaj dhe siç mund të shihet, shteti është përgjegjës për të ofruar mbështetje financiare për promovimin e identitetit kulturor, dhe për të marrë hapat e nevojshëm për të promovuar barazi për të gjitha komunitetet. Për më tepër, është një pikë në këtë nen (neni 58) që rregullon çështjen e lidhur me asimilim ku thuhet:

6. Republika e Kosovës ndërmerr veprime efektive kundër të gjithë atyre që pengojnë gëzimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve. Republika e Kosovës do të përmbahet nga politikat ose praktikat që kanë për qëllim asimilimin, kundër vullnetit të tyre, të personave që u përkasin

komuniteteve, dhe do t'i mbrojë ata persona nga çfarëdo veprimi që ka për qëllim një asimilim të tillë. (Kushtetuta, Kapitulli 3, neni 58, pika 6).

Është e qartë tashmë se një nga qëllimet kryesore të të drejtave të cilat u janë garantuar komuniteteve jo-shumicë nga Kushtetuta është për të shmangur çdo formë të shtyrjes së tyre në asimilim të dhunshëm, por përkundrazi, të shërbejë në promovimin e identiteteve të ndryshme kulturore. Kur flasim për këtë fenomen, pyetja që shtrohet është se nëse pakicave nuk u garantohen të drejta të veçanta a konsiderohet kjo si një tregues i përpjekjes për asimilim. Ndërkaq që disa teori thonë se të drejtat e veçanta u shërbejnë pakicave të ndjehen të lirë për të manifestuar identitetin e tyre kulturor dhe jo të bashkohen me shumicën, disa të tjera thonë se të drejtat e veçanta nuk shërbejnë si një mjet për të nxitur anti-asimilim, por më tepër, përjashtojnë komunitetin specifik nga mundësia e të qenit pjesë e identitetit të përbashkët qytetar të shoqërisë. Megjithatë, në rastin e Kosovës, në bazë të pikës 6 të nenit 58, të drejtat e veçanta janë dhënë si një mënyrë për të treguar se nuk ka përpjekje për asimilimin e ndonjë anëtarit të ndonjë komuniteti në kulturën e komunitetit shumicë kundër vullnetit të tyre.

Duhet përmendur që detajet për të drejtat që kanë minoritetet janë të specifikuar në nenin 58 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të këtij Kapitulli të Kushtetutës (d.m.th. Kapitulli 3). Disa prej tyre (janë gjithsej 14 pikë në këtë nen) që tregojnë llojet e të drejtave që janë projektuar për komunitetet jo-shumicë në Kosovë janë:

(1) të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre;

[...]

(10) të kenë qasje të garantuar dhe përfaqësim të veçantë në mediet transmetuese publike si dhe programet në gjuhën e tyre, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;

[...]

(14) të themelojnë shoqata të kulturës, artit, shkencës dhe arsimit, si dhe shoqata të studiuesve e shoqata të tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre (Kushtetuta, Kapitulli 3, neni 59, pika 1,10,14).

## Përfaqësimi i pakicave

### QEVERISJA NË NIVELIN QENDROR DHE PAKICAT

Derisa pjesa e mëparshme ishte një prezantim i të drejtave të garantuara të pakicave në Kosovë, si dhe lloji i shtetit të Republikës së Kosovës e përcaktuar me Kushtetutën e saj. Kjo pjesë merret me konceptin e përfaqësimit, e cila është padyshim një pjesë e pandarë e konceptit të të drejtave dhe zbatimit të tyre. Prandaj, në vijim është një përshkrim i përpjekjeve që ka ndërmarrë Kosova deri më tani për të promovuar idenë e një shteti shumë-etnik dhe të zbatojë të drejtat e grupeve të ndara respektivisht të pakicave. Kjo është bërë duke prezantuar pjesë të Kushtetutës që kanë të bëjnë me përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në territorin e Kosovës.

Neni 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] i Kushtetutës, siç e thotë vetë emri, përshkruan se si komunitetet joshumicë janë të vendosura në institucionet ministrore. Në përputhje me këtë nen, këto komunitete kanë të drejtat për vende të rezervuara dhe privilegje të caktuara shtesë. Për shembull, aty thuhet se qeveria e Kosovës duhet të ketë së paku një Ministër nga komuniteti Serb dhe një tjetër nga një komunitet tjetër joshumicë (në rast se ka më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra,

duhet të jetë një i tretë që është nga një komunitet jo-shumicë). Në mënyrë të ngjashme, duhet të ketë së paku dy (2) zëvendës ministra nga komuniteti serb dhe 2 nga komunitetet e tjera joshumicë (dhe në rast se ka më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, e njëjta gjë si më sipër zbatohet edhe në këtë pozitë)(Kushtetuta, Kapitulli 6, neni 96, pika 1-7). Këta janë shembuj që tregojnë përfaqësimin e grupit pakicë në Kosovë përmes vendeve të rezervuara (të drejtat e veçanta) në institucionet shtetërore të nivelit qendror.

Për të plotësuar atë çfarë u tha më sipër, është e rëndësishme të ceket neni 148 [Dispozitat Transicionale për Kuvendin e Kosovës] i Kapitullit XIV të Kushtetutës, i cili përshkruan se si janë të përfaqësuara komunitetet joshumicë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pika e parë e këtij neni përcakton se njëzet vende janë të rezervuara për komunitetet (pakicat) për dy mandatet e para zgjedhore (dhjetë prej të cilëve i takojnë komunitetit serb dhe dhjetë komuniteteve të tjera). Kjo aplikohet në bazë të parimit që vendet të cilat janë të zëna me anë të zgjedhjeve do të jenë shtesë e këtyre njëzet vendeve të cilat janë të rezervuara për komunitetet jo-shumicë. (Kushtetuta, Kapitulli 14, neni 148, pika 1)

Përveç vendeve të rezervuara në ministri dhe Kuvend, komuniteteve joshumicë në Kosovë u janë garantuar të drejta të veçanta të përfaqësimit nëpërmjet një formë tjetër shtesë. Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK) është komision i projektuar veçanërisht për grupet e pakicave, dhe është një organ shumë i rëndësishëm në kuadër të strukturave politike të vendit, konkretisht në kuadër të Zyrës së Presidentit. KKK është themeluar si në Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre], Neni 60 [Këshilli Konsultativ për Komunitete] të Kushtetutës, ku thuhet se ato janë formuar me qëllim të përfaqësimit të komuniteteve në Kosovë, nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës. Mandati i këtij Këshilli është për të“(1) ofruar një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës [dhe] mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legjislativë dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse [...]. (Kushtetuta, Kapitulli 3, neni 60, pika 1)

## **SISTEMI I QEVERISJES LOKALE NË KOSOVË**

Pasi që pjesa e mëparshme shpjegon përfaqësimin e pakicave në institucionet e nivelit qendror (pra ministritë, Kuvendin, dhe Zyrën e Presidentit), është po aq e rëndësishme të shohim përfaqësimin e pakicave në qeverisjen e nivelit lokal, duke pasur parasysh sistemin politik të Republikës së Kosovës. Por para se të bëjmë një gjë të tillë, është e rëndësishme për të kuptuar rolin që qeveria e nivelit lokal luan në sistemin politik të vendit. Prandaj në vijim është një përshkrim i mënyrës se si është themeluar Kosova si një subjekt politik, përkatësisht mënyrën e funksionimit të pushtetit qendror dhe lokal dhe autoritetin politik që këto autoritete kanë në nivelet përkatëse, ndaj njëra tjetrës ose të pavarura. Kapitulli X i Kushtetutës së Kosovës (Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial), Neni 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] përcakton mënyrën e funksionimit të qeverisjes vendore në qarkun. Ky nen thotë:

1. Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunitatet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.
2. Themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre, rregullohen me ligj.
3. Komunitatet kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.

4. Komunat kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.
5. Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.
6. Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.
7. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin. (Kushtetuta, Kapitulli 10, neni 124, pika 1-7)

Ligji Nr. 03/L-040: Ligji për Vetëqeverisje Lokale përcakton modalitetet e autoritetit drejtues të nivelit lokal, i cili në detaje paraqet se si ky autoritet funksionon në mënyrë të pavarur nga dhe në koordinim me nivelin qendror. Neni 2 (Fusha) i këtij ligji përcakton qëllimin e saj, si në vijim: "2.1. Ky ligj përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brendakomunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror." (Kosovë, Ligji për vetqeverisje lokale nr. 03/L-040, neni 2, pika 1). Përveç kësaj, është e rëndësishme që të specifikohet përkufizimi i kushteve përkatëse të nevojshme për qëllime shpjeguese, siç janë paraqitur në Nenin 3 (Përkufizimet) të këtij ligji. Së pari, përkufizimi i vetëqeverisjes lokale, është: "[ai] do të thotë e drejta dhe aftësia e autoriteteve lokale, të themeluara sipas këtij Ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të menaxhojnë një pjesë substanciale të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës vendore." (Ligji për vetqeverisje lokale, neni 3, pika 2) Një tjetër term që përdoret këtu dhe e dobishme për të dhënë përkufizimin e tij zyrtar është "komunitet;" sipas këtij ligji, "[ai] do të thotë grup komuniteti që i përkasin një grupi të njëjtë etnik, fetar apo gjuhësor." (Ligji për vetqeverisje lokale, neni 3, pika 2)

## **NIVELI I QEVERISJES LOKALE DHE PAKICAT**

Duke e pasur parasysh ndarjen e nivelit të qeverisjes lokale dhe pushtetit qendror në Kosovë siç përshkruhet më sipër, dhe autoritetin e këtyre strukturave qeverisëse në nivelet përkatëse (përgjegjësive të ndara dhe pushteteve të pavarura ekzekutive), mekanizmat e përfaqësimit të pakicave në nivel lokal (komunat) të Republikës së Kosovës janë po aq të rëndësishme. Është Neni 62 [Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal] Kapitulli III (Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që rregullon përfaqësimin në këtë nivel. Mes pikave përkatëse vlen për të përmendur atë që thotë se komunat me komunitetin të paktën dhjetë për qind jo-shumicë duhet të rezervojë postin e nënkryetarit të Kuvendit Komunal për Komunitete për një përfaqësues të këtij komuniteti, roli i të cilit është që të shërbejë si një pikë fokale për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo-shumicë, për të nxitur dialogun ndërmjet komuniteteve, për të adresuar të gjitha çështjet që lidhen me komunitetet joshumicë përmes mbledhjeve të Kuvendit Komunal, dhe kështu me radhë. Është me rëndësi të përmendet se ky nen përcakton gjithashtu se trupi ekzekutiv i komunës do të përfshijë detyrimisht përfaqësues të komuniteteve që jetojnë në atë komunë. (Kushtetuta, Kapitulli 3, neni 62, pika 1-2)

Përveç këtij neni të Kushtetutës, nenet 53, 54, dhe 61 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale sqarojnë më detajisht përfaqësimin në nivel lokal. Neni 53 (Komiteti për Komunitete) përcakton se secila komunë ka një Komitet për Komunitete, që është një organ komunal me objektivin për të përfaqësuar (me të paktën një përfaqësues) të komuniteteve që jetojnë në një komunë; anëtarët për këtë arsye janë përfaqësuesit e komunitetit dhe anëtarët të Kuvendit Komunal (pikë. 53.1). Komiteti është përgjegjës



për të kontrolluar pajtueshmërinë e autoriteteve komunale me ligjet, duke rishikuar politikat dhe aktivitetet komunale, në dritën e të drejtave të komuniteteve. Një tjetër detyrë e këtij Komiteti është që të rekomandojë për Kuvendin Komunal masa që mendohet se janë të nevojshme dhe adekuate për të promovuar, mbrojtur, dhe shprehur identitetet e komuniteteve që jetojnë në komunë, që janë etnia, feje dhe gjuha (pikë. 53.2). (Ligji për vetqeverisje lokale, neni 53, pika 54.2)

Përveç Komitetit të Komuniteteve, komuna të caktuara kanë edhe një Zëvendës Kryesues për Komunitete. Kryesuesi ka detyra specifike që lidhen me komunitetet jo-shumicë pasi që kjo pozitë është e rezervuar për një qëllim të veçantë. Ajo është themeluar nga Neni 54 (Zëvendëskryesuesi për Komunitete) i Ligjit për vetqeverisje lokale që komunat me dhjetë për qind ose më shumë qytetarë që i përkasin komuniteteve jo-shumicë, pozita e kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete është e rezervuar për një përfaqësues e këtyre komuniteteve (pikë. 54.1), dhe se personi që zë këtë post zgjidhet përmes votave në Kuvendin Komunal (pika 54.2). (Ligji për vetqeverisje lokale, neni 53, pika 54.2)

Pjesa e fundit në lidhje me përfaqësimin e komuniteteve në nivel lokal sa i përket Kushtetutës dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, është vend i rezervuar për një nënkryetar për komunitete. Kjo është themeluar me Nenin 61 (Zëvendës Kryetari për Komunitete) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, që thekson se ato komuna që kanë së paku dhjetë për qind e popullatës jo-shumicë të komunitetit që jeton në to, duhet të kenë një nënkryetar për komunitete (pika 61.1) dhe se ky post zgjidhet për mandat të njëjtë si të kryetari (pika 61.2). (Ligji për vetqeverisje lokale, neni 61, pika 61.1-2) Me këtë është konstatuar pjesa që ka të bëjë me përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në të dy nivelet e qeverisjes lokale dhe qendrore dhe me subjektet e tjera të krijuara në të dy nivelet ekskluzivisht për qëllimet e përfaqësimit të pakicave në dritën e të drejtave të veçanta të dhëna për këto grupe.

## Qasja teorike

Kjo pjesë përbëhet prej teorisë nga fusha e të drejtave të pakicave, dhe paraqitet këtu me qëllim që të lejoj krahasimin në mes të një rrafshi teorik apo gjendjeje të dëshiruar dhe rastit të Kosovës. Kjo është në përputhje me kushtin që modeli që rrjedh prej saj konsiderohet si më i përshtatshmi për t'u ndjekur në rast të veçantë, duke pasur parasysh sfondin historik dhe situatën politike në realitetin e pas-pavarësisë në Kosovë. E zhvilluar nga Will Kymlicka, filozofit politik të njohur kanadez në fushën e multikulturalizmit, kjo teori rehabiliton tensionet që ngrihen mes kulturave të shumicës dhe pakicës, duke akomoduar këtë të fundit, dhe në të njëjtën kohë, duke u dhënë atyre mundësinë për t'u integruar në nivelin që ata vetë e gjykojnë të nevojshëm (në aspektin e ruajtjes së dallimit të tyre kulturor dhe po ashtu, për të qenë pjesë e identitetit të përbashkët qytetar me qytetarët e tjerë). Në parim, teoria e ofruar nga Kymlicka dhe mbështetur në këtë punim fokusohet në plotësimin e të drejtave të njeriut nga të drejtat e pakicave atje ku këto të fundit janë të kufizuara, në përputhje me parimet e demokracisë, liritë individuale, dhe drejtësisë sociale (Kymlick 1995:6). Vlen të përmendet se kjo pjesë është përshkruese, ndërsa ai pasuesi mbulon pjesën analitike.

### TIPET E SHTETEVE DHE PAKICAT

Për të arritur rehabilitimin e tensioneve që ekzistojnë në mes të një komuniteti shumicë dhe ato të pakicave, është thelbësore që paraprkishtë të bëhen disa vërejtje: Llojet e shteteve që ekzistojnë nga pikëpamja e trajtimit të pakicave, llojet e të drejtave të pakicave që mund të jepen, dhe harmonizimi midis llojit të minoriteteve dhe llojit korrespondues të të drejtave. Kjo është e rëndësishme duke pasur parasysh se kjo teori, siç e ka paraqitur Kymlicka, bazohet në premisën se të drejtat e dhëna për një lloj

të pakicës duhet të përputhen me natyrën e atij grupi, ndryshe, një shtet rrezikon që të thelloj dallimet në mes komuniteteve të tij, gjë që i nuk shërben qëllimit kryesor të kësaj teorie, dhe të punimit në tërësi. Pas kësaj, llojet e shteteve që janë identifikuar në këtë teori janë shtetet shumëkombëshe dhe shtete shumë-etnike. Të parat janë shtetet që, si vetë emertimi flet, përmbajnë më shumë se një komb, ndërsa kjo e fundit, paraqet shtetet që përbëhen prej njerëzve të kulturave të tjera, që kanë ardhur në vend si emigrantë (Kymlicka 11-17). Përkatësisht, ka pakica kombëtare dhe minoritetet etnike. Të parat janë më pak të prirura për integrim duke pas parasysh që ato zakonisht janë të përqendruara në një pjesë të vendit, ndërsa të fundit duke folur në përgjithësi mund të konsiderohet se kanë më shumë gjasa për t'u integruar, megjithatë, dëshirojnë të ruhet një pjesë e dallimeve të tyre etnike pavarësisht të tjerave. (Kymlicka 10-11)

### **TIPET E TË DREJTAVE TË PAKICAVE**

Kymlicka argumenton se shumica e demokracive liberale në botë janë ose shumëkombëshe ose shumë-etnike ose edhe të dyja. Duke pasur parasysh këtë, ai shpjegon tre mënyra, në kontekst të të drejtave të dalluara grupore, të cilat i kanë ndjekur më shpesh këto demokraci për t'iu përgjigjur kërkesave të pakicave kombëtare dhe grupeve etnike që jetojnë brenda shtetit. Këto tre mënyra janë të bazuara në garantimin e të drejtave të vetë-qeverisjes, të drejtave shumë-etnike, ose të drejta të veçanta të përfaqësimit (Kymlicka 26). Në vijim janë përkufizimet që ofron Kymlicka për secilin prej tyre.

Të drejtat e vetëqeverisjes i japin një pakice kombëtare një formë të autonomisë ose juridiksion territorial.(Kymlicka 181-2). Ato të drejta janë më komplekse se të dy llojet e tjera, duke pasur parasysh se përderisa të drejtat e përfaqësimit dhe shumë-etnisë kërkojnë përfshirje më të madhe të pakicës në komunitetin më të gjerë politik, kërkesa për të drejtat e vetëqeverisjes tregon një dëshirë të atij grupi që ti zbeh lidhjet me komunitetin e njëjtë. Kjo edhe tregon një tendencë të grupit për të vërë në pikëpyetje autoritetin dhe qëndrueshmërinë e tij. Po kështu, ata që kërkojnë të drejtat e vetëqeverisjes gjithashtu kanë prirje të shohin veten e tyre si një komunitet i veçantë politik nga ai me i madhi. Me këtë në mendje, autoriteti i shtetit më të madh nuk mund të marrë përsipër autoritetin e komuniteteve të tjera kombëtare.(Kymlicka 181-2) Kompleksiteti qëndron me faktin se, siç deklaroi Kymlicka:

“Nëse demokracia është rregull i ‘popullit’, pakicat kombëtare pohojnë se ka më shumë se një popull, secila me të drejtën e shtetit të vetë. Të drejtat e vetëqeverisjes, për këtë arsye, janë rasti më i plotë i shtetësisë së diferencuar, pasi që ato i ndajë njerëzit në”popuj” të ndarë, secili me të drejtat e veta historike të tij, të territoreve, dhe kompetencat e vetëqeverisjes; dhe prandaj secili me komunitetin e vet politik. Ata mund të shohin komunitetin e tyre politik si kryesor, dhe vlerën dhe autoritetin e federatës më të madhe si derivativë.” (Kymlicka 182)

Megjithatë, arsyeja pse të drejtat e vetëqeverisjes konsiderohen si të nevojshme, pavarësisht potencialit të tyre për destabilizim politik, mund të gjendet në pyetjen: çfarë do të ndodhë në qoftë se pakicave të veçanta nuk u janë dhënë të drejtat e vetë-qeverisjes? Ndërsa ato mund të jenë potencialisht të rrezikshme, një shtet që në rrethana të veçanta (me një lloj të veçantë të pakicës) neglizhon domosdoshmërinë për të garantuar të drejtat e vetë-qeverisjes, ai lehtë mund të shkojë drejt një situatë ku këto pakica, si një shenjë e rebelimit kundër kërcënimit të perceptuar, mund të motivohen edhe më shumë për të lëvizur drejt shpërndarjes. Pritet që ata të jenë të prirur për të vepruar në këtë mënyrë, si rezultat i ndjenjës së diskriminimit dhe/ose mohimit të së drejtës për të ruajtur dhe manifestuar identitetin e tyre, kjo e fundit duke qenë si burim i kërkesës së tyre për të drejtat e

vetëqeverisjes. Kështu, ndërsa të dy opsionet janë (të drejtat e vetëqeverisjes dhe mungesa e saj) të rrezikshme, opsioni i parë është konsideruar si më pak i rrezikshëm.

Të drejtat shumë-etnike në anën tjetër janë të drejtat që u janë ofruar grupeve etnike brenda një shteti, si një mënyrë për të ndihmuar pakicat përkatëse për të ruajtur dhe shprehur dallueshmërinë e tyre kulturore, por pa qenë një pengesë në përshtatjen apo apo përfshirjen e tyre në shumicën e shoqërisë. Prandaj mund të thuhet se të drejtat shumë-etnike promovojnë integrimin. (Kymlicka 30) Së fundi, të drejtat e veçanta të përfaqësimit janë ato që zbatohen për një grup të tretë (grup i ri lëvizje sociale), por edhe për pakicat kombëtare dhe grupet etnike. Ato mbulojnë kërkesën për përfaqësim proporcional, kështu që zërat e pakicave janë pjesë e përfaqësimit politik. (Kymlicka 31-33)

Prandaj, bazuar në atë që u tha më lartë, Kymlicka pohon që pakicat kombëtare mund të akomodohen si duhet me të drejta të vetë-qeverisjes dhe të përfaqësimit të veçantë, ndërsa grupet etnike me të drejtat shumë-etnike. Kjo e fundit është rasti i ofrimit të mundësisë për të mbajtur aspektet e dëshiruara të kulturës së tyre për këto grupe, dhe gjithashtu mundësinë për t'u integruar. Kjo premisë është ndërtuar mbi supozimin e përgjithshëm që emigrantët dëshirojnë të integrohen në shoqërinë pritëse, andaj ruajtja e një pjese të kulturës së tyre në përgjithësi nuk është pengesë për integrimin.

### **QËLLIMI I TË DREJTAVE TË DIFERENCUARA GRUPORE**

Në lidhje me tipet e të drejtave, domethënë ato individuale dhe kolektive, Kymlicka argumenton se të drejtat grupore të diferencuara duhet të jenë mbrojtjet e jashtme dhe jo kufizimet e brendshme. Dallimi në mes të këtyre dy koncepteve, sipas autorit, është se e para (p.sh. mbrojtjet e jashtme) janë kufizimet që një grup mund ti zbatoj ndaj lirive të anëtarëve të vet me qëllim të mbrojtjes së grupit nga ndikimi destabilizues që mund të vijë nga mosmarrëveshjet e brendshme. Të fundit (dmth kufizimet e brendshme) në anën tjetër janë masat e përdorura për të ulur ndjeshmërinë e grupeve minoritare në skenën e presioneve ekonomike dhe vendimeve politike të shumicës. (Kymlicka 33-36) Megjithatë, të drejtat e vetë-qeverisjes dhe të drejtat shumë-etnike munden, në disa raste, të shërbejnë edhe për kufizime të brendshme.

### **KORRIGJIMI I TEORISË LIBERALE: TË DREJTAT E PAKICAVE DHE LIBERALIZMI**

Duke pasur parasysh pozitën e Liberalizmit ndaj të drejtave të veçanta ose grupeve të diferencuara, pyetja që ngrihet në kontekstin e teorisë së Kymlickës është se si liberalizmi mund të lidhet me të drejtat e pakicave konkretisht. Për të adresuar këtë çështje, autori merr detyrën e përcjelljes së marrëdhënieve historike në mes liberalizmit dhe të drejtave të pakicave. Në të vërtetë, në qoftë se liberalizmi konsiderohet si një teori serioze, atëherë kjo detyrë është e pashmangshme. Teoria e diskutuar këtu, që është zhvillimi i teorisë së liberalizmit për të akomoduar pakicat, ka për objektiva kryesor korrigjimin e asaj që Kymlicka e quan perceptim të gabuar të liberalizmit. Ky perceptim i gabuar është që tradita liberale politike i reziston njohjes politike dhe mbështetjes së etnisë dhe kombësisë, dhe thekson se kërkesat për të drejtat grupore të diferencuara për grupet kulturore janë asgjë më shumë se divergjenca nga modeli standard i liberalizmit (dmth, se ato janë devijim lehtë nga kjo traditë). Për të korrigjuar këtë, autori argumenton se neglizhimi i të drejtave të minoriteteve është një zhvillim i kohëve të fundit në teorinë liberale; ato ishin - sipas tij - një pjesë e rëndësishme e traditës liberale midis Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Kjo neglizhencë ka dalë si rezultat i ndryshimeve që ka përjetuar shoqëria sot, si denigrimi etnocentrik i kulturave që nuk janë evropiane, frika për paqen dhe sigurinë në skenën ndërkombëtare, dhe kështu me radhë. Janë këta faktorë që

kanë sjellë shtrembërimet në teorinë liberale, duke zbatuar rregullat dhe kushtet në bazë të situatave të përgjithësuara, dhe në situata të cilave ato nuk i përkasin. Kymlicka në këtë mënyrë përipiqet që të zgjidhë këtë problem, dhe në këtë mënyrë, tregon se të drejtat e minoriteteve kanë qenë legjitimisht pjesë e traditës liberale. (Kymlicka 40)

Argumenti më poshtë deklaron se të drejtat e grupit janë me të vërtetë pjesë e parimeve liberale, pasi që liberalizmi nuk është, dhe as nuk duhet të jetë, i kufizuar thjeshtë për të drejtat universale individuale. Autori sugjeron se disa dukuri historike kanë çuar këtë tendencë të kohëve të fundit të neglizhimit të të drejtave të pakicave në traditën liberale. Tre zhvillime kryesore pas Luftës Botërore që Kymlicka i mban përgjegjëse për këtë sjellje të re, janë: së pari, zhgënjimi me sistemin e të drejtave të pakicave në Lidhjen e Kombeve, e ndjekur nga lëvizja Amerikane për Heqjen e Dallimeve Racore, dhe së treti, ringjallja e përkatësisë etnike mes emigrantëve në Shtetet e Bashkuara. (Kymlicka 38) Reagimi i tij për këtë tendencë megjithatë është se "ringjallja etnike përfshin një rishikim në aspektin e integritimit, jo një refuzim të integritetit" (Kymlicka 67), për rrjedhojë, njohja e kombësisë dhe etnisë nuk duhet të shihet si mbështetje për ndarje, por procese që kontribuojnë për integritetin më të mirë të themeluara mbi barazinë dhe jo asimilimin. Vlen të theksohet se konkluzioni është se këto tendenca janë gjithashtu një rezultat i përgjithësimeve të tepërta: frika në lidhje me paqen ndërkombëtare, përkushtim për barazi racore, dhe shqetësimi për përshkallëzimin e kërkesave të grupeve të emigrantëve janë të gjitha arsye legjitime për shqetësim, megjithatë, këto raste kanë qenë të ekzagjeruara për të përfshirë të gjitha rastet e pluralizmit kulturor, andaj edhe përmenden rezultatet. (Kymlicka 69)

## **PËRSHTATSHMËRIA E TEORISË**

Teoria Kymlicka-së, përveç përmbytjes dhe qasjes së saj, ka një avantazh ndaj teorive të tjera të paraqitura në teorinë bashkëkohore politike në fushën e të drejtave të pakicave edhe për shkak se ajo përputhet me realitetin potencial në shumë vende me një teori; për këtë arsye, ajo më vonë bëhet e zbatueshme në vendet ku vlerësohet si e përshtatshme, në varësi të situatës. Çfarë Kymlicka bënë përveç realizimit të gjendjes reale në lidhje me kulturat e pakicave në botë sot, është gjithashtu një akomodim i tyre, duke bërë atë që është e mundur realisht për t'i përfshirë ato si një pjesë vitale e një identiteti të përbashkët qytetar, por duke mos ndërhyrë me natyrën e kulturës së pakicave. Nga respekti, dhe jo nga integriteti i detyruar, një kulture e pakicës do të shprehë dëshirën e saj për t'u integruar dhe t'u ndjerë pjesë e një identiteti të përbashkët qytetar të një shoqërie më të madh.

## **Rasti i Kosovës në kontekstin e teorisë**

Teoria e mësipërme është paraqitur si një përpjekje për përafrimin e rastit të Kosovës me të, për të identifikuar nëse sistemi politik i kësaj të fundit përshtatet me të parin dhe në këtë mënyrë të arrihet në përfundim nëse vendi është në rrugën e duhur në lidhje me legjislacionin e të drejtave të pakicave. Së pari, është e rëndësishme të diskutohen arsyet se pse kjo teori është konsideruar si modeli më i përshtatshëm për rastin e Kosovës. Në këtë aspekt, historia e tensioneve etnike në rajon dhe dukuritë të nëntëdhjetave në ish-Jugosllavi (theksi këtu është në konfliktin e vitit 1999 në Kosovë) të luajë një rol vendimtar; kjo është me të vërtetë një domosdoshmëri për të ilustruar si duhet gjendjen dhe rrethanat në lidhje me marrëdhëniet mes komuniteteve të ndryshme brenda vendit si qytetarë të Kosovës (përsëri, theksi këtu është në marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës). Vlen të përmendet se, me objektivin përfundimtar të krijimit të një sistemi në Kosovë që akomodon komunitetet sipas dallimeve të tyre, po shtyn drejt krijimit të një identiteti të përbashkët qytetar, në

aspektin e pajtimit me të kaluarën, si një çështje shumë komplekse, është një element kyç në marrjen e vendimeve politike në lidhje me të drejtat e pakicave.

Është e qartë tashmë se Kymlicka, në teorinë e tij mbi multikulturalizmin dhe akomodimin e pakicave, argumenton në thelb se pakicat që banojnë brenda një vendi duhet të lejohen që të integrohen në shoqërinë e shumicës në menyrën që ata ndjehen rehat; kjo është bërë duke i lejuar atyre dy opsione paralelisht: integrimin duke ofruar mundësi të barabarta, si dhe ruajtjen, e dallimeve duke i dhënë të drejta të veçanta. Kjo e fundit i shërben qëllimit për të eleminuar kërcënimin e asimilimit të identitetit të tyre. Ndarja në dy pjesë që qëndron në këtë opsion është konsideruar si një nga më të përshtatshme për pakicat e Kosovës (duke theksuar këtu serbët), duke marrë në konsideratë faktin shumë të rëndësishëm se dhuna etnike është pjesë e historisë së kohëve të fundit dhe në këtë mënyrë tensionet etnike ende ekzistojnë, edhe pse janë të ulatshme në varësi të kontekstit. Kjo rezulton se dallimet etnike midis këtyre komuniteteve luajnë një rol shumë të rëndësishëm politik dhe social, dhe duhet të njihen në përputhje me rrethanat.

Nevoja për të akomoduar dallimet e përmendura në kuadër të sistemit për këtë arsye është e pashmangshme, megjithatë është po aq e nevojshme për t'ia lejuar sistemit që të kryej detyrën e tij të bashkimit të qytetarëve nën një identitet të përbashkët qytetar (dmth shtetas të Kosovës). Situata aktuale politike në Kosovë dhe sidomos në raport me Serbinë, si dhe qëndrimi shoqëror në Ballkan në përgjithësi, nuk janë premtuese për alternativa të tjera të trajtimit të pakicave, përveç njohjes së dallimeve dhe të ofrimit të të drejtave të veçanta dhe privilegjeve. Kjo është për shkak të faktit se aty ku tensionet etnike janë të vazhdueshme dhe historia e dhunës etnike është e kohëve të fundit, mosnjohja e njërës palë si e ndryshme dhe trajtimi i njejtë sikurse me komunitetin shumicë ka të ngjarë të ketë efekt të kundërt dhe të godasë përsëri me antagonizma të tjerë dhe ti thellojë më tutje tensionet. Për më tepër, kjo gjithashtu mund të çojë në thellimin e tensioneve ndër-shtetërore (p.sh. në mes të Kosovës dhe Serbisë). Në parim, ky skenar është paraparë në përputhje me norma të perceptuara se dhuna ndër-etnike e tillë sikurse se ajo e ushtruar gjatë viteve të nëntëdhjeta në Kosovë lë të dyja palët të mposhtura me implikimet që rrjedhin nga barra e armiqësive ndër-etnike, prandaj rezistenca ndaj bashkimit të të dy grupeve nën një identitet qytetar (kjo e fundit e klasifikon identitetin etnik si vartës me atë qytetare). Si rezultat, do të ketë nevojë që disa breza të kalojnë para se të jetë e arsyeshme që të merren me zbatimin e një teorie liberale në rastin e Kosovës, në qoftë se është objektiv i dëshirueshëm në atë moment kohorë.

Duke pasur parasysh situatën e përshkruar më lart, çështja në rrezik nuk ka të bëjë nëse minoriteteve duhet tu jepet të drejta të veçanta ose jo, por më tepër, se në çfarë mënyre mund të zbatohen këto të drejta në mënyrë që të mos zgjerohen boshllëqet ekzistuese ndërmjet komuniteteve, të cilat do të punojnë kundër akomodimit të pakicave dhe drejt ndarjeve të mëtutjeshme dhe konflikteve ndëretnike. Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje, dhe në të njëjtën kohë për të parë se ku qëndron Kosova në lidhje me sistemin e dëshiruar politik në lidhje me trajtimin e pakicave, teoria e Kymlickes është përdorur si një zgjidhje dhe respektivisht mjet krahasues. Në procesin e bërjes së kësaj dhe për qëllime saktësisë, gjendja dhe sistemi i Kosovës do të vlerësohet në përputhje me termat e përdorur në teorinë e Kymlickes, siç shpjegohet në vijim

Midis elementeve më të rëndësishme që janë shënuar në teorinë e Kymlickes është dallimi në mes të shteteve shumëkombëshe dhe shumëetnike. Në këto kushte, Kosova është vlerësuar si një shtet shumëkombësh, duke mbajtur parasysh dallimin në mes këtyre dy tipeve të dhënë në pjesën e tretë të punimit. Megjithatë, një çështje që tërheq vëmendjen këtu, është fakti se Kosova është përcaktuar nga kushtetuta e saj si multietnike dhe jo si shumëkombëshe. Kjo është për shkak të

faktit se zyrtarisht, ekziston një komb qytetar kosovar i përbërë nga njerëz që i përkasin etnive të ndryshme, por megjithatë, janë qytetarë të dhe të unifikuar nën një shtet sovran. Nga ana tjetër, shtetet shumëkombëshe në përgjithësi korrespondojnë me parimin se grupet etnike individuale kanë një identitet të veçantë kombëtar brenda një shteti (në këtë mënyrë janë besnikë të kombit të origjinës, ndërsa lidhja e tyre me bashkimin është dytësore). Pika ku realiteti social në Kosovë dhe definicioni i Kymlickës mbi shtetin shumëkombësh përkohë pjesërisht edhe pse është joformale, është e prekshme në aspektin shoqëror, perspektiva: me sistemin e saj të decentralizuar politik, komunat e Kosovës janë kryesisht të ndara në baza etnike, pra etnive, përveç identitetit të veçantë social, gjithashtu posedojnë ekuivalentin politik të saj. Prandaj, e drejta multi-etnike (Kosova) dhe shumëkombëshe (Kymlicka) këtu janë përdorur në mënyrë të këmbyeshme.

Barra që shtetet shumëkombëshe mbajnë është se komunitetet janë më pak të prirura ndaj integritetit, duke pasur parasysh se ata kanë një identitet të veçantë kombëtar tashmë dhe më e rëndësishmja, ata kanë tendencë të përqendrohen territorialisht në të njëjtën pjesë të vendit. Një shembull që konfirmon këtë fenomen në rastin e Kosovës është fakti se komuniteti serb është i përqendruar në komuna të veçanta (p.sh. Graçanica, Kllokot, Partesh, Ranillug), kështu kufijtë e komunitetit janë krijuar dhe integrimi në shoqërinë shumicë të Kosovës është një sfidë. Përveç pengesës së integritetit që kjo krijon, një tjetër pasojë e ndarjes etnike territoriale është se ajo lejon lidhje më të forta me vendin e origjinës etnike, në krahasim me vendin e shtetësisë. Kjo është e dukshme në rastin e serbëve të Kosovës, ku lidhjet me Serbinë janë më të forta në krahasim me lidhjet me Kosovën, si politikisht ashtu edhe në aspektin shoqëror. Kjo megjithatë nuk është një argument se pakica etnike nuk i përmbahet kornizës ligjore të Kosovës, dhe se ajo nuk e njeh atë si autoritetin zyrtar qeveritar (edhe pse problemet ekzistojnë në këtë drejtim, në fushat e arsimit, shëndetit, etj) por më tepër, një argument se ata ndjehen të mbrojtur nga dhe që i përkasin vendit të origjinës etnike.

Një tjetër dallim thelbësor që është bërë në teorinë e Kymlickës është klasifikimi i të drejtave të pakicave në lidhje me tipin e pakicës për të cilat ato janë të dizajnuara dhe të siguruar. Siç përshkruhet në pjesën e dytë të këtij punimi, llojet ekzistuese të pakicave (në përputhje me llojet ekzistuese të shteteve) janë pakica kombëtare dhe etnike, ndërsa llojet e të drejtave janë të vetë-qeverisjes, shumëetnike dhe përfaqësimit të veçantë. Njohja e këtij dallimi është thelbësor në procesin e definimit të një trajtimi të përshtatshëm për një lloj të veçantë të pakicës pasi që është e pamundur për të klasifikuar një grup të caktuar pa një analizë aktuale të prejardhjes së tyre historike. Për të vendosur rastin e Kosovës në këtë teori si një mjet për vlerësimin e sistemit të saj, vlenqë vendi përbëhet nga pakicat kombëtare në vend të atyre etnike (duke iu referuar paragrafit të parë të kaluar) në kontekstin e teorisë. Tani, pasi që Kosova në këtë rast është një shtet shumëkombësh me pakicat shumëkombëshe, llojet e të drejtave që vendi duhet të garantojnë për pakicat e saj janë ato të vetë-qeverisjes dhe të përfaqësimit të veçantë (përderisa të drejtat shumëetnike janë kryesisht të zbatueshme për pakicat etnike, të përcaktuara si ato që vijnë si emigrantë, rast ky që nuk korrespondon me Kosovën). Në vijim është një përmbledhje e dëmeve të mundshme dhe avantazheve për shoqërinë në këtë skenar.

Të drejtat e vetëqeverisjes, domethënë ato që japin një autonomi apo juridiksion territorial për një pakice kombëtare brenda një vendi, janë aplikuar pjesërisht në Kosovë. Edhe pse komunat ku është i përqendruar komuniteti serb (të përmendura më sipër) janë në kompetencë të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ai gjithashtu është i aplikueshëm në komunat e tjera, ky parim nuk zbatohet për katër komunat në veri të Kosovës (dmth Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut), që janë të banuara nga serbët. Marrëveshja mes Beogradit dhe Prishtinës, e quajtur "Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve", nënshkruar

në Bruksel më 19 prill 2013 në mes të kryeministrit të Kosovës dhe kryeministrit serb, përcakton këto komuna si një rast të qartë të zbatimit të vetëqeverisjes dhe të drejta për popullsinë që jeton aty. Kjo është bërë e qartë nga dispozitat e mëposhtme pas themelimit të Asociacionit / Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë, që është një strukturë paralele me Asociacionin e komunave të Kosovës (pika 2), dhe ka kompetenca të plota në fusha të ndryshme, si në ekonomi, arsim, shëndetësi dhe të tjera (pika 3). Për më tepër, kjo marrëveshje përcakton se këto katër komuna do të kenë një komandant të veçantë Rajonal të Policisë dhe që forcat e Policisë së Kosovës që veprojnë atje do të jenë të etnicitetit të njëjtë me popullatën, përkatësisht serbe (pika 9). Këto janë disa shembuj që ilustrojnë natyrën e privilegjeve të tjera që janë të garantuara për qytetarët e këtyre katër komunave në bazë të përkatësisë etnike. (Radio Televizioni i Serbisë”Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve”)

Pasi që kjo u tha, është e rëndësishme që të konfirmojë shpjegimin e paraqitur nga kjo teori e përdorur këtu për të treguar avantazhin e të drejtave të vetë-qeverisjes në kontekst. Siç është elaboruar në pjesën e tretë të këtij punimi, ky grup i të drejtave përkufizohet si një e keqe e domosdoshme; përderisa ato nuk mund të shërbejnë më së miri qëllimit të integritimit të minoriteteve dhe nuk mund të kontribuojnë në krijimin e një identiteti të përbashkët qytetar, pa to situata mund të përkeqësohet. Ato pakicat kanë më shumë gjasa të ndihen të lëna pas dore ose të detyruara për t'u asimiluar në qoftë se dëshira e tyre për vetë-qeverisje si një grup i komunave etnike homogjene, me vendin e origjinës etnike fqinj, nuk njihet. Gjasat për përpjekjet për shkëputje nga Kosova dhe bashkimi me Serbinë, dhe në këtë mënyrë destabilizimi politik dhe trazira sociale, janë më të larta. Pas kësaj, përderisa të drejtat e vetëqeverisjes për komunat serbe në veri përbëhen nga disavantazhet politike për Kosovën, ato kanë më pak të ngjarë të shkaktojnë eskalim të situatës dhe në afat të gjatë mund të kontribuojnë që qytetarët e këtyre komunave të ndjehen rehat si pjesë e shoqërisë së Kosovës dhe në këtë rast, ato mund të ndryshohen ose të revokohen krejt.

Sa i përket të drejtave të veçanta të përfaqësimit, sistemi i Kosovës është një shembull i qartë i tyre, bazuar në Kushtetutën dhe kornizën e saj ligjore. Kjo është demonstruar në mënyrë të qartë nga themelimi politik i sistemit në Kosovë, siç përshkruhet në pjesën e dytë të këtij punimi. Qëllimi i këtyre të drejtave është për të mbuluar kërkesën për përfaqësim proporcional, dhe për të siguruar që pakicat janë pjesë e përfaqësimit politik në vend. Në lidhje me situatën në Kosovë, mund të thuhet se përderisa këto të drejta mund të zgjerojnë hendekun mes të grupeve të ndryshme, kjo është konsideruar si e vetmja alternativë për të promovuar marrëdhënie të shëndetshme ndër-komunitare si qytetarët të një vendi, përgjatë krijimit të një ambienti të përshtatshëm për akomodimin e dallimeve. Kjo e fundit është një mekanizëm që i lejon grupet joshumicë të ndihen të përfaqësuar në proceset politike të vendit. Përgjithësisht, edhe pse kjo nuk mund domosdoshmërisht të jetë alternativa më e mirë për të ardhmen afatgjatë të Kosovës dhe qytetarëve të saj, ajo patjetër është në kontekst të rrethanave të pranishme dhe afatshkurtra të së ardhmes. Opsionet alternative me një nivel më të lartë të bashkimit të komuniteteve nuk konsiderohen të favorshme të paktën deri në marrëdhëniet ndër-etnike (veçanërisht serbë - shqiptarë të Kosovës) brenda Kosovës dhe marrëdhëniet ndër-shtetëror (Kosovë - Serbi) të jenë më të relaksuara.

E fundit por jo më pak e rëndësishme në teorinë e Kymlicka-së që do të diskutohet në kontekst të Kosovës është koncepti dhe praktika, respektivisht e përfaqësimit të grupit. Duke pasur parasysh se mbështetja për përfaqësimin e grupit rrjedh nga argumenti se kjo nuk mjafton për të garantuar të drejtat grupore të diferencuara, por procedurat e vendimmarrjes duhet të përcaktojnë dhe të interpretojnë këto të drejta, kjo konsiderohet një mjet i dëshirueshëm për rrethanat e Kosovës në



lidhje me minoritetet e saj. (Kymlicka 131) Për më tepër, duke pasur parasysh dy rastet kur kërkesa për përfaqësimin e grupit është e ligjshme (p.sh. kur një grup i pakicës është në disavantazh për shkak se ata janë pakicë dhe, kur një grup i tillë ka nevojë për të provuar se dëshira për vetëqeverisje pasqyron vullnetin e anëtarët e komunitetit të tyre) (Kymlicka 144-5), edhe pse grupet e pakicave nuk janë në disavantazh në krahasim me shumicën shqiptare të Kosovës, e kaluara dhe paragjykimet etnike që ekzistojnë ende mund të konsiderohen si "të metat" në kontekst; ndërsa rasti i dytë zbatohet për katër komunat në veri (elaboruar më parë në këtë seksion). Për të ilustruar se si përfaqësimi grupor është themeluar në legjislaturën e Kosovës është shembulli i Komitetit Konsultativ për Komunitete në nivel qendror (Kushtetuta, Kapitulli 3, neni 60, pika 1), Nënkryetar i Kuvendit Komunal për Komunitete (Kushtetuta, Kapitulli 3, neni 62, pika 1-2) dhe Zëvendës Kryetari për Komunitete në nivel local (Kushtetuta, neni 61, pika 61.1-2), dhe të tjerët siç është elaboruar më parë.

## Konkluzione

Ky punim është një përpjekje për të vlerësuar themelimin politik të Kosovës dhe të kornizës së saj ligjore në lidhje me të drejtat e minoriteteve që jetojnë brenda vendit. Është e rëndësishme të përmendet se për shkak të faktit se pakica serbe është më e madhe e këtyre grupeve në Kosovë, theksi gjatë gjithë punimit është vënë mbi ta, edhe pse jo në mënyrë të qartë dhe pa përjashtuar të tjerët. Ky vlerësim është bërë në dritën e objektivit të përgjithshëm të punimit, që është për të parë se ku qëndron Kosova në lidhje me akomodimin e dallimeve (si një pjesë të rëndësishme të identitetit) dhe në të njëjtën kohë, krijimi i një identiteti të përbashkët qytetar. Kjo e fundit perceptohet si bazë e një vendi shoqërisht dhe politikisht të qëndrueshëm, dhe si një nga tiparet themelore të shoqërive demokratike moderne. Ky vlerësim është bërë duke marrë parasysh historinë e marrëdhënieve ndër-etnike ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve, dukuritë politike përkatëse, si dhe botëkuptimet që përcjellin popullatën respektive. Rezultatet tregojnë se sistemi aktual i Kosovës, duke i dhënë të drejta të veçanta minoriteteve, kontribuon në konsolidimin e shoqërisë (duke lehtësuar kështu procesin e integritit të minoriteteve në rrjedhën qendrore të kulturës) më shumë se sa që do të bënte duke mos garantuar këto të drejta, në kontekstin e rrethanave aktuale. Potenciali që ky sistem zgjeron hendekun midis komuniteteve dhe i kontribuon ndarjes është ende ekzistent, megjithatë, në një masë më të vogël sesa që do të ishte në rastin e kundërt të trajtimit të njëjtë.

Metoda e përdorur këtu për të kryer këtë vlerësim të sistemit është bërë me anë të paraqitjes së një pjese relevante të kushtetutës së Kosovës dhe kornizës së saj ligjore, si dhe karakteristikat të tjera të rëndësishme të sistemit të saj politik, e ndjekur nga konsiderimi i një teorie që konsiderohet si më e përshtatshme për rastin e Kosovës; kjo e fundit është e zhvilluar nga Will Kymlicka. Pas pjesës së qasjes teorike është një analizë e sistemit politik të Kosovës (në lidhje me të drejtat e komuniteteve jo-shumicë) në kontekstin e teorisë se paraqitur. Theksi është mbi ligjet dhe politikat në vend dhe mënyrën se si ato të kontribuojnë në kauzën e drejtë (që është, krijimi i një identiteti të përbashkët qytetare duke ruajtur dallimet e grupeve), si dhe arsyet për këtë përfundim. Si pasojë, në bazë të këtyre konkluzioneve, është vendosur që sistemi në Kosovë është në rrugë të drejtë dhe korniza ligjore nuk kërkon ndryshime të mëdha.

Për të përfunduar në aspektin e objektivit të përmendur më sipër, vlen të përmendet se edhe pse në parim sistemi i Kosovës përshtatet me teorinë e paraqitur, duke qenë se kjo e fundit është liberale në rrenjë të saj (plotësohet me elemente të të drejtave të veçanta), sistemit i mungon komponenti liberal pasi që çdo gjë është e bazuar në dallimet e komunitetit dhe trajtim të veçantë. Megjithatë,



siç është konkluduar më parë, duke pasur parasysh situatën aktuale në vend dhe në rajon, dhe mënyra se si historia e kohëve të fundit ka ndikuar në marrëdhëniet mes komuniteteve të ndryshme etnike në Kosovë, ky themelim i shërben qëllimit afatgjatë të pajtimit me të kaluarën dhe relaksimit të tensioneve ndërtnike ekzistente. Ai gjithashtu kontribuon në stabilitetin politik në rajon dhe shmangien e trazirave sociale. Në një shkallë më të madhe dhe të ardhmen e largët, ai mund të bëhet i përshtatshëm për krijimin e elementit të liberalizmit si pjesë e sistemit, dhe në këtë mënyrë të aplikojnë teorinë Kymlickas në një masë më të madhe. Megjithatë, kjo kërkon kohë. Rekomandimi që rrjedh nga ky konkluzion është se vëmendja tani duhet të përqendrohet drejt zbatimit efektiv të kornizës ligjore dhe të politikave për të drejtat e minoriteteve në Kosovë; me fjalë të tjera, të përqendrohet në një qasje praktike ndaj trajtimit teor

## Literatura

Kymlicka, Will. 1995 Multicultural Citizenship: A Liberal Theory of Minority Rights. New York: Oxford University Press

Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008. Kosovë, Qeveria e Kosovës, qershor.

Radio-televizija Srbije."First agreement of principles governing the normalization of relations."

Ligji mbi Vet-qeverisjen Lokale- 2008, nr. 03/Lo40, Kosovë, 2008.

Jelena Lončar

## Ndarja e pushtetit në Kosovë: efektet e kuotave etnike dhe vetos së pakicës

Garanci të ndryshme për ndarjen e pushtetit për bashkësitë etnike janë paraqitur në Kosovë që nga viti 2001. Këto garanci përfshijnë kuota etnike për të dyja sektorët si për legjislaturë ashtu edhe kompetenca ekzekutive dhe përdorimin e vetos për komunitetet pakicë. Pasi që efektiviteti i tyre ende nuk është analizuar sa duhet, ky punim synon të ekzaminoj ndikimet e ndryshme të marrëveshjeve për ndarje të pushtetit. Punimi veçanërisht fokusohet në kuotat etnike parlamentare dhe fuqine e vetos dhe ndikimin e tyre në stabilitetin demokratik, e vendim-marrjen dhe fuqizimin e grupeve të pakicave në Kosovë. Duke u bazuar në intervistat e elitave, gjysmë të strukturuar, me 18 anëtarët e parlamentit (deputetët) nga parlamenti i Kosovës, punimi argumenton se kuotat etnike kanë qenë të nevojshme për përfshirjen e komuniteteve në institucionet politike në Kosovë, por që vendet e rezervuara dhe fuqia e vetos së pakicave kanë pasur efekte negative në stabilitetin, bashkëpunimin ndëretnik dhe integrimin e komuniteteve. Duket se është bërë një kompromis në mes fuqizimit të pakicave në njërën anë dhe bashkëpunimit ndër-grupor dhe stabilitetit afatgjatë në anën tjetër.



Kuota etnike, fuqia e vetos, ndarja e pushteti, minoriteti etnik, Kosovë etj.



Ky tekst u shkrua fillimisht në gjuhën angleze.

## Hyrje

Hulumtimet e mëparshme teorike kanë argumentuar se anëtarët e grupeve pakicë kanë stimuj më të lartë për të përfaqësuar grupet e tyre sesa anëtarët e grupit shumicë (Phillips, 1995, Williams, 1998, Young, 1990). Rezervimi i vendeve për pakicat pra mund të rritë përfaqësimin e interesave të pakicave dhe zbatimin e të drejtave të tjera të pakicave. Për më tepër Lijphart (1977, 2004) argumenton se prania proporcionale e grupeve etnike në institucione politike dhe ndarja e pushtetit etnik janë të nevojshme për të siguruar paqe dhe stabilitet demokratik në shoqëritë me ndasi të thella. Megjithatë, qasja e ndarjes së pushtetit është kritikuar gjerësisht në literaturë duke sugjeruar se ndarja etnike e pushtetit mund të përforcojë vetëm ndarjet etnike dhe të thellojë konfliktin (Rothchild dhe Roeder, 2005b).

Pavarësisht mospajtimeve teorike, përsiatja e ndarjes së pushtetit është miratuar nga shumë vende dhe institucione ndërkombëtare me mision të promovimit të drejtave të njeriut dhe të pakicave. Për shembull, OSBE-ja ka dizajnuar rekomandime të ndryshme që do të përdoren si instrument për mbrojtjen e pakicave, veçanërisht në vendet e Evropës Juglindore. Midis tyre, Rekomandimet e Lundit për Pjesëmarrje Efektive të Pakicave Kombëtare në Jetën Publike të miratuara në vitin 1999 janë të fokusuara drejtpërsëdrejti në përfaqësimin e pakicave politike. Rekomandohet që vendet të sigurojnë përfaqësim të veçantë të pakicave kombëtare”përmes një numri të rezervuar të mandateve në një ose dy dhomat e parlamentit ose në komisionet parlamentare; dhe forma të tjera të pjesëmarrjes së garantuar në procesin legjislativ” (Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare, 1999, fq. 8).

Pas këtyre rekomandimeve, të paktën 28 vende deri më tani kanë futur një formë të kuotës etnike<sup>1</sup> (Bird, 2014, Htun, 2004). Përkundër gjithë kësaj, ekziston mungesë e hulumtimit empirik që tregon se si kuotat etnike ndikojnë në stabilitetin demokratik, cilësinë e përfaqësuesve dhe mundësinë për të përfaqësuar interesat e pakicave etnike (Krook dhe Zetterberg 2014). Ky punim ka për qëllim të shqyrtoj këto çështje duke analizuar efektet e kuotave etnike dhe fuqinë e përdorimit të vetos së pakicës në rastin e Kosovës.

Në vitin 2001 garanci të ndryshme për ndarjen e pushtetit për bashkësitë etnike<sup>2</sup> janë prezantuar në Kosovë nga Hans Haekkerup, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kombeve të Bashkuara (OKB-së). Këto garanci kanë përfshirë kuota etnike si në legjislaturë edhe në ekzekutiv, fuqinë e vetos për pakicat dhe autonominë segmentale (p.sh. në arsim dhe kulturë). Duke pasur parasysh kufizimet e hapësirës, ky punim përqendrohet vetëm në kuotat etnike dhe fuqinë e përdorimit të vetos në parlamentin e Kosovës. Punimi ka për qëllim të shqyrtoj efektet e kuotave etnike parlamentare dhe fuqinë e vetos mbi stabilitetin demokratik, vendim-marrjen dhe fuqizimin e grupeve të pakicave. Gjetjet janë të bazuara në intervista gjysmë të strukturuar të elitës me 18 anëtarët e parlamentit (deputet) nga parlamenti i Kosovës.

Pjesa e parë e punimit prezanton debatet kryesore teorike. Dizajni i hulumtimit dhe metodologjia janë paraqitur në pjesën e dytë. Kjo pasohet nga shpjegime të shkurtëra të marrëveshjeve institucionale të Kosovës të miratuara pas vitit 2001. Rezultatet e hulumtimit, të cilat sugjerojnë

---

1 Në këtë punim termi ‘kuotat etnike’ definohet si “rregullat formale zgjedhore që garantojnë numrin minimal të përfaqësuesve politik të grupeve të caktuara etnike” (Bird, 2014, fq. 12).

2 Termi ‘komunitet’, siç përdoret në legjisllacionin dhe praktikën kosovare e ka të njejtin kuptim me termin ‘etnik’ ose ‘pakicë kombëtare’. Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Kosovë, komunitetet përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare të pakicave tradicionalisht të pranishme në Kosovë. Ligji në mënyrë specifike njuh shtatë grupe të pakicave që janë komunitetet si në vijim: serbët, turqit, boshnjakët, romët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe goranët (Neni 1.4). Në këtë punim, pra, termi “komunitetit” dhe “grup minoritar” do të përdoren në vend të njëra tjetrës.

se kuotat etnike dhe fuqia e përdorimit të vetos nga pakicat kanë shumë efekte divergjente, janë paraqitur në seksionin e katërt. Është treguar se kuotat etnike kanë qenë të nevojshme për të përfshirë komunitetet në institucionet politike të Kosovës, por që vendet e rezervuara dhe fuqia e vetos për pakicat reflekton negativisht në stabilitetin, bashkëpunimin ndër-etnik dhe integrimin e komuniteteve. Këto të gjetura përmblihen në pjesën përmblylëse të punimit.

## Shqyrtim i literaturës: ndarja e pushtetit në shoqëri me ndasi të thella

Shumica e dijetarëve nga fusha e zgjidhjes së konflikteve pajtohen se formimi institucional i shoqërive me ndasi të thella është ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në perspektivat e këtyre shoqërive për stabilizimin dhe konsolidimin demokratik (Horowitz, 1985, Lijphart, 1977). Megjithatë, literatura ngre pritje kontradiktore në lidhje me efektet e marrëveshjeve të ndryshme institucionale. Nga njëra anë, pritet që kuota etnike të veprojë si nxitje për stabilizimin demokratik pas konfliktit dhe integrim të pakicave në shoqëri (Lijphart, 1977, Lijphart 2004). Ato gjithashtu kanë tendencë të sigurojnë përfaqësim të gjerë të grupeve të ndryshme etnike dhe përfshirje të të gjitha grupeve në institucionet politike (O'Flynn, 2005). Sipas Lijphart, për të siguruar mbrojtjen e pakicave, marrëveshjet për ndarjen e pushtetit të pasqyruara me vende të garantuara në legjislaturë dhe ekzekutiv (të cilat do të garantonin praninë proporcionale dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje të të gjitha segmenteve) gjithashtu duhet të pasohet nga autonomia e gjerë segmentale dhe garancia për veto në fushat që ndikojnë në interesat vitale të segmenteve të pakicave (Lijphart, 1977, fq. 36-37).

Arsyeshmëria e marrëveshjeve të ndarjes së pushtetit është që të tjerët nuk mund të promovojnë interesat e grupeve të ndryshme etnike. Lijphart pohon se është e vështirë të imagjinohet se pakicat e vogla do të jenë të gatshme të pranojnë të përfaqësohen nga lideri politik i një grupi shumicë më parë sesa të përfaqësohen nga një anëtar i grupit të tyre (Lijphart, 2002, fq. 48-49, Lijphart, 2004, f. 98). Pavarësisht nga ruajtja e ndasive etnike dhe etnicitetit të politikës, argumentohet se kompromisi dhe bashkëpunimi midis liderëve etnikë mund të pritet pasi që politikanët duan të jenë pjesë e qeverisë dhe për të qëndruar në pushtet, ata janë të gatshëm të bëjnë kompromise dhe të arrijnë marrëveshje (Lijphart, 2002, fq. 44). Përveç kësaj, ata e kuptojnë rrezikun e bllokimit nëse ata nuk bëjnë kompromis por edhe se përdorimi i tepruar i vetos mund të kthehet kundër interesave të tyre (Lijphart, 1977, fq. 37).

Në anën tjetër, disa autorë janë të mendimit se ndarja e pushtetit mund të jetë e dobishme në fazën e fillimit për ti bërë aktorët ti bashkohen tryezës së negociatave, por në fazat e mëvonshme kjo mund të paraqesë një pengesë për konsolidimin e paqes dhe demokracisë (Reilly dhe Reynolds, 1999, Roeder dhe Rothchild, 2005). Rothchild dhe Roeder argumentojnë se në mënyrë që marrëveshjet e ndarjes së pushtetit të kenë sukses nevojitet një identitet i përbashkët kombëtar dhe një shtet i fuqishëm legjitim (Roeder dhe Rothchild, 2005, p. 323). Sidoqoftë, shumica e shoqërive pas luftërave civile nuk i plotësojnë këto kushte. Për këtë arsye, ndasitë etnike mund të bëhet më të thella me zbatimin e garancive të vështira për ndarjen e pushtetit të tilla si ndarja etnike e posteve ekzekutive dhe vendet e garantuara në legjislaturë (Rothchild dhe Roeder, 2005a, f. 6). Duke inkurajuar votimin sipas linjave etnike, institucionet e shtetit mund të riprodhojnë dhe të thellojnë ndasitë etnike duke shkatërruar paqen dhe stabilitetin në afat më të gjatë (Reilly dhe Reynolds, 1999, fq. 30, Rothchild dhe Roeder, 2005b).

Për më tepër, garancitë për ndarjen e pushtetit mund të jenë më pak efektive në promovimin e konsolidimit demokratik (Reilly dhe Reynolds, 1999, fq. 29, Roeder, 2005). Përveç kësaj, fuqia e vetos mund të bllokojë procesin e vendimmarrjes dhe të shkaktojë jostabilitet. Një tjetër pengesë potenciale e ulëseve të garantuara është se pjesëmarrja politike dhe përfshirja e qytetarëve mund

të ulet në mënyrë të konsiderueshme. Për sa kohë që vendet janë të rezervuara, dhe zgjedhësit nuk janë mjaftueshëm aktivë në politikë, nuk ka mekanizma për të inkurajuar përfaqësuesit të veprojnë si avokatë të të drejtave të pakicave. Siç e vë në dukje Phillips, "një nga shqetësimet në lidhje me strategjinë e "vendeve të sigurta" për përfaqësuesit e pakicave është se politikanët mund të mos shqetësohet të përvetësojnë çfarëdo ide politike" (Phillips, 1995, fq. 102).

Me gjithë debatet e mëdha teorike në këtë fushë, hulumtimi i pamjaftueshëm empirik është kryer për të testuar teorinë. Për më tepër, në mesin e mekanizmave të ndryshëm të ndarjes së pushtetit, efektet e kuotave në veçanti nuk janë analizuar sa duhet. Prandaj ky punim përpiqet të provojë teorinë nëpërmjet studimit empirik të kuotave etnike dhe vetos së pakicës në parlamentin e Kosovës.

## **Rašti i studimit dhe metodologjia**

Fokusi mbi përfaqësimin e pakicave në Kosovë është zgjedhur për disa arsye. Së pari, përfaqësimi i pakicave në Kosovë nuk është hulumtuar sa duhet deri më tani (shih Beha, 2013, Cocosatu, 2012, Visoka dhe Beha, 2011). Së dyti, që nga viti 2001 Kosova zbaton garantitë e vështira për ndarjen e pushtetit për komunitetet<sup>3</sup>. Efektet e tyre nuk janë shqyrtuar në detaje deri më tani (por shih Bieber, 2005). Së treti, ky është edhe një hulumtim në kohën e duhur pasi që rregullat zgjedhore për zgjedhjen e përfaqësuesve të pakicave mund të ndryshojë në procesin aktual të reformës zgjedhore. Aktualisht është duke u zhvilluar një debat i madh në Kosovë për mundësinë e heqjes së incentivave për të fituar ulëse shtesë përtej vendeve të sigurta. Përderisa disa parti thonë se rregullat aktuale duhet të mbahen, të tjerët thonë se vendet e sigurta duhet të ndahen vetëm në qoftë se pakicat kombëtare nuk do të fitojnë në zgjedhjet e hapura të paktën të njëjtin numër ulësesh që ishte i garantuar deri në vitin 2014.

Analiza ime bazohet në 18 intervista gjysmë të strukturuar me anëtarët e parlamentit nga të dy grupet ato të shumicës dhe të pakicës. Intervistat u zhvilluan në shkurt dhe mars 2014. Pothuajse të gjitha intervistat u zhvilluan në parlamentin e Kosovës. Pjesëmarrësit u zgjedhën në bazë të përkatësisë së tyre partiake dhe përkatësisë etnike. Gjashtë intervista janë zhvilluar me përfaqësues të secilit grup në vijim: të komunitetit shqiptar, të komunitetit serb dhe komuniteteve tjera pakicë (duke përfshirë komunitetin turk, boshnjak, rome dhe ashkali). Nga pjesëmarrësit u kërkua të komentojnë mbi procesin dhe arsyeshmërinë e miratimit të sistemit të kuotave në Kosovë, të reflektojnë si në efektet pozitive edhe ato negative të kuotave etnike duke përfshirë ndikimin në stabilitetin demokratik, vendim-marrjen dhe marrëdhëniet ndëretnike.

## **Garancitë e ndarjes së pushtetit në Kosovë**

Kuvendi i Kosovës ka gjithsej 120 anëtarë. Nga këto 120 vende, 20 vende janë të garantuara për komunitetet jo-shumicë. Gjysma e vendeve të garantuara janë të rezervuara për pakicën kombëtare serbe; katër vende janë të rezervuara për përfaqësuesit e pakicave ashkali, egjiptian dhe rom; tre janë të garantuara për pakicën boshnjake; dy për pakicën turke në Kosovë dhe një vend për komunitetin goran (Kushtetuta e Kosovës, neni 64). Dy nga pesë nënkryetarët e Kuvendit të Kosovës duhet të jenë nga komunitetet e pakicave: një nga komuniteti serb dhe një nga komunitetet e tjera joshumicë

---

<sup>3</sup> Garancitë relativisht të vështira për ndarjen e pushtetit janë gjithëpërfshirëse në vendim marrje, sipas Rothchild dhe Roeder, që konsiderohet të jenë: ndarja etnike e posteve ekzekutive dhe vendeve të rezervuara në legjislaturë, ndërsa qeverisja parlamentare dhe lista e përfaqësimit proporcional me prag të ulët paraqesin garanci relativisht të buta (Rothchild dhe Roeder, 2005b, f. 31).

(Kushtetuta e Kosovës neni 67). Kushtetuta e Kosovës po ashtu siguron që së paku një zëvendës kryesues i secilit komision parlamentar duhet të jetë nga radhët e komunitetit tjetër nga ai i kryesuesit (Kushtetuta e Kosovës neni 77).

Garancitë për mbrojtjen e pakicave janë forcuar gjithashtu me krijimin e Komisionit të Përhershëm Parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve (këtu e tutje Komisioni). Komisioni ka kompetenca të propozoj ligje dhe të ofroj rekomandime dhe opinione këshilluese për çdo ligj të propozuar në Kuvend. Përbërja e Komisionit është si në vijim: një e treta e anëtarëve të komisionit janë deputetët nga komuniteti serb, një e treta tjetër nga komunitetet e tjera të pakicave dhe një e treta nga komuniteti shumicë (Kushtetuta e Kosovës neni 78).

Përveç kësaj, miratimi i ligjeve me interes vital për komunitetet kërkon si shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe votimin nga komuniteti etnik shumicë ashtu edhe shumicën e votave nga ana e deputetëve të pranishëm nga komunitetet pakicë (Kushtetuta e Kosovës neni 81). Ligjet me interes vital të komuniteteve sipas Kushtetutës konsiderohen si në vijim:” (1) ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkuftare; (2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë; (3) ligjet për përdorimin e gjuhëve; (4) ligjet për zgjedhjet lokale; (5) ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; (6) ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare; (7) ligjet për arsimin; (8) ligjet për përdorimin e simboleve, përfshirë simbolet e komuniteteve dhe për festat publike.” (Kushtetuta e Kosovës neni 81).

Komunitetet kanë gjithashtu përfaqësim të garantuar në ekzekutiv. Në të vërtetë, të paktën një ministër në qeveri duhet të jetë nga komuniteti serb dhe të paktën një nga komunitetet e tjera pakicë. Në qoftë se qeveria ka më shumë se 12 ministra ajo duhet të përfshijë ministrin e tretë me prejardhje të pakicave etnike (Kushtetuta e Kosovës neni 96). Komunitetet kanë të drejtë edhe për të paktën katër vende zëvendës ministrorë të ndara në mënyrë të barabartë në mes Serbeve dhe komuniteteve tjera jo-shumicë. Në qoftë se qeveria ka më shumë se 12 ministra, zëvendës ministri i tretë shtesë duhet të emërohet si nga komuniteti serb ashtu dhe nga komunitetet tjera jo-shumicë. Në qeverinë aktuale të Kosovës e cila përbëhet nga 20 ministri dhe 5 zëvendëskryeministra, 5 ministra<sup>4</sup> janë nga komunitetet pakicë (4 nga komuniteti serbë dhe 1 nga ai turk). Një nga tre ministrat e komunitetit serb është gjithashtu njëri ndër zëvendës kryeministrat.

Përveç kësaj, në komunat me së paku 10% të popullatës që i përket komuniteteve jo-shumicë, posti i nënkryetarit të Kuvendit Komunal për Komunitete në ato komuna, është i rezervuar për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve (Kushtetuta e Kosovës neni 62). Të paktën 15% të gjykatësve të Gjykatës Supreme dhe cilësdo gjykatë tjetër, duhet të jenë nga komunitetet pakicë (Kushtetuta e Kosovës neni 103). Komunitetet pakicë gjithashtu kanë vende të rezervuara edhe në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Për më tepër, komunitetet etnike kanë të drejtë për përfaqësim të barabartë në punësim në institucionet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet (Kushtetuta e Kosovës neni 61).

Për sa i përket të drejtave të pakicave Kushtetuta e Kosovës siguron pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (këtu e tutje Plani i Ahtisaarit), i cili është përgatitur nga i Dërguari i Posaçëm për Procesin e Statusit të Ardhshëm të Kosovës, Marti Ahtisaari, në mars 2007. Për më tepër, dispozitat e Planit të Ahtisaarit kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave tjera ligjore në Kosovë

4 Ministrinë e udhëhequra nga përfaqësuesit e pakicave janë: 1. Administrimi i Pushtetit Lokal, 2 Administrata Publike, 3 Puna dhe Mirëqenia Sociale, 4 Komunitetet dhe Kthimi, dhe 5 Rinia, Inovacioni dhe Shanset e Barabarta

(Kushtetuta e Kosovës neni 143). Sipas planit të Ahtisarit, për dy mandatet e para të njëpasnjëshme zgjedhore (në mënyrë efektive 2007-2010, 2010-2014) çdo vend që partitë politike, iniciativat e qytetarëve ose kandidatët që përfaqësojnë komunitetet pakicë fitojnë përmes zgjedhjeve, do ti shtohet 20 ulëseve të garantuara (Kushtetuta e Kosovës neni 148). Partitë që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë në dy zgjedhjet e para ishin gjithashtu të përjashtuara nga pragu 5% që vlen për partitë shqiptare. Në mënyrë që të fitojnë një vend shtesë më tepër se 20 ulëset e garantuara, listat e pakicave duhej të kalonin praguin 'natyrorë' prej 1% (KIPRED, 2012). Këto dispozita ua mundësuan komuniteteve që të fitojnë 5 vende shtesë (3 për serbë, 1 boshnjak dhe 1 për komunitetin turk) në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2010. Këto vende shtesë të fituara përmes zgjedhjeve të hapura janë të etiketuara gjerësisht në Kosovë si "vendet e rezervuar", ndërsa 20 vende e sigurta të pakicave janë konsideruar si "vendet e garantuara". Pasi që kjo terminologji është përdorur në mesin e politikanëve dhe studiuesve në Kosovë, e njëjta do të përdoret gjithashtu edhe për qëllimet e këtij punimi.

Është e rëndësishme të theksohet se asnjë nga këto masa nuk është miratuar me vullnetin e të dyja partive kryesore politike dhe të pakicave apo politikanëve në Kosovë. Përkundrazi, bashkësia ndërkombëtare ka pasur një rol të madh në dizajnimin e institucioneve politike në Kosovë (Weller 2012). Garantitë e ndarjes së pushtetit në Kosovë u vendosën së pari nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kombeve të Bashkuara (OKB-së) në vitin 2001 në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe politikanët shqiptarë është dashur ti pranojnë ato si "çmim të pavarësisë". Siç ka deklaruar në një intervistë një deputet nga partia në pushtet PDK: vendet rezervuara janë vënë në kohën kur "neve na është dhënë pavarësia dhe pastaj ne kemi qenë të gatshëm të sakrifikojmë disa të drejta tona siç është dhënia e diskriminimit pozitiv pakicave. Kjo ishte arsyeja, përndryshe, unë jam goxha i sigurt se në qoftë se ju do të pyesni shumicën e njerëzve në referendum, ata nuk do të votonin për vendet e rezervuara për shkak se vendet e rezervuara janë një problem, dua të them që kjo na shkakton ndonjëherë problem" (Intervista e Buzhalës). Qëllimi i bashkësisë ndërkombëtare ishte kryesisht sigurimi i stabilitetit demokratik dhe përfshirja e pakicave në shoqërinë kosovare që ka ndasi të thella. Vendet e garantuara në parlament dhe në qeveri sigurojnë që komunitetet të kenë përfaqësuesit e tyre në institucione, pavarësisht nga madhësia e popullsisë së tyre ose të votuesve. Inxhinierët zgjedhor kishin menduar në veçanti për komunitetin serb i cili në disa raste i kishte bojkotuar zgjedhjet. Në pjesën vijuese do të shqyrtojmë nëse këto qëllime janë arritur.

## **Efektet e kuotave etnike dhe fuqia e vetos në Kosovë**

Sipas intervistave me deputetët në Kuvendin e Kosovës, garantitë për ndarjen e pushtetit fillimisht ndikojnë në stabilitetin demokratik, procesin e vendim-marrjes dhe fuqizimin e komuniteteve. Prania në rritje e përfaqësuesve të komuniteteve në parlament ka qenë një mënyrë për të reduktuar pasigurinë dhe mosbesimin e pakicave në institucionet e Kosovës. Ky është një shans për komunitetet që të jenë më shumë të përfshira në shoqërinë kosovare dhe është një tregues veçanërisht për bashkësinë ndërkombëtare se shumica është e gatshme që të bashkëpunojë dhe të përfshijë pakicat (Intervista e Buzhalës). Pasi që votuesit e pakicave deri më tani kanë hezituar që të marrin pjesë në zgjedhje, masat e aksionit afirmativ ishin e vetmja mënyrë për të siguruar praninë e pakicave në parlament.

Ndërkohë që përfshirja e komuniteteve ishte efekti kryesor i vendeve të garantuara, vendet e rezervuara dhe fuqia vetos së pakicës ka ndikuar më drejtpërdrejtë në stabilitet demokratik dhe vendim-marrje. Forca numerike në parlament e përforcuar nga vendet e rezervuara dhe nga fuqia e përdorimit të vetos në miratimin e ligjeve me interes vital për komunitetet siguron se përfaqësuesit

e komuniteteve kanë ndikim në vendimmarrje. Sidoqoftë, perceptimet që deputetët e pakicave kanë mbi efektet e kompetencave të tyre vendimmarrëse ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ana e deputetëve të shumicës. Përderisa deputetët e pakicave besojnë se ata ushtrojnë ndikim të rëndësishëm personal<sup>5</sup> dhe në këtë mënyrë janë bashkëpunues dhe të moderuar në kërkesat e tyre (Intervista e Baljes), deputetët shqiptarë mendojnë se pakicat shpesh abuzojnë me pushtetin e tyre veçanërisht në interesin e tyre personal, dhe jo në interes të komuniteteve (Intervista e Lames). Prandaj, përderisa nga njëra anë pjesëmarrja e komuniteteve në vendimmarrje është e inkurajuar nga vendet e rezervuara dhe nga fuqia e vetos, stabiliteti demokratik dhe përfshirja e komuniteteve mund të sfidohet. Nga njëra anë, pa garanci për ndarjen e pushtetit komunitetet vështirë se do të ishin të pranishme në institucionet politike dhe në gjendje të ushtrojnë ndonjë ndikim. Në anën tjetër, garancitë e vështira të ndarjes së pushtetit e parandalojnë integrimin dhe stabilitetin afatgjatë. Duket se është bërë një kompromis në mes fuqizimit të minoriteteve në njërin anë dhe të bashkëpunimit grupor dhe pajtimit, nga ana tjetër.

Pasi që stabiliteti demokratik dhe përfshirja e komuniteteve në procesin e vendimmarrjes dhe reflektimit politik konsiderohen efektet kryesore të kuotave etnike, seksionet e mëposhtme do të përqendrohen më hollësisht në ato.

## Stabiliteti demokratik

Aranzhimet e ndryshme për ndarjen e pushtetit deri më tani kanë pasur efekte të divergjente mbi stabilitetin demokratik dhe konsolidimin e demokracisë në Kosovë. Vendet e garantuara ndihmojnë institucionet politike për të rritur legjitimitetin e tyre dhe për të zvogëluar mosbesimin e komuniteteve. Ato në veçanti kanë një efekt pozitiv në uljen e frikës nga shumica dhe nga pasiguria që anëtarët e komuniteteve kanë. Deputetja serbe Jasmina Zhivkovicq e përshkruan këtë mirë nëpërmjet shembullit të saj: "Deri sa kam filluar të punoj këtu në Prishtinë në kuvend, kisha frikë për të lënë kufijtë e enklavave. Ka ekzistuar gjithmonë një frikë. Ky nuk është rasti tani. Unë besoj se shembulli im gjithashtu u tregon të tjerëve se ata mund të provojnë dhe të dalin jashtë kufijve të enklavave dhe se kjo është e vetmja mënyrë për të parë se çfarë është e lejuar dhe çfarë jo dhe se kjo është e vetmja mënyrë që të provoni, tekstualisht, të ndërtoni jetën. Ky proces nuk ka përfunduar dhe neve do të na duhet shumë kohë, por ja vlen të provohet" (Intervista e Zhivkovic).

Nga ana tjetër, analiza ime tregon se deputetët shqiptarë janë të pakënaqur me kompetencat që përfaqësuesit e pakicave kanë. Besohet se fuqia e vetos do të ketë ndikim negativ në stabilitetin demokratik (Intervista e Lamës, Intervista e Sahatqiu) dhe se nuk është e ligjshme dhe demokratike që partitë e pakicave të jenë aq të forta në parlament në krahasim me përqindjen e votave të fituara në zgjedhje (Intervista e Gjnit). Komunitetet do të jenë të mbi-përfaqësuara edhe në qoftë se vetëm vendet e garantuara janë në fuqi. Me vendet e rezervuara, prania e pakicave në parlament rritet në mënyrë të konsiderueshme gjë që shkakton prishje të madhe të ekuilibrit në mes të fuqisë parlamentare të grupit etnik shumicë dhe madhësisë së tyre në popullatë. Sipas deputetit shqiptar në opozitë, "e gjitha duhet të jetë më e balancuar. Do të ishte keq për demokracinë dhe sistemin politik në Kosovë në qoftë se do të kemi një parti serbe e cila me ndihmën e vendeve të rezervuara bëhet partia e

---

5 Ky ndikim është i dukshëm jo vetëm kur çështjet e lidhura me pakicat janë në rendin e ditës, por kryesisht gjatë votimit për çështje me rëndësi të përgjithshme pasi që shumica parlamentare është ngushtë me votat dhe votat e përfaqësuesve të pakicave kanë vlerë të lartë.



dytë më e fuqishme, partia e dytë më e madhe në Kosovë, dhe kur ia numërojmë votat ajo është e pesta apo e gjashta. Kjo do të ishte e çuditshëm dhe e panatyrshme”.

Përveç vendeve të rezervuara, deputetët shqiptarë argumentojnë se fuqia e vetos ka gjithashtu efekte negative për stabilitetin demokratik. Fuqia e vetos lejon komunitetet të bllokojnë procesin e vendimarrjes, shkaktojnë përçarje të mëdha në mes të grupeve etnike dhe pakënaqësi tek shumicës. Siç dëshmohet në thënien e mëposhtme, shantazhi i vazhdueshëm mund të shkaktojë jostabilitet dhe rezistencë nga ana e shumicës:”Le të supozojmë se ata do të bllokojnë dhe kushtëzojnë, bllokojnë dhe kushtëzojnë, kjo do të krijojë problem. Ju e dini, se në asnjë shtet pakicat nuk mund të kushtëzojnë shumicën dhe kjo nuk është logjika e demokracisë. Në demokraci, shumica udhëheq, pakicat kanë të drejta” (Intervista e Lamës). Megjithatë, këto efekte negative ende nuk janë aq të dukshme pasi që bashkësia ndërkombëtare luan një rol të madh në moderim të marrëdhënieve ndër-etnike dhe në stabilizim të Kosovës.

Pavarësisht nga efektet negative të fuqisë së vetos së pakicës dhe të vendeve të rezervuara, shumica e pjesëmarrësve sugjeruan se vendet e garantuara janë të rëndësishme për konsolidimin demokratik të Kosovës, sepse ato sigurojnë bashkëpunim të ndërsjellë dhe komunikimin në mes të komuniteteve. Për ata, prania e pakicave në institucione mund të trajtohet si dëshmi që demokracia po funksionon mirë (Intervista e Gjinit, Intervista e Buzhalës, Intervista e Miletiq, Intervista e Haliti, Intervista e Rexhepit, Intervista e Ademit, Intervista e Bales). Për këtë arsye, vendet e garantuara të cilat sigurojnë praninë e pakicave janë të pranuar gjerësisht, të paktën përkohësisht, ndërsa deputetët shqiptarë janë kryesisht të pakënaqur me fuqinë e përdorimit të vetos dhe vendeve të rezervuara.

## Ndikimi në vendim bërje

Garancitë e vështira të pushtet-ndarjes të cilat përfshijnë jo vetëm vendet në parlament, por edhe vendet e sigurta ministrore dhe fuqinë e vetos në parlament, sugjerojnë se përfaqësuesit e komuniteteve mund të jenë në pozicion të ushtrorë ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimarrjes. Pasi që njëzet e katër nga njëzet e pesë deputetët që përfaqësojnë komunitetet janë pjesë e koalicionit qeveritar<sup>6</sup> dhe përkrahja e tyre është vendimtare për të mbajtur qeverinë në pushtet, mund të pritet që ata të kenë ndikim më të madh se sa që u garantohet me ligj.

Kjo pritje mbështetet nga të dhënat e mbledhura nga pjesët e intervistave me deputetët që përfaqësojnë komunitetet pakicë. Përfaqësuesi rom, Albert Kinolli, shpjegoi:” çdo gjë e rëndësishme për vendin tonë, çdo gjë e rëndësishme dhe relevante për komunitetet e pakicave nuk mund të ndryshohet pa votat e 80 deputetëve nga 120 gjithsej në parlamentin e Kosovës dhe pa mbështetjen e dy të tretave të komuniteteve pakicë” (Intervista e Kinollit). Kjo deklaratë është përforcuar më tej nga përfaqësuesi boshnjak:”Ne si pakica jemi praktikisht faktori që merr vendime. Asnjëri nga ligjet nuk mund të miratohet pa votat tona. Absolutisht! Dhe mësimi i këtij fakti të bënë të ndjehesh mire... Miratimi i ligjit të buxhetit, për shembull, nuk mund të ketë sukses pa ne, dhe kjo është vendimtare për mbijetesën e qeverisë” (Intervista e Baljes). Ndikimi i pakicave në vendim marrje dhe rrjedhimisht mundësitë për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të pakicave mundësohen nga fuqia e vetos dhe nga prania më shumë se proporcionale e komuniteteve në parlament.

Deputetët e pakicave kanë theksuar në veçantit rëndësinë e ulëseve të rezervuara përveç ulëseve të garantuara për ndikim në vendimarrje. Pasi që sipas planit të Ahtisarit vendet e rezervuara

6 Vetëm deputetja serbe Rada Trajković deklaroi se nuk e përkrah qeverinë (Intervista e Trajkovićit).

janë menduar të jenë në fuqi vetëm në dy mandatet e para parlamentare, ekziston një shqetësim se mundësitë e pakicave për të ndikuar në politikë do të ulen pas zgjedhjeve të ardhshme 2014 kur komuniteteve nuk do tu jepen më shumë se 20 vende parlamentare. Në veçanti komuniteti serb është i interesuar të ruaj vendet e rezervuara për shkak se qeveria e Serbisë tani për herë të parë tani, pas një dekade të tërë, ka inkurajuar serbët që të marrin pjesë në zgjedhjet e organizuara nga institucionet e Kosovës. Me mbështetjen nga Serbia dhe me pjesëmarrjen e veriut të Kosovës, pritjet pjesëmarrje e lartë dhe partitë dhe grupet serbe mund të fitojnë numër të konsiderueshëm të vendeve të rezervuara krahas atyre 10 të garantuara<sup>7</sup>.

Pavarësisht që vendet të rezervuara dhe fuqia e vetos sigurojnë pjesëmarrje të komuniteteve në vendimarrje, duhet theksuar se ata kanë dështuar që të nxisin bashkëpunimin. Ndikimi mbi vendimarrje është kanalizuar kryesisht nëpërmjet aktorëve ndërkombëtarë në Kosovë në vend se nëpërmjet bashkëpunimit të përfaqësuesve të grupeve në institucione. Përfaqësuesit e pakicave mbështeten në këshillat dhe përkrahjen e aktorëve ndërkombëtarë në pothuajse çdo çështje të rëndësishme për pakicat. Aktorëve ndërkombëtarë u kërkohet që të ndërhyjnë në çështje të ndryshme që nga ndryshimet e vetme dhe hartimet e ligjeve deri të votimi dhe zbatimi i ligjeve (Intervista e Kinollit, Intervista e Kostićit, Intervista e Buzhalës, Intervista e Baljes, Intervista e Stojanoviçit, Intervista e Halilit).

Edhe pse bashkësia ndërkombëtare është faktor ndërmjetësi që ndihmon në mbrojtjen e pakicave dhe në pjesëmarrjen në vendimarrje dhe moderon sjelljen e përfaqësuesve të të gjitha grupeve etnike, rreziqet e bllokimit dhe të armiqësive etnike për shkak të fuqisë së vetos nuk duhet injoruar (Bieber, 2005, f. 95-100, Rothchild dhe Roeder, 2005b). Sipas partive shqiptare, fuqia e vetos lejon pakicat të bllokojnë procesin e vendimarrjes dhe të shantazhojnë shumicën (Intervista e Lamës). Përveç kësaj, të gjithë gjashtë deputetët shqiptarë të intervistuar kanë deklaruar se deputetët e pakicave nuk e përdorin këtë ndikim për të çuar përpara interesat e komuniteteve të tyre, por për të kënaqur interesat e tyre personale. Ky është një perceptim i deputetëve shqiptarë që i gjithë sistemi çon në paefektshmëri, me ministrat e pakicave dhe deputetëve që shërbejnë thjesht si një lloj reklame. Për këtë arsye, qytetarët bëhen edhe më të zhgënjyer kur ata shohin se përfaqësuesit e tyre janë të korruptuar dhe të distancuar nga komuniteti (Intervista e Konjufcës).

Përshtypja që komunitetet kanë më shumë ndikim në krahasim me pjesën e tyre të popullsisë dhe se askush nuk përfiton në thelb nga kjo i ka nxitur partitë shqiptare që të jenë kundër vendeve të rezervuara përveç atyre të garantuara. Rritja shtesë e numrit të përfaqësuesve të pakicave komplikon vendimarrjen edhe në çështjet që nuk janë drejtpërdrejt relevante për komunitetet. Marrja e shumicës parlamentare ose varet nga votat e pakicave ose i shtyn partitë kryesore të jenë më të bashkuar. Për më tepër, irritimi i deputetëve shqiptarë me vendet e rezervuara rritet nga mungesa e përgjegjësisë së deputetëve të komuniteteve. Këto argumente janë përmbledhur në deklaratën e Alma Lamës: "Është më mirë për serbët që të ndikohen nga këtu sesa nga Beogradi. Nëse vendet e rezervuara do të mundësojnë këtë gjë atëherë duhet përkrahur që ato të mbeten edhe një mandat më shumë. Por duket se deputetët e pakicave mbrojnë vendet e rezervuara vetëm për interesat e tyre personale, për të punësuar disa nga miqtë e tyre dhe nuk i shohin komunitetet" (Intervista e Lamës gjithashtu e ngjashme me intervisten e Gjinit).

---

7 Për shembull, në zgjedhjet parlamentare të 2001 kur qeveria serbe kishte inkurajuar serbët që të marrin pjesë, Koalicioni Serb Kthimi fitoi 12 vende përveç atyre 10 të garantuara duke patur kështu gjithsej 22 vende në parlament. Në zgjedhjet e radhës, qeveria e Serbisë i fitoi serbët e Kosovës që të bojkotojnë zgjedhjet që rezultoi në dështimin e listave të pakicave serbe dhe të partive për të fituar ndonjë vend të rezervuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2004 dhe 2007.

Sidoqoftë, mungesa e përgjegjësisë mund ti atribuohet më drejtpërdrejt efekteve vendeve të garantuara sesa vendeve të rezervuara. Mundësia për të fituar vende të tjera përmes zgjedhjeve të hapura paraqet një nxitje për partitë e pakicave për të punuar më mirë në mënyrë që të tërheqin më shumë vota për vende të tjera shtesë. Pa shansin për të fituar ndonjë ulëse shtesë në zgjedhje, incentivat për partitë e pakicave do të ulen në mënyrë të konsiderueshme. Për përfaqësuesit turk, deputetët e pakicave do të punonin më shumë në qoftë se vendet nuk janë të garantuara dhe nëse pala turke do të kishte mundësi për të fituar më shumë se 2 vende të garantuara. Në qoftë se ata e dinë se gjithsesi do të kenë dy vende, ata nuk do të kenë nevojë për të bërë shumë përpjekje (Intervista e Damkës). Pavarësisht kësaj, vendet e garantuara janë aktualisht të pakontestueshme në tërë Kosovën<sup>8</sup>.

## Fuqizimi i komuniteteve

Shumica e deputetëve të intervistuar nga të gjitha komunitetet deklaruan se efekti më i rëndësishëm i vendeve të garantuara ishte përfshirja e komuniteteve në institucionet politike dhe shoqërisë në përgjithësi. Kjo u theksua në veçanti për komunitetin serb anëtarët e shumë prej të cilëve ende nuk e njohin dhe nuk pranojnë të marrin pjesë në institucionet e Kosovës, sidomos në veri të Kosovës. Përderisa serbët në veri të Kosovës janë ende më shumë të lidhur me institucionet e Serbisë përmes institucioneve paralele që funksionojnë atje, serbët në jug të Kosovës dhe komunitetet tjera janë më të varur nga institucionet në Prishtinë. Për ta vendet e garantuara ofrojnë një ndjenjë të përfshirjes politike dhe një shpresë që jeta në Kosovë është e mundur (Intervista e lamës, Intervista e, Sahatqit, Intervista e Konjufcës).

Rritja e dukshmërisë së komuniteteve në shoqëri dhe reduktimi i frikës dhe pasigurisë, siç tregohet në seksionet e mësipërme, ishin padyshim efektet kryesore të kuotave etnike. Megjithatë, integrimi i plotë i komuniteteve në shoqëri është ende një qëllim i vështirë për tu arritur. Perceptimi që deputeti shqiptar ka për deputetin serb përshkruhet shumë mirë këtu: "Është shumë e çuditshme për ti parë ata. Ata nuk pajtohen me shqiptarët. Ata më parë do të qëndronin të izoluar diku sikur të mos ndjehen mirë në lëkurën e tyre. Ju nuk keni ide se së shumë duken si një trup i huaj në dhomën e asamblesë, kur ata janë aty" (Intervista e Buzhalës). Është evidente që edhe parlamenti qartë është i ndarë në vija etnike. Një nga arsytet për këtë është se kanë kaluar vetëm pesëmbëdhjetë vjet nga konflikti etnik dhe mosbesimi i thellë ndër-etnike është ende realiteti i shoqërisë së Kosovës. Siç ka pranuar një deputet shqiptar, "Është e vështirë të ndërtohet një urë, por ne po punojmë çdo ditë për atë. Kjo nuk është e lehtë. Çdo familje ka diçka për të thënë këtu" (Intervista e Pajazitit). Për më tepër, barrierat gjuhësore në mesin e deputetëve janë një tjetër arsye e ndarjeve etnike në parlament. Shumica e përfaqësuesve të pakicave nuk e flasin gjuhën shqipe. Edhe pse përkthimi simultant është në dispozicion në seancat plenare, komunikimi jashtë sallës plenare është i vështirë. Së fundi, kuotat etnike gjithashtu i kontribuojnë vazhdimit të këtyre ndarjeve, duke favorizuar partitë etnike në vend se të mbështesin bashkëpunimin dhe koalicionet shumetnike<sup>9</sup>. Shumica e përfaqësuesve të pakicave besojnë se qytetarët do të përfitonin nga partitë shumetnike. Siç deklaroi një përfaqësues serb: "Unë jetoj për ditën kur unë do të jem anëtar i një partie politike së bashku me shqiptarët dhe kur ne do të jemi liberalë (kjo ide të jemi liberalë është e imja), diçka që ka të bëjë me ideologjinë jo përkatësinë etnike. Kjo ditë është shumë larg, ajo nuk do të vijë së shpejti. Unë mendoj se ky është qëllimi që ne duhet të përpiqemi ta arrijmë" (Intervista e Miletiqit)

8 Vetëvendosje është e vetmja parti politike në Kosovë që është kundër vendeve të garantuara apo çfarëdo forme të masave afirmative për komunitetet (Intervista e Konjufcës).

9 Argumenti i ngjashëm është bërë edhe nga Teuta Sahatqia në intervistën e saj.

Problemi është, megjithatë, se në kushtet e mosbesimit të thellë midis grupeve etnike, do të ishte pothuajse e pamundur të arrihet prania e komuniteteve në parlament pa masa të veprimit afirmativ. Arsyeja për këtë është se partitë kryesore janë ende kryesisht shqiptare dhe pothuajse nuk ka anëtarë nga komunitetet e tjera. Një tjetër arsye është se, në të gjitha komunitetet, përveç atij serb, bashkësitë e tyre janë shumë të vogla në numër<sup>10</sup>. Pavarësisht nga madhësia, përfaqësues të komunitetit serb dhe goran<sup>11</sup> deklaruan se fitimi i votave është shumë më i vështirë kur qeveria në Serbi fton votuesit të bojkotojnë të gjitha zgjedhjet që nga viti 2003 e cila ka ndikuar në pjesëmarrje shumë të ulët të votuesve (Intervista e Miletiqit, Intervista e Milosavljeviçit, Intervista e Halilit). Përveç kësaj, një numër i madh i votuesve nuk janë në gjendje të marrin pjesë në zgjedhje ose për shkak të problemeve me dokumente, ose për shkak se ata janë të zhvendosur nga shtëpitë e tyre gjatë luftës (Intervista e Kosticiçit, Intervista e Zhivkoviçit, Intervista e Stojanoviçit, Intervista e Halilit). Për këtë arsye, përfaqësuesit e komuniteteve pakicë e kanë parë të rëndësishme që praninë në institucione ta kenë të garantuar, e cila nuk do të varej nga pjesëmarrja e votuesve. Heqja e plotë e garancive për ndarjen e pushtetit në këtë pikë ndoshta do të rezultojë në marginalizimin e pakicave dhe të zhdukjes së tyre nga institucionet publike. Si pasojë, mund të pritet se minoritetet do të ndihen edhe më të përjashtuara nga shoqëria.

## Përfundimi

Analiza ime tregon se deri tani kuotat etnike kanë qenë një mekanizëm i rëndësishëm për përfshirjes e pakicave, siç pritet nga literatura për ndarje të pushtetit. Ato kanë përfaqësuar një nxitje për pakicat për të pranuar institucionet zyrtare dhe të qetësojnë konfliktin. Prania e anëtarëve të grupit në institucionet publike, paraqitja e tyre publike si përfaqësues të shtetit, në staza të gjata, mund ti bëjë institucionet përfaqësuese më legjitime. Përderisa shumica e grupeve të pakicave në Kosovë njohin institucionet e Kosovës, serbët e sidomos ata në veri të Kosovës nuk e shohin qeverinë në Prishtinë si autoritet legjitim. Në vend të kësaj, ata janë më shumë të lidhur me qeverinë në Beograd. Në këto rrethana të besnikërisë së dyfishtë, vendet e garantuara janë një mekanizëm që ndihmon komunitetet të kthehen në drejtim të institucioneve të Kosovës. Përveç kësaj, prania e partive të pakicave në institucionet përfaqësuese të Kosovës ka qenë një sinjal për qytetarët se bashkëpunimi dhe komunikimi i ndërsjellë mund të jetë i mundur. Në momentin kur shumë pjesëtarë të komuniteteve nuk ndihen të lirë për të ecur nëpër Prishtinë apo flasin gjuhën e tyre në vendet ku shqiptarët janë shumicë, pjesëmarrja e përfaqësuesve të pakicave në vendimmarrje ka përfitime të rëndësishme simbolike.

Megjithatë, efekti i tyre afatgjatë varet kryesisht nga cilësia e përfaqësimit dhe jo vetëm nga prania e thjeshtë. Komunitetet aktualisht kanë kompetenca ligjore për të ndikuar vendimmarrjen. Pyetja është se sa efektshëm përdoret ky pushtet. Përshtypja është se kryesisht politikanët përfitojnë prej

---

10 Sipas regjistrimit zyrtar të vitit 2011, komunitetet e pakicave në Kosovë përbëjnë rreth 7% të popullsisë së përgjithshme (serbë 1.5%, 1.6% boshnjakë, turq 1.1%, romë 0.5%, 0.9% ashkali, egjiptian, goran 0.7% 0.6%, të tjerë 0.1%) (Agjencia e statistikave e KOSOVËS, 2013). Megjithatë, rezultatet e regjistrimit duhet të shikohen me kujdes pasi që veriu i Kosovës është përjashtuar nga regjistrimi dhe komunitetet serbe dhe rome në jug të Kosovës pjesërisht bojkotuan regjistrimin e popullsisë. Pasi që në të kaluarën është vlerësuar se pakicat përbëjnë 10-12% të popullsisë së përgjithshme (ECMI Kosovës, 2012), mund të pritet që serbët përbëjnë të paktën 4-6%.

11 Komuniteti goran ka anuar më shumë kah qeveria serbe se sa kah institucionet në Kosovë. Pjesëtarët e komunitetit goran flasin gjuhën serbe dhe kanë pranuar sistemin arsimor serb. Mbështetja financiare që ata marrin nga Serbia jo vetëm për arsimin, por edhe nëpërmjet subvencioneve, vendeve të punës dhe pensioneve ka qenë një nxitje e rëndësishme për besnikërinë e tyre në Serbi.

tij. Duke qenë se "janë të mbrojtur si arinj të polar" (Intervista e Milosavljevic), ata nuk kanë arsye për të kundërshtuar sistemin. Sidoqoftë, është e qartë se përfshirja e komuniteteve ende nuk ka çuar në integrimin e pakicave. Përkundrazi, irritimi i shumicës, kryesisht për shkak të vendeve të rezervuara dhe fuqisë së vetos, është shfaqur dhe në qoftë se përfaqësues më radikalë hyjnë në parlament<sup>12</sup>, mund të pritet destabilitet (Horowitz, 1991).

Edhe pse kuotat etnike janë të nevojshme në fazën fillestare pas konfliktit si një mekanizëm për përfshirje të komuniteteve në institucionet e Kosovës, efektet negative të evidentuara të ndarjes së pushtetit të tilla si përgjegjësi e ulët, përdorimi i tepruar i vetos dhe etnifikimi i politikës mund të rrezikojë efektet pozitive. Për këtë arsye, në kundërshtim me pritjet e krijuara nga literatura për ndarje të pushtetit, analiza e mësipërme tregon se kuotat etnike dhe vetoja e pakicës mund të mos jetë mekanizmi i duhur për pajtim dhe stabilitet demokratik afatgjatë, sidomos pasi që roli i bashkësisë ndërkombëtare në implementimin e marrëveshjeve për ndarje të pushtetit zvogëlohet (shih McGarry dhe O'Leary, 2004). Ndërsa marrëveshjet për ndarjen e pushtetit, siç pritet, arrijnë të përfshijnë përfaqësues të pakicave në institucionet politike, ato kanë dështuar në sigurimin e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë. Për më tepër, vendet e garantuara inkurajojnë votuesit që të votojnë për anëtarët e komuniteteve të tyre, duke ulur në këtë mënyrë mundësitë për bashkëpunim shumetnik. Ajo që i duhet Kosovës është një përkushtim afatgjatë për pajtimin dhe transformimin e marrëdhënieve midis njerëzve. Është më shumë e mundshme që kjo të arrihet duke mbështetur zhvillimin e partive dhe mekanizmave shumetnike për rritjen e cilësisë së përfaqësimit dhe dialogut ndëretnik<sup>13</sup>.

Këto rezultate tregojnë nevojën për një hulumtim më të thellë të perceptimit të qytetarëve, qëllimet dhe mënyrat që përfaqësuesit e pakicave ushtrojnë ndikimin e tyre në vendimmarrje dhe marrëdhëniet e tyre me partitë kryesore. Edhe pse qëllimi i këtij punimi është i kufizuar në kalibrimin e efekteve kryesore të kuotave etnike dhe fuqisë së vetos nga perspektiva e përfaqësuesve politik në Kuvendin e Kosovës, ky punim gjithashtu ka dhënë prova se hulumtime të mëtejshme, në këtë fushë, janë të nevojshme dhe të justifikuar. Përveç kësaj, punimi ka prekur mbi rolin e bashkësisë ndërkombëtare në përcaktimin e kornizës ligjore dhe rolin e Serbisë në përfaqësimin efektiv të minoriteteve, por rolet e këtyre aktorëve duhet të shqyrtohen më me kujdes në të ardhmen.

---

12 Pritet që zgjedhjet në vijim për herë të parë do të rezultojnë me pjesëmarrje të serbeve të "vërtetë" (Intervista e Buzhalës) në parlamentin e Kosovës pasi që qeveria e Serbisë ka filluar të përkrah pjesëmarrjen në zgjedhje. Për më tepër, pjesëmarrja e të dy palëve, kandidatëve dhe votuesve, nga veriu i Kosovës pritet të ndodhë për herë të parë pas një dekade bojkoti.

13 Për shembull, listat e hapura elektorale mund të shihen si një mekanizëm i mirë fillestarë për përmirësim të sistemit të kuotave.

## Falënderime

Unë i jam mirënjohëse Nina Caspersen për komentet e saj të dobishme në versionin e parë të këtij punimi dhe anëtarëve të parlamentit që morën pjesë në hulumtim. Falënderoj, po ashtu Stefan Surlicin për ftesën për të qenë pjesë e këtij projekti kërkimor, Jasmina Lazoviçin për ndihmën e ofruar në vënien në kontakt me deputetët dhe caktimin e intervistave dhe Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut për përkrahjen organizative të këtij hulumtimi.

## Shtojca I

Tabela 1: Intervistat me deputetët e komunitetit shqiptarë

Emri	Partia	Shkrts	Data
Alma Lama	Lidhja Demokratike e Kosovës	LDK	28/02/2014
Ardian Gjini	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	AAK	06/03/2014
Berat Budzala	Partia Demokratike e Kosovës	PDK	03/03/2014
Glauk Konjufca	Vetvendosja	VV	25/02/2014
Teuta Sahatqia	Lidhja Demokratike e Kosovës	LD	25/02/2014
Zenun Pajaziti	Partia Demokratike e Kosovës	PDK	28/02/2014

Tabela 2: Intervistat me deputetët e komunitetit serb

Emri	Partia	Shkrts	Data
Biserka Kostić	Partia Progressive Demokratike	PDS	25/02/2014
Jasmina Živković	Partia e Pavarur Liberale	SLS	27/02/2014
Milivoje Stojanović	Deputet i pavarur		27/02/2014
Petar Miletić	Partia e Pavarur Liberale	SLS	26/02/2014
Rada Trajković	Lista e Bashkuar Serbe	JSL	26/02/2014
Saša Milosavljević	Partia e Pavarur Liberale	SLS	27/02/2014

Table 3: Intervistat me deputetët nga komunitetet tjera pakicë

Emri	Partia	Shkrts	Data
Albert Kinolli	Partia e Bashkuar Rome e Kosovës	PREBK	28/02/2014
Danush Ademi	Partia Demokratike Ashkalike e Kosovës	PDAK	28/02/2014
Duda Balje	VAKAT	VAKAT	28/02/2014
Emilija Redžepi	Partia e Re Demokratike	NDS	26/02/2014
Fikrim Damka	Partia Demokratike Turke e Kosovës	KDTP	27/02/2014
Murselj Haljilji	Iniciativa Qytetare e Gorës	GIG	28/02/2014

## Literatura

- Agjencia e statistikave të Kosovës (2013). Popullsia sipas gjinisë, ethnicitetit dhe vendbanimit. Regjistrimi i Popullsisë Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011. Rezultatet përfundimtare. Prishtinë, Agjencia e statistikave të Kosovës.
- Beha, A. (2013). Të Drejtat e Pakicave: Një Mundësi për Rregullimin e Marrënieve Etnike në Kosovë. Prishtinë, Instituti Kosovar i Paqes.
- Bieber, F. (2005). Power sharing after Yugoslavia: Functionality and Dysfunctionality of Power-sharing Institutions in Post-war Bosnia, Macedonia, and Kosovo. In S. Noel ed. *From Power Sharing to Democracy: Post-conflict Institutions in Ethnically Divided Societies*. Montreal & Kingston, London, Ithaca, McGill-Queen's University Press. 85-104.
- Bird, K. (2014). Ethnic quotas and ethnic representation worldwide. *International Political Science Review* 35(1) 12-26.
- Cocosatu, M. (2012). The Role of Ethnic Minorities within the Government System of Kosovo. *Acta Universitatis Danubius* 5(1) 111-122.
- ECMI Kosovë (2012). Komunitetet Pakicë në Rezultatit e Regjistrimit të Kosovës 2011: Analizat dhe Rekomandimet. Prishtinë, Qendra Evropiane për Çështjet e Pakicave (ECMI) Kosovë.
- Horowitz, D. L. (1985). *Ethnic groups in conflict*. Berkeley: California University Press.
- Horowitz, D. L. (1991). *A Democratic South Africa? Constitutional Engineering in a Divided Society*. Berkeley, Los Angeles, Oxford: University of California Press.
- Htun, M. (2004). Is Gender like Ethnicity? The Political Representation of Identity Groups. *Perspectives on Politics* 2(3) 439-458.
- KIPRED (2012). Zgjedhjet për Qytetarët: Vlerësimi i Sistemit Zgjedhor të Kosovës dhe Rekomandimet për Zgjedhjet e Ardshme. Prishtinë, KIPRED.
- Phillips, A. (1995). *The politics of presence*. Oxford: Oxford University Press.
- Krook, M. L. and P. Zetterberg (2014). Electoral quotas and political representation: Comparative perspectives. *International Political Science Review* 35(1) 3-11.
- Lijphart, A. (1977). *Democracy in Plural Societies: A Comparative Exploration*. New Haven: Yale University Press.
- Lijphart, A. (2002). The Wave of Power-Sharing Democracy. In A. Reynolds ed. *The Architecture of Democracy: Constitutional Design, Conflict Management, and Democracy*. Oxford, Oxford University Press. 37-55.
- Lijphart, A. (2004). Constitutional Design for Divided Societies. *Journal of Democracy* 15(2) 96-109.
- McGarry, J. and B. O'Leary (2004). *The Northern Ireland Conflict: Consociational Engagements*. Oxford: Oxford University Press.
- OSCE High Commissioner on National Minorities (1999). *Lund Recommendations on the Effective Participation of National Minorities in Public Life and Explanatory Note*.
- O'Flynn, I. (2005). Democratic Values and Power Sharing. In I. O'Flynn and D. Russell eds. *Power Sharing: New Challenges for Divided Societies*. London, Ann Arbor, MI, Pluto Press.
- Reilly, B. (1999). *Electoral Systems and Conflict*. Papers on International Conflict Resolution No. 2. Washington D.C.
- Roeder, P. G. (2005). Power Dividing as an Alternative to Ethnic Power Sharing. In P. G. Roeder and D. Rothchild eds. *Sustainable Peace: Power and Democracy after Civil Wars*. Ithaca, London, Cornell University Press. 51-83.
- Roeder, P. G. and D. Rothchild (2005). Conclusion: Nation-State Stewardship and the Alternatives to Power Sharing. In P. G. Roeder and D. Rothchild eds. *Sustainable Peace: Power and Democracy after Civil Wars*. Ithaca, London, Cornell University Press. 319-347.
- Rothchild, D. and P. G. Roeder (2005a). Dilemmas of State-Building in Divided Societies. In P. G. Roeder and D. Rothchild eds. *Sustainable Peace: Power and Democracy after Civil Wars*. Ithaca, London, Cornell University Press. 1-27.
- Rothchild, D. and P. G. Roeder (2005b). Power Sharing as an Impediment to Peace and Democracy. In P. G. Roeder and D. Rothchild eds. *Sustainable Peace: Power and Democracy after Civil Wars*. Ithaca, London, Cornell University Press. 29-51.
- Visoka, G. and A. Beha (2011). Minority Consultative Bodies in Kosovo: A Quest for Effective Emancipation or Elusive Participation. *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe* 10(1) 1-30.
- Weller, M. (2012). The Failure of Prevention. In S. Wolff and C. Yakinthou eds. *Conflict Management in Divided Societies: Theory and Practice*. London, New York, Routledge.
- Williams, M. S. (1998). *Voice, Trust, and Memory: Marginalized Groups and the Failings of Liberal Representation*. Princeton, N.J.; Chichester: Princeton University Press.
- Young, I. M. (1990). *Justice and the politics of difference*. Princeton, N.J.: Princeton University Press.

Nikola Beljinac

## Patriotizmi kushtetues në shoqëritë pluraliste – Raŝti i Kosovës

Në shembullin e Kosovës, teksti analizon themelet normative të tezës mbi patriotizmin kushtetues si strategji më e përshtatshme për ndërtimin e identitetit dhe të unitetit kombëtar në shoqëritë pluraliste dhe me ndasi të thella. Pjesa e parë dhe e dytë e tekstit paraqesin supozimet themelore të teorisë së patriotizmit kushtetues. Unë argumentoj se patriotizmi kushtetues, në të gjitha verzionet e tij, në radhë të parë synon të përgjigjet në pyetjen e legjitimitetit të sundimit politik dhe jo në pyetjen paraprirëse për strukturimin e një politike. Me fjalë të tjera, pikënisja është pyetja “Si dëshirojmë të jetojmë së bashku?”, ndërsa pyetja “Pse jemi së bashku?” konsiderohet tashmë e zgjidhur. Kjo më tej do të thotë se postulatet e teorisë së patriotizmit kushtetues mund t’i përkasin vetëm një hapësire tanimë të lidhur politike, që mund të jetë rasti me shumicën e shteteve bashkëkohore, por në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet një fakt i vetëkuptuar, kur është fjala për shoqëritë me ndasi. Pjesa e tretë e tekstit i është përkushtuar analizës kontekstuale të dinamikave sociale dhe politike në Kosovë. Duke marrë parasysh efektet e inxhinierisë kushtetuese dhe institucionale, konturat e kornizës së re politike janë përshkruar me ndihmën e modeleve të “shtetit të papërfunduar” dhe “shoqërisë së dyfishtë”.

Konkluzioni përmbledh argumente themelore, duke pretenduar se është shumë ambicioze të kërkohet nga patriotizmi kushtetues që të largojë barrën e rëndë të konflikteve të vazhdueshme ndëretnike dhe tensioneve në Kosovë këtu dhe tani, njëjtë sikurse është joreale të pritet që patriotizmi kushtetues, duke u mbështetur ekskluzivisht në logjikën normative të tij, mund të gjeneroj lidhjet e përkatësisë qytetare.



Pluralizmi etno-kulturor,  
patriotizmi kushtetues, identitetit  
politik, të drejtat e pakicave.



Ky tekst u shkrua fillimisht në  
gjuhën serbe.



## Hyrje

Ekziston një mendim i përgjithshëm që të gjitha shtetet ekzistuese, shikuar nga pikëpamja demografike, janë qeveri pluraliste. Pasi që kjo i referohet një tipari të përhershëm të shoqërive bashkëkohore që është e pamundur të hiqet me mjete të lejuara moralisht, pikënisja e shkencëtarëve të sotëm politik nuk është nëse por si të merren me faktin e pluralizmit etno-kulturor. Natyra e sfidës sa është praktike, po aq është dhe teorike. Në nivel institucional, kërkesa për politizimin e identiteteve etno-kulturore vë para "inxhinierëve politikë" detyrën e ripërcaktimit të institucioneve konvencionale liberale-demokratike të cilat për tre shekuj të tërë kanë shërbyer vetëm për të zbutur preferencat e interesit të individëve. Në nivelin teorik, procesi i demontimit të diçkaje që deri në mesin e viteve të 1980-ta është konsideruar të jetë një "konsensus social-demokratik"<sup>1</sup> i padiskutueshëm i pasluftës, fiton shprehjen e tij akademike në zhvillimin e teorisë politike të njohjes e cila teoricienëve politikë u jep një detyrë mjaft të pakëndshme që të rishqyrtojnë të kuptuarit tradicional të pothuajse të gjitha koncepteve kyçe të teorisë politike, veçanërisht parimet e barazisë, drejtësisë, legjitimitetit demokratik, integritetit politik, lirisë dhe autonomisë.

Pavarësisht nëse zgjedhim qasjen empirike apo normative në analizimin e natyrës multi-kulturore të shoqërive bashkëkohore, sfida më e madhe ka të bëjë me nevojën urgjente për pajtimin e dy imperativëve të fuqishëm me të cilët përballet çdo shtet pluralist. Në anën tjetër, është e nevojshme të stimulohen lidhjet e përkatësisë së përbashkët midis gjithë qytetarëve, në mënyrë të pavarur nga identifikimet e tyre të veçanta, por me domosdoshmërinë e një niveli të caktuar të njohjes publike të kulturave të pakicave. Këto janë kërkesa të cilat janë në të njëjtën kohë reciprokisht të kushtëzuara dhe të konfrontuara. Në rastin e ekzistimit të disa grupeve të ndryshme etno-kulturore, nuk është e mundur të ndërtohet një identitet i përbashkët përveç nëse pjesëtarët e këtyre grupeve ndajnë ndjenjën se përkatësitë e veçanta të identitetit të tyre pranohen dhe vlerësohen në mënyrë të barabartë. Në të njëjtën mënyrë, njohja e plotë ligjore dhe institucionale e identiteteve të veçanta mbart rrezikun e shpërbërjes së asaj çfarë Jon Elster quan "bazament i shoqërisë" – një hapësirë e përbashkët politike e cila harkon konceptet tona të veçanta të jetesës së mirë (Elster 1989), dhe e cila përfundimisht mund të çojë në zhdukjen e vetë shtetit. Prandaj qëndrueshmëria e politikave publike aktuale, ashtu si forca normative e konkluzioneve teorike, matet gjithmonë me kapacitetin për të balancuar nevojën për unitet politik dhe kujdesin për diversitetin etno-kulturor. Përvoja historike na tregon se shoqëritë pluraliste kanë arritur të harmonizojnë këto dy kërkesa me nivele të ndryshme të suksesit, dhe se rezultatet më të mira janë arritur nga shoqëritë me identitete me ndërthurje të shumta, si dhe me një marrëveshje të nënkuptuar për të jetuar së bashku, e themeluar në mënyra të ndryshme joformale të bashkëpunimit shoqëror.

Megjithatë, situata është shumë më komplekse në qoftë se shoqëria pluraliste në të njëjtën kohë është me ndasi të thella. Këto janë shoqëritë në të cilat linjat e ndarjeve etno-kulturore janë të reflektuara në pothuajse të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe politike, ndërsa niveli i depërtimit ndër-kulturor është i reduktuar në minimum. Prandaj është e zakonshme që në shoqëri të tilla partneritetet dhe martesat bëhen vetëm në mes të anëtarëve të grupeve të njëjta etnike, dhe klubet sportive, vendet

---

1 Konsensusi ishte i bazuar në tezën sipas së cilës të gjitha shtetet demokratike liberale karakterizohen nga të njëjtat parime kushtetuese: të gjitha janë liberale (të themeluara mbi mbrojtjen kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut), demokratike (të gjithë qytetarët e rritur gëzojnë të drejtën aktive dhe pasive të votimit), sociale (duke lejuar një nivel të caktuar të rishpërndarjes së të ardhurave) dhe kombëtare (përputhja e kufijve të kombit me të shtetit).

e jetës së natës, mediet, shoqatat e qytetarëve dhe partitë politike janë të ndara në bazë të kriterëve etnike si "e jona dhe e tyre". Shpesh, këta kufij jo-fizik të ndarjeve sociale janë rritur më tepër duke futur pengesat fizike apo ndarjen e qyteteve. E gjithë kjo dëshmon se shoqëritë pluraliste me ndasi janë duke kaluar nëpër një krizë të përhershëm të unitetit shoqëror. Nëse gjatë rrjedhës së kohës ndasitë e segmentuara thellohen edhe më për shkak të konflikteve të luftës së kohëve të fundit, çdo përpjekje për të gjetur "horizontin e logjikës së shëndoshë" do të ballafaqohet me sfida serioze.

Kosova sot është një shembull paradigmatic i një shoqërie pluraliste, të ndarë dhe e dalë pas luftës. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, popullsia e Kosovës përfshin nëntë komunitete pakicë të cilat e përbëjnë rreth 7% të numrit të përgjithshëm të banorëve<sup>2</sup>. Shumë më e rëndësishme se numri dhe forca numerike e grupeve përkatëse etnike është fakti se këto janë format e diversitetit komunal. Bhikhu Parekh përdor këtë term në mënyrë që të nxjerr në pah ekzistencën e komuniteteve të qëndrueshme, jetëgjate, dhe ndërgjenerata të lidhura ngushtë me territorin ku ata banojnë (Parekh 2000, f. 4). Pjesëtarët e këtyre komuniteteve janë tejet të interesuar në ruajtjen e mënyrës së jetesës së tyre me qëllimin për ta transferuar atë tek brezat e ardhshëm. Për këtë qëllim, kërkohet një mbrojtje e jashtme nga shoqëria e gjerë, në formën e të drejtave kolektive.

Përveç pluralizmit, një tjetër tipar i rëndësishëm i strukturës demografike të Kosovës është ekzistenca e ndasive të thella në mes të komunitetit të shumicës etnike (shqiptarët) dhe komunitetit më të madh pakicë (serbë). Hulumtimi mbi nivelin individual të afërsisë dhe dallimeve në lidhje me grupet e tjera etnike në territorin e Kosovës zbulon këmbënguljen serbe me dekada të gjatë për stereotipe negative për shqiptarët dhe anasjelltas. Edhe pse distanca etnike është regjistruar qartë në sondazhet e kryera në kohën e RSF të Jugosllavisë, nuk ka dyshim se statusi ekzistues i marrëdhënieve ndëretnike është ndikuar vendosmërisht nga konflikti i luftës i shënuar me krime masive, brutalitet dhe shkatërrime. Në këtë kuptim, shoqëria kosovare vuan nga të gjitha "sëmundjet" tipike për shoqëritë pas-konfliktuale, kryesisht nga mungesa kronike e besimit dhe solidaritetit, ligjshmërisë së shkatërruar, ankthit dhe pasigurisë. E gjithë kjo ka thelluar më tepër "llogoret" e ndarjeve etnike, duke e shndërruar sferën e jetës së përditshme në fushë të "të vërtetave paralele".

Hulumtimi i zhvilluar në kuadër të projektit, rezultatet e të cilave janë të paraqitura në këtë vëllim, konfirmon një nivel jashtëzakonisht të lartë të distancës etnike mes pjesëtarëve të popullsisë së re shqiptare dhe serbe, që do me thënë, mes brezit që pritet në të ardhmen të marrë përsipër përgjegjësinë nga struktura aktuale e liderëve politikë. Kjo dëshmon se në mesin e pjesëtarëve të ardhshëm të shoqërisë elitë modeli i "frikës nga tjetri" ende do të mbahet me këmbëngulësi dhe do të riprodhohet, edhe kur nuk ka përvojë të këqija personale ose më shpesh edhe kur nuk ka fare ndonjë përvojë të komunikimit social. Me fjalë të tjera, për të shprehur veten si serb apo shqiptar në Kosovë nuk do të thotë vetëm të prezantosh karakteristikat që përshkruajnë përkatësinë etnike (dimension pozitiv i identitetit), por edhe ekzistencën e kontrasteve të forta negative kundër karakteristikave etno-kulturore të komunitetit shqiptar apo serb. Shumë më shpesh të supozuara se sa vërtetë ekzistuese,

---

2 Regjistrimi i përgjithshëm ka rezultuar me komunitetet pakicë si në vijim: serbë, boshnjakë, turq, romë, ashkali, egjiptianë dhe goran. Edhe pse regjistrimi nuk i ka paraqitur si grupe të veçanta etnike, komunitetet pakicë malazeze dhe kroate kanë qenë gjithashtu të pranishme. Të dhënat e marra nuk janë të plota meqë regjistrimi është bojkotuar në tërësi nga serbët e katër komunave të veriut të Kosovës, dhe pjesërisht nga serbët nga pjesët qendrore dhe jugore të Kosovës. E njëjta gjë vlen për një pjesë të madhe të anëtarëve të popullatës rome. Sipas vlerësimeve të organizatave jo-qeveritare ndërkombëtare, numri i saktë i popullsisë pakicë në Kosovë është ndërmjet 10 dhe 12%. Është vlerësuar se rreth 125,000 serbë jetojnë sot në Kosovë, prej të cilëve rreth 60.000 në veri. Një pjesë e popullatës serbe është ende në mërgim.

dallimet ngrehen në nivelin e qenies ontologjike, dhe në të njëjtën kohë ato bëhen pjesë e niveleve më të thella të kujtesës kolektive të cilat, si rregull, ndryshohen me vështirësi dhe ngadalë.

Çdo gjë që u tha deri më tani ilustron në mënyrën më të mirë të mundshme barrën e gjendjes së shoqërisë kosovare sot. Me pak fjalë, në kushtet e ekzistencës së identiteteve etnike të kundërta dhe reciprokisht veçuese është e nevojshme të gjendet një pikë minimale e besimit për jetë të përbashkët. Meqë pretendimet se patriotizmi kushtetues është kandidati më i përshtatshëm për këtë lloj të punës po bëhen gjithnjë e më të forta, qëllimi i këtij punimi është që të përdoret shembulli i Kosovës për të kuptuar nëse patriotizmi kushtetues në kuptimin normativ është në të vërtetë strategjia më e mirë për krijimin e një identiteti politik dhe krijimin e unitetit në shoqëritë pas-konfliktit, pluraliste, me ndasi të thella. Unë do të përiqem të tregoj se kapacitetet e integritit dhe motivimit të patriotizmit kushtetues janë të kufizuar kryesisht në kontekste pas konfliktit, dhe se nuk ka mjaftueshëm arsye për të paraqitur drejtimet e saja teorike si një formulë shpëtimtare për tejkalimin e ndasive të thella etnike. Megjithatë, para se të përballemi me supozimet normative të patriotizmit kushtetues me karakteristikat formuese të dinamikës sociale në Kosovë, unë do t'i referohem së pari argumenteve të autorëve të cilët mbrojnë patriotizmin kushtetues si një formë të rekomandueshme të lojalitetit politik dhe përkatësisë në shoqëritë multikulturore.

## **Patriotizmi kushtetues dhe diversiteti etno-kulturor**

Teza e patriotizmit kushtetues si zgjidhja më e përshtatshme për problemet e shoqërisë multikulturore nuk është e re. Kjo tezë u paraqit për herë të parë nga Jurgen Habermas, në kohën e të famshmit "konflikt të historianëve" (Historikerstreit) në vitin 1986, e që u rafinua më tej në tekstet e tij dhe paraqitjet publike gjatë viteve të 1990-ta. Në to Habermas, me një dozë të jashtëzakonshme të këmbënguljes akademike dhe erudicionit, mbron qëndrimin se regjimi i patriotizmit kushtetues – bazuar në dallimin mes një kulture të kuptuar gjerësisht e cilat nuk ka nevojë që të ndahet me të gjithë qytetarët dhe kulturën politike, karakterizuar nga respekti reciprok i të drejtave – lë hapësirë të mjaftueshme për bashkëjetesë të traditave të ndryshme kulturore brenda një shteti të vetëm. (Habermas 2003, f. 111-112).

Habermas është ndjekur nga shumë teoricienë tjerë politik të cilët janë përpjekur të provojnë se patriotizmi kushtetues, duke decentralizuar temën e përkatësisë patriotike nga vlera të padiskutueshme etike të kombit, arrin të përbëjë një bazë minimale të unitetit të shtetit politik aty ku nuk është e mundur të arrihet një marrëveshje substanciale mbi baza të jetës së përbashkët. Kështu Jan-Werner Muller pretendon se "nuk është e paarsyeshme të mendohet se patriotizmi kushtetues mund të jetë i rëndësishëm për krijimin e një rendi demokratik në shoqëritë ku dallimet në mesin e popullatës janë në rritje, ku kërkohet krijimi i një lloj minimumi qytetar, në mënyrë që të definohet mënyra e të jetuarit së bashku – dhe kush mund të marrë përkatësinë, dhe kujt duhet t'i mohohet përkatësia" (Muller 2010, f. 11). Premisa fillestare për argumentet e avokuesve të kësaj zgjidhje normative është se e mira e përbashkët politike në shoqërinë pluraliste nuk duhet të jetë ndonjë kulturë e veçantë etnike, por një regjim kushtetues të cilin qytetarët mund ta justifikojnë me njëri-tjetrin. Kjo, megjithatë, në asnjë mënyrë nuk do të thotë se patriotizmi kushtetues reduktohet në besnikërinë ndaj një kushtetute konkrete, siç përiqen ta paraqesin disa kritikë<sup>3</sup>. Regjimi kushtetues këtu kuptohet në një mënyrë shumë më të gjerë se sa qasje e pastër pozitiviste që është karakteristike për ligjin.

---

3 (Will Kymlicka) së pari gabimisht barazon patriotizmin kushtetues me besnikërinë ndaj kushtetutës si një sërë nenesesh, dhe në fund, në bazë të një interpretimi të tillë kufizues, arrin në përfundimin se patriotizmi kushtetues nuk është në gjendje të shpjegojë arsyet për jetesë të përbashkët të disa grupeve etnike brenda një shteti të vetëm. (Kymlicka 1996)

Qëndrimi për patriotizmin kushtetues si një strategji mbrojtëse e integritetit politik të shoqërive pluraliste është i pranishëm edhe në punën e autorëve nga territori i ish-Jugosllavisë. Ekzistojnë dy argumente kryesore të cilat e rekomandojnë patriotizmin kushtetues si një zëvendësim të nevojshëm për modelet nacionaliste të legjitimitetit të shoqërive post-jugosllave. Baza e argumentit të parë qëndron në pluralizmin etnik dhe fetar të shteteve të këtij rajoni. Milan Podunavac deklaroi se në kushtet e heterogjenitetit etnik dhe nacionalizmit të papërligjur, patriotizmi kushtetues është e vetmja formulë e drejtë e ndërtimit të identitetit kolektiv në Serbi. Ai synon "rindërtimin e rendit politik përtej shtetit-kombit dhe mundëson më shumë identitete të përhershme dhe lojalitet ndaj shtetit e që formësohet në fushën e parimeve politike dhe vlerave të dala nga vetë kushtetuta. Përmbajtja e patriotizmit kushtetues do të formohet nga vlerat dhe parimet e vlerës së pakufizuar dhe të paanshme për të gjithë qytetarët, të barabartë në lidhje me karakteristikat e veçanta të unitetit para-politik të anëtarëve të shtetit (traditat e veçanta dhe kombëtare), por edhe në lidhje me fushën republikane të institucioneve dhe proceseve demokratike." (Podunavac 2006, f. 90) Argumenti i dytë i referohet funksionit të "pastrimit" të patriotizmit kushtetues. Duke iu referuar përvojës së Gjermanisë së pasluftës, ku vënia publikisht në dyshim të së kaluarës në mbështetje të identitetit të ri politik gjerman në frymën e parimeve morale universale kontribuoi në rritjen e kohezionit social dhe solidaritetit, Nenad Dimitrijeviq pretendon se patriotizmi kushtetues mund të ketë një efekt të ngjashëm në shoqëritë post-kriminale në territorin e ish-Jugosllavisë. Patriotizmi kushtetues i kuptuar në një mënyrë të tillë është i bazuar në idenë e kushtetutës vetë-referuese, "parimet përkushtuese, jo-demokratike nga natyra, dhe universale të së cilës duhet qartazi të kenë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet tona në të tashmen dhe në të ardhmen, por forca e tyre në kontekst specifik dhe justifikimi duhet të rrjedhin nga reflektimi mbi krimin". (Dimitrijeviq 2010, f. 203).

Kur flasim për patriotizëm kushtetues në kontekstin e shoqërisë së Kosovës, argumentet e mëparshme marrin një dimension të ri. Siç me të drejtë vë në dukje Gëzim Krasniqi, rasti i Kosovës nuk është specifik vetëm për paraqitjen e fenomenit të një "kombi të de-institucionalizuar". Sfidë shumë më e madhe është ekzistenca e "komuniteteve të institucionalizuara", konkurrenca e ndërsjellë e të cilëve minon çdo përpjekje për të ndërtuar një ndjenjë më të lartë të identifikimit (Krasniqi 2012, f. 132). Pra, në këtë rast patriotizmi kushtetues thirret për të ndihmuar, jo sepse është i nevojshëm për të ndaluar mbështetjen institucionale për ndërtimin e vendit të shumicës, por më tepër për të korrigjuar efektet negative të garancive të tepërta të të drejtave etno-kulturore që akuzohen për krijimin e një gjendje të ngjashme me atë që Amartya Sen e përshkruan si monokulturalizmi pluralist (Sen 2006, f. 47). Duke marrë parasysh njërin anë të multikulturalizmit të Kosovës, ideologjia e vetme integruese në Kosovë, sipas Krasniqit, "mund të jetë ajo për të cilën Habermas flet si i patriotizmi kushtetues". (Krasniqi 2012 f. 132) Konkluzioni i ngjashëm mund të gjendet në raportin e përbashkët të Institutit Kërkimor për Çështje Evropiane dhe Zhvillim dhe Qendrës për Studime Ndërkombëtare e Universitetit të Oksfordit, duke theksuar se tensionet ndëretnike në Kosovë mund të tejkalohen vetëm me një këmbëngulje më të fortë për një zgjidhje në harmoni me "vlerat evropiane dhe konceptin e patriotizmit kushtetues të cilat së bashku përbëjnë themelin e projektit evropian" (Institutit Kërkimor për Çështje Evropiane dhe Zhvillim dhe Qendra për Studime Ndërkombëtare në Universitetin e Oksfordit, p. 12).

A mundet patriotizmi kushtetues të justifikoj pritjet normative të paraqitura si më lartë? Disa vëzhgime parimore shfaqen që në fillim të kërkimit në gjetjen e përgjigjes për pyetjen e paraqitur. Së pari, në një përmbledhje të literaturës përkatëse është e pamundur të shmanget përshtypja se patriotizmi kushtetues është përshkruar shumë lehtë si një ilaç universal për problemin e përkatësisë në shoqëritë pluraliste të demokracive liberale, shpesh pa ndonjë specifikim të mëtejshëm të argumenteve për të

mbështetur pretendimet e tilla. Së dyti, duket se të paktën një pjesë e arsyeve për një anim në modë për”produktin më të njohur të pas luftës së filozofisë politike të Gjermanisë” janë të bazuara në atë se patriotizmi kushtetues, që nga shfaqja e konceptit e deri më sot, për shkak të lidhjes së fortë me idenë e të drejtave të njeriut, gëzon reputacionin e”njeriut të mirë” të teorisë bashkëkohore politike e që është në kundërshtim me nacionalizmin”militant dhe ekskluziv”. Së fundi, ajo çka është befapsuese është se sa shpesh keqkuptohet përmbajtja e patriotizmit kushtetues, e cila gabimisht është reduktuar në grupin e normave liberale-demokratike, vlerave dhe procedurave, ndërsa humb nga perspektiva konceptin e kulturës politike, pa të cilën çdo patriotizëm kushtetues është një ide e pajetë e destinuar për të dështuar.

Duke marrë parasysh shënimet hyrëse, në pjesën tjetër të tekstit do të përpiqem të shqyrtoj themelin e tezës së një ”aleance të natyrshme” midis teorisë të patriotizmit kushtetues dhe shoqërive të ndara. Për fillim është e rëndësishme të theksohet se patriotizmi kushtetues në të gjitha versionet e tij, në radhë të parë synon t’i përgjigjet pyetjes së legjitimitetit të sundimit politik dhe jo pyetjes pararendëse të përbërjes së shtetit. Me fjalë të tjera, pikënisja është pyetja “Si dëshirojmë të jetojmë së bashku?”, ndërsa pyetja “Pse jemi së bashku?” konsiderohet tashmë e zgjidhur. Kjo më tej do të thotë se postulatet e teorisë së patriotizmit kushtetues mund t’i përkasin vetëm një hapësirë tanimë të lidhur politike, që mund të jetë rasti me shumicën e shteteve bashkëkohore, por në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet një fakt i vetëkuptuar, kur është fjala për shoqëritë e ndara. Edhe avokuesit më të zjarrtë të patriotizmit kushtetues e pranojnë se ai është i padobishëm në situata të shteteve të reja, meqë patriotizmi kushtetues në asnjë mënyrë nuk është”një teori e vetë-mjaftueshme e demarkacionit politik dhe për këtë arsye nuk i përgjigjet pyetjeve të vetëvendosjes politike të cilave teoritë rivale si nacionalizmi liberal mund të jetë në gjendje që t’u përgjigjet”. (Muller 2010, f. 59)

Çdo gjë që është thënë deri më tani ende nuk ofron bazë të mjaftueshme për kritikët e patriotizmit kushtetues që e përshkruajnë atë si një formë të maskuar të nacionalizmit. Patriotizmi kushtetues në masë të madhe nënkupton një logjikë të ndryshme të ndërtimit të identitetit politik në krahasim me çdo lloj tjetër të karakterit nationalist. Çështja është se forca normative e patriotizmit kushtetues mbështetet në supozimin se është e mundur (dhe e dëshirueshme) që shtetet ekzistuese të transformohen në shtete post-nacionaliste, por vetëm kur në”pikën e fillimit” të procesit transformues të ekzistoj një popull i cili është i lidhur disi, qoftë në nivel të ulët siç edhe ndodh zakonisht, me kulturë të përbashkët kombëtare<sup>4</sup>. Thënë më thjeshtë, nuk është e mundur të merret një vendim për organizimin e një shteti mbi bazën e patriotizmit kushtetues në qoftë se ata që preken nga vendimi i tillë nuk mendojnë për njëri-tjetrin si pjesëtarë të të njëjtit shtet. Megjithatë, ajo çka avokuesit e patriotizmit kushtetues duan të thonë është se është e mundur të transformohet baza fillestare etnike e jetesës së një shteti në një kulturë të përbashkët politike, arrijtet më të rëndësishme të së cilës do të shkruheshin në kushtetutë e që në këtë mënyrë bëhet simbol i vetëkuptimit kolektiv të komunitetit. Shteteve të sapo themeluar dhe në të njëjtën kohë me ndasi të thella u mungon pikërisht kjo lidhje fillestare integruese e që patriotizmi kushtetues në vetvete nuk mund ta ofroj. Prandaj patriotizmi kushtetues nuk duhet të keqkuptohet si një formulë magjike e besnikërisë patriotike e cila do të mbante së bashku shoqëritë me ndasi të thella, por më tepër si një strategji e aftë për të shmangur rreziqet morale të nacionalizmit në shoqëritë pluraliste të demokracive liberale, duke përfshirë rrezikun që shoqëritë e tilla, të udhëhequra nga koncepti esencializues i përkatësisë patriotike, në një pikë arrijnë deri në ndasi të thella.

4 Ky supozimi fillestar”i fshehur” i patriotizmit kushtetues shpjegon më së miri pse debatet aktuale teorike mbi zbatueshmërinë e tij në kushtet e pluralizmit etno-kulturor janë mbajtur kryesisht në fushën e shoqërive të emigrantëve. Këto janë shoqëritë ku pjesa më e madhe e popullsisë është e lidhur fort me ndjenjën e përkatësisë në kulturën e përbashkët kombëtare.

## Njëanshmëria e shtetësisë së Kosovës: Kushtetuta në sprovë

Duke marrë parasysh efektet e inxhinierisë kushtetuese dhe institucionale në Kosovë, konturet e kornizës së re politike mund të përshkruhen më së miri me ndihmën e nocioneve të "shtetit të papërfunduar" dhe "shoqërisë së dyfishtë". Edhe pse mungesa e verifikimit ndërkombëtar të shpalljes së pavarësisë (mbi të gjitha në formë të anëtarësimit në organizatat dhe shoqatat ndërkombëtare) me të drejtë është konsideruar një faktor kufizues i shtetësisë së Kosovës (Tansey 2007, f. 132-134), procesi i papërfunduar i shtetndërtimit ndër të tjera reflekton në mungesë të dukshme të fushës horizontale të marrëveshjes midis anëtarëve të shtetit të ri në lidhje me bazën e jetesës së tyre të përbashkët. Në vend të konsensusit themelor i cili në çdo shoqëri politike krijohet "përtej fushës së luftërave politike dhe pa të cilin është e pamundur të formohet politika si një fushë e lidhjes publike, paqësore dhe miqësore me akterët politik brenda një shteti" (Podunavac 2006, f. 87), ne kemi një mosmarrëveshje bazike sa i përket natyrës së marrëveshjes politike. Perceptimi i hapësirës së përbashkët politike siç shihet nga komunitetet kryesore etnike është krejtësisht ndryshe. Për një pjesë të popullsisë (shumicën) është një shtet i përfunduar për nga territori dhe sovran, ndërsa pjesa tjetër e popullsisë (pakica) tërësisht refuzon të respektojë kornizën ekzistuese politike si shtet, të paktën jo atij të cilit duhet t'i bindet politikisht.

Kufizimi i arritjeve të territorializimit të politikës, si dhe centralizimi i pushtetit administrativ, janë vetëm disa nga sindromat e shtetësisë së mohuar. Megjithatë, problem shumë më të madh paraqet mungesa e ideologjisë integruese e cila do të stimulonte identifikimin emocional të qytetarëve me tiparet e shpallura të identitetit të rendit juridik dhe politik të Kosovës. Për ndryshim nga aspektet teknike të organizimit të një shteti, çështja e identitetit i takon sferës së sjelljes emocionale politike e cila nuk mund të krijohet me "dokumente dhe vullë". Deklaratat e mësipërme konfirmohen më së miri nga rezultatet e procesit të negociatave që janë në vazhdim e sipër. Pavarësisht ndarjes administrativ me lirshëm të rregulluar të veriut të Kosovës, për shkak të marrëveshjeve në Bruksel, problemi i përkatësisë së identitetit mbeti i paprekur. Sigurisht, është joreale të pritet që çdo qytetar gjithmonë do të identifikohet me shtetin ku ai/ajo jeton; megjithatë, sigurisht që është situatë alarmante nëse e gjithë pjesa e popullsisë refuzon ta bëjë një gjë të tillë për një periudhë më të gjatë kohore. Në këtë rast ka bazë të flitet për një krizë të rëndë të legjitimitetit të shtetit.

Mangësitë e projektit të ndërtimit të shtetit mund të sqarohen edhe nga këndi i kushtetutshmërisë së fuqisë politike e cila në Kosovë shpaloset në baza të tri strategjive reciprokisht jokohërente të formësimit të identitetit kushtetues. Këto janë proceduralizmi liberal, multikulturalizmi dhe, në një formë shumë rudimentare, patriotizmi kushtetues<sup>5</sup>. Secila prej strategjive të përmendura më lart bazohet në të kuptuarit e ndryshëm të parimit të shtetësisë. Proceduralizmi liberal është i lidhur me shtetësinë "pasive", që nënkupton barazinë universale të gjendjes civile së bashku me një grup të të drejtave individuale, ku vlera më e lartë normative i atribuohet të drejtave civile të "brenzit të parë". Multikulturalizmi, në anën tjetër, bazohet në idenë e shtetësisë "të diferencuar sipas grupeve"

5 Tipari i përshkruar i dinamikës kushtetuese në Kosovë i përshtatet situatës në të cilën pothuajse të gjitha shtetet e hapësirës pas-jugosllave e kanë gjetur veten gjatë periudhës së tranzicionit politik dhe ekonomik. Siç na thotë Nenad Dimitrijeviq, kjo "dramë e kundërshtimeve të konfrontuara" është pasojat e faktit se "vendet post-komuniste duan çdo gjë që nuk ka ekzistuar deri më dje: lirinë e njeriut, demokracinë, ekonomi të tregut, drejtësi sociale (dhe të drejtat e pakicave). Së bashku, këto cilësi formojnë një shoqëri të hapur. Megjithatë, problemi është se cilësitë e mësipërme, nga njëra anë janë të gjitha të nevojshme këtu dhe tani, ndërsa në anën tjetër në zbatimin e tyre në praktikë shpesh dëshmojnë të jenë reciprokisht konfrontuese dhe përjashtuese." (Dimitrijeviq 2007, f. 110.)

dhe në këtë mënyrë shkel idealin liberal të uniformitetit të gjendjes civile. Dhe në fund, në zemër të patriotizmit kushtetues qëndron ideja republikane e qytetarit aktiv i cili, së bashku me qytetarët e tjerë, në mënyrë të pavarur nga identitetet e tyre të veçanta, ushtrojnë "lirinë politike".<sup>6</sup> Pra, këto janë pikënisje normative dukshëm të ndryshme dhe konkurruese, ku ngjashmëria e vetme në mesin e strategjive të paraqitura është përpjekja për të shmangur etnifikimin e parimit të qytetarisë. Pikërisht kjo karakteristikë e modelit aktual kushtetues çoi në protesta të komunitetit shqiptar. Ndryshe nga grupet etnike shumicë në shtetet fqinje, shumica shqiptare në Kosovë nuk kanë arritur, të paktën në nivelin e përkufizimit kushtetues, që të përfitojnë pozitën e tyre dominuese duke zbatuar formulën e nacionalizmit liberal. Kjo ka çuar në një situatë paradoksale ku të dy komunitetet etnike, shqiptare dhe serbe, secila për arsyt e veta, të e mohojnë zgjidhjen kushtetuese. Krasniqi përshkruan pakënaqësinë e dyfishtë me tekstin kushtetues në këtë mënyrë: "Në praktikë, shumë shqiptarë nuk mendojnë se Kosova (duke përfshirë edhe kornizën e saj ligjore dhe ikonografinë shtetërore) reflekton shumicën mbizotëruese shqiptare, ndërsa shumica e serbëve e konsiderojnë Kosovën si 'shtet shqiptar'. Kjo është arsyeja pse sot si shqiptarët ashtu dhe serbët ende favorizojnë simbolet e tyre kombëtare (ikonografinë shqiptare, respektivisht serbe) në krahasim me simbolet e reja të Kosovës." (Krasniqi 2012, 132) Prandaj nuk është për t'u habitur që proceset më intensive integruese në Kosovë ndahen në nivelin para-politik, brenda komuniteteve etnike konfrontuese dhe jo brenda një sfere të vetme politike. Pasoja e kësaj janë një lloj milletizimi i jetës shoqërore, pasi që individët së pari shikohen kryesisht si njësi etno-kulturore të cilët ekzistencën e tyre ua detyrojnë komunitetit etnik në të cilin ata kanë lindur<sup>7</sup>. Në konstelacion të tillë të marrëdhënieve ndëretnike shteti gradualisht humb statusin e pavarur moral dhe të bëhet një kornizë e pavlerë për bashkëjetesën e botëve të ndara kulturore. Pikërisht për këtë arsye, Kosova sot është shumë më afër modelit të shtetit të dyfishtë, ngjashme me skenarin kushtetues të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Maqedonisë, se sa idealit të një shteti unitar me administratë të decentralizuar.

## **Shënime përmbyllëse: a është (megjithatë) patriotizmi kushtetues i mundur në Kosovë?**

Duke marrë parasysh vërejtjet e paraqitura deri më tani, ajo që vijon është përpjekja jonë për të përmbledhur argumentet nga kapitujt e mëparshëm. Çka duhet pasur parasysh mbi të gjitha gjatë shqyrtimit të mundësive për zbatimin e patriotizmit kushtetues në shoqëritë e ndara si Kosova është (mos)ekzistenca e një pikë referuese për jetesë të përbashkët e cila me kohë do duhej të sillte një kulturë politike. Këtu unë kujtoj se një parakusht i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e patriotizmit kushtetues është që çdo qytetar të socializohet në një kulturë të përbashkët politike. Në mënyrë që kjo të ndodhë, siç me të drejtë Muller e ka paraqitur (Muller 2010, f 70-72), është e nevojshme që të ketë "pajisje speciale" që do ta konsolidonin idenë e kushtetutshmërisë në shtetin e caktuar. Me pak fjalë, është e

---

6 Konturet e patriotizmit kushtetues janë të pranishme në përpjekje për të "liruar" simbolet dhe rritualët e përkatësisë nga preferencat etnike të qytetarëve.

7 Modeli Millet për organizimin e marrëdhënieve shumicë-pakicë ka një traditë të gjatë në këtë territor. Në sistemin e milletit i cili ka ekzistuar në Perandorinë Osmane, grupe të caktuara fetare kanë gëzuar nivel të lartë të autonomisë në ushtrimin e zakoneve dhe praktikave të tyre fetare, sigurisht brenda kufijve të komunitetit të tyre fetar. Shtrirja e të drejtave dhe detyrave të secilit individ kryesisht varej nga millet i të cilit ai i përkiste. Milletet kanë funksionuar si lloj oazash për autonomitë kulturore, pa pasur shumë kontakte dhe përhapje mes tyre. Përshtypja është se shumë probleme aktuale në zbatimin e politikave multikulturore në Ballkan janë pasoja të faktit se të drejtat etno-kulturore edhe sot kuptohen shpesh si një mjet për vetë-getoizim të grupeve etnike.



nevojshme të gjendet një instancë minimale e përbashkët për vlerësimin e marrëdhënieve tona të cilat do të mbaheshin së bashku me mospajtime të pritshme dhe të arsyeshme për zbatimin më të mirë të mundshëm të idesë së kushtetutshmërisë, madje edhe kur idetë tona të jenë krejtësisht të ndryshme sa i përket asaj se si duhet të jenë dispozita të caktuar të marrëveshjes kushtetuese.

